REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 42, Datë 29.03.2024

MBI

MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-S "GJENDJA E SEKTORIT TË ENERGJISË DHE VEPRIMTARIA E ERE-S GJATË VITIT 2023"

Në zbatim të nenit 25 të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*" i ndryshuar dhe nenit 21 të ligjit nr. 102/2015 "*Për sektorin e gazit natyror*" i ndryshuar; nenit 5, pika "d" të *Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 199, datë 27.11.2020; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2026; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.03.2024, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës dhe Sekretari i Përgjithshëm me nr. 850/1 prot., datë 29.03.2024, "*Për gjendjen e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2023",*

Konstatoi se:

- ERE në zbatim të parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar dhe nenit 21 të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" i ndryshuar, paraqet në Kuvend raportin vjetor mbi situatën e sektorit të energjisë elektrike, gazit natyror dhe veprimtaritë e ERE-s për vitin paraardhës brenda datës 31 Mars.

- Nga Drejtoritë Teknike të ERE-s u morën masat për fillimin e punës për përpunimin dhe analizimin e të dhënave të mbledhura nga të licencuarit me qëllim hartimin e raportit vjetor, brenda afatit të përcaktuar, datë 31 Mars 2024.

- Raporti Vjetor i Entit Rregullator të Energjisë, pasqyron veprimtarinë e ERE-s, sa i përket monitorimit të ecurisë së sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, veprimtarinë e të licencuarve dhe mbikëqyrjes së të drejtave të klientëve të energjisë, si dhe ecurinë e punës së Entit Rregullator të Energjisë në hartimin e rishikimin e legjislacionit me qëllim adresimin e detyrimeve ligjore të ERE-s, por edhe rregullimit të marrëdhënieve mes të licencuarve dhe klientëve në sektorin e energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Raportit Vjetor të ERE-s "Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2023", që do t'i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë. (Raporti bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

RAPORT VJETOR

Gjendja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2023

Tiranë, 2024

1. Tabela e Përmbajtjes

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SEKTORIN E ENERGJISË NË VENDIN TONË PËR VITIN 2023 14

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE PËR VITIN 2024-2026 31

1. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE 44

1.1. Situata e Sektorit Elektro-energjitik Shqiptar 44

1.2 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE 47

1.2.1 Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2023 48

1.2.2 Të dhënat teknike kryesore dhe prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese publike për vitin 2023 52

1.2.3 Gjendja e TEC-it Vlorë 58

1.2.4 Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese private të pavarura dhe ato me përparësi 59

1.2.5 Prodhimi nga centralet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2023 60

1.2.6 Prodhimi i energjisë elektrike sipas rrjetit ku janë lidhur centralet prodhuese 61

1.3 TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE 65

1.3.1 Bilanci energjitik 66

1.3.2 Veprimtaria e OST sh.a. 68

1.3.2.1 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit 68

1.3.3 Gjendja e përgjithshme e Sistemit Elektroenergjitik referuar raportimit të OST sh.a. 73

1.3.4. Operimi i zonës së përgjegjësisë së OST-së 75

1.3.4.1. Sistemet e Kontroll - Monitorimit Automatik 77

1.3.4.2 Menaxhimi i fluksit të energjisë 78

1.3.4.3 Analiza e kontigjencave dhe trajtimi 78

1.3.4.4 Menaxhimi i qëndrueshmërisë dinamike 79

1.3.4.5. Balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë 5-vjeçare 79

1.3.4.6. Niveli i pritshëm i kërkesës dhe prespektivës së sigurisë së furnizimit për një periudhë 5 deri në 20-vjeçare 80

1.3.4.7. Kapaciteti shtesë prodhues i propozuar, i planifikuar apo në fazë ndërtimi 82

1.3.4.8. Parashikimi i investimeve për 5 (pesë) vitet e ardhshme, që OST sh.a. apo çdo palë tjetër planifikon të realizojë në lidhje me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkoneksionit 87

1.3.4.9. Modelet e pritshme të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit, si dhe marrja e masave për menaxhimin e kërkesës për energji elektrik 88

1.3.4.10. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të rrjetit të transmetimit në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian 89

1.3.4.11. Informacion i hollësishëm i OST, për investimet e parashikuara për linjat e interkoneksionit dhe për ndërtimin e linjave të brëndshme të rrjetit, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në linjat e interkoneksioneve ndërkufitare. 89

1.3.4.12. Cilësia dhe niveli i mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit 91

1.3.4.13. Masat e marra nga OST sh.a. për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike, si dhe për rritjen e sigurisë së furnizimit në rast nevoje 92

1.3.4.14.Plani i sistemit të mbrojtjes së OST sh.a. në rast të një situate emergjente 93

1.3.4.15. Plani i Sistemit të Mbrojtjes në rast të Situatës në Emergjencë 94

1.3.4.16. Masat e Planit të Mbrojtjes të Sistemit 94

1.3.4.17. Masat e marra per garantimin e gadishmërisë dhe sigurisë së sistemit brenda të gjithë kufijve operativë, përfshirë sistemet primare dhe ato sekondare, si edhe përsa i përket sigurisë kibernetike dhe infrastrukturave kritike 96

1.3.4.18. Masat për sigurinë kibernetike dhe infrastrukturave kritike të ndërmara nga OST sh.a. 96

1.4. SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE 97

1.4.1 Veprimtaria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.) 97

1.4.2 Konsumi i energjisë elektrike 100

1.4.3 Struktura e konsumit të energjisë elektrike 2023 102

1.4.4 Profili i konsumit të energjisë elektrike 104

1.4.5 Treguesit e energjisë elektrike të furnizuar, shitur dhe humbur, për çdo zonë dhe agjenci të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2023 107

1.4.6 Efektiviteti i shitjes së energjisë elektrike 111

1.4.7 Asetet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike 118

2. TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE 120

2.1 Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike 120

2.1.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike 120

2.1.2 Monitorimet periodike të OST sh.a. 122

2.1.3 Disbalancat në tregun e energjisë elektrike 123

2.1.4. Mbikëqyrja e të Licencuarve Gjatë Vitit 2023 124

2.1.5 Transaksionet e kryera nga KESH sh.a., në Treg të liberalizuar (parregulluar) gjatë vitit 2023 125

2.1.6 Rekomandime për operatorët dhe pjesëmarrësit e tregut nga monitorimet 128

2.2 Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT) 129

2.2.1 Detyrime që lindin nga Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT).....129
2.2.2 Monitorimi dhe regjistrimi i pjesëmarrësve në treg në zbatim të rregullorës REMIT 129
2.2.3 Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut sipas REMIT 129
2.2.4. Monitorimi i zbatimit të detyrimeve sa i takon sigurisë kibernetike per vitin 2023 130
3. BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE (ALPEX) 134
3.1. Ecuria e Krijimit të Bursës Shqiptare të Energjisë ALPEX sh.a. 134
3.2. Operimi i Bursës Shqiptare të Energjisë 135
3.3. Anëtarësimi në Bursë për zonën e ofertimit Shqipëri 135
3.4. Anëtarësimi në Bursë për zonën e ofertimit Kosovë.....136
3.5. Operimi i tregut. 136
3.6. Klerimi dhe shlyerja 137
3.7. Bashkimi i tregjeve të ditës në avancë Shqipëri-Kosovë 137
3.8. Të dhënat e tregtimit dhe klerimit 139
4. LICENCIMI, DHËNIA E AUTORIZIMEVE DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARIVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE GJATË VITIT 2023 142
4.1 Licencimet dhe kërkesat e trajtuara gjatë vitit 2023 142
4.2 Licensimi në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....144
4.3 Licensimi në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....145
4.4 Njohje e Licensave 146
4.5 Licencimi në aktivitetet e Gazit Natyror 149
4.6 Kërkesat për të cilat është vendosur mosfillimi i procedurës ose refuzimi i dhënies së miratimit nga ERE.....149
4.7 Dhënia e Autorizimeve nga ERE per vitin 2023.....150
4.8. Dhënia e Garancive të Origjinës 150
4.9. Përcaktimi i Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).....151
4.10. Raporti vjetor i Pajtueshmërisë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (OST sha).....151
4.11. Raporti vjetor i Pajtueshmërisë i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSSH sha 152
5. AKTIVITETI I ERE-s NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË TARIFAVE DHE ÇMIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR.....153
5.1. Vlerësimi i aktiviteteve të shoqërive të rregulluara si dhe Shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin 2023. 153

5.1.1. Aktiviteti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023. 154

5.1.2. Lidhur me aplikimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike për përcaktimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike. 154

5.1.3 Lidhur me miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal 155

5.1.4. Mbi përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2023 156

5.1.5 Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2023 për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. 161

5.1.6. Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga Shoqëria Albgaz sh.a. për vitin 2024 162

5.1.7. Mbi propozimin për Miratimin e metodologjisë për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX dhe Miratimin e listës së Tarifave. 163

5.2 Përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2023 164

5.2.1. Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike për vitin 2023. 164

5.2.2. Në lidhje me çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2023. 165

5.3 Kosto e blerjes së energjisë elektrike në zbatim të kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për vitin 2023 166

5.3.1 Kosto e blerjes së energjisë elektrike nga “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. 166

5.3.2 Kosto e blerjes së energjisë elektrike nga “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2023 167

5.4 Hartimi, Rishikimi dhe Miratimi i Metodologjive të llogaritjes së tarifave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. 169

5.4.1 Metodologjia për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike. 170

5.4.2 Metodologjia për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX” 170

5.5. Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE dhe çmimet e energjisë elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2023 171

5.5.1 Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE 171

5.5.2. Çmimet e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2023 172

6. RREGULLIMI I SEKTORIT TË GAZIT NATYROR 174

6.1. Ecuria e Furnizimit me Gaz në Botë dhe Pozicioni i Strategjik i Vendit Tonë 174

6.2. Konsumi i Gazit Natyror 174

6.3. Prodhimi i Gazit Natyror në Bashkimin Europian 176

6.4. Eksporti dhe Importi i Gazit natyror me Tubacione 177
6.5. Importet e LNG-së 177
6.6. Çmimet e gazit me shumicë 177
6.7. Çmimet e gazit me pakicë. 178
6.8. GAZSJELLËSI TRANS ADRIATIK (TAP) – GREQI, SHQIPËRI, ITALI 179
6.8.1. Aksionerët e Kompanisë TAP 179
6.8.2. Veprimtaria e TAP gjatë vitit 2023 179
6.8.3. Rishikimi i Kodit të rrjetit nga TAP dhe Bashkëpunimi me Rregullatorët 180
6.8.4. Ndryshimet në Liçencën e Transmetimit 182
6.8.5. Përmbushja e detyrimit për informimin e klientëve dhe marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit 182
6.8.6. Zhvillimet e operacioneve tregtare dhe produktet e reja 184
6.8.7. TAP një projekt strategjik për Shqipërinë dhe Europën Jug-Lindore 186
6.9. Vendimet e Miratuara nga ERE gjatë vitit 2023 për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e gazit natyror. 187
6.10. Situata dhe Veprimtaria e ALBGAZ sh.a. përgjatë Vitit 2023 190
6.11. Zhvillimet e fundit në sektorin e gazit 190
6.12. Objektivat që synohen të arrihen ne sektorin e gazit 192
6.13. Projektet e targetuara nga ALBGAZ sh.a. 192
6.14. Tubacioni Fier-Vlorë-Fier (Interkoneksioni me TAP) 192
6.15. Seksioni i IAP: Fier-Kashar 193
6.16. Seksioni i IAP: Kashar-Mali i Zi 193
6.17 Depozita nëntokesore Dumrea. 193
6.18. Gazifikimi i qytetit të Korçës 194
6.19. Plani i Investimeve te ALBGAZ 2023-2032 194
6.20. Hidrogjeni 195
6.21. Situata Aktuale-Konteksti i Përgjithshëm në sektorin e gazit 195
6.22. Shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe rregullator 196
6.23 Terminali GNL në Vlorë. 198
6.24 Ionian Adriatic Pipeline (IAP) 198
6.24.1. Seksioni i IAP: Fier-Kashar 198
6.24.2. Seksioni i IAP: Kashar-Mali i Zi 199
6.25. Objektiva për të Ardhmen në Sektorin e Gazit Natyror 199

7. MBI RAPORTIMIN E ERE NË LIDHJE ME ZBATIMIN DHE NDJEKJEN E PLOTËSIMIT TË REKOMANDIMEVE TË "REZOLUTËS SË KUVENDIT TË

SHQIPËRISË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ERE PËR VITIN 2022 201

8. AKTIVITETI I ERE NË ZHVILLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKONDAR DHE NDRYSHIME TË TJERA LIGJORE TË NDODHURA GJATË VITIT 2023 206

8.1 Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të zbatimit te ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar 206

8.2. Vendimet kryesore te ERE-s në Sektorin e Energjisë Elektrike për Vitin 2023 206

8.3. Proceset gjyqësore në të cilat ERE ka qenë palë gjatë vitit 2023 212

8.4. ERE në cilësinë e palës së tretë 212

8.5. ERE në cilësinë e palës paditëse 212

8.6. ERE në cilësinë e palës se paditur 213

8.7. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve 214

9. AKTIVITETI I ERE NË FUSHËN E MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE 216

9.1. Veprimtaria e ERE Për Mbrojtjen e Konsumatorit. 216

9.1.1. Ankesat Për Mbifaturimin e Energjisë Elektrike 218

9.1.2. Ankesat Për Dëm Ekonomik 218

9.1.3. Ankesat Për Vlera Referuese 219

9.1.4. Ankesat Për Kontratë Fiktive 220

9.1.5. Ankesat e Konsumatorëve Për Lidhje të Re 220

9.1.6. Ankesat Për Ndryshim Tarifimi 220

9.1.7. Ankesa të ndryshme 221

9.2.Ankesat e Trajtuara nga FSHU sh.a. 222

9.3. Masat e marra për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga "Plani i masave për furnizuesin e shërbimit universal për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike" miratuar me Vendimin nr. 201, datë 03.09.2018, i ndryshuar. 225

9.4. Ankesat e Konsumatorëve Në Treg të Lirë 225

9.5. Dhënia Zë e Konsumatorit 226

9.6. Konsumatorët Në Treg Të Lirë 228

9.7. Lidhjet e Reja Në Transmetim 228

9.8. Lidhjet e Reja në Rrjetin e Shpërndarjes 230

9.9. Standardet e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit .230

9.9.1. Standardet Për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancën e Sigurisë së Rrjetit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike 230

9.9.2. Standardet e Matjes Për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes 233

9.10. Konsumatorët/Vetëprodhuesit e Energjisë Elektrike 234
9.11. Makinat Elektrike 236
10. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ERE 237
10.1 Marrëdhëniet Ndërkombëtare 237
10.2 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare ne Organizma Ndërkombëtar 237
10.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s 238
10.4 Marrëdhenit me Publikun 238
10.5 ERE në marrëdhëniet ndërinstitucionale 240
11. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ERE DHE ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE 242
11.1.Organizimi dhe Funksionimi i ERE 242
11.2. Rekrutimi dhe Trajnimi i Stafit në ERE 243
11.3. Zbatimi i Rregulloreve Përgjatë vitit 2023 245
12. ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE TË ERE GJATË VITIT 2023 247
SHTOJCA 1. Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare 249
SHTOJCA 2. Raporti i Performancës 250

Tabela e Figurave

Figura 1. Platforma PCT 21
Figura 2. Skema e Sistemit Elektroenergjitik 45
Figura 3. Skema e Fluksit të Energjisë dhe Tregtar 46
Figura 4. Të dhëna mbi prodhuesit për vitin 2023 48
Figura 5. Prodhimi neto vendas për vitin 2023 49
Figura 6. Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2023 (MWh) 50
Figura 7. Prodhimi mujor vendas për vitin 2023 krahasuar me mesataren e periudhës 2009-2023 51
Figura 8. Prodhimi neto vendas historik për periudhën 2009-2023 në raport me mesataren e prodhimit për këtë periudhë 51
Figura 9. Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik 52
Figura 10. Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit 53
Figura 11. Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2023 54
Figura 12. Shkarkimet e Ujit nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (2002-2023) 54
Figura 13 Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2023 (m) 55
Figura 14. Niveli i Liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2023 56
Figura 15. Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2023 56
Figura 16. Prurjet mesatare mujore (m3/sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2023 krahasuar me mesataren historike 57
Figura 17. Rezerva Energjitike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2023 58
Figura 18. Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi dhe ato të pavarur për vitin 2023 59
Figura 19. Të dhëna mbi prodhuesit me përparesi për vitin 2023 59
Figura 20. Të dhëna mbi prodhuesit e pavarur për vitin 2023 60
Figura 21. Impiantet fotovoltaikë viti 2023 60
Figura 22 .Prodhimi nga Impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2023 61
Figura 23. Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2023 62
Figura 24. Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2023 65
Figura 25. Bilanci Energjitik i OST sh.a. për vitin 2023 krahasuar me atë të viteve 2015 - 2023 (MWh) 66
Figura 26 Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjitik shqiptar për vitin 2023 67
Figura 27. Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë. 69
Figura 28. Skema e Sistemit të Transmetimit Shqiptar 70
Figura 29. Skema njëfazore e Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar në nivelin 400-220-150-110kV. 71
Figura 30. Kapaciteti i instaluar sipas nenstacioneve (MVA) 72

Figura 31. Balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për periudhën 2024 - 2028 80
Figura 32. Parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për periudhën 2021 – 2042 81
Figura 33. Skenarët e parashikimi të kërkesës për energji elektrike 81
Figura 34. Vlerat Max dhe Min të Importit dhe Eksporit në kapacitete transmetuese 87
Figura 35. NTC Modelet e pritshme të prodhimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit 88
Figura 36. Avaritë në sistemin e transmetimit 92
Figura 37. Treguesit kryesorë të OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe FTL sh.a. gjatë vitit 2023 99
(Raportuar nga OSHEE Group sh.a.) 99
Figura 38. Konsumi total i energjisë elektrike në vend ndër vite 100
Figura 39. Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës import-eksport në konsumin total të energjisë elektrike në Shqipëri 101
Figura 40. Komponentët për mbulimin e konsumit dhe komponentët e konsumit të energjisë elek. siguruar për vitin 2023 102
Figura 41. Shpërndarja e klientëve të OSSH sh.a. sipas rajoneve dhe kategorive gjatë vitit 2023 102
Figura 42. Shpërndarja e numrit të klientëve 2023 sipas kategorive (%) 103
Figura 43. Raportet e faturimit sipas kategorive të klientëve gjatë vitit 2023 103
(Burimi: FSHU sh.a.) 103
Figura 44. Klientët familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite 104
Figura 45. Konsumi mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2023 105
Figura 46. Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2023 105
Figura 47. Profili dhe piku i ngarkesës në Shkurt 2023 (MW) 106
Figura 48. Profili dhe minimumi i ngarkesës në Janar 2023 (MW) 106
Figura 49. Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo agjenci të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2023 107
Figura 50. Shpërndarja e furnizimit me energji elektrike sipas drejtorive rajonale (%) 108
Figura 51. Shpërndarja e humbjeve të energjisë elektrike sipas drejtorive rajonale (%) 108
Figura 52. Humbjet mujore/vjetore në sistemin e shpërndarjes, krahasuar me targetin e humbjeve të energjisë elektrike 109
Figura 53. Sasia në furnizim dhe humbje të energjisë elektrike në rajonet e agjencitë e rrjetit të shpërndarjes 110
Figura 54. Bilanci Elektroenergjitik i vitit 2023 sipas raportimeve të OST dhe OSSH sh.a. 111
Figura 55. Humbjet vjetore në sistemin e shpërndarjes në periudhën 2009-2023 112
Figura 56. Grafiku i humbjeve vjetore në sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2023 112
Figura 57. Humbjet vjetore në sistemin e shpërndarjes në periudhën 2009-2023 113
Figura 58. Niveli i arkëtimeve mujore në periudhën 2011-2023 113
Figura 59. Arkëtime totale vjetore 2011 – 2023 114

Figura 60. Ecuria e treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (%) 115
Figura 61. Efektiviteti i shitjeve të FSHU sh.a. / OSHEE Group sh.a., 2009-2023 116
Figura 62. Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergjitik kundrejt konsumit 117
Figura 63. Faturimi/arkëtimi 2009-2023, me TVSH 118
Figura 64. Të dhëna mbi asetet kryesore të OSSH sh.a. 119
Figura 65. Të dhëna mbi Ankandet e Alokimit të Kapaciteteve në Sistemin e Transmetimit gjatë vitit 2023 123
Figura 66. Disbalancat totale për vitin 2023 (MWh) 124
Figura 67. Transaksionet e kryera gjatë vitit 2023 nga KESH sh.a. 127
Figura 68 Balanca Import – Eksport e energjisë elektrike në vite 128
Figura 69. Regjistri i pjesëmarrësve të tregut sipas REMIT 2023 130
Figura 70.Të dhëna mbi ofertat dhe blerjet – shitjet në ALPEX sh.a. 137
Tabela 71. Të dhënat e Tregut të Ditës në Avancë 139
Tabela 72. Faturimet (blerje-shitje) 139
Tabela 73. Volumet e tregtuar në MWh 140
Tabela 74. Çmimi Klerues orar në €/MWh - 2023 140
Tabela 75. Volumet në MWh 140
Tabela 76. Të dhënat krahasimore të çmimeve mesatare të nxjerra ne tregun vendas me ato të Burses Hungareze HUPX. 141
Tabela 77. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike 147
Tabela 78. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror 148
Tabela 79. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e e tregtimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror 148
Tabela 80. Nr. i licencave të miratuara për çdo veprimtari sipas viteve 149
Figura 81. Çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për klientët 35 kV për vitet 2022 – 2023 157
Figura 82. Kurba lëvizëse e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të miratuar nga ERE për vitet 2022-2023 158
Figura 83. Realizimi i treguesve të FMF për vitet 2022 - 2023. 159
Figura 84. Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për mbulimin e nevojës së klientëve FMF të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për periudhën 2022 – 2023 159
Figura 85. Kurba lëvizëse e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga FMF, për vitet 2022-2023 160
Figura 86. Realizimi i treguesve të FMF për vitet 2022 - 2023 , për klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV 161

Figura 87. Çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga FMF sipas nivelit të tensionit për vitin 2023 , për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime 162
Figura 88 Sasia e energjisë së shitur dhe të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike të FSHU sh.a. 167
Figura 89. Struktura e sasisë së blerë për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2023-2022 168
Figura 90. Struktura e shpenzimeve të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2023 - 2022 168
Figura 91. Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike të miratuara ndër vite periudhën 2012 - 2023. . 171
Figura 92. Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për periudhën 2012 – 2023. 172
Figura 93. Çmimet e energjisë elektrike të klientëve jo-familjarë në vendet e rajonit për vitin 2023 173
Figura 94. Çmimet e energjisë elektrike të klientëve familjarë në vendet e rajonit për vitin 2023 173
Figura 95. Konsumi i gazit në BE 175
Figura 96. Ndryshimi nga viti në vit në konsumin e gazit të BE-së në çdo tremujor ne (%) 175
Figura 97. Ndryshimi nga viti në vit në konsumin e gazit në tremujorin e parë të 2023 176
Figura 98. Prodhimi mujor i gazit në BE 176
Figura 99. Skenarët e ofertës globale të LNG kundrejt kërkesës për vitet 2023-2024 177
Figura 100. Vendosja e TAP në hartë 180
Figura 101. Krahasimi i vëllimit të gazit natyror të transmetuar përmes Shqipërisë në vitin 2023 me vëllimin e transmetuar në vitin 2022. 185
Figura 102. Zgjerimi i kapacitetit të projektit TAP 187
Figura 103. Ankesat e rregjistruara 217
Figura 104. Ankesat që janë adresuar nëpërmjet ERE, për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 217
Figura 105. Niveli zgjidhshmërisë së ankesave 222
Figura 106. Ndryshimi në numrin e ankesave të adresuara pranë Furnizuesit dhe performancën e tij gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022. 223
Figura 107. Të dhënat 5 vjeçare të kontratave të reja të lidhura në rrjetin e shpërndarjes. 224
Figura 108. Furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të lirë 228
Figura 109. Numri i aplikimeve në njësi të lidhura 229
Figura 110. Aplikimet për lidhjet e reja dhe shtesë fuqie. 230
Figura 111. Standartet e cilësisë së OST sh.a dhe ato të miratuara nga ERE. 231
Figura 112. Performanca e OST sh.a dhe ato të miratuara nga për vitin 2023 231
Figura 113. Key Performance Indicator (Treguesit kryesorë të performancës) nga OST sh.a. 232
Figura 114. Treguesit e cilësisë së OST sh.a. 5 vitet e fundit 233
Figura 115. Treguesit e realizuar nga OSSH sh.a për 2022, 2023 dhe treguesit e miratuar nga ERE 233
Figura 116. Krahasim i Performances së OSSH sh.a në TL+TM+TU 2022-2023 Lidhur me Treguesit Kryesore SAIFI, SAIDI, CAIDI 234

Figura 117. Kategoria e kontratave të cilat kanë të instaluar në rrjetin e shpërndarjes panele fotovoltaike 235
Figura 118. Struktura Organizative e ERE-s 242
Figura 119. Pjesëmarrja gjinore në ERE 243
Figura 120. Buxheti i ERE-s për vitin 2024 248

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SEKTORIN E ENERGJISË NË VENDIN TONË PËR VITIN 2023

Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti i vetem rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror në Shqipëri, i cili funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, Ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar, Ligjin nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", si dhe akte të tjera ligjore të miratuara në zbatim të tyre.

Bordi i ERE-s, është organi vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ERE-s dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisëë elektrike", i ndryshuar, përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen në detyrë nga Kuvendi i Shqipërisë me një mandat 5 vjeçar.

ERE ndër objektivat e vet kryesore rendit, (i) promovimin e krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë, (ii) bashkëpunimin me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera, (iii) krijimin e kushteve lehtësuese për futjen në rrjet të kapaciteteve të reja prodhuese, si dhe heqjen e barrierave që mund të pengojnë futjen e pjesëmarrësve të rinj të tregut dhe atyre që prodhojnë nga burimet e rinovueshme, (iv) angazhimin në zhvillimin e një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm, jodiskriminues dhe në mbrojtje të konsumatorit, në përputhje me objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike, efiçencës së energjisë elektrike, si dhe integrimitnë shkallë të gjerë të prodhimit të energjisë nga burimet e energjisë së rinovueshme

ERE gjithashtu në fushën e veprimtarisë së vet kryen licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në sektor, monitoron tregun e energjisë, harton kuadrin rregullator, shqyrton në përputhje me metodologjitë respektive aplikimet e tarifave dhe çmimeve, e nëpërmjet autoritetit vendimmarrës të saj dhe në zbatim të ligjit, vepron rast pas rasti duke e shprehur vullnetin nëpërmjet vendimmarrjeve të Bordit.

Raporti mbi "Gjendjen e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtarinë e ERE-s gjatë vitit 2023", është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 43/5015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar dhe Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar.

Raporti paraqet në mënyrë të detajuar të dhëna mbi ecurinë e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror për vitin 2023, si dhe krahasimet e disa prej treguesve kryesor të këtij viti me vitet paraardhës.

Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria publike KESH sh.a. dhe shoqëria HEC Lanabregas sh.a. të cilat janë shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore, si dhe nga subjektet private të licencuara në këtë aktivitet të tille.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në vendin tonë deri më 31 Dhjetor 2023 është rreth **2,675** MW. Ky kapacitet ka pasur një nivel rritje në vitin 2023 prej rreth **26 MW.**

Centralet e prodhimit të energjisë elektrike janë të lidhura si në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike ashtu dhe në rrjetin e shpërndarjes. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2023 është rreth 2,288 MW, dhe Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2023 është rreth 382 MW.

Prodhimi total neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2023 është **8,795,637** MWh, nga i cili **5,131,482** MWh u prodhua nga centralet në zotërim të kompanisë publike KESH sh.a., dhe **3,664,155** MWh u prodhua nga centralet e tjera.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2023, nga KESH sh.a. zë **58.3 %** të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë rreth **41.7 %.**

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2023 me sasinë e prodhuar prej 8,796 GWh, rezulton mbi mesataren e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023. Mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023 ka rezultuar 6,770 GWh. Prodhimi i realizuar për vitin 2023 është rreth 2,026 GWh, ose 30 % më i lartë se mesatarja e prodhimit te energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023.

Viti 2023 konsiderohet si një vit i mirë hidrologjik nga pikëpamja e prodhimit të energjisë elektrike, i cili për këtë vit ka rezultuar në sasinë **8,796** GWh, pra **2,026** GWh më shumë se prodhimi mesatar i energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2023.

Transmetimi i Energjisë Elektrike në Shqipëri kryhet nga OST sh.a. nëpërmjet sistemit të transmetimit i cili perfshin rrjetin e tensionit të lartë 400 kV, 220 kV, 150 kV, dhe 110 kV. Energjia totale e transmetuar ne sistemin e transmetimit për vitin 2023 rezulton 10,148 GWh, pra me një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2022 që ka rezultuar në vlerën 9, 547 GWh.

Rrjeti i transmetimit në të gjitha nivelet e tensionit 400 kV, 220 kV, 150 kV zotëron 3, 478.5 Km linja dhe 15 nënstacione transformuese me fuqi totale të instaluar prej 4621 MW.

Niveli i humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit për vitin 2023 është 220 GWh ose 2.17 % e energjisë elektrike të transmetuar.

Shpërndarja e energjisë elektrike në vendin tonë kryhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i cili ka në pronësi asetet në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, me qëllim lëvrimin e energjisë elektrike tek klientët.

OSSH sh.a. është organizuar në 11 zona shpërndarjeje dhe 42 agjenci. Sipas të dhënave të OSSH sh.a., energjia totale e hyrë në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2023 është **7,084,213 MWh**, nga e cila **1,434,274 MWh** janë humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Numri total i kabinave elektrike në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2023 është 26,151, dhe gjatësia totale e linjave të tensionit të mesëm në sistemin e shpërndarjes është 17,505 km. Gjatësia totale e rrjetit të tensionit të ulët në sistemin e shpërndarjes është 48,259 km. Gjatesia totale e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të mesëm dhe në tension të ulët rezulton të jetë 65, 764 km.

Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes te raportuara nga OSHEE Group përgjatë vitit 2023 janë 18.93 %, me një diferencë prej 0.7 % më të ulta se targeti i vendosur në VKM-në nr. 758, datë 09.12.2021,"Për një ndryshim në vendimin nr. 253, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik".

Niveli total i arkëtimeve per vitin 2023 është 99.4 % kundrejt energjisë elektrike të faturuar. Ky nivel arkëtimesh për vitin 2023 rezulton me rritje, krahasuar me nivelin e arkëtimeve të

realizuara për vitin 2022 i cili rezulton të jetë realizuar në nivelin 98 % Këto vlera të arkëtimeve përfshijnë edhe arkëtimet e prapambetura, të cilat janë realizuar në vitin respektiv.

Konsumi total i energjise elektrike i realizuar për vitin 2023 rezulton 7,875,861 MWh, në pothuaj të njëjtat vlera sa konsumi i arritur përgjate vitit 2022. Konsumi i energjisë elektrike për vitin 2023 krahasuar me konsumin e vitit 2021, i cili është dhe konsumi maksimal i arritur, rrezulton me një ulje prej 538,975 MWh. Ulja e konsumit të energjisë elektrike total në vend për vitin 2023, krahasuar me konsumin maksimal per vitin 2021, shkon në rreth 6.4 %. Në të njëjtën kohë, konsumi i energjisë elektrike total i realizuar për vitin 2023 është rreth 9.2 % më i lartë se konsumi mesatar vjetor për periudhën 2004 – 2023.

Kjo ulje e konsumit total të energjisë elektrike është reflektuar për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, por veçanërisht për konsumatorët që furnizohen në tregun e parregulluar, të cilët për vitin 2021 kanë konsumuar rreth 1,361 GWh energji elektrike, për vitin 2022 këta konsumatorë kanë konsumuar rreth 929 GWh energji elektrike dhe për vitin 2023 rreth 858 GWh. Kjo ulje e konsumit ka ardhur edhe si pasojë e krizës energjitike në të cilën shume biznese instaluan impiante alternativ të gjenerimit të energjisë elektrike si vetë – prodhues.

Numri i përgjithshëm i klientëve për vitin 2023 është 1,334,091 dhe pjesën më të madhe të klientëve për këtë vit e zënë klientët familjarë, që përbëjnë 77.1 % të numrit total të klientëve të FSHU sh.a. Në shpërndarjen demografike të klientëve edhe për vitin 2023 pjesa më e madhe është në Tiranë, me rreth 27.4 % të të gjithë klientëve që ka FSHU sh.a.

Konsumi i klientëve familjarë zë rreth 39.5% të konsumit total, shifër kjo më e lartë krahasuar me konsumin për të njëjtën kategori për vitin 2022, i cili ishte në masën 38.8%.

Struktura e klientëve të FSHU sh.a. reflektohet dhe në strukturën e faturimit të energjisë elektrike të realizuar për vitin 2023. Klientët familjarë zënë pjesën më të madhe dhe për rrjedhojë pjesën më të madhe të energjisë së faturuar për vitin 2023, ose 44.5 % të të gjithë faturimit të realizuar për vitin 2023.

Piku i ngarkesës per vitin 2023 është arritur në datën 08.02.2023, ora 19:00, në vlerën 1542 MW, kurse ngarkesa minimale është regjistruar në datën 02.01.2023, ora 05:00, në vlerën 439 MW.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX), filloi operimin ne oren 00:00 të datës 12.04.2023. Me fillimin e operimit te bursës shqiptare të energjisë nga ALPEX sh.a., ka vijuar edhe regjistrimi i antarëve në këtë bursë. Përgjate vitit 2023 numri i anëtarëve të bursës të regjistruar është 17 (shtatëmbëdhjetë). Gjithashtu anëtar i Përgjithshëm i Klerimit te Burses është Raiffeisen Bank Albania. Ka aplikuar për tu bërë Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit, Tirana Bank, e cila është në fazën e parë të anëtarësimit pranë ALPEX.

Volumi total i tregtuar në bursë për vitin 2023 rezulton të jetë 827,541 MWh dhe cmimi mesatar i arritur nga ALPEX sh.a. rezulton të jetë 106,5 Eur/MWh.

Përgjatë aktivitetit të ERE një pjesë e rëndësishme e punës fokusohet në zgjidhjen e ankesave të klientëve të energjisë elektrike duke mbledhur dhe përpunuar të dhëna për numrin dhe natyrën e tyre. Veçanërisht vitet e fundit, e më konkretisht gjatë viteve 2022-2023, ERE ka marrë një rol shumë më aktiv sa i përket kanaleve të komunikimit me konsumatorët duke gjetur mënyrat bashkëkohore të komunikimit me publikun jo vetëm drejtëpërdrejtë por edhe

nëpërmjet rrjeteve sociale, si një rrugë më të shpejtë e të aksesueshme për të orientuar informacion drejt destinacionit të synuar, konsumatorit fundor.
Në përputhje me aktet ligjore në fuqi, Rregullatori merr përsipër zgjidhjen e një ankese, pasi verifikon se kërkesa e paraqitur plotëson kriteret minimale për t'u trajtuar, dhe pasi konstaton se çështja që paraqitet për shqyrtim përfshin një shoqëri të licencuar në një nga aktivitetet në sektorin e energjisë apo atë të gazit natyror.
Në ERE gjatë vitit 2023 janë paraqitur ne total 164 ankesë/kërkesa nga të cilat, 56 prej tyre janë përcjellë nëpërmjet formularit në faqen web të ERE-s "bëj një ankesë", 10 të tjera nëpërmjet e-mail dhe 98 me anë të postës tradicionale apo zyrave të ERE-s.

Përgjatë vitit 2023 rezultojnë 99 ankesa dhe 65 kërkesa për orientim apo informacion në lidhje me trajtimin e një çështje apo adresimin e një shqetësimit të konsumatorëve. Nga numri total i ankesa/kërkesave të adresuara në ERE rreth 66 prej tyre janë adresuar nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, faqes së ERE dhe formularit të aplikueshëm të depozitimit të një ankese. Kështu edhe gjatë vitit 2023 shihet një trend në rritje i praktikave digjitale të komunikimit me institucionin e ERE, duke çuar në një lehtësim të praktikave administrative, uljes së kohës së procesimit të një ankese por edhe uljes së kostove të vetë konsumatorit në arritjen e synimit, për gjetjen e një zgjidhje.

Në Sektorin e Gazit Natyror, ERE dhe për vitin 2023 ka vijuar punen për miratimin e akteve rregullatore në këtë sektor. Gjithashtu pergjate vitit 2023 tregjet globale të gazit lëvizën drejt një ribalancimi gradual kryesisht gjatë sezonit të ngrohjes. Ky ribalancim i cmimeve përgjatë vitit 2023 vjen pas krizës së krijuar që nga shkurti i vitit 2022 kur filloi lufta në Ukrainë. Në vitin 2023 çmimet evropiane të gazit vazhduan prirjen rënëse. Çmimi mesatar tremujor i tregut spot ishte 53.32 €/MWh. Kjo përfaqëson një rënie prej 44% nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar (95.15 €/MWh), dhe një rënie prej 45% nga viti në vit (97 €/MWh).

Përsa i takon aktivitetit të ERE në fushën e përcaktimit të tarifave dhe çmimeve gjatë vitit 2023 rezulton si vijon:

Shoqëria OST sh.a. ka vijuar të ushtrojë aktivitetin e saj të transmetimti të energjisë elektrike bazuar në tarifën mesatare të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 3 vjeçare 2022 – 2024 prej 0.85 lekë/kWh, të miraturar me anë të vendimit të Bordit të ERE nr. 72, datë 13.04.2022 .vendosi miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Maj 2022 – 31 Dhjetor 2024, prej 0.85 lekë/kWh.

Për sa i përket tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike, në mungesë të aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a., për përcaktimin e tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2023, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 324, datë 14.12.2022, vendosi të shtyjë fuqinë juridike të vendimit nr. 73, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2023 ose konstatimit të ndryshimit të kostove bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në fuqi për vitin 2023, kanë vijuar të mbeten si vijon: (i) *Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV është 1.55 Lekë/Kwh,* (ii) *Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.6 deri 20 kV është 3.99 Lekë/Kwh,* (iii) *Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV është 6.42 Lekë/Kwh,* (iv) *Cmimi i aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive është 1.92 lekë/kVArh*.

Shoqeria FSHU sh.a. nuk aplikoi për çmime në ERE për vitin 2023 dhe për rrjedhojë ERE me qëllim që shoqëria FSHU sh.a. të vijonte të ushtronte aktivitetin për të cilin është licencuar edhe për vitin 2023, konform ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, me Vendimin e Bordit nr. 325, datë 14.12.2022, miratoi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2023.

Nga analiza e raporteve periodike të vitit 2023, evidentohet se sasia e energjisë elektrike e shitur për klientët e FMF-së, të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, ka qënë 21.2 GWh, me një vlerë të faturuar prej 250 milion lekë, duke rezultuar në një çmim mesatar vjetor prej 11.83 lekë/kWh.

Për sa i përket çmimit të furnizimit me energji elektrike për klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 29, datë 16.02.2023 vendosi të miratojë çmimin prej 18.26 Lekë/kWh për vitin 2023. Për shoqëritë Ujësjellës-Kanalizime të cilat furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 16, datë 06.02.2023, vendosi të miratojë për vitin 2023 çmimin prej 9.33 lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV dhe çmimin prej 11.77 lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.

Referuar bilancit energjitik rezulton se sasia e energjisë elektrike të konsumuar nga klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2023 është 1,070 GWh, me një vlerë të faturuar prej afro 18,802 milion lekë, me çmimin mesatar të realizuar prej 17.56 lekë/kWh.

Për sa i përket çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW, ERE me vendimin e Bordit nr. 25, datë 22.02.2024 miratoi çmimin prej 95.04 Euro/MWh, për vitin 2023.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 327, datë 14.12.2022, vendosi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi prej 8.5652 lekë/kWh për vitin 2023. Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, Këshilli i Ministrave me anë të Vendimit nr. 67, datë 08.02.2023 "Për një ndryshim në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi", të ndryshuar, vendosi që niveli maksimal i çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike, në çdo rast nuk do të jetë më i lartë se çmimi 10 lekë/kWh (pa TVSH). Në këto kushte, meqënëse çmimi rezultues sipas përllogaritjeve në zbatim të VKM nr. 687/2017 është mbi nivelin maksimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike të përcaktuar në gërmën "d" të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, e ndryshuar, prej 10 lekë/kWh, Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 27, datë 16.02.2023 vendosi të miratojë çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, prej 10 lekë/kWh, duke përcaktuar gjithashtu se efektet financiare të këtij çmimi fillojnë nga data 09.02.2023 me publikimin në Fletoren Zyrtare të VKM-së nr. 67/2023 e deri më 31.12.2023.

Po ashtu gjatë vitit 2023, me vendimin e Bordit nr. 364, datë 15.12.2023, ERE ka miratuar edhe çmimin vjetor që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2024, prej 10 lekë/kWh.

Shoqëria Albgaz sh.a, është licensuar nga ERE si operator i kombinuar i gazit për transmetim dhe shperndarje. Për vitin 2023 Albgaz sh.a. ka zhvilluar aktivitetin në përputhje me objektin e veprimtarisë së themelimit dhe më pas licensimit të tij, i cili përfshin zhvillimin dhe operimin e infrastrukturës së transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri.

Albgaz sh.a, ka një nga detyrimet kryesore përmbushjen e angazhimeve ndaj shoqërisë TAP AG. Për këtë qëllim, u krijua shoqëria "Albanian Gas Service" sh.a me objekt të veprimtarisë realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së gazsjellësit TAP. Kjo u bë e mundur nëpërmjet partneritetit me shoqërinë italiane SNAM S.p.A, një shoqëri lider në fushën e infrastrukturës së gazit natyror dhe njëkohësisht aksionar i shoqërisë TAP AG. Gjithashtu, në funksion të realizimit të detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjen e Mirëmbajtjes, janë financuar nga TAP AG dhe realizuar nga "Albgaz" sh.a, Qendra e Mirëmbajtjes në Korçë dhe Qendra e Mirëmbajtjes në Fier. Të dyja këto qendra tashmë funksionojnë në përputhje me standartet më të larta të sektorit të përcaktuara nga ana e TAP. Albgaz sh.a është aksionari mazhoritar në Shoqërinë "Albanian Gas Service" sh.a., zotërues i 75% të aksioneve.

Në përputhje me kushtet e tregut, Albgaz sh.a ka klient të vetëm për ofrimin e shërbimit të transmetimit të gazit natyror shoqërinë Albpetrol sh.a, e cila me fillimin e pandemisë COVID-19 uli në mënyrë të ndjeshme prodhimin e naftës dhe rrjedhimisht edhe sasitë e gazit shoqërues për transmetim, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe të ardhurat nga ky aktivitet.

Pavarsisht performancës pozitive të sektorit të energjisë përfshirë dhe sektorin e gazit natyror për vitin 2023, ku një rol të vecantë ka pasur dhe përgatitja e legjislacionit sekondar dhe rregullator, vlen të theksohet se ndër fushat të cilat do të jenë objektiv kryesor i punës së ERE-s për vitin në vijim është monitorimi i tregut te energjise si dhe rishikimi e miratimi i akteve rregullatore për te pasur nje zhvillim të mëtejshëm te ketij tregu në vendin tonë.

REKOMANDIMET E PROGRES RAPORTIT TË BE-SË PËR VITIN 2023

Rekomandimet e progres raportit të Bashkimit Europian për vitin 2023 për Shqipërinë lidhur me kapitullin 15 "Energjia" janë si më poshtë vijon:

1. Të sigurohet akses i plotë në tregun e liberalizuar për të gjithë klientët e lidhur në 20 kV në vitin 2022 dhe të zgjerohet ky akses në mënyrë progressive për të gjithë klientët. Gjithashtu, shit-blerja e energjisë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes të realizohet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë ALPEX.

2. Të përditësohet dhe zbatohet Plani kombëtar të energjisë dhe klimës 2020-2030 (NECP), si pjesë e udhërrëfyesit të dekarbonizimit të vitit 2030 dhe të sigurohet që operatori i energjisë së rinovueshme shqiptare është funksional deri në fund të vitit 2023. Të forcohet kapaciteti i Agjencisë për Efiçiencën e Energjisë dhe të vazhdohet hartimi dhe miratimi i legjislacionit zbatues, duke përfshirë krijimin e skemës së detyrimit të efiçiencës së energjisë dhe miratimin e rregullores së etiketimit. Të vazhdohet me vlerësimin gjithëpërfshirës të potencialit të ko-gjenerimit me efiçencë të lartë dhe ngrohjes qendrore, në përputhje me detyrimet e tij sipas Direktivës së Efiçiencës së Energjisë.

3. Të transpozohet dhe implementohet Paketa e Integrimit të Energjisë Elektrike të miratuar nga Këshilli Ministerial i Komunitetit të Energjisë në dhjetor 2022.

Lidhur me sa parashtruar, bëjmë me dije se për sa i përket pikes 1 të rekomandimeve, nga data 1 janar 2024 të gjithë klientët e lidhur në 20 kV furnizohen në treg të liberalizuar. Për sa i përket pikes 2 të rekomandimeve, ERE ka dhënë kontributin e saj për hartimin e Planit kombëtar të energjisë dhe klimës 2020-2030, të miratuar me VKM nr. 872, date 29.12.2021, si pjesë e grupit ndër-institucional të punës të ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 52, datë 07.03.2019. Në vijim, me nisjen e punës për rishikimin e këtij plani nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ERE është në fazën e përgatitjes së komenteve lidhur me ndryshimet e nevojshme të PKEK.

Për sa i përket transpozimit dhe implementimit të paketës së Integrimit të Energjisë Elektrike të miratuar nga Këshilli Ministerial i Komunitetit të Energjisë në dhjetor 2022, ERE, siç prezantuar dhe në takimin bilateral të kapitullit 15 "Energjia" me Komisionin Europian, të zhvilluar në Bruksel gjatë muajit shtator 2023, ka miratuar aktet rregullatore të cilat legjislacioni në fuqi ja ngarkon si detyrim dhe pret miratimin e ndryshimeve të nevojshme të ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, të cilat do të mundësojnë dhe miratimin e pjesës së mbetur për transpozimin nga paketa e integrimit të energjisë elektrike.

ECURIA E ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË ERE-s PËR PERIUDHËN 2023 E NË VIJIM, SIPAS PLANIT TË MASAVE PËR ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË ERE*s PËR PERIUDHËN 2021 – 2023 SI DHE PËRDITËSIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË ERE-s PËR VITIN 2023

Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 74, datë 12.03.2021 u miratuan Objektivat Strategjikë të ERE-s për vitet 2021-2023 dhe në vijim është miratuar Kalendari i Përditësuar i Masave të ERE-s për zbatimin e këtyre Objektivave Strategjikë.

Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 20, datë 04.02.2022 është shqyrtuar mbi ecurinë e zbatimit të objektivave strategjikë të ERE për vitin 2021, sipas planit të masave për zbatimin e objektivave strategjikë të ERE për periudhën 2021 – 2023 si dhe vendosur në lidhje me përditësimin e planit të masave për objektivat strategjikë të ERE-s për vitet 2022 – 2023.

Ky dokument vendos objektivat strategjikë që ERE synon të realizojë brenda periudhës së përcaktuar me qëllim përmbushjen e detyrave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 43/2015 *"Për Sektorin e Energjisë Elektrike"*, i ndryshuar dhe ligjin nr. 102/2015 *"Për Sektorin e Gazit Natyror",* i ndryshuar.

Kalendari i Masave i rishikuar, rivendos në afat, disa nga detyrat dhe targetat e planit të masave të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96/2021, me qëllim adresimin e tyre brenda viteve 2022-2023.

Në lidhje me **ndërgjegjësimin e konsumatorit për t'u bërë klient i aftë në vlerësimin e ofertave, kuptimin e drejtë të mekanizmave të tregut, deri në mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në shërbimet e lidhura me furnizimin e energjisë elektrike**, sqarojmë se ky objektiv është ndarë në disa minidetyra ndër të cilat ia vlen të përmendim të gjitha hapat e ndërmarra nga strukturat përgjegjëse të ERE me qëllim Implementimin e platformës mbi ofertat e tregut të furnizimit me energji elektrike (PCT).



Platforma tashmë është ngritur dhe me qëllim vënien në funksion të saj ERE ka organizuar disa trajnime me stafin por edhe me furnizuesit në treg të lirë, me qëllim orientimin e tyre mbi modalitet e përdorimit të platformës.

Figura 1. Platforma PCT

PCT (https://pct.ere.gov.al/) do të shërbejë si një vitrine për konsumatorët, në të cilën do të mund të vlerësojnë sipas kategorisë së tyre të konsumit, ofertat më të mira të tregut sa i përket garantimit të furnzimit me energji elektrike.



Platforma paraqet informacion të bollshëm mbi përmbajtjen e saj duke lejuar si furnizuesit ta përdorin atë në mënyrë sa më eficiente por edhe konsumatorët për tu orientuar drejt ofertave më të mira të furnizimit në treg të lirë.

Duke qënë se numri i konsumatorëve të dale në treg të lirë, aktualisht është ende i vogel, besojmë se impakti i kësaj pltaforme në liberalizimin e tregut por dhe aktivizimin e konsumatorit do të jape rezultatin e saj më të mire në planin afatmesëm.

1. **Incentivimi i teknologjise së lëvizjes së makinave elektrike.**

Gjatë vitit 2022 ERE përgatiti dhe miratoi "*Vleresimin mbi kuadrin rregullator dhe ligjor me qellim perdorimin e teknologjive te reja per stacionet e ngarkimit te automjteve elektrike, perfshire rregullimin e tarifimit te ketij sherbimi"*.

Gjetjet e këtij studimi janë shpërndarë në të gjitha palët e identifikuara të interesit, dhe jane zhvilluar takime ma perfaqesues te Bankes Boterore lidhur me gjetjet e ketij e ketij studimi me qëllim jo vetëm njohjen e tyre me gjetjet e këtij studimi por edhe sensibilizimin e palëve të intersit në lidhje me impaktin që ka apo mund të ketë integrimi i kësaj teknologjie në jetën tone.

2. **Sensibilizimi i konsumatorëve mbi racionalizimin e energjisë elektrike.**

ERE ka adresuar disa korrespondenca me Agjensinë e Eficencës duke i kërkuar koordinimin e punës me qëllim adresimin më të shpejtë dhe eficient të çështjeve të interesit për konsumatorin apo informimin e tyre në lidhje me synimin tonë të përbashkët, mbrojtjen e interesave të konsumatorit si edhe përdorimin eficient të energjisë elektrike. Lidhur me sa më sipër, aktualisht ERE është në negociata zyrtare me Agjencinë e Eficiencës për me qëllim lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi për koordinimi e punëve sa I përket të cilat do të synojnë të përcjellin këtë informacion të konsumatorit për të adresuar kësisoj bashkërisht këtë çështje interesi të përbashkët. Nga ana e ERE do të bëhen përpjekjet më të mira që broshura që do të përgatitet për këtë qëllim të mbërrijë tek çdo konsumator.

Po ashtu, gjatë vitit 2023 janë realizuar komunikime të vazhdueshme të mesazhevesensibilizuese për konsumatorët me qëllim ndërgjesimin e tij në përdorimin më eficient të energjisë elektrike të tillë si informacione se si të kursejmë energji, si funksionon e operon Sistemi ngrohës/ftohës, si ndikon matësi inteligjent në menaxhimin e konsumati familjar apo edhe njohuri në lidhje me përdorimin eficient të pajisjeve eletkroshtëpiake dhe informacion mbi konsumin mesatar të tyre.

3. **Dhënia Zë konsumatorit**.

Në lidhje me dhënien zë konsumatorit, gjatë vitit 2023 është realizuar dhe arritur nëpërmet disa mjeteve të komunikimit ku peshën më të madhe e zë, vënia në funksion e numrit të gjelbër për informimin e konsumatorit.

Aktualisht konsumatorët telefonojnë rregullisht për të pyetur për stautsin e ankesës së bërë pranë ERE-s, por edhe për të marrë informacion të përgjithshëm mbi cështjet e tyre të interesit. Nga ana e strukturave përgjegjëse për menaxhimin e numrit të gjelbër jepen përgjigjet lidhur me trajtimin e ankesës si dhe orientohen gjithashtu për të ndjekur në faqën zyrtare të ERE-s në regjistrin e ankesave që përditësohet rregullisht.

Ky numër telefonik reklamohet jo vetëm në faqen zyrtare të ERE-s dhe në rrjetet sociale por dhe në shkresat e drejtorisë së DMPKS.

Përgjatë vitit 2023 janë organizuar disa aktivitete ndërkombëtare të organizatave në të cilat ERE adreron, ku objekti i diskutimit dhe fokusi ka qënë pikërisht arritja te konsumatori me informacion utilitar dhe aktivizimi i tij. Rregullatorët e përfaqësuar kryesisht nga nivelet më të larta drejtuese të tyre si dhe përfaqësues të strukturave të Mbrojtjes së Konsumatorit, kanë diskutuan mes tyre dhe shkëmbyen mendime në lidhje me mjetet më të mira që duhen përdorur për të rritur angazhimin e pjesëmarrjen e konsumatorit në politikbërje si një aktor i rëndësishëm në adresimin e çështjeve të interesit dhe tregut të energjisë. Epoka e re e digjitalizimit dhe impakti tek konsumatori ka qënë një çështje për të cilën Komisionerja e Bordit të ERE dhe njëkohësisht Zv. Kryetarja e Grupit të punës së Konsumatorit të MEDREG Znj. Sadushi prezantoi për pjesëmarrësit gjetjet dhe analizën e saj mbi raportimet e rregullatorëve në lidhje me afrimin drejt këtij procesi nga vendet anëtare.

Komunikimi nëpërmjet rrjeteve sociale qoftë me anketa apo me informacione utilitare për konsumatorët ka qënë gjithashtu një nga modaltiet eeficiente të përdorura nga ERE për të arritur më shpejtë pranë konsumatorit e në mënyrë më të lehtë.

4. Mbrojtja e Klientëve në nevojë.

Gjatë vitit 2023 ERE me ngritjen e grupit të punës për arritjen e detyrave të përcaktuara në këtë objejktiv pune, ka realizuar dhe miratuar një "*Vlerësim mbi politikat rregullatore për mbrojtjen e klientëve në nevojë në sektorin e energjisë elektrike*". Në realizimin e këtij studimi janë mbajtur në konsideratë analizimi I të dhënave si: 1. Varfëria energjitike dhe konsumatorët në nevojë në BE 2. Varfëria energjitike dhe konsumatorët në nevojë në Palet Kontraktore te Traktatit të Komunitetit të Energjisë 3. Faktoret që ndikojnë ne vleresimin e varferise energjitike 4. Krijimi i observatorit të varfërisë energjitike të Bashkimit Europian dhe Energy Advisory Hub 5. Monitorimi i Varferise Energjitike 6. Programet e Varferise Energjitike 7. Komunitetet e Energjise per zbutjen e varferise energjitike 8. Shqipëria dhe legjislacioni për konsumatorët në nevojë dhe varfërinë energjitik 9. Rekomandimet e ERE.

Gjetjet e këtij vlerësimi të ERE u janë përcjellë të gjitha palëve të identifikuara të interesit duke përfshirë ministritë përgjegjëse për draftimin e kritereve të identifikimit të klientëve ne nevoje apo edhe shoqatave që në objekt të veprimtarisë së tyre kanë mes të tjerave dhe mbrojtjen e kësaj kategorie.

5. Zhvillimi i një Portali të Konsumatorit

Me qëllim përmbushjen e kësaj detyre, nga ana e ERE-s nuk është realizuar një faqe e re por një zë më vete nën emërtimin shërbime konsumatori. Ky shërbim përfshin: **Kontratat** ku bëjnë pjesë kontratat që lidhen ndërmjet klientit dhe Furnizuesit dhe me Operatorin e Shpërndarjes; **Formulari i ankesave** ku klienti mundet me nje klikim të dërgojë ankesën në ERE, pa e printuar dhe pa ardhur fizikisht në zyrën e mbrojtjes së konsumatorit; Informacion mbi **Lidhjet e reja** ku në këtë zë gjithashtu janë reflektuar, kostot, kushtet, procedurat që duhen ndjekur për lidhjen e re; **Anketa e konsumatorit**, e vendosur zë më vete për vlerësimin e nivelit të kënaqësisë së klientit të energjisë; **Si të gjeni furnizuesin tuaj në treg të lirë**, zë me anë të cilit janë njoftuar klientët fundor, që plotësojnë kushtet për të dalë në treg të liberalizuar të energjisë elektrike; **Fushatë sensibilizuese,** me anë të cilës është sensibilizuar konsumatori duke i treguar se si mund të ulim konsumin e energjisë elektrike; **Regjistrat e ankesave**, me anë të së cilave orientohen klientët lidhur me statusin e ankesës.

Azhornimi I rregjistrave bëhet në fillim të çdo jave ose në çdo rast që vijnë përgjigje apo adresohen ankesa të reja. Në *Database*-n hidhen të dhëna të freskuara në lidhje me trajtimin nga ERE të ankesës, nr e protokollit e datën e shkresës së adresuar nga ERE, statusin e përgjigjes së të licencuarit në lidhje me ankesën si dhe statusin e kërkesës sa i përket pranimit apo refuzimit të saj nga ana e të licencuarit mbështetur në provat dokumentare të gjeneruara, apo edhe statusin e pranimit apo rrëzimit të kërkesës në rastet kur është ERE që i jep zgjidhjen apo rekomandimin për zgjidhje të licencuarit ndaj të cilit është ushtruar ankimim.

6. Përcaktimi i treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj Klientit që garanton çdo i licencuar në furnizim

Sa i përket mbikëqyrjes së standardeteve të cilësisë së shërbimit ndaj klientit, ERE ka mbikëqyrur në mënyrë periodike faqet zyrtare të operatorëve të licencuar që ofrojnë shërbim për konsumatorët e energjisë, dhe ka sjellë në vëmendje të tyre në të gjitha rastet që shërbimi nuk është ofruar me standarde. Përmendim këtu, sjelljen në vëmendje të FSHU sh.a. të rishikimit të kushteve të marrëveshjes me Postën Shqipëtare, pas marrjes së disa ankesave nga konsumatorët në lidhje me mungesën e shërbimit të rregullt sa i përket përcjelljes së kopjes fizike të faturës së energjisë në adresën e tyre, tërheqjen e vëmendjes ndaj FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a. në përshpejtimin e afateve për kthimin në operim të faqeve të internetit, pas konstatimit të problematikave në to, apo dhe sjelljen në vëmendje për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e furnizimit për përmbushjen e detyrimeve për informim ekstensiv në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit nëpërmjet faqeve zyrtare të internetit.

7. Monitorime për furnizuesit në treg të lirë lidhur me zbatimin e rregullores.

ERE i jep një rëndësi të madhe arritjes dhe ruajtjes së standardeve me qëllim shërbimin cilësor ndaj klientit të energjisë elektrike dhe për këtë arsye ka kërkuar informacion paraprak lidhur me sa përmbushur detyrimet e parashikuara e përshkruara shkurtimisht edhe më sipër, përveç rregullores.

Për gjithë sa më sipër, disa nga të licencuarit që kanë raportuar pranë EREs kanë paraqitur draftin e parë të Kodit të Menaxhimit të Ankesave dhe Kërkesave për konsumatorët e tyre të ardhshëm dhe bazuar mbi këtë të fundit do të përgatiten format standarde për ankesat dhe kërkesat e ndryshme. Rezulton se nga sa kërkuar e sipas raportimeve, shumica e të licencuarve duke qenë se ndodhet në kushte në të cilat nuk furnizon asnjë klient fundor citojnë edhe sipas vendimit nr. 23, datë 14.02.2022 "Mbi miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit" neni 8, pika 1 se: *"Kjo regullore nuk aplikohet për furnizuesit të cilët, gjatë një viti kalendarik, nuk kanë furnizuar asnjë klient fundor. Në çdo rast, furnizuesit që vendosin të ushtrojnë aktivitetin e furnizimit njoftojnë ERE-n për masat e marra për garantimin e përmbushjes së kushteve të kësaj rregullore, jo më vonë se 15 ditë nga fillimi i ushtrimit të aktivitetit të furnizimit për klientët fundorë."*

Gjatë vitit 2023, ERE ka vijuar punën me realizimin e një rubrike të dedikuar mbrojtjes së konsumatorit publikuar në faqen e ERE https://ere.gov.al/sq/, nën zërin Shërbime Konsumatori. Rubrika jep një informacion të detajuar për konsumatorin dhe vendos në dispozicion të tij legjislacionin në fuqi dhe mekanizmat e ankesës që konsumatori disponon. Për të marrë një vlerësim më të mirë të punës që kryen apo mund të përmirësojë në shërbimet e saj, ERE ka organizuar dhe një anketë mbi nivelin e kënaqësisë së konsumatorit. Konsumatorët e kanë plotësuar anketën, nëpërmjet së cilës kanë shprehur kënaqësitë dhe opinionet e tyre në lidhje

me shërbimet e marra apo që duan të marrin. Disa nga pyetjet e anketës lidhen me shërbimet e marra në ERE dhe sa i plotë ka qenë informacioni i marrë në faqen zyrtare të ERE.

Anketa është një e drejtë dhe jo një detyrim për konsumatorin ndaj një numër i vogël e ka plotësuar atë Megjithatë, gjatë vitit 2024 do vijojë analiza e të dhënave të anketës dhe mundësia e përmirësimit të rubrikës dhe vijim i punës së shpërndarjes së anketës, në mënyrë periodike 2 herë në muaj në rrjetet sociale ose me metodat tradicionale të plotësimit të anketës.

Së fundmi, me anë të rrjeteve sociale është organizuar një poll në faqen zyrtare të ERE-s në Instagram, ku janë publikuar pyetje të ndryshme për qëllim të aspekteve të lartpërmendura. Disa nga pyetjet e gjeneruara në këtë anketë janë:

- Sa i kënaqur jeni me shërbimin që keni marrë në ERE?
  Konsumatori ka votuar kryesisht- “Shumë i kënaqur".
- Si keni mësuar rreth ERE-s?
  Konsumatori ka votuar më tepër opsionin; “Nëpërmjet Web faqes - 46%”.
- Ankesën për furnizuesin e energjisë elektrike e adresoni:
  Konsumatori ka votuar në POLL; Furnizuesi - 50% dhe ERE - 50%.
- Mendoni se legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të Konsumatorit:
  Konsumatori ka votuar “i plotë” dhe “i plotë por nuk zbatohet.”
- Sa i efektshëm është informacioni që merrni nëpërmjet faqes së ERE-s?
  Konsumatori kryesisht ka votuar se informacioni është i qartë.
- Informacioni për konsumatorin në faqen e ERE-s:
  Konsumatorit ka votuar që të jetë më profesional dhe më i thjeshtë në raport 50/50.
- Dëshironi të merrni më shumë informacion mbi të drejtat e konsumatorit:
  Kryesisht prej Faqes web, lajmeve në mail, dhe rrjeteve sociale - 16%
- Çfarë lloj informacioni dëshironi të merrni nëpërmjet ERE:

Konsumatori ka kërkuar të marrë më tepër informacion lidhur me “Të drejtat për cilësinë e shërbimit”, “Të drejtat për të qenë vetëprodhues.”

8. Zhvillimi i një reforme tarifore nisur nga riorganizimi dhe hapja e tregut:

Edhe gjatë vitit 2023, ERE ka vijuar me analizën e problematikave të hasura jo vetëm në metodologjitë por dhe çështjeve gjatë proceseve të shqyrtimit të tarifave. ERE ka adresuar nevojën për asistencë lidhur me akte të tjera apo çështje të ndryshme sa i takon rregullimit në tërësi në takimet e zhvilluara midis ERE, NARUC por dhe Expertise France. Në kushtet aktuale të tregut të energjisë, i cili vijon të jetë tejet i luhatshëm dhe të ketë shkaktuar një krizë në sektorin e energjisë në kontinentin europian gjatë vitit 2023, impakti I së cilës vijoi të ndihet deri në muajt e fundit të vitit 2023, vlersojmë se ndryshimi i metodologjive sa i takon modelit të rregullimit apo parimeve rregullatore në tërësi duhet të kryhet në një kohë të dytë, pas stabilizimit të çmimit të Energjisë elektrike dhe aktualisht këto akte mund të rishikohen vetëm në përcaktimin e disa prej elementeve përbërës të tyre.

Sa më sipër, gjatë vitit 2024 do të rivlerësohen mundësitë e përmirësimit të metodologjive ekzistuese të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe metodologjive të cilat lidhen me përcaktimet që do të dalin nga zbatimi i ligjit të ri të RES dhe metodologjinë e NEMOS-s.

Shumica e vendeve kanë patur një rritje të jashtëzakonshme të çmimit të energjisë elektrike, duke sjellë ndërhyrjen në disa raste në aplikimin e një çmimi tavan për arsye të dinamikës së tregjeve energjitike apo vendosjen e një takse mbi të ardhurat e jashtëzakonshme, me qëllim zbutjen e këtij efekti te konsumatorët familjare. Ulja e kostove është në fokusin e të gjitha vendeve tashmë dhe ndër çështjet më thelbësore mbetet ndërtimi i burimeve të reja gjeneruese dhe diversifikimi i tyre me qëllim përballimin e kërkesës për energji elektrike dhe si rrjedhojë uljen e kostove për konsumatorët fundorë, nevojë e cila është adresuar dhe nga Qeveria Shqiptare nëpërmjet Vendimeve respektive. ERE gjatë vitit 2024, synon përpunimin e të dhënave të publikuara nga shoqatat rajonale.

9. Analizë e tregut për gaz natyror

Lidhur me identifikimin e nevojës dhe kërkesave për gaz si dhe analizës studimore mbi përdoruesit e gazit në vendet e rajonit dhe pritshmëritë për tregun shqiptar, ERE është fokusuar në studimin dhe vlerësimin e e skenarërve të parashikuar në dokumentin strategjik "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018-2033", miratuar me VKM nr. 480 datë 31.07.2018., dhe "Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare", miratuar me VKM nr. 87, datë 14.2.2018, detyrë që vijoi edhe gjatë vitit 2023. ERE mbetet e përkushtuar që të vlerësojë të gjitha mundësitë për të vijësuar përfshirjen e saj aktive në projektet e përbashkëta të Komunitetit të Energjisë për gazin natyror që varen nga zhvillimet e projekteve rajonale të gazit në Evropën Juglindore.

Studimi i skenarëve për këtë target është një çështje që do jetë në vijim edhe për vitin 2024, pasi lidhet ngushtësisht me zhvillimin e tregut të gazit natyror në vendin tonë, parshikuar kjo edhe në Strategjinë Kombëtare të Energjisë (2018-2030), sipas Rekomandimit 2018/01/MC-EnC të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë.

Lidhur me studimin e politikave të çmimeve dhe tarifave në sektorin e gazit natyror janë kryer takime pune dhe diskutime duke patur një fokus studimin e dokumentave të publikuara nga aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë që veprojnë në sektorin e gazit natyror si shoqëria Albgaz sh.a. dhe TAP AG.

Për sa i takon vlerësimit të rrjetit ekzistues të gazit në Shqipëri, dhe dhënia e rekomandimeve për integrimin e tij të mundshëm në sistemin e ardhshëm kombëtar të gazit, nga ERE janë ndërmarrë disa iniciativa që lidhen me korrespondencën e saj me dy Operatorët kryesorë të sektorit të gazit natyror në Shqipëri, Operatori i kombinuar Albgaz sh.a., dhe TAP AG që është një Operator i Sistemit të Transmetimit (OST) dhe një Operator i Pavarur Transmetimi (OPT), i cili iu jep mundësinë transportuesëve të interesuar të transportojnë gaz në mënyrë të sigurtë, të besueshme dhe efikase.

Shoqëria "Albgaz" sh.a. është autoriteti publik që është përgjegjës për transmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë dhe e cila administron rreth 500 km tubacione magjistrale të transportit të gazit të ndërtuar para 40 vitesh, me teknologji tashmë të vjetëruar, ku masat mbrojtëse nga korozioni janë minimale.

Rrjeti i tubacioneve të gazit është i shpërndarë në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë dhe përfundon në ORC në Ballsh. Infrastruktura vendase e rrjetit të gazit në Shqipëri ka një shtrirje më të madhe se infrastruktura e naftës. Fushat e gazit shtrihen nga Durrësi deri në Delvinë, duke krijuar kështu një mundësi për konsumatorët për t'u lidhur me rrjetin.

Infrastruktura e kufizuar e gazit vendas në disa vende është jashtë gjendjes operative dhe nevojiten punime të mëdha rehabilitimi.

Gjatë vitit 2023 ERE ka patur korrenspondecë të vazhdueshme me shoqërinë Albgaz sha, në ndjekjen e objektivit për krijimin e një rrjeti të kompletuar dhe adekuat me kërkesat dhe kushtet e vendosura nga dokumentat e marrëveshjeve ndërqeveritare, me qëllim 5-fishimin gjatësia e tubacioneve dhe lidhjen e tij me rrjetin ndërkombëtar të gazit në rajon dhe e cila mbetet një ndër sfidat kryesore edhe për vitin 2024.

10. Forcimi i aksesit në informacion për funksionimin korrekt të proceseve të tregut.

Me licensimin e ALPEX dhe me tej me operimin e tregut te nje dite me pare ne Prill te vitit 2023 nga ana e ERE eshte parashikuar raportim periodik (javor) mbi ecurine e transaksioneve ne burse apo dhe proceseve te cilat lidhen me regjistrimin e operatoreve ne burse apo dhe problematikave te tjera pergjate operimit te burses.

Percjellja e raportimeve periodike ka ndihmuar ne kuptimin e proceseve te tregut apo dhe nevojave per nderhyrje te rregullatorit ne permirsimin e proceseve te tregut persa i takon regullatorit

Mbikqyrje e nivelit të implementimit të Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike nga operatorët si dhe shtrirjen e saj dhe në sektorin e gazit natyror.

Ne janar 2023, u prezantua ne ERE drafti perfundimtar i dokumentit “Vlerësimet Rregullatore të Maturimit Kibernetik në Sektorin Shqiptar tëe Energjisë” i përgatitur nga NARUC. Ky dokument finalizoi dhe përmblodhi gjetjet e analizës së legjislacionit mbi sigurine kibernetike si dhe parashtroi një plan zbatimi për adresimin e vëzhgimeve të identifikuar në analizë, gjithashtu propozoi një metodologji për të krijuar një proces që mbështet vlerësimet rregullatore efektive të maturise së shoqërisë, bazuar në premisën se çdo shoqëri do të zbatojë ISO27001.

Në vijim të programit të marrëveshjes së sipërcituar USAID/NARUC zhvilloi në prill 2023 pjesën e dytë të trajnimit bazuar në Web për rregullatorët e energjisë të Evropës Juglindore dhe Euroazisë. Qëllimi i këtij webinari ishte vlerësimi i maturisë së Infrastrukturave Kritike te Informacionit. Ne kete webinar ERE paraqiti konkluzionet kryesore të përftuara nga asistenca teknike e personalizuar dhe ndau eksperiencën me rregullatorë të tjerë partnerë. Ndër konkluzionet më të rendesishme vlerësuam si vijon:

- Ligji Nr. 2/2017 është në përputhje me standartin ISO27001.
- Certifikimi me ISMS ISO27001 është i rëndësishëm për ERE-n, pasi certifikimi nga një organizatë audituese e akredituar krijon besimin se shoqëria ndjek proceset e ISO 27001 në vijimesi.
- Përputhshmëria me masat e sigurisë të Ligjit Nr. 2/2017 demonstrohet nëpërmjet auditimeve të brendshme dy herë në vit per standartin ISO27001 nga shoqëritë e certifikuara. Kjo lehtëson ERE -n pasi do t'i duhet vetëm të vlerësojë raportin e auditimit të brendshëm ISMS, i cili do të jetë dukshëm më pak i komplikuar dhe më i shkurtër se raportet e vetëvlerësimit të ligjit nr. 2/2017.

Konkluzionet e mësiperme, u vunë në zbatim për vlerësimin e raporteve të vetëvlerësimit të shoqërive të certifikuara me standartin ISO 27001duke filluar që nga pjesa e dytë e vitit 2022.

Në vijim të bashkepunimit me USAID përfaqësuesit e ERE morën pjesë ne webinarin e datës 23 maj ku u prezantua vendimi i Komisionit Federal Rregullator i Energjisë i SHBA (FERC) për nxitjen e investimeve vullnetare në sigurinë kibernetike. Po ashtu, ka vijuar komunikimi me USAID sa i takon shkëmbimit të informacioneve mbi cështje të tilla si: përditësimi në lidhje me përkufizimet e infrastrukturës kritike të informacionit, raportimi mbi progresin në sigurinë kibernetike ne sektorin e energjisë, etj.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i cili monitoron ecurine e sektorit të energjisë, ne Raportin Vjetor te Implementimit per vitin 2023 te dates 1 nëntor 2023, ne kapitullin për Shqiperine e ka trajtuar sigurinë kibernetike si pjesë përbërëse të cështjes së sigurisë së furnizimit. Në total, sa i takon shkallës së implementimit të acquis, siguria e furnizimit është e vleresuar në shkallen 75% pra me rritje te konsiderueshme ne krahasim me vitin 2022 ku ky tregues vleresohej 61%. Raporti evidentoi se "Në përputhje me rregullat kombëtare për sigurinë kibernetike në sektorin e energjisë elektrike, kompanitë e energjisë elektrike paraqitën vetëvlerësimet për sigurinë kibernetike, të cilat u rishikuan nga rregullatori. Operatori i sistemit të transmetimit OST dhe kompania e prodhimit të energjisë elektrike KESH kanë përmbushur detyrat e tyre, ndërsa operatori i sistemit të shpërndarjes OSSH nuk mundi të paraqese dokumentacionin e kërkuar". Duke konsideruar faktin që ky raport ka përfunduar në fund të vitit 2023 ndërsa detyrimi për raportim për 6-mujorin e dytë ishte në fund të muajit janar 2024 gjykojmë se vlerësimet e mësiperme nuk pasqyrojnë situatën për gjysmën e dytë të vitit e cila rezultoi e përmirësuar sa i përket OSHEE sh.a.. Gjithashtu, në këtë raport evidentohet fakti që gjatë vitit 2023 nuk ka pasur sulme serioze kibernetike në sektorin e energjisë.

Në kuader të forcimit dhe mbajtjes së standarteve të sigurise kibernetike për vetë rregullatorin, ERE ka zhvilluar procedurën me objekt "Përmirësimi i mbrojtjes dhe sigurisë së rrjetit të ERE dhe implementimi i firewall" dhe ka finalizuar kontraten me operatorin ekonomik fitues.

Po ashtu pergjate takimeve me autoritetin e AKCESK eshte vene theksi ne bashkepunimin dhe bashkerendimin e punes midis te dy institucioneve per ndryshimet e nevojshme ligjore dhe perfshirjen e infrastrukturave kritike te energjise, bashkepunim qe do te vijoje dhe me tej midis te dy institucioneve tona.

11. Krijimi i platformës së Garancive të Origjinës

ERE në maj te vitit 2023 ka firmosur me shoqerinë Grexel e përzgjedhur nga Sekretariati i Energjise në Vienë, kontratën për shërbimin e mbajtjes së regjistrit elektronik të garancive të origjinës në vendet e Traktatit të Energjisë së vendeve të Evropes Juglindore. Sa më siper shënon një hap të rëndësishëm në njohjen e Garancive të Origjinës në vendet e rajonit. Në po këtë kuadër përgjatë vitit 2024 do të realizohet dhe pjesmarrja e plotë e ERE-s në Shoqatën Evropiane te Autoriteteve lëshuese të garancive të Origjinës (AIB). Përgjatë 2023 janë lëshuar Certifikata të Garancisë së Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme për të licencuarit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te cilat do të regjistrohen në platformën Grexel gjatë muajve të parë të vitit 2024. Ne po kete prizem ERE ka filluar proceduren me vendimin 379/2023 per miratimin e "Rregullores për Lëshimin,

Transferimin, Shlyerjen dhe Revokimin/Anullimin e Garancive të Origjinës për Energjinë Elektrike të Prodhuar nga Burimet e Rinovueshme" ne perputhje me parashikimet e ligjit 24/2023 "per nxitjen e perdorimit te Energjise nga Burimet e Rinovushme" e cila eshte na fazen e konsultimeve me palet e interesit.

12. Funksionimi i proceseve të tregut

Raportimet periodike të infrastrukturave kritike për *Cybersecurity* nga ana e kompanive pjesë e rregullores dhe në bashkëpunim dhe me USAID/NARUC i cili aktualisht ka angazhuar asistencë teknike për ERE-n lidhur me këtë rregullore po punohet mbi përpunimn e të dhënave apo dhe mundësinë e përmirësimeve në Regullore sipas eksperiencës së krijuar.
Në po këtë kuadër është e rëndësishme të theksohet se dhe gjatë takimeve me USAID është vendosur theksi në marrjen e masave dhe të regullatorëve perveç analizimit dhe mbikqyrjes së të licencuarve dhe mbajtja e standardeve të *Cybersecurity* për vetë Regullatorin. Në këtë prizëm, gjatë vitit 2023 do punohet për krijimin e një rregulloreje të brendshme dhe parashikimin në buxhet të realizimit të një testi për *Cybersecurity* në IT-në e ERE-s.

Termat tona të Referencës (TOR) rreth *Cybersecurity* u përzgjodhën nga NARUC për raundin e parë të asistencës teknike afatshkurtër për sigurinë kibernetike. NARUC synon të mbështesë ERE-n në lidhje me vlerësimet rregullatore, të përgatitjes së infrastrukturave kritike duke patur si synim në perfundim këto dokumenta si mëposhtë vijojnë:

- ✓ Udhëzues të personalizuar për të vlerësuar investimet kibernetike duke përdorur rezultatet e një modeli maturimi.
- ✓ Modeli i personalizuar i vlerësimit të rrezikut dhe udhëzimi.
- ✓ Axhendë e personalizuar dhe Planifikim për përditësime të vazhdueshme të proceseve dhe raportimit të incidenteve.

  Nëpërmjet kësaj Asistence Teknike që do të ofrohet nga USAID, stafi i ERE-s do të marrë eksperiencë dhe do të jetë më i aftë për të vlerësuar planet e gatishmërisë kibernetike të paraqitura nga shoqëritë dhe do të jetë më i përgatitur për të monitoruar sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit elektroenergjetik shqiptar dhe për të avancuar praktikat më të mira të sigurisë kibernetike, kjo do të mundësojë monitorimin efektiv të mbrojtjes kritike të infrastrukturës së rrjetit elektrik.

- Është marrë pjesë në grupet e punës së ngritura nga ECRB në të cilën janë diskutuar problematkat e hasura nga implementimi i Regullores së Cyber Security në vendet e Sekretariatit e me gjerë.
- ERE ka vijuar komunikimin me NARUC lidhur me implementimin e plotë të rregullores për sigurinë kibernetike Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë.
- Janë plotësuar pyetësorët e dërguar nga NARUC në të cilat është evidentuar një seminar me përfshirje të gjerë të ERE, dhe operatorëve që zotërojnë infrastruktura kritike OST sh.a. OSSH sh.a. dhe KESH sh.a..
- Janë realizuar gjatë vitit 2023 seminarë me pjesëmarrësit e tregut dhe përfaqësues NARUC.
- Përsa i takon zbatimit të rregullores së REMIT është marrë pjesë aktive në grupet e punës së Sekretatriatit si dhe trainimet e përbashkëta midis Sekretariatit dhe ERRA lidhur me zbatimin e rregullores dhe detyrat që i dalin palëve përfshirë këtu dhe ERE për zbatimin e saj si dhe në shkollat rregullatore të organizuara po nga Sekretariati lidhur me këtë tematikë. Po ashtu është menduar që me ndihmën dhe të Sekretariatit të zhvillohet një seminar me pjestarët e tregut për të shkëmbyer eksperiancat në këtë drejtim dhe për të shpjeguar mënyrën e funksionimit të Regullores dhe detyrat që i dalin palëve nga zbatimi i saj.
- Është zhvilluar një trajnim i gjerë me përfaqësuesit e CRE-së, Francë, pjesë e programit të bashkëpunimit me Agjensinë Franceze të Zhvillimit, gjatë së cilit u shkëmbyen

eksperiencat me përfaqësuesit e rregullatorit Francez lidhur me masat e marra për monotorimin e tregut, kushtet që duhet të plotësojnë të licencuarit apo dhe mënyrat e investigimit si në tregun vendas ashtu dhe në rastet e investigimeve në tregjet e përbashkëta. Në përfundim të trajnimit nga ana e palës Francese u përpilua dhe një raport i cili do t'ju shërbejë specialistëve të ERE-s në vijim për përmirësimin e punës në drejtim të monitorimit të tregut.



- Në këtë kuadër u vlerësua e domosdoshme mundësia e automatizimit nëpërmjet platformave online nga faqja web-it të ERE-s ose link-u i saj ku pjesëmarrësit e tregut të plotësojnë formularët e regjistrimit në Remit apo dhe të hedhin të dhënat e duhura të nevojshme për zbatimin e rregullores apo dhe të dhëna të tjera të cilat nevojiten për raportimet periodike që kryhen në Kuvend dhe që lidhen ngushtësisht me monitorimin e tregut të energjisë elektrike dhe të gazit natyror. Për realizimin e këtij funksioni është e nevojshme adaptimi i faqes së *web*-it të ERE-s apo dhe krijimi i një *database* për monitirmin e tregut

Gjatë vitit 2023 ka ecur ndjeshëm puna me qëllim realizimin e kësaj platforme e cila aktialisht është drejt finalizimit.

13. Realizimi i bashkimit të tregjeve Shqipëri -Kosovë

Në lidhje me këtë detyrë është synohet që gjatë vitit 2023 të vijnte puna me sekretariatin per implementimin e CACM ne vendet e rajonit. Nepermjet paltformes se trainimit qe do te trajtohen nepermjet sshkolles se Balkanit te energjise e krijuar me pjesmarrjen e Italise, Malit te Zi maqedonise dhe Bosnjes do te shihet mundesia kontrollit te legjislacionit kombetar per barrierar e mundshme

14. Transparenca dhe integriteti në veprimitarinë administrative

Sa i përket përfshirjes së palëve të interesuara në përcaktimin e strategjive, politikave rregullatore, mund të themi që ERE ka treguar kujdes të shtuar sa i përket konsultimit me një numër gjithmonë e më të madh të palëve të interesit duke përfshirë në praktikën e punës së rregullatorit dhe njoftimet e vendimamrrjeve të ERE nëpër rrjete sociale më qëllim arritjen e një numri më të madh të palëve të interesit të cilat nuk mund të identifikohen si të tilla lehtësisht nëpërmjet metodave konvencionale të mendimarrjes shkresore.

Për këtë qëllim në fund të vitit 2022 është miratuar *Metodologjia e analizës së ndikimit të akteve rregullatore të Entit Rregullator të Energjisë.*

Kjo Metodologji përmban disa udhëzime të përgjithshme se si ERE synon të zbatojë analizën e ndikimit të rregullimit në përputhje me fushën e përgjegjësisë së saj, sikurse parashikohet në ligjin nr. 43/2015 dhe nr.105/2015. Në kuptim të këtyre ligjeve, ERE ushtron funksione mbikqyrëse dhe rregullatore, (nxjerres së akteve rregullatore, metodologji) vendosjes së tarifave, licencimit të subjekteve. Metodologjia ka funksionin e vlerësimit të një vendimi rregullator, në lidhje me palët që ju drejtohen këto akte për të verifikuar nëse një operacion rregullimi është i nevojshëm dhe efektiv, nëpërmjet përshkrimit të objektivave, identifikimit të problematikave, krahasimi midis opsioneve alternative; vlerësimin e përfitimeve dhe kostot për pjesëmarrësit e tregut; efektet pozitive dhe negative në proceset rregullatore.
Në metodologji është parashikuar që analizës së ndikimit rregullator do t'i nënshtrohen kryesisht aktet rregullatore për:

- Përcaktimin e çmimeve për klientët fundorë për një periudhë të re rregullatore;
- Përcaktimin e cilësisë së shërbimit për një periudhë të re rregullatore;
- Ndryshimin e kushteve të shërbimit universal;
- Shpenzimet totale të rregullimit;
- Aksesi në tregun e energjisë.

Sa i përket Publikimit të vendimeve, relacioneve dhe aplikimeve rezulton se janë publikuar në faqen e ERE të gjitha vendimmarrjet e ERE të vitit 2023 dhe gjithashtu relacionet e aplikimeve apo aplikimet për përcaktimin e tarifës nga Rregullatori.

Sa i përket Ngritjes së strukturave konsultative të përhershme të tillë si komisione të përbashkëta të palëve të interesit që do ti shërbejnë vendimmarrjes, gjatë vitit 2023 është punuar për draftimin e rregullave për përzgjedhjen e strukturave konsultative dhe synohet që gjatë vitit 2024 të miratohet ky dokument për ti hapur rrugën përzgjedhjes së komisioneve të përherëshme të cilat do të shërbejnë si një mendim i pavarur e në mbrojtje të interesave të palëve të treta me synim daljen në vendimmarrje të mbështetura në gjithëpërfshirjen e këtyre të fundit.

Sa i përket detyrës që lidhet me Studimin e praktikave më të mira për vlerësimin e efekteve të rregullimit me mbështetje nga ekspertë akademikë dhe ekspertë të tjerë me përvojë në fushë, synohet që kjo detyrë të kryhet gjatë vitit 2024.

Ligji nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë elektrike", i ndryshuar, ka përcaktuar detyrimet e operatorëve të rrjetit si dhe të ERE në procesin e hartimit, shqyrtimit, miratimit dhe zbatimin e kodeve të rrjetit. Në lidhje zbatimin e këtyre detyrimeve ligjore, ERE do të vijojë të kërkojë angazhimin e operatorëve të rrjetit mbi administrimin e kodeve respektiv. Pjesë e administrimit të kodeve të rrjetit janë dhe vlerësimet që duhet të bëhen nga Operatorët e rrjetit për të bërë propozimet përkatëse në ERE lidhur me hartimin, ndryshimet e këtyre akteve të cilat mund të lidhin si rezultat i kërkesave ligjore, por edhe si rezultat i nevojës për përshtatje në kuadër të zhvillimit të rrjetit që këta operatorë administrojnë. ERE, në përputhje me legjislacionin në fuqi ka shqyrtuar dhe vlerësuar duke bërë dhe miratimet përkatese propozimet e operatorëve të rrjetit për ndryshime apo miratime të këtyre kodeve në frymën e zhvillimit të këtyre normave nga ENTSO-E si dhe transpozimeve përkatëse të Komunitetit të Energjisë EnC. Gjithashtu në frymën e administrimit të Kodeve janë vlerësuar raportet për administrimin e kodeve të rrjetit dhe pajtueshmërinë e përdoruesve të rrjetit me kodet përkatëse. Në të njëjtën kohë, në zbatim të rregullores për miratimin e kritereve për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike të miratuar me vendimin e Bordit nr. 85, datë 12.05.2020 si dhe janë shqyrtuar kërkesat për derogime nga këto kode.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE PËR VITIN 2024-2026

Me këtë dokument, Enti Rregullator i Energjisë, në vijim ERE, adreson objektivat strategjikë dhe aspektet kryesore të veprimit për periudhën 2024 – 2026 në kuadër të dinamikës së zhvillimit të sektorit në kontekstin kombëtar, si dhe atë të integrimit rajonal.

Enti Rregullator i Energjise, në vijim ERE, nëpërmjet këtij dokumenti sjell të perditësuar objektivat strategjikë dhe planin e veprimit për periudhën 2024 - 2026.

Ky dokument strategjik, vjen në vijim të Objektivave Strategjikë të ERE-s për vitet 2021-2023, të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 74, datë 12.03.2021. Përmes miratimit të këtyre objektivave ERE siguron vullnetin e plotë të saj për të kontribuar plotësisht në ofrimin e shërbimeve rregullatore në perputhje me politikën në vend, siç është adresimi i çshtjeve mjedisore, sigurimi i furnizimit të pandërprerë dhe me cilësi të energjisë dhe mbrojtja e interesave të të gjithë konsumatorëve (përfshirë fuqizimi i tyre). Ky plan është rezultat i një procesi të gjerë të studimit të ndryshimeve që ka pësuar tregu i energjise, politikave rregullatore jo vetëm në eksperiencën e ERE por edhe në kuader të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare ku jemi anëtare.

Në praktikën e saj të punës ERE do të vijojë angazhimin me cdo palë të interesit në formën e konsultimeve të saj apo marrjen e opinioneve për përmirësimin e punës së saj apo në hartimin dhe rishikimin e akteve rregullatore.

Këndvështrim i përgjithshëm, Misioni, Vizioni dhe objektivat e ERE

Krijimi i ERE

Enti Rregullator i Energjise (ERE) është Rregullatori i pavarur i energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri i krijuar për herë të parë në vitin 1996 me ligjin për rregullimin e sektorit të energjise elektrike dhe aktualisht funksionon në bazë të ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

Kompetencat

ERE është një organ i administratës publike i organizuar si ent publik, fusha e përgjegjësisë së të cilit përfshin kompetenca në drejtim të:

Hartimi i akteve rregullatore

ERE miraton aktet rregullatore në tregun e energjise lidhur me ushtrimin e aktivitetit te prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, dhe furnizimit të energjisë, përfshirë kontratat tip ose kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Trajton mosmarrëveshjet në lidhje me ankesat e klientëve ndaj të licensuarve dhe ndërmjet të licensuarve.

Shqyrtimi i planeve të investimeve

Shqyrton dhe miraton në përputhje me parimin e planifikimit me koston më të ulët, planet e investimeve të operatorëve të rregulluar.

Licencimi i subjekteve në tregun e energjisë

Trajton kërkesat për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave për ushtrimin e aktiviteteve në veprimtarinë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike. Në sektorin e gazit natyror, ERE shqyrton aplikimet për licensim për ushtrimin e aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, dhe furnizimit të energjisë.

Përcaktimi i Tarifave

Aktivitetet që lidhen me detyrimet e shërbimit publik nga të licensuarit realizohen me tarifa dhe cmime të përcaktuara nga ERE.

Rritja e kërkesës për energji, nevoja për zgjerimin e rrjetit apo mirëmbajtje, zhvillimi teknologjik ndikon në kostot e shërbimit, dhe si të tillë në cmimin e shitjes së energjisë elektrike.

Monitorimi

Ligji përcakton të drejtën e ERE për të monitoruar dhe kontrolluar funksionimin e tregut të energjisë elektrike si dhe për te detyruar të licencuarit të ndërmarrin masa të nevojshme për nxitjen e konkurrencës efektive dhe sigurinë e funksionimit të tregut. Po ashtu ERE monitoron zbatimin e kontratave të lidhura midis të licencuarve duke ushtruar të drejtën e aksesit mbi dokumentacionin dhe informacionin e të licencuarit dhe duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë si dhe kontrollon nëse shërbimi është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kushtet e licencës apo rregulloret e miratuara nga ERE. Në cdo rast monitoron kryerjen e veprimtarisë nga operatorët e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Organizimi

ERE është nje person juridik publik, me seli në Tirane dhe përbëhet nga Bordi i Komisionerëve me nje Kryetar dhe 4 Anëtarë, të cilët kane funksion vendimmarrës dhe emërohen nga Kuvendi i Shqiperisë. Përvec Bordit është edhe personeli teknik i organizuar në Drejtori dhe Sektorë. Pjesë integrale e Strukturës aktuale të ERE janë edhe Këshilltari dhe Sekretari i Përgjithshem.

Misioni i Entit Rregullator në Sektorin e Energjisë

Garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Rregullimi i marrëdhënieve në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, i cili vendos rregullat lidhur me:

a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;

b) pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;

c) dhënien e autorizimeve dhe licencave në sektorin e energjisë elektrike;

ç) rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;

d) integrimin e tregut shqiptar në tregun rajonal dhe atë europian të energjisë elektrike.

Misioni i Entit Rregullator në Sektorin e Gazit Natyror

Garantimi i shërbimeve për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të sigurt për funksionimin e tregut të gazit natyror, duke mundësuar krijimin e një tregu funksional dhe konkurrues duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me gaz natyror si dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Rregullimi i marrëdhënieve në veprimtaritë e transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, depozitimit të gazit natyror, si dhe operimit në impiantet e GNL-së, i cili vendos rregullat lidhur me:

a) përcaktimin e fazave të hapjes së tregut, organizimin dhe funksionimin e nje tregu konkurrues, duke mundësuar dhe siguruar qëndrueshmërinë në investimet e nevojshme në rrjete.

b) dhënien e autorizimeve dhe licencave për shoqëritë e gazit natyror.

c) krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror, duke bashkëpunuar me autoritete të tjera rajonale dhe/ose europiane rregullatore.

Vizioni i Entit Rregullator

Një rregullator që njeh rolet dhe përgjegjësitë e tij në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, të cilin e ushtron bazuar në parimet e transparencës, besueshmërisë, drejtësisë dhe praktikat më të mira, duke bërë të mundur një sektor konkurrues të energjisë ku cdo palë ndihet e mbrojtur dhe e perfshirë dhe gjithashtu investitori dhe shteti gjejnë të ekuilibruara interesat e tyre.

Puna e ERE në ushtrimin e përgjegjësive të saj rregullatore ndikon jo vetëm ndaj konsumatorëve por edhe aktorëve të tjerë të tillë si operatorët e rrjetit, investitorët, dhe qeveria, në kuadër te ofrimit të një sherbimi të sigurt dhe të qëndrueshëm në interes të të gjithë palëve. ERE vepron si një organ i pavarur por gjithmonë brenda një kuadri politik dhe të vendosur në ligje dhe në aktet e KM apo politikat e tjera të organeve të ngarkuara me ligj për rregullimin e aspekteve të caktuara të sektorit të energjisë.
Një fushë thelbësore e punës së ERE për tre vitet e ardhshme është bashkëpunimi me palët e interesuara, duke vendosur një program veprimesh që nevojitet për të arritur objektivat 2024-2026, duke vazhduar të përmbushë kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe ndryshimeve respektive të tij,- objekt i fushës së përgjegjësisë së ERE. Legjislacioni dhe politika e re në sektorin e energjisë elektrike rrit ndjeshëm rolin dhe përgjegjësinë e ERE në këtë periudhë, pasi merr ne konsiderate zhvillimet teknologjike, të sigurisë, përfshirë asaj kibernetike, dhe fuqizimit të konsumatorit referuar Clean Energy Package. Plani strategjik i ERE gjithashtu përcakton prioritetet tona për të mundësuar dhe mbrojtur konsumatorët e energjisë, veçanërisht konsumatorët vulnerabël. Sigurimi që klientët aktiv dhe komunitetet e energjisë luajnë një rol në rritje në veprimet në kuadër të mbrojtes mjedisore zhvillimit të buriemeve të rinovueshme, do të jenë fusha thelbësore të fokusit të këtij plani strategjik që bazohet në legjislacion dhe zhvillimet e politikave në vend. Qëllimi i këtij plani strategjik është edhe përdorimi eficent i burimeve ekonomike dhe njerëzore duke u përshtatur edhe me mënyrat më fleksibile të punës bazuar në nje vizion për furnizime të sigurta, dhe të qëndrueshme të energjisë.

Plani ë strategjik I ERE ka tre pjesë:

Misioni i ERE : - Eshtë ajo që ERE bënë çdo ditë bazuar në rolin dhe fushën e përgjegjësisë të përcaktuar në ligj;

Vizioni I ERE - përcakton një rrugë të qartë për të gjitha shërbimet që ofrojmë.

Objektivat/ prioritetet e ERE përfshirë planin e veprimeve të ndërlidhura mes tyre pasqyrojnë fushat e fokusit dhe përmirësimit ndër-organizativ për të siguruar në kohë dhe me efikasitet funksionet rregullatore në përputhje me misionin dhe vizionin e ERE.

Objektivat, prioritet dhe iniciativat

Roli i ERE në sektorin e energjise elektrike dhe gazit natyror është të sigurojë përmes akteve rregullatore furnizimin e vazhdueshëm me cilësi dhe me kostot më të ulëta, të promovojë konkurrencën dhe zhvillimin në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike dhe me gaz natyror. ERE përcakton tarifat e operatorëve të rrjetit, monitorimin dhe mbikqyrjen e aktiviteteve të të licencuarve, miratimin e akteve nënligjore për ushtrimin e aktiviteteve në tregun e energjisë.

Në ushtrimin e përgjegjësive të saj ERE synon të jetë:

- Një institucion i besueshëm, që siguron ekspertizën e saj në sherbimet që ofron;
- Administrim eficient dhe efektiv të proceseve rregullatore
- Përfshirje të të gjitha palëve të interesit në praktikat rregullatore

Objektivat strategjik të ERE për periudhën 2024- 2026

- Mbrojtja e konsumatorëve duke u mundësuar atyre të marrin pjesë në tregjet e energjisë;
- Rregullimi efektiv per nje treg konkurrues përmes monitorimit dhe raportimit, tarifave të drejta, zbatimit dhe përputhshmërisë.
- Promovimi i rregullimit efikas të infrastrukturës duke inkurajuar operatoret e rrjeteve për të shërbyer si platforma ndëraktive për shërbimet energjitike,
- Përdorimi i ekspertizës për të informuar rreth zhvillimeve te tregut të energjisë dhe mbështetja e tranzicionit të energjisë.

Çdo vit, ERE raporton në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kuvend dhe është objekt i vlerësimit dhe rekomandimeve në Rezolutën respektive. Për këtë ERE harton nje plan veprimi dhe përshtat planin e veprimit të miratuar në kuadër të Objektivave Strategjike.

Pjesë e vazhdueshme e punës së ERE do të jetë në vijim edhe bashkepunimi me organet e tjera dhe palët e interesit në tregun e energjisë në fushat me interes të përbashkët, për një konsumator të kenaqur, një sistem i sigurt i energjisë elektrike dhe gazit; zhvillimi efektiv i tregjeve të hapura dhe konkurruese; dhe investime efikase dhe në sistem.

ERE si rregullator, e bënë këtë duke kryer funksionet rregullatore, në bashkëpunimin me institucionet dhe aktorët e tjerë për të ndërtuar besimin në autoritetin e saj. Strategjia e ERE është e fokusuar në arritjen e një sistemi të energjisë elektrike që është:

I qëndrueshëm - ku konsumatorët mund të kenë mundesi për tu përfshirë në prodhimin, rezervimin dhe në tërësi të perfitojnë nga teknologjitë e rinovueshme.

Ata mund të kontrollojnë përdorimin e tyre të energjisë, duke ulur kostot dhe te ndikojnë në përmirësimin e mjedisit.

I aksesueshëm - Konsumatorët kanë mundësi përmes proceseve të thjeshta dhe të qëndrueshme për të hyrë në tregun e energjise. Ata mund të zgjedhin furnizuesit e tyre të energjisë nga një treg konkurrues dhe efikas.

I sigurt dhe efikas - Konsumatorët kanë besim në furnizuesit e tyre të energjise dhe janë më pak të ekspozuar ndaj çmimeve të larta.

Objektivi kryesor i ERE është mbrojtja e interesave të konsumatorëve, tani dhe në të ardhmen, duke përfshirë interesin e tyre në një mjedis më të pastër dhe më të gjelbër. ERE synon ta arrijë këtë duke vendosur:

- çmime të drejta për konsumatorët
- monitorimin dhe zbatimin e standardeve të cilësisë dhe standardeve të shërbimit

ERE synon të jetë fleksibël për të përshtatur sherbimet dhe praktikat rregullatore me zhvillimet dhe sfidat e reja të sektorit të energjisë.

Objektivi 1 - Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë dhe fuqizimi i konsumatorëve.

Një nga prioritet kryesore të punes së ERE është mbrojtja e konsumatorëve me fokus në mënyrë të vecantë të konsumatorëve që për rrethana ekonomike apo sociale janë në pamundësi për të kuptuar drejtedhe për të marrë vendimet e duhura që lidhen me furnizimin e tyre me energji.

Plani jonë i veprimit në këtë drejtim përfshin:

- ERE informon nëpërmjet të gjitha mjeteve që lehtësojnë komunikimin me konsumatorët me qëllim qe ata të marrin pjesë në mënyrë efektive ne treg.
- ERE mbështet dhe mbron konsumatorët e energjisë, për të realizuar këtë ERE së pari përpunon informacionet qe lidhen me konsumatorët në tregun e energjise për të vijuar më tej me përgatitjen e informacioneve lehtësisht te kuptueshem te konsumatorëve të energjisë.
- ERE zhvillon pyetesorë me qellim që të kuptojë drejtë mungesat në informacion apo natyrën e informacionit që konsumatorët kanë nevojë, apo sa besim kanë konsumatorët në shërbimet që atyre ju ofrohen dhe në informacionet që marrin.

Natyrisht jo vetëm ERE, por edhe organizma të tjerë punojnë fuqimisht për të rritur mbrojtjen e konsumatorit, si për shembull: Zyra e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Ministrisë së Financave, Agjensia për Eficiencen e Energjisë, Avokati i Popullit, organizmat dhe shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit, etj. ERE vlerëson me mjaft rëndësi bashkëpunimin me këto institucione për të vijuar punën e saj për të ofruar fushata informimi publik dhe edukim të konsumatorëve.

Po ashtu ERE do te bashkëpunojë me furnizuesit për të siguruar politika informuese/ edukuese.

Një tjetër dimension me mjaft rëndesi në mbrojtjen e konsumatorit është dhe mbrojtja konsumatorit në këndvështrimin e diferencave gjinore.

Në shumë kontekste, janë grate që vuajnë më shumë nga kushtet e varfërisë ekstreme. Por edhe grupe te tjera jane ekspozuar në këtë drejtim. Të tillë jane njerëzit e moshuar, fëmijët, njerëzit me aftësi të kufizuara, etj.

Plani i veprimit

Politika e ERE në mbrojtjen e konsumatorit do të marrë në konsiderate edhe promovimin e politikës me fokus grupe në përgatitjen e informacioneve të tilla si ato për perdorimin eficient të energjisë, programet e vecanta për të përfituar nga skemat qeveritare apo dhe ato të shoqatave me fokus mbështetjen e konsumatorit. Të tilla jane promovimi i pjesëmarrjes në Komunitetet e Energjisë.

Po ashtu në funksion të këtij objektivi ERE do të zhvilloje Strategjinë e saj për mbrojtjen e Konsumatorëve.

Gjatë vitit 2023 me Urdhër të Kryeministrit është ngritur një grup pune për hartimin e kritereve për përfitimin e statusit të klientëve në nevojë, dhe masave respektive për mbështetjen e tyre. ERE në vijim do të punojë për të reflektuar këtë politikë të qeverisë në strategjine e saj të mbrojtjes së konsumatorit.

Plotësimi dhe rishikimi i kuadrit rregullator

Politika e mbrojtjes së konsumatorit është vazhdimisht në zhvillim për t'iu përgjigjur mjedisit të ndryshem, nevojave dhe pritshmërisë së konsumatorëve.

Plani i veprimit:

ERE është gjithashtu e fokusuar në zhvillimin e kuadrit rregullator për të adresuar qasjen e duhur ne çështjet që janë shumë të rëndësishme për konsumatorët në këtë treg dinamik te energjisë

Si rregullator, ERE gjithashtu do të angazhohet me subjektet e licencuar për të përditësuar planet e masave për shërbimet e ofruara nga furnizuesit dhe respektimin e të drejtave të konsumatorëve nga furnizuesit në perputhje me zhvillimin e kuadrit rregullator.

Pjese e planit te veprimit për mbrojtjen e kosumatorit do të jete edhe përgatitja e informacioneve perfshirë këtu video mesazhe apo quizze për të kuptuar nivelin e tyre të informacionit për të drejtat e tyre për ndryshimin e furnizuesit, apo pse është në të mirë të tyre të përdorin të drejtën e tyre për ndryshimin e furnizuesit. Në funksion te edukimit do të jetë edhe promovimi i Platformës Pct të krahasimit të cmimeve.

ERE ka gjithashtu si pjesë të strukturës organizative te saj një strukture të dedikuar për trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe mosmarrëveshjeve midis operatorëve dhe konsumatorëve dhe është fokusuar në sigurimin e informacionit të qartë, për të informuar drejt konsumatorët e energjisë për të drejtat e tyre.

Arritja e këtij objektivi do të mbështetet kryesisht nga Drejtoria e Mbrojtjes se Konsumatorit si struktura qe vendos kontaktin e pare me konsumatorin i cili zakonisht i drejtohet dhe njihet me ERE në momentin e nje pakënaqësie ndaj furnizuesve.

Sa i takon edukimit të konsumatorit kjo do të jetë një punë që do të perfshijë angazhimin e plotë të të gjitha niveleve vendimarrëse dhe drejtuese në ERE.

Përvec sa më sipër plani i veprimit të ERE për qëllime të fuqizimit të konsumatorit përfshin:

Përditesimi i akteve rregullatore me praktikat më të mira rregullatore dhe me ndryshimet në legjislacionin primar. Pa përjashtuar mundësine e rishikimit apo nxjerrjes së akteve te tjera, ERE vlerson si prioritare rishikimin e akteve rregullatore si vijon:

- Kushtet e përgjithshme të kontrates së furnizimit;

- Rregullat për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjes së mosmarrveshjeve;

- Rishikimi i rregullave të trajtimit të ankesave nga furnizuesit dhe planeve të masave të tyre. Për këtë qëllim, puna do të konsistojë në zhvillimin e pyetësoreve me konsumatorët dhe me vetë furnizuesin lidhur me perceptimet e tyre ndaj këtyre rregullave.

Rishikimi do te konsistojë në përshtatjen me rregullimet në legjislacionin primar të sektorit por edhe atë të zgjidhjes së mosmarrveshjeve. Për këtë ERE do të punojë ngushtësisht me të gjitha palët, institucionet shtetërore, shoqatat e konsumatorit dhe operatorët (të licensuarit) për të ndarë me ta nevojat për ndërhyrjet e ndryshme në përmirësimin e këtyre rregullave për të pasur nje qasje gjithnjë e më afër te zgjidhjeve jashtëgjyqësore të mosmarreveshjeve.

Fuqizimi i Konsumatorit do të konsistojë edhe në vendosjen e planeve të përbashketa me shoqatat e konsumatorit dhe autoritetet lokale për promovimin e komuniteteve të energjisë dhe zhvilliimin e programeve edukuese për organizimin dhe pjesëmarrjen në këto komunitete.

Promovimi i sondazhit të vlerësimit të kënaqesisë së besueshmërise konsumatore, duke futur modele të standartizuara për marrjen e informacionit mbi nivelin e shërbimit të perceptuar nga konsumatori, do të jetë pjesë e standardeve të komunikimit me publikun.

Do të punohet për të kuptuar aksesin në shërbime digjitale nga konsumatori dhe për nevojën për promovimin e shërbimeve digjitale sa më të thjeshta.

Plani i veprimit do të perfshijë edhe promovimin e sherbimeve me fokus klientët me aftësi ndryshe për të mundësuar kështu akses të plotë dhe të njëjtë për të gjith konsumatorët.

Objektiva të ERE për mbrojtjen e konsumatorit janë gjithashtu:

Tarifa te drejta: Tarifa të bazuara në shërbime të realizuara me koston më të ulet dhe eficente e të shpërndara në mënyrë të drejtë. Këto tarifa duhet të shmangin ndërsubvencionet e të shmangin riskun e ekspozimit të konsumatorëve ndaj ngjarjeve të papritura.

Standarte dhe cilesi sherbimi - Shërbimet e klientëve gjatë zinxhirit të furnizimit me energji duhet të jenë të qendrueshme, transparente dhe të përgjegjshme. Konsumatorët duhet të mbrohen në funksion të një shërbimi me cilësi.

Plani i veprimit:

Për këtë ERE do të kryejë një proces konsultimi mbi efektivitetin dhe nevojën për rishikim me të gjitha palet e interesit dhe në vleresim të praktikave më të mira rregullatore dhe në pershtatje të mundesive dhe nevojave për investime.

N konsulte me praktikat më të mira dhe në kuader të problematikave të hasura deri më tani, ERE do të rishikojë Metodologjitë respektive të përcaktimit të tarifave.

Fleksibilitet
Konsumatorët kanë furnizim të sigurt dhe të qëndrueshëm. Kjo do të thote që sektori tërheq investime të mjaftueshme afatgjata për të ofruar interesa të konsumit.

Plani i veprimit perfshin vendimarrje të kujdeshme per investime që lidhen me sigurinë e furnizimit, dhe që fuqizojnë më tej rrjetin, e që jane të hapur ndaj zhvillimeve teknologjike.

Objektiv 2 - Për një treg konkurrues përmes rregullimit, monitorimit dhe raportimit, zbatimi dhe përputhshmëria.

Liberalizimi

"Paketa e pastër e energjisë" e vendos konsumatorin në qendër të tregut, nga njëra anë duke u bazuar në të drejtën e tij për zgjedhjen e lirë të furnizuesit, duke siguruar pjesëmarrje aktive të konsumatorëve. Aktualisht ERE ka miratuar rregullat për ndryshimin e furnizuesit. Zbatimi i

këtyre rregullave në një kontrast që garanton tregun operacional është një nga prioritet e ERE. Përveç zbatimit të të detyrimeve të caktuara nga ligji për aspektet që lidhen me tregun e brendshëm të energjisë elektrike, ERE duhet të monitorojë tregun e në mënyrë të vecantë zhvillimet e tregut të shitjes me pakicë, duke patur parasysh edhe politikën e qeverisë dhe ministrisë përgjegjëse për energjinë në lidhje me liberalizimin e tregut i cili në janar të ketij viti, me daljen në treg të lirë të një numri jo të vogel konsumatorësh, rregjistroi në total 7358 konsumatorë që furnizohen në treg të lirë

Monitorimi

Si cituar më sipër një nga përgjegjësitë e ERE është edhe monitorimi i të licensuarve në tregun e energjisë. ERE në zbatim të Ligjit 43/2015 "Për Sektorin e energjisë elektrike ", më konkretisht Neni 19, gërma k), publikon në faqen e internetit të dhëna katërmujore për funksionimin e tregut të energjisë elektrike. Këto te dhena përpunohen edhe mbi bazë vjetore dhe përfshijnë:

- Të dhëna mbi prodhimin neto vendas e te ndarë sipas kategorisë prodhim nga kompania publike apo burimet e tjera,

- Energji e siguruar per Furnizuesin Universal, për Furnizuesin Publik, energji e siguruar për mbulimin e humbjeve,

- Të dhëna që lidhen me Oshee Group (OSSH; FSHU, FTL) përfshirë energji totale e hyrë per OSHEE, humbjet totale ne rrjet,

- Shitjet sipas kategorive të konsumatorëve

- Arkëtimet

- Bilanci i OST (prodhimi, eksport, import i realizuar në vend).

Gjithashtu ERE përgatit Raporte dhe të Dhëna të Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike

Implementimi i REMIT aktualisht bazohet në Kuadrin ligjor dhe praktikat më të mira ndërkombetare të orientuar në:

Detyrimin për të publikuar informacione të brendshme
Ndalimin e abuzimit të tregut (tregtimi i brendshem dhe manipulimi i tregut)

- Monitorimin e Tregut (regjistrimi i pjesëmarrësve në treg).Mekanizmin e Raportimit te detajuar, mbledhja e të dhënave
- Kompetencat hetimore dhe të zbatimit të penaliteteve te rregullatorit
- Aspekte të tjerë në lidhje me mbrojtjen dhe besueshmërinë e të dhënave
- Lista e kontratave dhe të dhënave që do të raportohen
- Palët përgjegjëse dhe afatet
- Udhëzime, rekomandimeNjohja e palëve me detyrimet e zbatimit të kësaj rregullorejeBashkveprimi ndër rajonal për zbatimin e saj në rajon e më gjerë

Sikurse edhe më sipër politikat rregullatore edhe ne vijim do të kenë për qëllim që të sigurojnë qëndrueshmëri ligjore dhe rregullatore per të menaxhuar potencialin për praktika abuzive që dëmtojnë ne menyre te padrejte tregun.

Plani i veprimit

Aktualisht ERE ka miratuar Rregullat për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT), në vijim të miratimit të të cilave puna e ERE do të konsistojë në monitorimin e zbatimit të këtyre rregullave.

Fokusi i punës së ERE edhe përgjate viteve 2024 - 2026 do të vijojë të jetë përditësimi i Regjistrit Kombetar REMIT në Shqipëri, i publikuar rregullisht edhe në faqen e ERE sikurse publikimin e të dhenave mbi tregun e brendshëm të energjisë elektrike.

Por gjithashtu ERE do të monitoroj rregullisht transparencën në shërbimet e operatorëve, jo vetem me qëllim informimin e konsumatorëve, por edhe për të vlersuar zbatueshmërinë e përgjegjësive të tyre në raport me aktet rregullatore në fuqi.

Konkurrenca

Një treg efektiv i energjisë ka në themel konkurrencën. Është në pergjegjësinë e ERE që vendimarrjet e saj, të promovojnë konkurrencën. Si e tillë kjo kërkesë ligjore është një objektiv i vazhdueshëm i ERE.

Plani i Veprimit

Për qëllime të promovimit të konkurrencës në treg ERE synon të forcojë bashkëpunimin me Autoritetin e Konkurrencës për të ndarë zgjidhjet më të mira për promovimin e konkurencës në tregun e energjisë.

Me qëllim arritjen e objektivit për një treg me pakicë që punon për konsumatorët ne synojmë qasjen ndaj metodologjive që sigurojnë çmimet e drejta e q promovojnë konkurrencën dhe investimet inovative në treg, investime në përputhje me politikat mjedisore nëvend si dhe politika që marrin në konsideratë promovimin e burimeve te rinovueshme si dhe mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë. Si e tillë puna e ERE do të konsistojë në një rivleresim dhe konsultë me organizma të ndryshem ndërkombetare për ndarjen e praktikave më të mira dhe të pershtatshme për sektorin e energjisë elektrike n vendin tonë.

Objektivi 3 Të përdorim ekspertizën tonë për të informuar rreth zhvillimeve të tregut te energjisë dhe mbështesin tranzicionin e energjisë.

Qëllimi i ERE në ushtrimin e detyrave të saj është ndër të tjera të jet një burim zyrtar dhe i besuar i informacionit rreth tregut të energjisë. ERE angazhohet në mënyrë efektive me palët e interesuara.

ERE kushton vëmendje në ndjekjen ose promovimin e çështjeve prioritare në sektorin e energjisë.

Plani i veprimit per realizimin e ketij objektivi perfshin:

Studim i cështjeve me impakt në tregun e energjisë duke ofruar eksperiencën dhe ekspertizën tonë në kuadër edhe të bashkëpunimit dhe pjesmarrjes në organizatat ndërkombëtare për të sjellë praktikat më të mira të rregullimit. Komunikimi përmes të gjitha formave të komunikimit përfshirë perdorimin e rrjeteve sociale për të tërhequr vemendje për cështjet me interes të përbashkët.

Për të përmbushur nevojat e sistemit dhe mundësuar apo përshpejtuar investimet e nevojshme në infrastruktura, puna e ERE do te fokusohet ne:

- Bashkëpunimin me operatorët e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në hartimin e planeve te zhvillimit të rrjetit dhe planeve te investimit të kompanive të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike
- Ndërmarrjen e iniciativave per rishikimin e akteve për lidhjen ne rrjet dhe për përdorimin e tij.

Promovimi i teknologjive në shërbimet që ofrohen të tillë si programet për matësat inteligjentë por edhe te programeve të tjera që lidhen me fuqizimin e konsumatorit të till si Programi i Menaxhimit të të dhënave, apo programet e mbrojtjes së të dhenave të konsumatorit.

Po ashtu në kuadër të një dimensioni tjetër te ndryshëm nga ai klasik i operatorëve të rrjetit që lidhet me futjen e shërbimeve dixhitale por edhe me cënueshmerine e tyre prej këtyre shërbimeve, ERE do të fokusohet në përmirësimin e Strategjisë së saj për Sigurinë Kibernetike në perputhje me ndryshimet në ligjin primar për sigurinë kibernetike.

Siguria kibernetike

ERE dhe më heret ka konsideruar me mjaft rëndesi sigurinë kibernetike të infrastrukturave të rrjetit.

ERE ushtron funksionet rregullatore me qëllim promovimin e një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera.

ERE konsideron sigurinë në hapësirën kibernetike si përgjegjësi e përbashkët me të licensuarit që operojnë në sektorin e energjisë elektrike për qëllime të furnizimit pa ndërprerje.

Per kete qëllim ERE hartoi dhe miratoi rregullat dhe masat që duhet të ndërmerren nga operatorët e infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike për të shmangur rreziqet e shkeljes apo dëmtimit të këtyre infrastrukturave në kuadër të operimit përmes platformave të ndryshme dixhitale.

Plani veprimit:

Objektivi yne eshte të vazhdojmë të mbrojmë konsumatorët duke ngritur vemendjen në marrjen e masave per sigurinë e infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë me fokus:

- Rishikimi i Rregullave në fuqi në bashkëpunim me operatoret e këtyre infrastrukturave dhe në konsultim me Akcesk (?) si dhe në vlerësim të ndryshimeve në ligjin për Sigurinë e Infrastrukturave Kritike.
- Mbikqyrja e vazhdueshme e zbatimit të planeve të masave nga operatorët e infrastrukturave kritike për mbrojtjen nga incidentet dhe sigurinë kibernetike për të shmangur ekspozimin e konsumatorëve.
- Digitalizimi - Mbeshtetje e operatorëve të infrastrukturave kritike në implementimin e standardeve që lidhen me sigurinë kibernetike.

Objektiva të tjerë

Zhvillimi i Burimeve te Rinovueshme

ERE për qellime të promovimit të burimeve te rinovueshme ushtron funksionet e saj bazuar në ligjin nr. 24/2023 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*".

Veprimtaria e ERE përfshin si të tillë referuar edhe rekomandimeve në rezolutën respektive të Kuvendit, për promovimin e programeve për zhvillimin e burimeve të rinovueshme, dhe eficencëen e energjisë.

Plani i veprimit

Politikat e promovimit të Burimeve të Rinovueshme - ERE do të vijojë punën për miratimin e akteve rregullatore të përcaktuara në ligjin për burimet e rinovueshme.

Në kuptim të ligjit, ERE është autoriteti përgjegjës për lëshimin e garancive të origjinës. Në zbatim të nenit 22, pika 2 e këtij ligji përcaktohet se ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës në Republikën e Shqipërisë dhe siguron përafrimin e politikave dhe parimeve të garancisë së origjinës me sistemet e certifikatave të njohura në Komunitetin e Energjisë.

Po ashtu, në nenin 22, pika 14 e këtij ligji është parashikuar se *ERE duhet t'i bashkohet sistemit rajonal të komunitetit të energjisë për të mundësuar tregtimin e garancive të origjinës me palët e tjera kontraktuese të komunitetit të energjisë.*

Ky detyrim është përmbushur nga ERE me nënshkrimin e marrëveshjes për regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancisë së origjinës.

Në nenin 22, pika 1, të këtij ligji përcaktohet, ndër të tjera, se *ERE miraton rregullat për lëshimin e garancive të origjinës dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të garancive të origjinës.*

Në zbatim të këtij përcaktimi është draftuar Rregullorja për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme.

Në hartimin e kësaj rregulloreje janë marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", specifikat e sistemit rajonal të garancive të orgjinës dhe elementet e regjistrit elektronik të GO-ve. Në vijim ERE do të punojë për finalizimin e këtij procesi për miratimin e këtyre rregullave dhe implementimin e marrëveshjes për regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancisë së origjinës.

Digjitalizimi: - Puna e ERE do të konsistojë në bashkepunimin me operatorët, për të përshpejtuar proceset e digjitalizimit që lehtesojnë aksesin e përdoruesve dhe konsumatorëve ndaj shërbimeve që operatoret ofrojn.

Përfundime

Sfidat e tregut të energjisë, ndryshimet në legjislacionin primar dhe atë sekondar, si dhe me ndryshimet teknologjike, me të cilat ballafaqohen konsumatorët e energjisë dhe pjesëmarrsit e tregut në tërësi sjellin në fokus të punes të ERE, adresimin e cështjeve që kërkojnë ndërhyrjen e rregullatorit. Për këtë qëllim ERE ka përcaktuar në këtë dokument objektivat strategjike për të patur një vizion të qarteë te cështjeve prioritare dhe planit të veprimeve.

ERE do të vijojë të kryejë analiza/studime të aspekteve të rëndësishme të kuadrit rregullator që kanë të bëjnë me çështjen e sherbimeve te rregulluara.

ERE do të shqyrtojë kuadrin rregullator të nevojshëm për fuqizimin e Konsumatorëve dhe mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë;

Vendosja e cmimeve të drejta dhe të arsyeshme është një nga prioritet kryesore dhepër këtë qëllim ERE do të rishikojë metodologjitë respektive të përcaktimit të tarifave të transmetimit, shpërndarjes dhe cmimeve te rregulluara.

ERE do të perditesoje Rregullat e saj mbi sigurine kibernetike si dhe do të monitorojë zhvillimet e planeve të zbatimit të sigurisë kibernetike gjithashtu nga këta operatorë.

Prioritet në punën e ERE vijon të jete mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorit, dhe nxitja e konkurrencës ne treg, përcaktimin e tarifave dhe cmimeve të drejta, mbështetjen e operatorëve në investimet për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, monotorimin e sherbimeve të të licensuarve në pergjithësi dhe në përmbushjen e standarteve të cilësisë së shërbimit, dhe plotësimin e kuadrit rregullator të nevojshëm apo dhe rishikimin e tij.

ERE do të vijojë të promovojë, dhe bëjë përpjekjet më të mira për të përfshirë palet e interesit në vendimmarrje, per te percuar besimin tone në vlera te tilla si integriteti, thjeshtësia, gjithëpërfshirja, dhe mbi te gjitha besimi dhe respekti i ndërsjellë.

Këto vlera përbëjnë Kulturën tonë të punes, nje kulturë ku të gjithë kanë përgjegjësi për të vepruar për interesin afatgjatë të shoqërisë.

1. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

1.1. Situata e Sektorit Elektro-energjitik Shqiptar

Sistemi elektro-energjitik në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga: Prodhimi, Transmetimi, Shpërndarja e energjisë elektrike, Operimi i tregut të energjisë; Tregtimi si dhe Furnizimi i energjisë me qëllim furnizimin e klientëve të energjisë elektrike. Këto veprimtari ushtrohen nga subjekte të licencuara nga ERE në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.

Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria publike KESH sh.a. dhe shoqëria HEC Lanabregas sh.a. të cilat jan shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore, si dhe nga subjektet private të licencuara në këtë aktivitet të tilla si: Prodhuesit me Përparësi, Prodhuesit e Pavarur dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike.

Transmetimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a., e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore. Në përputhje me nenin 58 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, OST sh.a. është certifikuar dhe licencuar për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Shpërndarja e energjisë elektrike realizohet nga shoqëria "Operatori i Sistemit te Shpërndarjes" (OSSH) sh.a., e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore, dhe është licencuar për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Në të njëjtën kohë ERE në mbështetje të neneve 16 dhe 72, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, me vendimin nr. 257, datë 21.12.2020, ka vendosur miratimin e Programit të Pajtueshmërisë të shoqërisë OSSH sh.a.

Më poshtë paraqitet Skema e Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar si dhe Skema e Fluksit të Energjisë Elektrike dhe Tregtare.

SKEMA E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK



Figura 2. Skema e Sistemit Elektroenergjitik

(Burimi: ERE)



Figura 3. Skema e Fluksit të Energjisë dhe Tregtar

(Burimi: ERE)

Skema e mësipërme e fluksit të energjisë dhe atij tregtar në sektorin e energjisë elektrike përgjatë vitit 2023, funsionoi bazuar në VKM-në nr.650, datë 10.10.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 08.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes se emergjencës në furnizimin me energji elektrike" ndryshuar. .

Nga data 12.04.2023 në skemen e flukseve tregtare dhe energjitike eshte futur dhe Bursa e energjisë elektrike ALPEX.Me fillimin e operimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike

ALPEX sha hyri ne zbatim edhe VKM nr. 519, datë 13.07.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, ndryshuar me VKM nr. 872, datë 27.12.2022 .

1.2 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëritë publike dhe private të licencuara për këtë aktivitet. Shoqërite publike janë KESH sh.a. dhe shoqëria HEC Lanabregas sh.a., me 100% të aksioneve shtetërore. Subjektet private të licencuara në këte veprimtari janë: Prodhuesit me Përparësi, Prodhuesit e Pavarur dhe Vetë prodhuesit e Energjisë Elektrike, që zhvillojnë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike bazuar në Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndyshuar si dhe Ligjin nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili ne Prill te vitit 2023 eshte zevendesuar me Ligjin e ri nr. 24/2023 Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme.

KESH sh.a vijon të jetë shoqëria më e madhe prodhuese e energjisë elektrike në Shqipëri. Përgjate vitit 2023 ka ushtruar aktivitetin e detyrimit te shërbimit publik bazuar në VKM-në nr. 456, datë 29.6.2022, ndryshuar “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

Për periudhën që mbulon ky vendim parashikohet që KESH sh.a. për menaxhimin e kaskadës dhe sigurimit të energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve në treg të rregulluar kryen procedurat sipas këtij vendimi, për depozitimin dhe shkëmbimin e tepricave të energjisë elektrike, vetëm pasi ka plotësuar nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal. Bazuar në këtë vendim, teprica e energjisë së prodhuesit publik është sasia e energjisë që mbetet pas furnizimit të plotë të nevojave të Furnizuesit Universal të Energjisë dhe të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Gjithashtu, shoqëria e prodhimit publik të energjisë ka të drejtë të bëjë optimizim financiar të kaskadës, vetëm në rastet kur nuk cënon sasitë e nevojshme të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe vetëm brenda periudhave javore ose mujore.

Prodhuesit me përparësi dhe prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike janë subjekte të licencuara në vite nga ERE që shfrytëzojnë centralet ekzistuese apo të reja, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të privatizimit, marrëveshjeve të koncesionit apo kontratave për shfrytëzimin dhe administrimin e impianteve prodhuese të energjisë elekrike.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në vendin tonë deri më 31 Dhjetor 2023 është rreth **2,675** MW. Ky kapacitet ka pasur një nivel rritje në vitin 2023 prej rreth **26 MW**.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i kompanisë publike KESH sh.a. është 1453 MW dhe përbën rreth 54.2 % të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë.

Kapaciteti total i instaluar i prodhuesve të tjerë të energjisë elektrike është 1 222 MW dhe përbën rreth 45.8 % të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë.

1.2.1 Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2023

Prodhimi total neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2023 është **8,795,637** MWh, nga i cili:

- **5,131,482** MWh u prodhua nga centralet në zotërim të kompanisë publike KESH sh.a.
- **3,664,155** MWh u prodhua nga centralet e tjera.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2023, nga KESH sh.a. zë **58.3 %** të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë rreth **41.7 %.**

Centralet e prodhimit të energjisë elektrike janë të lidhura si në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike ashtu dhe në rrjetin e shpërndarjes. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2023 është rreth 2,288 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 7,709 127 MWh.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2023 është rreth 382 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 1,086,510 MWh.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT 2023		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2023 (MWh)
P.Pub	Prodhues Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)	Lidhur në OST	1	4	1,448	**5,131,482**
P.Pav	Prodhues të Pavarur Hidro (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OST	4	9	438	**1,204,762**
P.Pav	Prodhues të Pavarur Fotovoltaike(Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OSSH	3	4	14	**18,885**
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	33	51	402	**1,372,883**
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	137	178	334	**1,005,636**
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	17	17	34	**61,989**
			195	**263**	**2,670**	**8,795,637**

Figura 4. Të dhëna mbi prodhuesit për vitin 2023

Në figurën më sipër paraqiten të dhëna mbi prodhimin e energjisë elektrike për gjithë kategoritë e prodhuesve të cilët janë në operim.

Në të njëjtën kohë në figurën më poshtë paraqitet prodhimi neto vendas për vitin 2023, duke evidentuar kontributin në prodhimin e energjisë elektrike të KESH sh.a., si prodhues publik si dhe kontributet e prodhuesve të tjerë. Prodhimi i realizuar nga kompania publike KESH sh.a., ka vijuar të zerë peshën kryesore në prodhimin vendas edhe përgjatë vitit 2023.

PRODHIMI NETO VENDAS 2023 (MWh)	2023
HEC-et / PPE ne rrjetin e OSSH sha	982,392
HEC-et / PPE ne rrjetin e OST sha	1,085,256
HEC-et e pavarur IPP ne rrjetin e OST sha	1,204,759
HEC Lanabregas	23,244
HEC Ashta	287,628
Centralet Fotovoltaike (kontr me FTL)	61,989
Centralet Fotovoltaike (ne treg te lire)	18,885
Prodhimi nga HEC-et e KESH sha	5,131,482
TOTAL VENDAS 2023	8,795,635



Figura 5. Prodhimi neto vendas për vitin 2023

Burimi OST sh.a.; KESH sh..a; FTL sh.a.



	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR
Impiante Fotovoltaikë	3,609	5,445	5,924	7,149	8,207	8,554	10,334	9,407	7,233	6,684	4,393	3,937
Prodhimi Neto KESH.	665,048	599,427	350,763	318,558	488,334	381,563	405,103	455,548	377,610	283,354	302,754	503,420
HEC Qami	592	126	659	702	430	83	3	68	58	23	696	718
HEC Moglice	30,090	33,919	31,602	23,209	12,164	37,614	14,178	7,089	16,866	20,311	33,550	42,773
HEC Banje	19,006	17,988	18,262	12,703	7,780	20,938	10,916	7,489	5,847	9,330	20,521	26,401
HEC Fangu	41,733	21,699	32,666	20,161	17,504	6,123	4,155	8,673	17,951	12,041	26,254	41,182
HEC Peshqesh	13,532	6,558	13,089	12,741	9,140	5,257	2,507	1,463	1,281	2,232	18,131	17,008
HEC Ashta	35,169	30,291	23,019	20,043	26,672	20,513	18,998	21,314	19,370	16,195	25,307	30,736
Prodhimi Neto Kurum	44,271	41,090	36,363	34,900	45,761	26,674	26,849	13,613	12,370	12,028	31,130	41,927
HEC Lanabregas	1,990	1,984	2,352	2,231	2,259	1,955	1,859	1,819	1,435	1,126	2,044	2,191
Hec-et Private/Konc.rrjeti OST	128,643	69,793	137,555	126,555	132,825	100,896	41,039	12,915	9,074	16,815	156,650	152,497
Hec-et Private/Konc.rrjeti OSHEE	115,928	74,408	132,656	121,564	114,368	92,807	36,581	16,598	13,324	18,209	117,880	128,069
PRODHIMI VENDAS TOTAL	1,099,609	902,727	784,911	700,516	865,443	702,975	572,522	555,995	482,419	398,348	739,310	990,859

Figura 6. Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2023 (MWh)

Figurat më poshtë paraqesin krahasimin e prodhimit mujor neto të energjisë elektrike përgjatë vitit 2023 me mesataren e prodhimit të periudhës 2009 – 2023.



Figura 7. Prodhimi mujor vendas për vitin 2023 krahasuar me mesataren e periudhës 2009-2023



Figura 8. Prodhimi neto vendas historik për periudhën 2009-2023 në raport me mesataren e prodhimit për këtë periudhë

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2023 me sasinë e prodhuar prej 8,796 GWh, rezulton mbi mesataren e prodhimit të energjisë elektrike

për periudhën 2009 – 2023. Mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023 ka rezultuar 6,770 GWh. Prodhimi i realizuar për vitin 2023 është rreth 2,026 GWh, ose 30 % më i lartë se mesatarja e prodhimit te energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023. Duke marrë në konsideratë konsumin total të energjisë elektrike në sasinë 7,876 GWh, prodhimi total i realizuar gjatë vitit 2023, rezulton me i larte se kerkesa per energji elektrike ne vendin tone , për rrjedhojë janë realizuar eksporte të energjisë elektrike.

Prodhimi maksimal mujor i energjisë elektrike për vitin 2023 është shënuar në muajin Janar 2023 në sasinë **1,099,609** MWh. Ky prodhim është realizuar nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a. në masën deri **60.5 %**, ndërkohë që prodhimi minimal mujor i energjisë elektrike gjatë vitit 2023 rezulton në muajin Tetor në sasinë **398,348** MWh.

Në grafik evidentohet se viti 2023 konsiderohet si një vit i mirë hidrologjik nga pikëpamja e prodhimit të energjisë elektrike, i cili për këtë vit ka rezultuar në sasinë **8,796** GWh, pra **2.026** GWh më shumë se prodhimi mesatar i energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2023. Duke marrë në konsideratë faktin se vendi ynë e bazon prodhimin e energjisë elektrike kryesisht në burimet hidrike, në vitet e mira hidrologjike ku bën pjesë edhe viti 2023, prodhimi i energjisë elektrike është më i lartë se mesatarja shumë vjeçare në periudhën 2009 – 2023.

1.2.2 Të dhënat teknike kryesore dhe prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese publike për vitin 2023

Shoqëria publike KESH sh.a. ka në zotërim tre hidrocentralet e kaskadës së Lumit Drin, termocentralin e Vlorës, si dhe impiantin fotovoltaik Qyrsaq me fuqi 5.14 MW. Përbërja e grupit të centraleve të zotëruara nga KESH sh.a. dhe kapaciteti i instaluar i secilit prej tyre është paraqitur në të dhënat më poshtë ku evidentohet numri i agregateve, kapaciteti i instaluar për çdo agregat dhe fuqia e instaluar për çdo central.

	HEC Fierzë	HEC Koman	HEC Vau i Dejës	TEC Vlorë	Centrali fotovoltaik i Digës së Qyrsaqit, Vau i Dejës
Numri i agregatëve	4	4	5	2	
Kapaciteti i instaluar i agregatëve. (MW)	125	150	50	70+28	
Kapaciteti i instaluar i centralit prodhues së energjisë elektrike (MW)	500	600	250	98	5
Kapaciteti i instaluar total (MW)	**1453**				

Figura 9. Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik

(Burimi: KESH sh.a.)

Kapaciteti total i instaluar në zotërim nga KESH sh.a., arrin në 1,453 MW, nga të cilat kapaciteti i instaluar i HEC-ve në kaskadën e lumit Drin është 1,350 MW ,TEC Vlorë 98 MW si dhe ai i impantit fotovoltaik Qyrsaq 5.14 MWp.

Viti 2023 ka filluar me prodhim të lartë në periudhën Janar-Shkurt dhe është mbyllur në Dhjetor përsëri me një prodhim të lartë.

Prurjet mesatare gjate vitit 2023 rezultuan me rreth 197 m^3/s në liqenin e Fierzës. Këto prurje të vitit 2023 rezultojnë më të larta krahasuar me mesataren historike (176 m^3/s).

Niveli në liqenin e Fierzës më 31 Dhjetor 2023 rezulton në kuotën 284.5 metër mbi nivelin e detit (mmnd), krahasuar me të një viti më parë 2022 që ishte 291.7 m,

Rezerva Energjitike në fillim të vitit 2023 ishte 1,339 GWh ndërsa në fund të 2023 ishte 950 GWh. Rezerva Mesatare Energjitike gjatë 2023 ishte 1,066 GWh.

Referuar treguesve të mësipërm rezulton që në tërësi viti 2023 është më i lagësht nga pikëpamja hidrike krahasuar me vitin 2022, duke sjellë edhe prodhim krahasimisht më të larte.



	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
V.Dejës	1,082	1,507	815	973	1,314	805	933	1,106	681	1,233	727	702	1,137	927	1,120
Koman	2,062	2,873	1,602	1,828	2,444	1,548	1,883	2,134	1,364	2,425	1,415	1417	2,416	1,839	2,331
Fierzë	1,541	2,634	1,238	1,228	2,054	1,055	1,636	1,851	872	2,193	845	978	1,790	1,094	1,776
Kaskada	4,686	7,014	3,655	4,029	5,812	3,409	4,452	5,092	2,917	5,851	2,987	3,097	5,343	3,860	5,227

Figura 10. Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit

(Burimi: KESH sh.a., OST sh.a.)

Prodhimi maksimal i enegjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a. për periudhën 2009 – 2023 është arritur në vitin 2010 në sasinë 7,014 GWh. Prodhimi i energjisë elektrike i vitit 2010 është 1,787 GWh më i lartë se prodhimi i energjisë elektrike i arritur në vitin 2023 i cili rezulton në sasinë 5,227 GWh. Ky tregues, paraqet në mënyrë të qartë shkallën e lartë të varësisë nga kushtet hidrologjike dhe për rrjedhojë ekzistencën e riskut hidrologjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë. Varësia e prodhimit të energjisë elektrike, (për shkak se ky prodhim bazohet kryesisht në burime hidrike) bën të nevojshëm vijimin e diversifikimit të burimeve të prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë, në perputhje me Strategjinë Kombëtare tëe energjisë dhe Planit të Konsoliduar Kombetar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme tëe energjisë miratuar nga Këshilli i Ministrave. Më poshtë paraqitet në mënyrë të detajuar prodhimi mujor i energjisë elektrike nga hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin në administrim të shoqërisë KESH sh.a.



Figura 11. Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2023

(Burimi: KESH sh.a.. , OST sh.a.)

Prodhimi maksimal i KESH sh.a. është regjistruar në muajin Janar me sasinë 665,048 MWh dhe minimal në muajin Tetor me sasinë 283,354 MWh. Sikurse evidentohet diferenca ndërmjet prodhimit maksimal mujor të realizuar në sasinë 665,048 MWh dhe atij minimal të realizuar në sasinë 283,354 MWh për vitin 2023 vijon të jetë e konsiderueshme në sasinë 381,694 MWh. Edhe ky tregues identifikon gjithashtu varësinë e prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë nga kushtet hidrologjike.

Në figurën 11, janë paraqitur në mënyrë grafike shkarkimet e ujit pa prodhim energjie nga HEC-et e KESH sh.a. në Kaskadën e lumit Drin, për secilin vit në periudhën 2002 - 2023.



Figura 12. Shkarkimet e Ujit nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (2002-2023)

(Burimi: KESH sh.a.)

KESH sh.a. raporton se viti 2023 u karakterizua në tërësinë e tij nga një situatë e mirë hidrike si pasojë e reshjeve më intensive dhe prurjeve më të mëdha në fillim dhe fundin e vitit. Përgjatë vitit 2023 shkarkimet e ujit pa prodhim energjie kanë qenë në vlera të vogla. Kryesisht këto shkarkime kanë ndodhur nga basenet e hidrocentraleve të Komanit dhe të Vaut të Dejes, kjo për faktin se basenet e ketyre hidrocentraleve jane me vëllim më të vogël se baseni i Hec Fierzë. Krahasuar me shkarkimet e ujit pa prodhim energjie përgjate vitit 2023 me ato te vitit 2022 jemi pothuaj në të njëjtat volume uji të shkarkuar.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat mbi nivelin në metra të Liqenit të Fierzës për vitin 2023 në fund të çdo muaji.



Figura 13 Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2023 (m)

(Burimi: KESH sh.a)

Baseni i HEC-it të Fierzës është baseni më i madh ujor në kaskadën e Lumit Drin dhe shërben si rregullator vjetor i rezervës hidrike të kaskadës së lumit Drin. Niveli i i ujit në basenin e Fierzës ndikon drejtë për drejtë në shfrytëzimin e gjithë kaskadës mbi lumin Drin. Sikurse evidentohet nga të dhënat më sipër në fundin e muajit Dhjetor 2023 niveli i ujit në liqenin e Fierzës ka qënë në kuotën 284.5 metër. Niveli maksimal i vitit rezulton në Qershor 2023 me 296.3m. Të dhënat historike mbi nivelin e liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2023 paraqiten si më poshtë duke evidentuar kuotat minimale dhe kuotat maksimale.

NIVELI I FIERZES 1991-2023												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1991	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1992	278.0	274.1	268.0	278.8	281.0	279.6	275.2	268.7	263.9	271.4	281.9	280.6
1993	275.2	265.3	264.7	278.5	280.5	277.3	271.0	261.1	253.6	249.9	255.6	270.2
1994	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1995	253.8	260.3	262.5	275.3	289.0	288.7	284.5	282.2	288.2	283.8	279.9	287.5
1996	287.1	288.7	286.5	294.7	295.8	293.1	287.6	282.2	285.1	284.3	289.2	291.3
1997	289.4	284.5	281.7	285.2	294.1	292.0	287.0	280.0	272.9	272.4	270.8	277.2
1998	273.7	270.0	265.2	278.9	288.1	287.4	281.8	277.6	276.0	277.1	279.0	277.1
1999	272.7	275.6	281.5	290.5	295.9	293.3	288.3	279.5	271.0	257.6	263.6	276.9
2000	276.4	276.7	276.8	286.9	286.6	280.1	273.5	267.5	261.6	248.4	249.3	252.1
2001	253.6	258.2	275.1	282.9	287.6	283.8	273.7	271.1	269.2	263.6	263.2	252.1
2002	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	267.8	274.3	286.1	285.3	284.0
2003	291.1	289.5	286.3	287.0	292.3	290.3	285.9	280.8	276.0	282.6	285.6	283.3
2004	284.7	290.8	293.4	296.0	296.2	296.2	293.1	286.3	281.1	280.0	286.1	288.0
2005	281.2	281.5	293.3	296.1	295.6	294.1	286.7	277.2	266.5	256.9	253.6	279.0
2006	283.5	288.6	294.4	295.9	296.5	295.9	293.8	290.2	285.3	278.7	266.2	256.2
2007	256.1	263.7	272.0	276.8	276.8	274.8	268.5	263.6	261.8	261.1	275.8	282.1
2008	285.1	289.7	290.9	295.5	295.3	295.7	294.3	288.6	283.9	280.9	285.2	286.5
2009	283.6	281.8	283.4	292.5	293.7	292.4	288.0	281.2	276.2	271.6	266.3	280.1
2010	290.1	289.2	293.9	296.0	296.3	294.4	291.8	288.6	284.9	285.2	284.3	287.5
2011	281.6	274.1	275.0	276.6	281.0	286.1	284.7	279.0	273.9	268.2	261.6	264.5
2012	265.8	274.1	262.0	280.2	293.4	294.4	288.4	280.4	261.4	261.6	269.0	276.6
2013	278.3	274.1	294.8	296.9	296.9	294.2	289.7	283.6	280.8	281.4	282.5	276.1
2014	275.1	274.1	274.6	285.3	292.9	294.9	291.7	286.8	285.5	285.0	284.8	286.3
2015	288.7	274.1	292.2	296.3	296.1	293.3	287.5	280.1	272.1	275.4	278.9	275.9
2016	289.9	274.1	291.8	296.5	296.2	295.6	290.5	285.4	283.3	288.4	288.9	281.6
2017	271.5	274.1	280.9	278.7	281.6	272.4	270.2	268.0	271.0	264.6	269.6	289.9
2018	289.7	274.1	295.0	296.5	296.4	296.0	294.0	287.5	277.9	270.2	266.5	267.3
2019	267.3	274.1	272.7	279.9	289.9	292.7	287.6	278.5	274.2	268.6	273.2	275.6
2020	271.6	272.0	283.5	288.6	293.6	291.7	284.6	276.5	273.5	274.1	268.7	272.7
2021	291.7	294.1	292.6	294.3	296.7	291.7	282.7	274.3	271.3	267.7	267.8	275.1
2022	270.7	268.3	260.7	282.5	289.0	288.0	281.5	270.4	271.4	267.9	281.7	291.7
2023	293.2	286.4	291.5	295.6	296.1	296.3	291.4	281.3	270.8	263.5	280.1	284.5
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2023	293.2	286.4	291.5	295.6	296.1	296.3	291.4	281.3	270.8	263.5	280.1	284.5
Mesatarja	275.50	276.90	279.82	286.48	290.68	289.53	284.98	279.25	275.33	273.34	274.52	277.52
Minimumi	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	261.1	253.6	248.4	249.3	252.1
Maksimumi	293.2	294.1	294.4	296.9	296.9	296.2	294.3	291.5	289.4	288.3	289.2	288.0

Figura 14. Niveli i Liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2023

(Burimi: KESH sh.a., OST sh.a.)

Më poshtë paraqitet grafikisht niveli i ujit në metra në rezervuarin e Fierzës për çdo muaj të vitit 2023, krahasuar me nivelet mesatare historike mujore për periudhën 1991– 2023.



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2023	293.2	286.4	291.5	295.6	296.1	296.3	291.4	281.3	270.8	263.5	280.1	284.5
Mesatarja	275.50	276.90	279.82	286.48	290.68	289.53	284.98	279.25	275.33	273.34	274.52	277.52
Minimumi	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	261.1	253.6	248.4	249.3	252.1
Maksimumi	293.2	294.1	294.4	296.9	296.9	296.2	294.3	291.5	289.4	288.3	289.2	288.0

Figura 15. Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2023

Sikurse shihet ne muajin janar 2023 rezulton se niveli i ujit ne liqenin e Fierzës prej 293.2 m është ne nivelin maksimal të mundshëm për këtë muaj. Sikurse evidentohet më sipër përgjatë periudhes Janar – Gusht dhe Nentor – Dhjetor 2023 rezulton që niveli i ujit në liqenin e Fierzës rezulton mbi nivelin mesatar. Përgjatë periudhës Gusht – Tetor 2023 e cila karakterizohet nga prurje të ulta të ujit dhe konsum të larte të energjisë elektrike rezulton që niveli i ujit në liqenin e Fierzës të jetë nën nivelin mesatar. Në muajin Qershor 2023, niveli i ujit në liqenin e Fierzës ka qënë 296. 3 meter qe rezulton në nivelin maksimal historik të tij prej 296.2 metër. Niveli minimal i ujit ne liqenin e Fierzës është shenuar në muajin Tetor 263.5 m. Gjithësesi ky nivel minimal i muajit Tetor 2023 mbetet mbi nivelin minimal mujor historik për muajin Tetor prej 248.4 m.

Mesatarja shumëvjeçare e nivelit të ujit në liqenin e Fierzës është një tregues kryesor në planifikimin e prodhimit të energjisë elektrike në kaskadën e Lumit Drin.

Në Figurën në vijim paraqiten prurjet mesatare të ujit për vitin 2023 në Liqenin e Fierzës krahasuar me prurjet mesatare historike për çdo muaj nepermjet grafikut perkates.



Figura 16. Prurjet mesatare mujore (m3/sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2023 krahasuar me mesataren historike

Gjatë vitit 2023 prurjet mesatare të ujit janë përgjithësisht të përafërta me mesataren historike përvec muajve Janar, Nentor, Dhjetor ku prurjet rezultojne më të larta se mesataret historike.

Në grafikun e figurës që vijon është paraqitur shfrytëzimi i rezervës hidroenergjitike në Kaskadën e lumit Drinit gjatë vitit 2023.



Figura 17. Rezerva Energjitike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2023

(Burimi: KESH sh.a.)

Rezerva hidroenergjitike e kaskadës së lumit Drin duke marrë në konsideratë rëndësinë që ka kaskada në prodhimin e energjisë elektrike për vendin tonë në cdo rast duhet të administrohet nga KESH sh.a. bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Optimizimin e portofolit të KESH sh.a., dhe të sektorit në përgjithësi;
- Operimin në nivele optimale të HEC-it dhe shfrytëzimim sa më të mirë të baseneve;
- Operimin sipas përcaktimeve të rregullores së sigurisë së digave.

Përvec sa me siper duhet te realizohet dhe gjenerimi në mënyrë të qëndrueshme e me cilësi ne këtë kaskadë, duke garantuar furnizim me energji elektrike të sigurtë dhe me kosto sa më të ulët për konsumatorët fundorë.

Duke qenë se KESH sh.a. është dhe ndër ofertuesit kryesor të shërbimeve ndihmëse të sistemit elektroenergjitik duhet të ofrojë në kohën dhe masën e duhur shërbimet ndihmëse, për të garantuar operim të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit elektroenergjitik.

Rezerva energjitike sic shihet, është ruajtur e lartë deri ne Gusht e me pas deri ne Tetor vërehet ulje deri ne 337 GWh dhe për dy muajt e fundit të vitit 2023 është rritur sërisht deri në 950 GWh.

ERE me vendimin nr. 109/2023 ka licensuar KESH sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës, me fuqi të instaluar prej 110 MW për një afat 2-vjeçar, duke filluar nga data e komisionimit të veprës. Aktualisht nga raportimet e KESH sh.a. nuk është livruar energji elektrike në rrjet për këto centrale.

1.2.3 Gjendja e TEC-it Vlorë

Shoqëria KESH sh.a. është aksionere e vetme e shoqërisë Termocentrali Vlorë sh.a. (TEC Vlora sh.a.), shoqëri kjo e cila ka në administrim asetin gjenerues TEC Vlora.

Shoqëria TEC Vlora sh.a. edhe përgjatë vitit 2023, ka kryer aktivitetin e saj në lidhje me konservimin e asetit gjenerues i cili nuk është në gjendje pune për shkak të problematikave të shfaqura që nga viti 2012.

1.2.4 Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese private të pavarura dhe ato me përparësi

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga centralet prodhuese të pavarur dhe ato me përparësi për vitin 2023 është 3,664,155 MWh ose rreth 41.7 % e prodhimit total vendas.

Për vitin 2023, numri i centraleve prodhuese të pavarur dhe ato me përparësi të cilat kanë prodhuar energji elektrike është 259 ku 13 prej të cilëve janë prodhues të pavarur të cilët zotërohen nga 7 subjekte të licencuara, kurse pjesa tjetër prej 246 centrale janë prodhues me përparësi të energjisë elektrike të cilët zotërohen nga 187 subjekte te cilet ushtrojne aktivitetin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Në këtë listë është përfshirë edhe HEC Lanabregas me kapacitet të instaluar 5 MW dhe prodhim vjetor për vitin 2023 prej 23,244 MWh, aksionet e të cilit sikurse sipërcituar janë 100% shtetërore. Në total, kapaciteti i instaluar i centraleve prodhuese të pavarur dhe prodhuesve me përparësi është 1,222 MW, ku kapaciteti i instaluar i centraleve të prodhuesve të pavarur është 452 MW, kurse 770 MW i përket centraleve të prodhuesve më përparësi të energjisë elektrike perfshirë dhe HEC-in Lanabregas.

Të dhënat mbi grupimet e prodhuesve janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur më poshtë.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT 2023		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2023 (MWh)
P.Pub	Prodhues Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)	Lidhur në OST	1	4	1,448	**5,131,482**
P.Pav	Prodhues të Pavarur Hidro (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OST	4	9	438	**1,204,762**
P.Pav	Prodhues të Pavarur Fotovoltaike(Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OSSH	3	4	14	**18,885**
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	33	51	402	**1,372,883**
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	137	178	334	**1,005,636**
PPE	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	17	17	34	**61,989**
			195	**263**	**2,670**	**8,795,637**

TË DHËNA MBI PRODHUESIT E PAVARUR DHE ATO ME PËRPARËSI 2023		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2023 (MWh)
P.Pav	Prodhues të Pavarur (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OST	4	9	438	**1,204,762**
P.Pav	Prodhues të Pavarur Fotovoltaike(Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OSSH	3	4	14	**18,885**
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	33	51	402	**1,372,883**
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	137	178	334	**1,005,636**
PPE	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	17	17	34	**61,989**
			194	**259**	**1,222**	**3,664,155**

Figura 18. Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi dhe ato të pavarur për vitin 2023

TË DHËNA MBI PRODHUESIT ME PËRPARËSI 2023		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2023 (MWh)
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	33	51	402	**1,372,883**
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	137	178	334	**1,005,636**
PPE	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	17	17	34	**61,989**
			187	**246**	**770**	**2,440,508**

Figura 19. Të dhëna mbi prodhuesit me përparesi për vitin 2023

TË DHËNA MBI PRODHUESIT E PAVARUR 2023					
	HECET	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	Prodh.2023
P.Pav	Hec "Ulez" me fuqi 25,2 MW	25.200	"Kurum International" sh.a.	110 kV	366,977
P.Pav	Hec "Shkopet" me fuqi 24 MW	24.000		110 kV	
P.Pav	Hec "Bistrica 1" me fuqi 22,5Mw	22.500		110 kV	
P.Pav	Hec "Bistrica 2" me fuqi 5 Mw	5.000		110 kV	
P.Pav	Hec"Peshqesh"me fuqi 27,94 MW;,	28.000	"Ayen As Energji"sha	220 kV	102,939
P.Pav	Hec"Fangu"me fuqi 74.6 MW;,	74.600		220 kV	250,142
P.Pav	Hec "Banje" me fuqi 73 MW	73.000	"Devoll Hydropower" sha	110 kV	177,181
P.Pav	Hec "Moglice" me fuqi 184 MW	184.000		110 kV	303,365
P.Pav	Hec Qami-1	1.730	"Lajthiza Invest "shpk	110 kV	4,158
P.Pav	EZ-5 Solar Park	10	Fotovoltaike	35 kv	9,051
P.Pav	EZ-5 Solar Park			35 kv	8,953
P.Pav	FV ALBSOLAR	2		35 kv	660
P.Pav	FV SUN ENERGY SOLUTIONS	2		35 kv	222
		452.030			1,223,647

Figura 20. Të dhëna mbi prodhuesit e pavarur për vitin 2023

PRODHIMI GJATE VITIT 2023 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)																
CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	12-M 2023
Seman – 2	2	"SEMAN2SUN" sh.p.k	35 kV	190	288	283	394	402	398	458	416	317	253	186	162	3,748
Topojë	2	"SONNE" sh.p.k	35 kV	189	286	282	393	400	393	457	419	316	253	186	160	3,733
Topojë 2	2	"AED SOLAR" sh.p.k	35 kV	192	283	281	393	399	391	455	417	315	256	184	160	3,726
Topojë (Sheq Marinas)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	187	285	281	392	399	392	457	419	317	254	184	159	3,726
Topojë (Sheq Marinas) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	199	289	287	407	411	397	462	423	320	255	186	163	3,799
Seman1solar	2	" SEMAN1SOLAR " sh.p.k	35 kV	201	293	292	391	385	372	438	411	315	281	198	174	3,751
ES 2019 sh,p,k	2	ES 2019 sh,p,k	35 kV	221	319	352	431	428	413	487	461	360	300	216	191	4,179
SMART WATT sh,p,k	2	SMART WATT sh,p,k	35 kV	221	323	349	434	425	411	488	462	369	299	216	191	4,188
Tren Bilisht	2	" RTS " sh.p.k	35 kV	215	303	315	290	293	349	472	387	319	305	208	184	3,640
STATKRAFT Renewbles albani PV Lundrues ban	2	"STATKRAFT"	35 kV	77	126	167	197	178	181	259	295	221	157	61	41	1959
Pv -Plug	2	"AEE" sh.p.k	10 kv	187	291	383	459	480	464	534	471	361	333	167	159	4,290
Korca Photovoltaic Park Shpk/920	2	Korca Photovoltaic Park Shpk	35 kV	195	306	316	291	258	365	461	422	343	337	219	179	3,691
NTSP Shpk/944	2	NTSP Shpk	35 kV	204	304	300	288	255	361	453	418	331	337	217	183	3,650
Sun Beat System Shpk/921	2	Sun Beat System Shpk	35 kV	199	307	312	293	257	359	461	423	342	335	218	185	3,691
Tren Sun System Shpk/919	2	Tren Sun System Shpk	35 kV	204	312	319	290	258	359	440	426	344	338	224	183	3,696
ERENI SOLAR	2	ERENI SOLAR shpk 35 kv	35 kV	0	0	-	0	456	377	482	469	383	403	273	238	3,080
GREEN ENERGY BILISHTI	2	GREEN ENERGY BILISHTI SHPK 35 kv	36 kV	0	0	-	0	567	467	589	537	432	391	258	201	3,442
Total				2,883	4,314	4,520	5,340	6,249	6,449	7,854	7,276	5,706	5,085	3,400	2,913	61,989
EZ-5 Solar Park	10	EZ-5 Solar Park	35 kV	364	564	698	970	965	1,046	1,223	1,021	757	584	425	434	9,051
EZ-5 Solar Park		EZ-5 Solar Park	35 kV	362	567	706	839	993	1,060	1,257	1,109	770	612	372	307	8,953
FV ALBSOLAR	2	"ALBSOLAR" SH.P.K.		0	0	-	0	0	0	0	0	0	402	146	112	660
FV SUN ENERGY SOLUTIONS	2	"SUN ENERGY SOLUTIONS" SH.P.K.		0	0	-	0	0	0	0	0	0	0	51	171	222
Tot ne treg te lire				725	1,131	1,404	1,808	1,958	2,105	2,480	2,131	1,527	1,598	993	1,024	18,885
	48			3,609	5,445	5,924	7,149	8,207	8,554	10,334	9,407	7,233	6,682	4,393	3,937	80,874

Figura 21. Impiantet fotovoltaikë viti 2023

1.2.5 Prodhimi nga centralet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2023

Prodhimi vjetor neto i energjisë elektrike nga impiantet të cilat kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2023 eshte 34,799 MWh dhe paraqitet në mënyrë të detajuar në Figurën nr. 21 më poshtë. Siç shihet përgjatë vitit 2023 kanë hyrë në prodhim gjithsej 12 impiante me një kapacitet të instaluar prej 26 MW. Kjo fuqi e instaluar per vitin 2023 është shtuar ne burime hidrike me

kapacitet 7.00 MW dhe ne Burime Fotovoltaike me kapacitet 18 MW. Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2023 zë rreth 0.4 % të prodhimit total vendas të energjisë elektrike për këtë vit.

TE DHENA LIDHUR ME HEC-et + centralet Fotovoltaike TE HYRA NE PRODHIM GJATE VITIT 2023

Gjate vitit 2023 kane hyre ne prodhim 6 H/C-e dhe 6 fotovoltaike
Kapaciteti I instaluar i Hec-eve te hyra ne prodhim gjate vitit 2023 eshte 7.99 MW
Prodhimi gjate vitit 2023 nga hec-et e reja te hyra ne prodhim eshte 9,392 MWh.
Centralet fotovoltaike te hyre ne prodhim gjate vitit 2023 kane kapacitet te instaluar prej 18 MW dhe kane prodhuar 25,407 MWh energji elektrike

PRODHIMI GJATE VITIT 2023 NGA HEC-et E RINJ TE LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)

HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	12-M 2023
Hec "Shelli"	1.52	"ARIS ALBANIA" SHPK		0	526	554	199	171	96	0	0	0	0	624	822	2,993
Hec "Daznjane"	1.52			0	326	404	550	539	476	115	0	0	74	770	507	3,762
Hec "Vokopola"	2.30	'Vokopola Energji"SHPK		0	0	0	21	37	7	4	6	0	0	0	0	75
Hec "Shutrej 1&2"	1.97	'ATEANI ENERGY" SHPK		0	0	0	0	0	325	51	8	3	73	915	650	2,026
Hec KRONZ	0.43	"LAST'ER ENERGY" SH.P.K.	-	0	0	0	0	0	0	0	37	83	50	142	167	479
Hec Bushi	0.25	"BUSHI-LUFI" SH.P.K.		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12	45	57
	7.99															9,392

PRODHIMI GJATE VITIT 2023 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË RINJ TE LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)

CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	12-M 2023
ERENI SOLAR	2.0	ERENI SOLAR shpk 35 kv	35 kV	0	0	-	0	456	377	482	469	383	403	273	238	3,080
GREEN ENERGY BILIS	2.0	GREEN ENERGY BILISHTI SHP	36 kV	0	0	-	0	567	467	589	537	432	391	258	201	3,442
EZ-5 Solar Park	10.0	EZ-5 Solar Park	35 kV	364	564	698	970	965	1,046	1,223	1,021	757	584	425	434	9,051
EZ-5 Solar Park		EZ-5 Solar Park	35 kV	362	567	706	839	993	1,060	1,257	1,109	770	612	372	307	8,953
FV ALBSOLAR	2.0	"ALBSOLAR" SH.P.K.		0	0	-	0	0	0	0	0	0	402	146	112	660
FV SUN ENERGY SOLU	2.0	"SUN ENERGY SOLUTIONS" SH.P.K.		0	0	-	0	0	0	0	0	0	0	51	171	222
	18.0															25,407
	26															34,799

Figura 22 .Prodhimi nga Impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2023

1.2.6 Prodhimi i energjisë elektrike sipas rrjetit ku janë lidhur centralet prodhuese

Fuqia e instaluar e centraleve të lidhur në sistemin e transmetimit për vitin 2023 është 2,288 MW. Prodhimi total i energjisë elektrike nga këto centrale është 7,709,127 MWh. Prodhimi i detajuar për secilin nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2023 paraqitet në tabelën në vijim:

PRODHIMI GJATE VITIT 2023 NGA CENTRALET E LIDHURA NE RRJETIN E TRANSMETIMIT (MWh)				
HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12-M 2023
Hec "Fierze"	500.000	"KESH" sha	220 kV	5,131,482
Hec "Koman"	600.000		220 kV	
Hec "V. Dejes"	250.000		220 kV	
Tec Vlora	98.000	"KESH" sha	220 kV	
	1,448.000			5,131,482
Hec "Ulez"	25.200	"Kurum International" sh.a.	110 kV	366,977
Hec "Shkopet"	24.000		110 kV	
Hec "Bistrica 1"	22.500		110 kV	
Hec "Bistrica 2"	5.000		110 kV	
Hec"Peshqesh"	28.000	"Ayen As Energji"sha	220 kV	102,939
Hec"Fangu"	74.600		220 kV	250,142
Hec "Banje"	73.000	"Devoll Hydropower" sha	110 kV	177,181
Hec "Moglice"	184.000	"Devoll Hydropower" sha	111 kV	303,365
Hec Qami-1	1.730	"Lajthiza Invest "shpk		4,158
	438.000			1,204,762
Hec "Ashta"	48.200	"Energji Ashta" shpk	110 kV	287,627
				287,627
Hec "Bishnica 2"	2.500	"HEC Bishnica 1,2 "shpk	110 kV	10,578
Hec "Dardhe"	5.800	"Wenerg " shpk	110 kV	16,972
Hec"Truen"	2.500	"TRUEN" shpk	110 kV	
Hec"Ternove"	8.385	"TEODORI 2003" shpk	110 kV	9,876
Hec"Gjorice"	29.610	"DITEKO" shpk	110 kV	130,966
Hec "Sllabinje 2C"	3.400	'Hidropower Elektrik" shpk	110 kV	10,623
Hec "Sllabinje 2D"	4.885		110kV	10,416
Hec "Sllabinje 2E"	3.800		110 kV	13,547
Hec "Sllabinje"	13.800	'Power-Elektrik-Slabinje" shpk	110 kV	37,902
Hec"Bele 1"	5.000	"Euron Energy" shpk	110 kV	152,846
Hec"Topojan 2"	5.800			
Hec"Bele 2"	11.000	"Alb-Energy" shpk		
Hec"Topojan 1"	2.900			
Hec"Orgjost I Ri"	4.800	"Energal" shpk		
Hec "Cerruje-1"	2.300	"Energy partners Al" shpk	110 kV	18,801
Hec "Cerruje-2"	2.800			
Hec "Rrupe"	3.600			
Hec "Rapuni 1,2"	8.100	"C & S Construction Energy" shpk	110 kV	38,402
Hec "Rrapuni 3,4"	8.850	"C & S Energy" shpk	110 kV	33,345
Hec"Llapaj"	13.620	"Gjo-Spa POWER"shpk	110 kV	52,719
Hec"Lengarice"	8.940	"Lengarica & Energy" shpk	110 kV	27,664
Hec"Lura 1"	6.540	"Erdat Lura" shpk	110 kV	41,758
Hec"Lura 2"	4.020		110 kV	
Hec"Lura 3"	5.660		110 kV	
Hec"Malla"	5.455	"Gjurr Rec" shpk	110 kV	14,005
Hec Prella	14.970	"Prelle Energji"	110 kV	42,523
HEC Cemerica 1	0.88	"REJ ENERGY" shpk	110 kV	15,214
HEC Cemerica 2	1.08		110 kV	
HEC Cemerica 3	2.1		110 kV	
HEC TUÇ	4.47	MC Inerte Lumzi	110 kV	30,056
HEC Lumzi	11		110 kV	
Hec Denas	14.5	"Denas Power" shpk	110 kV	38,038
Llënga 1	1.73	"HEC LLËNGË" sh.p.k	110 kV	10,960
Llënga 2	0.3		110 kV	
Llënga 3	1.5		110 kV	
HEC Shpella Poshte 2	2.3	Liria Energji shpk	110 kV	10,035
HEC Germani 1	4.8	SA'GA-MAT shpk	110 kV	13,165
HEC Germani 2	1.5		110 kV	
Hec Lashkiza 1	4.076	HEC Lashkiza shpk	110 kV	7,124
Hec Lashkiza 2	0.882		110 kV	
Hec Seta 1+2	7.454	"Hydro Seta" sh.p.k	110 kV	39,777
Hec Seta 3	2.722		110 kV	
Hec Seta 4	4.724		110 kV	
HEC Darsi 1,2	14.963	Henz Energy shpk	110 kV	33,084
HEC Egnatia	5	REMI shpk	110 kV	12,907
HEC Seka & Zais/684	14.96	SEKA Hydopower shpk	110 kV	71,853
HEC ARSTI	3.13	Hec Arsti shpk	110 kV	14,149
HEC KASKADA GJADER T1/344	24.9	S.P.E. Gjader shpk	110 kV	24,805
HEC-et Dragobia&Ceremi/686	21.9	Dragobia Energy shpk	110 kV	73,933
HEC Veleshica 1,2	13.9	"Kalisi Hydropower"shpk	110 kV	27,217
	353.806			1,085,256
	2,288			7,709,127

Figura 23. Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2023

(Burimi: FTL sh.a., OST sh.a.)

PRODHIMI GJATE VITIT 2023 NGA CENTRALET E LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)				
HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12-M 2023
Hec"Lanabregas"	5.000	"Hec Lanabregas" sha	35	23,244
Hec "Lenie"	0.400	"EMIKEL 2003" sh.p.k	10kV	2,621
Hec "Çorovode"	0.200		10kV	725
Hec "Smokthine"	9.200	"Albanian Green Energy" sh.p.k	35 kV	35,752
Hec "Bulqize"	0.600	"Balkan Green Energy" shpk	10kV	1,442
Hec "Homesh"	0.395		10kV	434
Hec "Zerqan"	0.625		6kV	1,482
Hec "Arras"	4.800		20kV	18,073
Hec "Orgjost"	1.200		10kV	5,639
Hec "Lekbibaj"	1.400		10kV	7,010
Hec "Dukagjin"	0.640		10kV	2,066
Hec "Marjan"	0.200		10kV	-
Hec "Lozhan"	0.100		10kV	315
Hec "Barmash"	0.830		10kV	1,113
Hec "Treske 2"	0.250		10kV	729
Hec "Nikolice"	0.700		10kV	1,804
Hec "Funares"	1.920		10kV	6,908
Hec "Lunik"	0.200		10kV	1,086
Hec "Kerpice"	0.420		6kV	690
Hec "Ujanik"	0.630		10kV	1,052
Hec "Borsh"	0.250		6kV	798
Hec "Leshnice"	0.380		10/6kv	627
Hec "Velcan"	1.200		10kV	3,969
Hec "Muhur"	0.250		6kV	605
Hec "Rajan"	1.020		10kV	2,252
Hec "Lure"	0.750		10kV	206
Hec "Gjanç "	3.700	"Spahiu Gjanç" sh.p.k.	35 kV	9,843
Hec "Bogove"	2.500	"Wonder power" sha	35 kV	8,339
Hec "Xhyre"	0.570	"Amal" sh.p.k	10kV	1,824
Hec "Stranik"	4.600	"Hidro Invest 1" shpk	35kV	13,155
Hec "Zall Tore"	3.000		35kV	11,458
Hec "Klos"	1.950	"Malido-Energji" shpk	6kV	3,549
Hec "Borje-Oreshke"	1.500	"HIDROALBANIA Energji" shpk	35kV	24,930
Hec "Cernaleve "	2.950		35kV	10,695
Hec "Cernaleve 1"	3.270		35kV	11,853
Hec "Murdhar 1"	2.680	"HydroEnergy "shpk	10kV	11,845
Hec "Murdhar 2"	1.000		10kV	6,822
Hec "Dishnice"	0.200	"Dishnica Energji" shpk	10kV	400
Hec "Lubonje"	0.300	"Elektro Lubonja" shpk	10kV	574
Hec "Peshk"	3.430	"Koka & Ergi Energy Peshk" shpk	35kV	13,830
Hec "Labinot –Mal"	0.250	"Ansara Koncension" shpk	6kV	337
Hec "Pobreg"	12.300	"Energy Plus" shpk	35kV	51,482
Hec "Vlushe"	14.200	"Hec Vlushe " shpk	35kV	38,999
Hec"Belesova 1"	0.150	"Korkis 2009" shpk	6kV	80
Hec "Faqekuq 1,2"	6.400	"HP OSTROVICA ENERGY" shpk	35kV	17,881
Hec"Shemri"	1.000	"Erald Energjitik" shpk	10	2,595
Hec"Mgulle"	0.280		10kV	1,951
Hec"Kryezi 1"	0.600	"Bekim Energjitik" shpk	10kV	3,577
Hec"Selishte"	2.000	"Selishte" shpk	35kV	7,055
Hec"Carshove"	1.500	"ERMA MP" shpk	10kV	2,895
Hec"Ura e Dashit"	1.200		10kV	9,869
Hec"Gizavesh"	0.500	"Dosku Energy" shpk	10kV	660
Hec "Koka 1"	3.200	"Snow Energy" shpk	35kV	6,891
Hec "Stravaj"	3.600	"Stravaj Energji" shpk	35kV	12,421
Hec"Picar 1"	0.200	"Peshku Picar 1" shpk	6kV	532
Hec"Vertop"	1.520	"Hydro Salillari Energy "shpk	35kv	1,473
Hec"Martanesh"	10.500	"Albanian Power" shpk	35kV	20,333
Hec"Verba 1,2"	5.000	"Hydro power Plant Of Korca" shpk	35kV	9,108
Hec"Fterra"	1.080	"HYDROBORSH" shpk	35kV	7,987
Hec"Ostren i Vogel"	0.320	"Lu & Co Eco Energy 2011" shpk	10kV	1,023
Hec"Kozel"	0.500	"E.T.H.H. "shpk	10kV	841
Hec"Helmes 1"	0.800		10kV	2,082
Hec"Helmes 2"	0.500		10kV	1,189
Hec"Qafezeze"	0.400	"Caushi -Energji" shpk	10kV	3,506
Hec"Trebisht"	1.775	"SA-GLE Kompani "shpk	10kV	4,241
Hec"Mollaj"	0.600	"Energji Xhaci" shpk	10kV	802
Hec"Tucep"	0.400	"Tucep" shpk	10kV	2,885
Hec"Treska4"	3.600	"Hec-Treska"shpk	35kV	9,844
Hec"Treska3"	0.400		35kV	1,502
Hec"Treska 2T"	0.620		35kV	2,569
Hec"Sotire 1 & 2"	2.200	"Hydro Energy Sotira"shpk	35kV	5,335
Hec"Shutine"	2.400	"Shutina energji"shpk	10kV	3,570
Hec"Cekrez 1,2"	0.660	"Zall Herr Energji 2011"shpk	6kV	4,097
Hec"Qarr"	1.000	"Hec Qarr & Kaltanj"shpk	35kV	4,661
Hec"Bisak"	1.300	"Bardhgjana" shpk	6kv	4,175
Hec"Shales"	1.080	"Gjoka Konstruksion -Energji" shpk	35kV	1,219
Hec"Strelce"	1.174		35kV	4,537
Hec "Shpelle "	0.400	"Sarolli" sh.p.k	10kV	1,187
Hec "Bicaj"	3.100	"En.Ku" sh.p.k	10kV	-

Hec "Leskovik 1"	1.072	"Maksi Elektrik" sh.p.k	10kV	354
Hec "Leskovik 2"	1.100		10kV	429
Hec "Orenjë"	0.875	"Juana" sh.p.k	10kV	1,437
Hec "Tamarë"	0.750	"WTS Energji" shpk	10kV	-
Hec "Benë"	1.000	"Marjakaj" shpk	6kV	1,149
Hec "Vithkuq" 2		"Favina 1" shpk		4,514
Hec "Vithkuq"1	2.715	"Favina 1" shpk	35/10kV	5,129
Hec "Selca"	1.600	"Selca Energji" shpk	10kV	7,611
Hec" Kumbull- Merkurth"	0.830	"DN & NAT Energy"shpk	6kV	1,806
Hec "Sasaj"	8.600	"Energo – Sas" shpk	35kV	22,775
Hec "Tervol"	10.600	"Hec i Tervolit" shpk	35kV	33,056
Hec "Radove"	2.500	"M.T.C. Energy" shpk	10kV	8,602
Hec"Gurshpat 1"	0.840	"Gurshpat Energy" shpk	10kV	4,780
Hec"Gurshpat 2"	0.830		10kV	5,177
Hec"Bistrica 3"	1.570	"Bistrica 3 Energy" shpk	6kv	5,272
Hec"Hurdhas 1"	1.710	Hydropowerplant Construction shpk	6kV	14,315
Hec"Perrollaj"	0.500	"Fatlum" shpk	10kV	780
Hec"Koxheraj"	0.620	"Koxherri Energji" shpk	10kv	1,755
Hec"Kacni"	3.870	"Kisi-Bio-Energji" shpk	20kV	5,821
Hec"Lena 1"	1.950	"Gama Energy" shpk	35kv	7,962
Hec"Lena 2"	2.300		35kv	
Hec"Lena 2A"	0.250		35kv	
Hec "Driza"	3.408	"Mesopotam Energy" shpk	35kv	2,410
Hec Strelca 1,2,3	5.349	"Strelca Energy" shpk	35kv	13,038
Hec "Ujanik 2"	2.500	"HP Ujaniku Energy" shpk	35kv	5,122
Hec "Nishove"	1.360	"Nishova Energy" shpk	35kv	387
Hec "Shtika"	1.300	"Perparimi SK" shpk	10kv	2,157
Hec "Ballenje"	1.900	"Ballenja Power Martanesh" shpk	35kv	4,121
Hec "Gavran 1"	0.998	"Gavran Energy" shpk	35kv	2,816
Hec "Gavran 2"	1.215	"Gavran Energy" shpk	35kV	2,236
Hec "Kasollet e Selces 1"	4.000	"Xhengo Energji" shpk	35kV	8,958
Hec "Holta Kabash"	2.200	HEC Kabash Porocan shpk	35kV	11,134
Hec "Holta Poroçan"	3.300		35kV	
Hec "Lusen 1"	0.315	"Eurobiznes" shpk	35kV	512
Hec "Ura e Fanit"	1.000	"Ayen As Energji"sha	35kV	6,089
Hec "Gorice"	1.747	"THE BLUE STAR" sh.p.k	35kV	5,875
Hec "Kabash 1&2"	5.800	"Energji Univers" shpk	35kV	6,194
Hec "Tucep 2"	1.7	"DUKA T2" shpk	35kV	4,128
Hec "Dobrenje Tomorrice"	2.4	DAAB Energy Group shpk	35kV	2,517
Hec "Razdoll"	0.765	Hidro Vizion shpk (I pa licens nga ERE)	35kV	2,313
Hec "Dragostunje"	3.1	"HEC-i Dragostunje" shpk	35kV	22,895
Hec "Stebleve"	3.4	"PURE ENERGY STEBLEVA" shpk	35kV	2,466
Hec "Zerec 1"	0.55	"EnRel Hydro" shpk	35kV	5,520
Hec "Zerec 2"	1.315			
Hec "Shëngjon 1"	0.651	"EDIANI" sh.p.k.	35kV	2,627
Hec "Shëngjon 2"	0.356			
Hec "Blaç"	1.3	"BLAC ENERGY" sh.p.k	35kV	1,070
Hec "Qarrishtë"	0.3	"IDI-2005" SHPK	35kV	1,286
Hec "Vendresh"	0.456	"HP VENDRESH ENERGY" SHPK	35kV	146
Hec "Antena"	1.105	"DERBI-E" shpk	35kV	2,537
Hec "Kamenicë"	0.973	HP Kamenica shpk	10	3,240
Hec "Qytezë"	0.9	Muso Hc Qytezë	10	2,409
Hec "Marjan Gura e Vesheve"	0.63	Marituda Shpk	10	1,534
Hec "Skatinë"	2.677	Skatine- Hec Shpk	10	5,093
Hec "Kaparjel"	0.2	ABV Konstruksion Shpk	10	459
Hec "Letaj"	0.54	Asi-Tre Shpk	10	1,074
Hec "Nice"	2.27	MP-HEC Shpk	35	1,708
Hec "Meshurdhe"	1.3	SIMA-Com Shpk	10	6,803
Hec "Thanez"	2	AFRIMI K Shpk	35	7,439
Hec "OSOJE"	1.9	OSOJA HPP shpk	35	8,969
Hec "Voskopoje"	1.9	FAVINA 1 shpk	35	6,477
Hec "Nderfushas "	1.125	'SGD Energy " shpk	35	2,136
Hec "Rreshen"	0.38	Nikolli Energy shpk	10	1,136
Hec "Gurra"	0.5	Uleza Ndertim shpk	6	1,269
Hec "Vile"	1.994	Hydro Power Panariti shpk	35	5,481
Hec "Dukona"	0.800	Dukona shpk	20	638
Hec "Prevalli"	1.750	Gega-G shpk	35	8,580
Hec "Camerice"	0.800	Rei Energy shpk	35	6,094
Hec "Stror"	2.000	Era Hydro shpk	35	10,948
Hec "Mivas"	1.940	Elva 2001 shpk	35	4,283
Hec "Spathare"	1.038	Lucente koncensionare shpk	10	3,676
Hec "Miraka"	0.600	Kuarci Blace shpk	10	1,196
Hec "Shengjun"	2.000	Irarba Energji shpk	10	2,688
Hec "Dobrunje"	0.840	W.T.S. Energji shpk	10	2,778
Hec "Muras"	2	Mateo& Co shpk	10	8,644
Hec "Trojet"	0.9	Troijet Energji shpk	10	3,656
Hec "Deni"	0.85	ASI TRE shpk	35	1,989
Hec "Kamican"	1.86	IDI 2005 shpk	35	7,086
Hec "Vardar"	1.972	Gerti shpk	35	12,654
Hec "Stavec"	6.52	Koka Ergi Stavec shpk	35	32,518
Hec "Kalis"	2.138	ERDY Energy shpk	35	9,686
Hec "Gjinar"	0.83	Erdi Gas shpk	10	1,433
Hec "Backa 1"	3.36	Kroi Mbret shpk	35	13,872
Hec "Plepi"	2.28	Domi Tec shpk	35	2,630
Hec "Zall Xhuxhe 1 &2"	4.7	Hec Zall Xhuxhe shpk	35	6,217
Hec "Pishat"	1.911	GRRENTECH ENERGY SYSTEMS shpk	35	1,110
Hec "Lingjanca1&2"	2.2	"Rei-Energji"shpk	35	5,326
Hec "Guri i Zi"	1.719	"Aris Albania"shpk	35	3,316
Hec "Drita"	1.98	"Brecani R.O.S.P." shpk	20	9,879
Hec "EME"	0.45	"Hec EME" shpk	6	1,379
Hec "Terfoje"	1.98	"HEC TERFOJA" sh.p.k	10	6,849
Hec "Borie Lura 1"	1.8	"AGETA" sh.p.k	20	2,924
Hec "Mali"	1.49	"TIRANA ENERGJI" sh.p.k	20	12,547
Hec "Shelli"	1.518	"ARIS ALBANIA" SHPK	35	2,993
Hec "Daznjane"	1.518		35	3,762
Hec "Vokopola"	2.3	'Vokopola Energji"SHPK	6	75
Hec "Shutrej 1&2"	1.97	'ATEANI ENERGY" SHPK	6	2,026
Hec KRONZ	0.43	"LASTER ENERGY" SH.P.K.	-	479
Hec Bushi	0.25	"BUSHI-LUFI" SH.P.K.		57
	334			1,005.636

PRODHIMI GJATE VITIT 2023 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)				
CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12-M 2023
Seman – 2	2	"SEMAN2SUN" sh.p.k	35 kV	3,748
Topojë	2	"SONNE" sh.p.k	35 kV	3,733
Topojë 2	2	"AED SOLAR" sh.p.k	35 kV	3,726
Topojë (Sheq Marinas)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	3,726
Topojë (Sheq Marinas) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	3,799
Seman1solar	2	" SEMAN1SOLAR " sh.p.k	35 kV	3,751
ES 2019 sh,p,k	2	ES 2019 sh,p,k	35 kV	4,179
SMART WATT sh,p,k	2	SMART WATT sh,p,k	35 kV	4,188
Tren Bilisht	2	" RTS " sh.p.k	35 kV	3,640
STATKRAFT Renewbles albani PV Lundrues ban	2	"STATKRAFT"	35 kV	1,959
Pv -Plug	2	"AEE" sh.p.k	10 kv	4,290
Korca Photovoltaic Park Shpk/920	2	Korca Photovoltaic Park Shpk	35 kV	3,691
NTSP Shpk/944	2	NTSP Shpk	35 kV	3,650
Sun Beat System Shpk/921	2	Sun Beat System Shpk	35 kV	3,691
Tren Sun System Shpk/919	2	Tren Sun System Shpk	35 kV	3,696
ERENI SOLAR	2	ERENI SOLAR shpk 35 kv	35 kV	3,080
GREEN ENERGY BILISHTI	2	GREEN ENERGY BILISHTI SHPK 35 kv	36 kV	3,442
Total				61,989
EZ-5 Solar Park	10	EZ-5 Solar Park	35 kV	9,051
EZ-5 Solar Park		EZ-5 Solar Park	35 kV	8,953
FV ALBSOLAR	2	"ALBSOLAR" SH.P.K.		660
FV SUN ENERGY SOLUTIONS	2	"SUN ENERGY SOLUTIONS" SH.P.K.		222
Tot ne treg te lire				18,885
	48			**80,874**

Kapaciteti Instaluar i gjithe prodhuesve	**2,670**	**MW**	**Prodh.**	**8,795,637**

Figura 24. Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2023

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes është 382 MW. Kapaciteti i instaluar i centraleve në rrjetin e shpërndarjes përbëhet nga 334 MW fuqi e instaluar në burime Hidrike dhe 48 MW fuqi e instaluar në impiante fotovoltaike.

Prodhimi i realizuar nga centralet hidrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2023 është në sasinë 1,005,636 MWh, ndërsa prodhimi i realizuar nga impiantet fotovoltaike është në sasinë 80,874 MWh.

1.3 TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Transmetimi i Energjisë Elektrike në Shqipëri kryhet nëpërmjet sistemit të transmetimit i cili perfshin rrjetin me tensionit të lartë 400 kV, 220 kV, 150 kV, dhe 110 kV.

Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, përcakton se: "Sistemi i Transmetimit" është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

1.3.1 Bilanci energjitik

Tabela e mëposhtme paraqet bilancin energjitik të OST sh.a. për vitin 2023, si dhe për periudhën 2015 – 2022 per efekte krahasimore. Sikure evidentohet Energjia totale e transmetuar ne sistemin e transmetimit per vitin 2023 rezulton 10,148 GWh me një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2022.

Nr.	Bilanci Energjetik i OST sh.a (GWh)	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
I	ENERGJI TOTALE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT	7,830	8,462	7,577	9,848	7,943	8,130	10,685	9,547	10,148
1	- Prodhimi vendas	5,475	6,636	4,174	8,076	4,767	4,892	8,432	6,504	8,226
2	- Energji në marrje (import ne interkoneksion)	2,355	1,827	3,403	1,772	3,177	3,238	2,253	3,044	1,922
II	ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR	7,672	8,272	7,419	9,606	7,775	7,958	10,685	9,547	9,927
1	- Energji në dhënie (eksport ne interkoneksion)	956	1,869	488	2,685	770	963	2,800	2,123	2,842
2	- Energji e transmetuar për OSSH sh.a.	6,106	5,901	6,148	5,963	6,137	6,184	6,606	6,546	6,492
3	- Energji transmetuar për klientëte lidhur në rrjetin e transmetimit	610	503	781	957	867	811	1,049	679	594
III	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+Newjat Vetjake	159	190	158	242	169	172	228	200	220
	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+Newjat Vetjake (%)	2.03	2.25	2.08	2.46	2.12	2.12	2.13	2.09	2.17

Figura 25. Bilanci Energjitik i OST sh.a. për vitin 2023 krahasuar me atë të viteve 2015 - 2023 (MWh)

Niveli i Humbjeve në sistemin e transmetimit për vitin 2023 është 220 GWh ose 2.17 % e energjisë elektrike të transmetuar krahasuar me vleren 2.09% te vitit 2022. Ky nivel humbjesh i energjisë elektrike në sistemin e transmetimit për vitin 2023 rezulton me një rritje krahasuar me atë të vitit 2022, kjo per faktin se niveli i humbjeve në Sistemin e Transmetimit është i lidhur me sasinë e energjisë elektrike të transmetuar si dhe me nivelin e prodhimit të HEC-eve të lidhura në Sistemin e Transmetimit. Rritja e sasise së energjisë elektrike të transmetuar ne sistemin e transmetimit për vitin 2023 në vleren 601 GWh krahasuar me vitin 2022, fakt qe ka dhene impaktin e vete ne drejtim te rritjes se humbjeve ne sistemin e transmetimit.



Figura 26 Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjitik shqiptar për vitin 2023

Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjitik shqiptar jepet në mënyrë të detajuar në figurën më sipër. Sasia totale e energjisë elektrike e hyrë në sistemin e transmetimit për vitin 2023 është rreth 10,147 GWh. Sasia totale e energjisë elektrike e hyrë në sistemin e shpërndarjes është rreth 7,062 GWh.

Energjia elektrike në sistemin e shpërndarjes injektohet nga sistemi i transmetimit dhe nga impiantet gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes. Sistemi i transmetimit ka injektuar për vitin 2023 në rrjetin e shpërndarjes sasinë prej 6,492 GWh, ndërsa impiantet gjeneruese të lidhura direkt në rrjetin e shpërndarjes kanë injektuar në këtë rrjet sasinë neto të energjisë elektrike prej rreth 570 GWh.

1.3.2 Veprimtaria e OST sh.a.

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. është personi juridik i liçensuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, i cili ka në pronësi sistemin e transmetimit dhe respekton parimin e pavarësisë, të përcaktuar në Nenin 54 të Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar. Në vendin tonë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) është shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore. Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në ligj.

OST sh.a. aktualisht kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, si dhe Operatorit të Sistemit të Dispeçerimit të sistemit.

OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

- Furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes, si dhe klientëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit,
- Transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit,
- Tranzitimin dhe shkëmbimin e nevojshëm me vendet e rajonit.

Në këtë kuadër OST sh.a. zhvillon Sistemin e Transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të energjisë elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkonjeksionit me vendet fqinje. OST sh.a. dispeçeron sistemin Elektroenergjitik Shqiptar nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera fqinje.

1.3.2.1 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike të Shqipërisë përfshin të gjitha linjat me tension 400 kV, 220 kV, 1150 kV, 10 kV dhe nënstacionet lidhëse midis tyre që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike dhe interkonjeksionit.

Gjatësitë e linjave të sistemit të transmetimit (përfshirë edhe investimet e bëra nga investitorë privatë), sipas nivelit të tensionit janë:

- Linjat e transmetimit 400 kV 445.7 km
- Linjat e transmetimit 220 kV 1,297.4 km
- Linjat e transmetimit 150 kV 34.4 km
- Linjat e transmetimit 110 kV 1,701 km

Në përbërje të linjave të mësipërme janë pjesë e sistemit të Transmetimit dhe linjat e interkonjeksionit me vendet fqinje si:

- Linja e interkonjeksionit 400 kV Zemblak (Shqipëri) – Kardia (Greqi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Koman (Shqipëri) – Prishtinë (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Fierzë (Shqipëri) – Prizren (Kosovë)

- Linja e interkonjeksionit 220 kV Koplik (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Linjë e interkonjeksionit 150 kV Bistricë (Shqipëri) – Myrtos (Greqi).



Kapaciteti teknik i shkëmbimit me vendet fqinje është i mjaftueshëm për të realizuar shkëmbimet e nevojshme dhe tranzitimet e kërkuara në çdo kohë, megjithatë në periudha të caktuara ka kongjestion të kapaciteteve transmetuese në interkonjeksion.



Figura 27. Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë.



Figura 28. Skema e Sistemit të Transmetimit Shqiptar



Figura 29. Skema njëfazore e Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar në nivelin 400-220-150-110kV.

Më poshtë janë listuar Nënstacionet kryesore të Sistemit të Transmetimit.

Nr	Nënstacioni		Fuqia e Instaluar (MVA)	Njësia Operative
1	400 kV	N/st 400/220kV Koman	345	Shkodër
2		N/st 400/220kV/110kV Tirana 2	840	Tiranë
3		N/st 400/220kV Elbasan 2	600	Elbasan
4		N/st 400/110kV Zemblak	300	Korçë
5	220 kV	N/st 220/110kV V.Dejës	240	Shkodër
6		N/st 220/110kV Fierzë	120	Shkodër
7		N/st 220/110kV Koplik	90	Shkodër
8		N/st 220/110kV Burrel	120	Shkodër
9		N/st 220/110kV/20kV Tirana1	486	Tiranë
10		N/st 220/110kV Sharrë	190	Tiranë
11		N/st 220/110kV Rrashbull	200	Tiranë
12		N/st 220/110kV Elbasan 1	330	Elbasan
13		N/st 220/110kV Fier	360	Fier
14		N/st 220/110kV Babicë	200	Fier
15		N/st 220/110kV Shumbat	120	Burrel
15	150 kV	N/st 110/150kV Bistrica 1	80	Fier
Total			**4621**	



Figura 30. Kapaciteti i instaluar sipas nenstacioneve (MVA)

1.3.3 Gjendja e përgjithshme e Sistemit Elektroenergjitik referuar raportimit të OST sh.a.

OST sh.a., në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi është përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit. OST sh.a. realizon këto detyra duke u bazuar në kërkesat dhe parimet e sigurisë operative dhe garantimin e funksionimit të sistemit të transmetimit në nivel të lartë koordinimi, besueshmërie, cilësie dhe qëndrueshmërie.

Siguria operative e rrjetit

Aftësia e sistemit të transmetimit për të qëndruar në gjendje normale dhe/ose aftësia për t'u kthyer në gjendjen normale në një kohë sa më të shkurtër, karakterizuar nga limitet e sigurisë së operimit, cilësohet nga OST sh.a. si siguria operative e rrjetit. Si rrjedhojë, sistemi i transmetimi konsiderohet në gjendje normale dhe të sigurtë kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

Sistemi i Transmetimit operohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, gjithashtu sigurohet të përmbush të gjithë udhëzimet dhe politikat e ENTSO-E, veçanërisht parashikimet e marrëveshjes së operimit të zonës sinkrone të ENTSO-E si dhe udhëzuesin mbi Sigurinë dhe Operimin e Sistemit të Transmetimit (SO GL). Gjatë vitit 2023 OST sh.a. në përmbushje të roleve të saj ka realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Operimin e sistemit elektroenergjetik në pajtueshmeri me Kodin e Transmetimit dhe standarteve të ENTSO-E.
- Planifikimin e mbulimit të kërkesës me bazë ditore/orare, skedulimin orar për çdo central dhe kontrollin e nivelit të sigurisë së operimit duke përdorur kriterin e sigurisë "n-1".
- Menaxhimin e shërbimeve ndihmëse të domosdoshme për funksionimin e sigurtë të sistemit të Transmetimit.
- Menaxhimin e gjenerimit dhe kërkesën e energjisë elektrike në kohë reale, duke siguruar balancën ndërmjet gjenerimit, shkëmbimit dhe konsumit të energjisë elektrike.
- Shkëmbimin dhe harmonizimin e skedulimit orar të shkëmbimit të energjisë me OST-të fqinje, për ditën pasardhëse si dhe llogaritjen e shkëmbimit të energjisë për çdo interkonektor për ditën paraardhëse.
- Analizën e punës së Sistemit Energjetik dhe aktivizimin e masave për ruajtjen e sigurisë së punës, në koordinim me Përdoruesit e Rrjetit dhe OST-të e rajonit.
- Parashikimin e punës së Sistemit Energjetik në terma afatshkurtër e afatmesëm.
- Në bashkëpunim me OST-të fqinje,ka përcaktuar kapacitetin transmetues ndërkufitar për çdo kufi e drejtim të fluksit të energjisë me bazë vjetore, mujore dhe ditore.

Për sa më lart parashtruar, duke analizuar çdo proces që konsiderohet thelbësor për të menaxhuar funksionimin e sistemit të transmetimit dhe për të ruajtur sigurinë operative të rrjetit, OST sh.a. ka raportuar për vitin 2023 duke përfshirë sa vijon:

- Nivelet e tensionit dhe flukset e fuqisë janë brenda limiteve të sigurisë operacionale të përcaktuara në Kodin e Transmetimit edhe brenda intervalit të përcaktuar në rregulloren miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 207, datë 18.12.2017 për "Cilësinë e Furnizimit dhe Përformancën e Sigurisë së Rrjetit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike".
- Frekuenca e sistemit ka qenë brenda diapazonit +/- 200mHz, duke respektuar përcaktimet e Kodit e Transmetimit dhe të Vendimit ERE Nr.207, datë 18.12.2017 për "Cilësinë e Furnizimit dhe Përformancën e Sigurisë së Rrjetit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike".
- Rezervat e fuqisë aktive dhe reaktive kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar ngjarjet e paplanifikuara pa cënuar kufinjtë e sigurisë operacionale;
- Edhe në rastet e aktivizimit të veprimeve korrigjuese, pas ndodhjes së një kontigjence Operimi i zonës së përgjegjësisë së OST-së ka mbetur brenda kufijve të sigurisë operative.

Nivelet e tensionit

Në dispozitat e Kodit të Transmetimit dhe të Rregullores së miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 për "Cilësinë e Furnizimit dhe Përformancën e Sigurisë së Rrjetit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike" përcaktohet se, OST sh.a. duhet të respektojë diapazonet e tensioneve sipas niveleve, si në vijim:

- Për nivelin 400 kV diapazoni i lejuar eshtë nga 0.9 pu deri me 1.05 pu.
- Për nivelin e tensionit 220/154/110 kV diapazoni i lejuar eshtë 0,90 pu deri ne 1,118 pu.

Niveli i tensionit në rrjetin e transmetimit varet nga zhvillimi i rrjetit , topologjia e tij si dhe nga shpërndarja e gjenerimeve dhe e konsumit në ketë rrjet. Sistemi energjitik Shqiptar në rajonin Verilindor të vendit ka të instaluar pjesen me të madhe të gjenerimeve nga ku injektohet energjia në rrjet, si rrjedhojë, në sezonet me shumë rreshje, kur dhe gjenerimi i centraleve eshtë maksimal, jane shfaqur tensione relativisht të larta, por brenda diapazoneve të përcaktuara ne Kodin e Transmetimit.

Megjithatë pas hyrjes në operim më 17 nëntor të nënstacionit Shumat 220/110kV dhe Linjës 220 kV Shumat – Burrel situata në rajonin Verilindor është përmirësuar ndjeshëm. Investimi i ri dhe puna e kooordinuar në kryejen e veprimeve operative në kohën me të shkurtër të mundshme ndërmjet QKD të OST dhe Qendrave Dispeçer të OSSH duke kontrolluar, vazhdimisht, ngarkesat e linjave në teresi por me prioritet linjat 110 kV, si pjesa më e ngarkuar dhe më problematike e sistemit, kanë bërë të mundur që në rrjetin 110kV vlerat e tensionit të jenë brenda diapazoneve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit.

Kontrolli i frekuencës

Kontrolli i frekuencës për Sistemin e Transmetimit menaxhohet tashmë në mënyrë të automatizuar nga FCR dhe aFRR. Nëse është e nevojshme, ndonjëherë rezervat shtesë aktivizohen manualisht (mFRR ose RR). Veprimet parandaluese, FCR dhe aFRR janë vazhdimisht aktive për të kundërvepruar në rast të imbalancave të sistemit. Veprimet kurative mFRR dhe RR aktivizohen në mënyrë manuale nga Operatorët e QKD. Në zbatim të kërkesave dhe përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, OST sh.a. i merr shërbimet balancuese nga Gjeneruesit e kualifikuar si Ofrues i Shërbimit të Balancimit (OSHB).

Nëpermjet modulit LFC (Load Frequency Control) pjese e paketës AGC, aplikacion i cili mbledh, analizon dhe i përgatit të dhëna hyrëse, llogarit gabimin e kontrollit të zonës (devijimin nga vlerat e planifikuara - ACE) dhe nga ajo llogarit ndryshimin total të kërkuar të energjisë të OST-së në Shqipëri. Devijimi nga vlerat e planifikuara i dergohet si kerkese për kontribut të gjitha njesive të OSHB-ve qe kanë fituar ankandin per te ofruar sherbimin ne ate moment dhe janë integruar në kontrollin e LFC.

Gjatë vitit 2023 vlerat e frekuencës në zonën e monitorimit të OST sh.a janë mbajtur brenda diapazoneve të parashikuara në Kodin e Transmetimit dhe rregulloret e tjera në fuqi.

Rezervat e fuqisë aktive dhe reaktive

Gjatë procesit të vlerësimit të mjaftueshmërisë në zonën e përgjegjësisë, OST vlerëson mundësinë e plotësimit të kërkesës totale të vendit, duke konsideruar gjenerimin disponibel nga të gjithë gjeneruesit në kombinim me aftësinë e linjave të interkoneksionit, me skenarë të ndryshëm operacionalë duke marrë parasysh nivelin e kërkuar të rezervave të fuqisë aktive dhe reaktive.

Në bazë të Kodit të Transmetimit, Manualit të Operimit të ENTSO-E (SO-GL), dhe Vendimit ERE nr.106 datë 02.07.2020 per miratimin e Rregullave te Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, OST sh.a. prokuron rezervën balancuese të nevojshme për ruajtjen e balancës të zonës së kontrollit në menyrë të vazhdueshme.

1.3.4. Operimi i zonës së përgjegjësisë së OST-së

Planifikimi

OST planifikon zhvillimin e sistemit të transmetimit në përputhje me kriterin (N-1) të Sigurisë Operacionale. OST sh.a. bashkëpunon me OST fqinje për të koordinuar zhvillimin e rrjetit të interkoneksionit e në të njëjtën kohë merr në konsideratë zhvillimin e rrjetit/objekteve të përdoruesve të sistemit të transmetimit në planifikimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit.

Planifikimi afatgjatë

Qëllimi kryesor i planifikimit afatgjatë është të identifikojë kongjestionet e ardhshme strukturore në rrjet, zakonisht falë analizave të sigurisë N-1 ose N-k, dhe më pas të gjejë mënyrën më të mirë për t'i zgjidhur ato. Dy mekanizmat kryesorë për studime të tilla të rrjetit janë:

- Studime ad-hoc të rrjetit (horizonti kohor < 5-10 vjet): nxitur nga modifikimet lokale të rrjetit, për shembull në rast të një kërkese të re për kyçje në rrjet ose çaktivizimit të një elementi kryesor të rrjetit,
- Planet afatgjata të zhvillimit (horizonti kohor > 5-10 vjet): studime globale dhe strategjike të kryera në baza të rregullta, duke marrë parasysh zhvillimin kombëtar dhe ndërkombëtar të rrjetit.

Tradicionalisht, zgjidhja kryesore për të eleminuar pikat e dobta eshtë zhvillimi i rrjetit duke ndërtuar element te rinj te sistemit te transmetimit te tilla si linja të reja transmetimi ajrore ose kabllore si dhe instalimi i transformatorëve ne nenstacione. Sidoqoftë, meqenëse është më e vështirë të zbatohen zgjidhje të tilla (kosto të larta, kohëzgjatje të gjatë të projektit), nga OST

merren parasysh edhe zgjidhje të reja dhe inovative, të tilla si skema të veçanta mbrojtjeje ose vendosja e pajisjeve të kontrollueshme.

Planifikimi afatmesëm

Planifikimi afatmesëm mbulon aktivitetet që fillojnë nga viti në vazhdim. Në këtë hark kohor OST fokusohet në planifikimin e ndërprerjeve, të cilat duhet të koordinohen nëse ndikojnë në funksionimin e sistemeve fqinje. Kjo përfshin asetet e veta, si dhe njësitë gjeneruese ose objektë të tjera të rëndësishme. Rëndësia e aseteve të nevojshme për t'u koordinuar rrjedh në bazë të një metodologjie, e cila përfshin aspektë cilësore dhe sasiore si afërsia me kufijtë e një zonë kontrolli ose efekti në vlerat elektrike nga simulimet e fluksit të energjisë.

Planifikimi afatshkurtër

Planifikimi afatshkurtër përfshin disa nënprocese. Procesi i një jave në avance merret me planifikimin e ndërprerjeve me një njoftim të shkurtër (kerkesa për javen në vazhdim) dhe aktivizimin e centraleve shtesë, të cilat janë të nevojshme për të ruajtur sigurinë e sistemit.

Alokimi i kapaciteteve fillon dy ditë përpara dhe përcakton kapacitetet maksimale të transferimit ndërmjet zonave të ndryshme të ofertave. Vlerësimi përsëritet një ditë para dhe brenda ditës.

Procesi i ditës në vazhdim përqendrohet në planifikimin e veprimeve përmiresuese për të parandaluar të gjitha konxhestionet, të cilat mund të ndodhnin ditën e nesërme. Në mënyrë tipike, veprimet korrigjuese planifikohen në bazë kombëtare dhe më pas koordinohen me të gjithë fqinjët përkatës. Rezultatet nga planifikimi i ditës në vijim përditësohen brenda ditës bazuar në parashikimet e reja. Analizat në planifikimin e ditës në vijim bazohen në modele të gjendjes së qëndrueshme.

Operimi në kohë reale

Në operimin në kohë reale, operatori i OST monitoron dhe vlerëson sigurinë e sistemit të transmetimit me anë të analizave të gjendjes së qëndrueshme. Verifikohen veprimet parandaluese korrigjuese të përcaktuara nga planifikimi operacional. Nëse identifikohen kongjestione të mundshme ose shkelje të niveleve të tensionit, operatori duhet të marrë veprime të arsyeshme korrigjuese për të zgjidhur problemet. Për shkak të kufizimeve kohore, operatori duhet të bëjë vlerësimin pa mbështetjen e një mjeti optimizimi. Nëse ndodh një kontingjencë reale, operatori duhet të rivendosë sigurinë N-1 sa më shpejt që të jetë e mundur. Në rast të situatave emergjente zbatohen veprimet nga plani i mbrojtjes. Kontrolli i frekuencës është i automatizuar. Veprimet manuale nga operatori janë të nevojshme nëse ndodhin devijime më të mëdha të frekuencës ose nëse rezervat për kontrollin e frekuencës janë pothuajse të shteruara.

Protokolli i bashkëpunimit operativ për operimin në kohë reale ndërmjet OST sh.a. dhe OSSH sh.a.

Të dy qendrat Dispecer (OST, OSSH) monitorojnë parametrat kryesorë të Sistemit Elektronergjetik, si rryma, tensionë në linja dhe transformatore dhe vecanërisht në linjat e rajonit të Tiranës, respektivisht secili në zonat e veta të vëzhgimit.

Në rast avarie, Opëratorët e n/st (OST, OSSH) marrin sinjalet e veprimit të mbrojtjeve dhe raportojnë në Qendrat Dispecer përkatese; mbi bazën e vlerësimit të tyre, kur gjykohet e

arsyeshme, Dispeceria OST dhe OSSH kanë bashkëpunuar për rikycjen pa vonesë të elementit të stakuar.

Në funksion të zvogelimit të kohës së ndërprerjes, vlerësohet, cdo informacion tjetër që merret në rruge operative në lidhje me elementin e stakuar.

Në rastet kur prova e rikycjes rezulton e pasuksesshme, të dy qendrat Dispecer marrin masa për rikonfigurimin përfundmitar të skemës, sipas regjimeve të vendosura pas avarisë, si më sipër me kufizimet e detyruara të energjisë. Kjo situatë, vazhdon deri në normalizimin e gjendjes.

1.3.4.1. Sistemet e Kontroll - Monitorimit Automatik

Për të përmbushur objektivat, OST mundëson kontrollin automatik të rrjetit të transmetimit nëpërmjet sistemeve të kontrollit lokal (sisteme të instaluar në nënstacione) si dhe nëpërmjet sistemeve SCADA/EMS, sisteme në operim nga Operatoret e e QKD-s. Këto sisteme mundësojnë monitorimin dhe operimin në kohë reale të të gjithë nënstacioneve 220/400kV, si dhe pjesës më të madhe dhe më të rëndësishme të nënstacioneve 110kV. Krahas Nënstacioneve monitorhen dhe operohen Centralet e lidhura në rrjetin e Transmetimit. Aktualisht, OST monitoron në kohë reale në sistem këto të dhëna: a) Flukset e fuqisë aktive dhe reaktive; b) Tensioni në zbara; c) Rrymat në linja, Transformatorë dhe elementë të tjerë të sistemit të transmetimit, d) Frekuenca dhe gabimi i kontrollit të rivendosjes së frekuencës në zonën e vet të LFC; e) Monitorimi dhe kontrollit i Bllokut AK (OST-KOSTT) f) Rezerva e fuqisë aktive dhe reaktive; g) Gjenerimi dhe konsumi.

Krahas operimit në kohe reale të sistemit të transmetimit, në sistemin SCADA/EMS janë të implementuar aplikacionet e rrjetit EMS. EMS është paketa e aplikacioneve të rrjetit, e cilat nëpërmjet studimeve të brendshme të sistemit, bazuar në gjendjen aktuale të tij dhe në paramentrat e çdo elementi të sistemit energjitik të përfshirë në SCADA, optimizon gjendjen e sistemit. Ndër funksionë të tjera EMS mbulon: a)Suport në vendimmarrje; b) Kontollin mbi gjenerimin; c) Planifikimin e Energjisë; d) Analizat e Sigurisë; e) Suport për manovrime të mundshme; f) Monitorimin e rrjetit energjetik.

Moduli EMS përbëhet nga disa aplikacionë të cilat bashkëveprojnë në rrjet me njëra tjetrën dhe në të njëjtën kohë mund të menaxhohen individualisht nga njëra tjetra. Secili nga aplikacionet e rrjetit të përfshira në paketën EMS është i implementuar si paketë software-ike e ndarë nga aplikacionet e tjera, por që ndërfaqësohen mes tyre me anë të bazës së të dhënave në kohë reale. Modularizimi në këtë mënyrë ofron lehtësira në manaxhimin e paketës EMS në tërësi. Përveç studimeve mbi stacionet nga të cilat monitorohen në kohë reale, EMS duke u bazuar në të dhëna referuese kryen studime edhe për nënstacionet e tjera të cilat nuk janë përfshirë në monitorim.

Në qendren e kontrollit të OST sh.a. është implementuar paketa AGC (Automatic Generation Control), modul i cili rregullon prodhimin e gjeneratorit në menyre qe të mbaje frekuncen dhe shkembimin në vlerat e skeduluara. Ky modul eshtë konfigururar duke iu përmbajtur manualeve operacionale të publikuara nga ENTSO-E.

Moduli kryesor i paketës AGC është LFC (Load Frequency Control), aplikacion i cili mbledh, analizon dhe i përgatit të dhëna hyrëse, llogarit gabimin e kontrollit të zonës (devijimin nga

vlerat e planifikuara - ACE) dhe nga ajo llogarit ndryshimin total të kërkuar të energjisë të OST-së në Shqipëri. Devijimi nga vlerat e planifikuara i dërgohet si kërkesë për kontribut të gjitha njësive që janë në kontrollin e LFC.

OST sh.a. disponon rrjet telekomunikacioni të dedikuar për operimin e sigurtë të sistemit. OST sh.a. ka një qendër rezervë të kontrollit të lidhur në rrjetin e telekomunikacionit të sigurisë e pajisur me pajisje kontrolli. Të gjitha të dhënat që merren në distancë, thirren apo përftohen dhe përpunohen në mënyrë të dyfishtë me anë të kanaleve të ndryshme.

1.3.4.2 Menaxhimi i fluksit të energjisë

Menaxhimi i fluksit të energjisë ka të bëjë me krijimin apo përcaktimin e mjeteve operacionale për të mbajtur rrjedhën e flukseve të energjisë brenda kufijve të sigurisë operative në çdo element të sistemit të transmetimit. Për të monitoruar dhe kontrolluar parametrat operacionale është e nevojshme që të ketë informacion të saktë mbi gjendjen e sistemit dhe vlerësimit të tij. OST kontrollon parametrat operacionale brenda zonës së vet të përgjegjësisë dhe në mënyrë të koordinuar, merr në konsideratë parametrat operative nga zona e observimit që përfshin pjesë të OST-ve fqinje.

Gjatë vitit 2023 nuk janë konstatuar raste ku janë cënuar kufijtë që ndikojnë në mbajtjen e rrjedhës së flukseve të energjisë brenda kufijve të sigurisë operative në çdo element të sistemit të transmetimit.

Për të qenë në gjendje për të përballuar avaritë në sistem, nga ana e OST përgatiten veprimet përmirësuese individuale dhe të koordinuara dhe zbatohen kur është e nevojshme, për të parandaluar shkeljen e limiteve të Sigurisë Operative dhe për të suportuar kthimin në normalitet në rastet e gjendjes së alarmit ose gjendjes së emergjencës

Çdo element i Sistemit të Transmetimit ka kufijtë e sigurisë operative në drejtim të rrjedhës së energjisë. Këto kufizime janë të rëndësishme për mbrojtjen e pajisjeve dhe njerëzit në afërsi të një elementi të caktuar të Sistemit të Transmetimit, duke marrë parasysh kufizimet teknike të materialeve të përdorura, me qëllim shmangien e dëmtimit apo vjetërimin e parakohshëm të pajisjes. Për të qenë në gjendje për të përballuar avaritë në sistem, nga ana e OST përgatiten veprimet përmirësuese individuale dhe të koordinuara dhe zbatohen kur është e nevojshme, për të parandaluar shkeljen e limiteve të Sigurisë Operative dhe për të suportuar kthimin në normalitet në rastet e gjendjes së alarmit ose gjendjes së emergjencës.

1.3.4.3 Analiza e kontigjencave dhe trajtimi

OST sh.a. përfiton analiza sigurie nga Qendra e Koordinimit të Sigurisë, SCC Ltd. Beograd(Regional Security Coordinator for SEE) nëpërmjet një kontratë si përdorues i shërbimeve të SCC Ltd. Beograd. Kjo kontratë përfshin 5 shërbimet e mëposhtme:

- Vlerësimi dhe përmirësimi i modelit të rrjetit individual/të përbashkët (IGM/CGM),
- Llogaritja e koordinuar e kapacitetit (ndërkufitar),
- Koordinimi i analizës së sigurisë (përfshirë masat përmirësuese, parandaluese),
- Mjaftueshmëria, besueshmëria e punës në terma afat shkurtër/mesëm,

- Koordinimi i planifikimit të remonteve.

Siguria e operimit të sistemit është shkaku i realizimit të analizave të kontigjencës, të cilat OST i realizon duke simuluar stakim të elementeve të Sistemit të Transmetimit. Kjo analizë kryhet duke përdorur modelin individual të OST dhe modelin e përbashkët të rrjetit, duke respektuar kufijtë e sigurisë operative dhe ndërkohë bëhet përgatitja për kryerjen e veprimeve përmirësuese para dhe pas incidentit, kur kërkohet nga rezultati i analizës. Parimet kryesore që ndiqen në lidhje me analizën e kontigjencave, janë:

Sigurimi i parandalimit dhe/ose përmirësimit për sa i përket veprimeve përmirësuese, të kërkuara për të ruajtur sigurinë e operimit, për të gjitha kontingjencat e besueshme që ndikojnë në sistemin e transmetimit.

Koordinimi i analizave dhe veprimeve përmirësuese, kurdo që është e nevojshme, për të siguruar rezultatin e dëshiruar - ruajtjen e sigurisë operative në sistem dhe në interkoneksion.

Mbështetja në të dhënat e duhura dhe informacionin në kohë reale dhe atë të bazuar në parashikimin e ngarkesave. Përdorimi i modelit të përbashkët të rrjetit rajonal dhe shkëmbimi i të gjitha të dhënave të nevojshme dhe informacionit ndërmjet OST, OSHEE dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit.

Vërehet nga Raportimi se nga ana e OST-së nuk është cënuar në asnjë rast siguria e operimit pergjatë vitit 2023 në rrjetin e Transmetimit të Energjisë Elektrike.

1.3.4.4 Menaxhimi i qëndrueshmërisë dinamike

OST monitoron qëndrueshmërinë dinamike të Sistemit të Transmetimit në termat e tensionit, frekuencës dhe qëndrueshmërisë së këndit të rotorit, me studime off-linë me matje në zonë të gjerë, duke përfshirë shkëmbimin e të dhënave relevantë me OST-të e tjera kur është e nevojshme, në mënyrë që të jetë në gjendje të marrë masat e nevojshme korrigjuese kur siguria operative e sistemit është në rrezik. Qëllimi i studimeve dinamike offline është të sigurojë ndërgjegjësimin e operatorit të OST në lidhje me gjendjen aktuale dhe parashikimin në të ardhmen të situatës së sistemit në lidhje me qëndrueshmërinë, në situatën (N) dhe në atë të mundshme (N-1). Përveç kësaj, studime të tilla ndihmojnë në vendimmarrjen për veprime përmirësuese sa më efikase, për parandalimin e incidenteve ose korrigjimin e pasojave të tyre, nëse ato ndodhin.

Gjatë vitit 2023 rezulton se në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nuk janë shënuar ngjarje apo cënuar kufijtë e sigurisë operacionale, si dhe sistemi i transmetimit ka funksionuar në mënyrë të qëndrueshme dhe në kushte normale operimi.

1.3.4.5. Balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë 5-vjeçare

Në bazë të të dhënave historike të OST sh.a., duke konsideruar rritjen potenciale të gjenerimit të PPE + PVE dhe reduktimin e humbjeve jo teknike në rrjetin e shpërndarjes, është pranuar që rritja e pritshme e vëllimit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST sh.a., të jetë e rendit 1%. Mbi këtë bazë, duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e

mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i parametrave kryesore energjetike dhe sigurimi i balancës së sistemit për pesë vjeçarin në vijim 2024-2028, siç jepet në tabelat e mëposhtme:

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vit 2024
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	805	803	933	866	801	717	713	709	687	797	880	1065	9,825
a)	Prodhim vendas	"	565	553	670	580	553	390	450	460	365	435	460	585	6,060
b)	Energji ne marrje	"	330	249	263	286	248	327	263	259	272	362	420	480	3,765
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	805	765	915	850	765	700	695	690	620	780	870	1,045	9,810
a)	Energji elektrike e dhene	"	185	116	285	285	258	180	20	25	50	234	254	365	2,224
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	505	564	535	477	482	450	525	575	485	446	506	572	6,264
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	95	85	95	90	95	90	90	90	85	100	110	125	1,150
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	20	18	18	16	16	17	18	19	17	17	19	20	214
b)	Humbjet ne %	%	2.25%	2.34%	1.93%	1.85%	2.00%	2.37%	2.52%	2.68%	2.67%	2.13%	2.14%	1.88%	2.23%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vit 2025
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	906	863	948	816	788	761	834	810	677	752	849	961	9,995
a)	Prodhim vendas	"	580	560	675	595	570	400	490	400	365	405	435	560	6,125
b)	Energji ne marrje	"	326	303	273	221	218	361	344	520	312	347	414	401	3,870
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	885	845	930	800	770	745	815	790	660	735	820	920	9,715
a)	Energji elektrike e dhene	"	110	175	225	170	205	165	125	85	90	130	185	305	1,770
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	675	575	600	535	475	485	590	600	480	530	520	665	6,780
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	100	95	105	95	90	95	100	105	90	95	115	150	1,235
Gjatë vitit 2023, ERE ka monitoruar përmes raportimit periodik blerjet e energjisë elektrike në treg të hapur nga shoqëritë pjesërisht të rregulluar KESH sh.a., ku rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë në treg të hapur nga shoqëria KESH sh.a., e ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik është rreth 110.52 EUR/MWh, ndërkohë qe çmimi mesatar i ponderuar i shitjes së energjisë në treg të hapur nga shoqëria KESH sh.a. rezulton me rreth 87.55 EUR/MWh.

KESH sh.a. gjatë vitit 2023 ka shitur/blerë dhe shkëmbyer energji elektrike në treg të parregulluar kryesisht për optimizim, në zbatim të "Rregullores së Tregtimit të Energjisë

Elektrike nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a." miratuar me Vendimin nr. 2762/8, datë 06.06.2019, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e pronarit të KESH sh.a. dhe "Rregullave të përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a." të miratuar me Vendimin nr.5233/1, datë 12.06.2020, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit.

Më poshtë po paraqesim një tabelë me të dhëna të transaksioneve më të detajuara të kryera gjatë vitit 2023 nga KESH sh.a.

Blerje energji elektrike sipas detyrimit për shërbim publik të vendosur me VKM 456/2022 & 449/2023							
Shoqëria	Periudha	Statusi	Sasia	Çmimi	Vlera	TVSH	Vlera me TVSH
			MWh	Euro/MWh	Euro	Euro	Euro
Janar	01-31.01.2023	Blerje	-	-	-	-	-
Shkurt	01-28.02.2023	Blerje	-	-	-	-	-
Mars	01-31.03.2023	Blerje	-	-	-	-	-
Prill	01-30.04.2023	Blerje	-	-	-	-	-
Maj	01-31.05.2023	Blerje	-	-	-	-	-
Qershor	01-30.06.2023	Blerje	-	-	-	-	-
Korrik	01-31.07.2023	Blerje	108,125.00	112.64	12,179,724.08	1,341,357.68	13,521,081.76
Gusht	01-31.08.2023	Blerje	107,700.00	107.60	11,588,616.00	420,374.40	12,008,990.40
Shtator	01-30.09.2023	Blerje	89,772.00	104.85	9,412,439.28	979,228.20	10,391,667.48
Tetor	01-31.10.2023	Blerje	161,710.00	107.84	17,438,810.72	2,023,433.68	19,462,243.92
Nentor	01-30.11.2023	Blerje	89,000.00	121.47	10,811,086.00	885,914.00	11,697,000.00
Dhjetor	01-31.12.2023	Blerje	5,120.00	120.86	618,812.00	123,762.40	742,574.40
TOTALE		**Blerje**	**561,427.00**	**110.52**	**62,049,488.08**	**5,774,070.36**	**67,823,557.96**

SHITJE ENERGJI ELEKTRIKE NE KUSHTET E PRURJEVE TE MEDHA					
Shoqëria	**Periudha**	**Statusi**	**Sasia**	**Çmimi**	**Vlera**
			MWh	**Euro/MWh**	**Euro**
Janar	01-31.01.2023	Shitje	135,690.00	109.01	14,792,103.12
Shkurt	01-28.02.2023	Shitje	40,686.00	95.79	3,897,117.32
Mars	01-31.03.2023	Shitje	-	-	-
Prill	01-30.04.2023	Shitje	-	-	-
Maj	01-31.05.2023	Shitje	215,137.00	62.80	13,509,555.03
Qershor	01-30.06.2023	Shitje	96,024.00	85.68	8,227,773.12
Korrik	01-31.07.2023	Shitje	-	-	-
Gusht	01-31.08.2023	Shitje	-	-	-
Shtator	01-30.09.2023	Shitje	-	-	-
Tetor	01-31.10.2023	Shitje	-		
Nentor	01-30.11.2023	Shitje	80,600.00	102.99	8,301,300.76
Dhjetor	01-31.12.2023	Shitje	71,400.00	101.72	7,262,752.44
TOTALE		**Shitje**	**639,537.00**	**87.55**	**55,990,601.79**

Figura 67. Transaksionet e kryera gjatë vitit 2023 nga KESH sh.a.

(Burimi KESH sh.a.)

Në grafikun e Figurës 68 më poshtë është paraqitur balanca (hyrje – dalje) import-eksport e energjisë elektrike për periudhën e 10-vjeçarit 2014 – 2023.

Për 10-vjeçarin e fundit, vendi ynë rezulton të jetë përgjithësisht një importues neto i energjisë elektrike me përjashtim të viteve 2016, 2018, 2021 dhe 2023. Sqarojmë se vlerat e paraqitura përfaqësojnë të gjitha flukset hyrëse e dalëse nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.



Figura 68 Balanca Import – Eksport e energjisë elektrike në vite

(Burimi: OST sh.a.)

2.1.6 Rekomandime për operatorët dhe pjesëmarrësit e tregut nga monitorimet

Përgjatë vitit 2023 në kuadër të vijimit të ushtrimit të funksionit monitorues nga ERE, për operatorët dhe pjesëmarrësit e tregut janë lënë rekomandime dhe detyra si vijon:

Zbatimi i plotë i Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 118, datë 27.07.2017, nga OST sh.a. dhe shoqeritë të cilat janë pjesë e OSHEE Group sh.a. në kuadër të rritjes së shkallës së transparencës në tregun e energjisë elektrike;

Zbatimin me rigorozitet të përcaktimeve të vendimit të Bordit të ERE-snr. 106, datë, 02.07.2020 "Mbi miratimin e rregullave të tregut Shqiptar të balancimit të energjisë elektrike", nga OST sh.a. përfshirë dhe garantimin e neutralitetit të saj financiar siç është përcaktuar në këto rregulla;

Zbatimin e kritereve të plota të ndarjes së OSHEE Group sh.a. në tre kompanitë e licencuara OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe FTL sh.a., përfshirë dhe format e mënyrat e raportimit të të dhënave në ERE sipas ndarjes;

Marrjen e masave nga OST sh.a., OSHEE GROUP sh.a. dhe KESH sh.a. për zbatimin e plotë të parashikimeve të Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 126 datë 30.07.2020.

2.2 Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)

Me vendimin e ERE nr. 126, datë 17.05.2021, është miratuar Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT). Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë transpozon Rregulloren REMIT 1227/2011 siç është miratuar dhe përshtatur për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe ka si qëllim të përcaktojë kriteret që ndalojnë praktikat abuzive që mund të ndodhin dhe prekin tregjet e energjisë me shumicë. Në të njëjtën kohë R regullorja ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.

2.2.1 Detyrime që lindin nga Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)

Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë, ndalon tregtimin e energjisë nga personat e brendshëm të kompanive. Kjo për faktin se këta persona posedojnë informacione të brendëshme në lidhje me produktet e energjisë që do të tregtohet për rrjedhojë përfshirja e këtyre personave në procesin e tregtimit të produkteve të energjisë dëmton konkurrencën, transparencën dhe deformon tregun e energjisë.

2.2.2 Monitorimi dhe regjistrimi i pjesëmarrësve në treg në zbatim të rregullorës REMIT

ERE monitoron aktivitetin tregtar të produkteve të energjisë me shumicë për të zbuluar dhe parandaluar tregtinë bazuar në rrjedhjen e informacionittë brendshëm dhe manipulimin e tregut vendas.

ERE bashkëpunon në nivel rajonal nëpërmjet Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë në kryerjen e monitorimit të tregjeve të energjisë me shumicë. Për monitorim të tregut të energjisë me shumicë, ERE gjithashtu do të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës, apo ndonjë organ tjetër për këtë qëllim. Në kryerjen e monitorimit të tregut, Autoriteti i Konkurrencës ose organi i monitorimit të tregut do të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ERE.

Pjesëmarrësit e tregut që hyjnë në transaksione me produkte të energjisë me shumicë në Shqipëri, ose shprehin interesin për të hyrë në transaksione të tilla përmes procedurave të tregtimit, duhet të regjistrohen pranë ERE.

2.2.3 Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut sipas REMIT

Përgjatë vitit 2023 ERE në zbatim të rregullores REMIT, ka krijuar një rubrike të vecantë në faqen zyrtare të internetit në seksionin, Tregu i Energjisë. Në këtë rubrikë gjenden dokumetat përkatës të rregullores përfshi dhe shtojcën A në të cilën paraqiten respektivisht Forma 1, kjo formë do të përdoret për paraqitjen e Informacionit nga ERE në Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë (ECRB) në rast të dyshimeve për ndikime abusive në Palët Kontraktuese bazuar në nenin 4(1) të ECRB, akti procedurial 01/2020, si dhe Forma 5 e cila do të përdoret me qëllim krijimin e Regjistrit Kombëtar të pjesmarrësve të tregut i cili publikohet.

Fokusi kryesor i punës së ERE këtë vit ka qënë në mirëmbajtjen dhe azhornimin Regjistrit Kombëtar REMIT në Shqiperi, i publikuar në faqen e ERE. Në vijim regjistri REMIT i krijuar përgjatë vitit 2023:

Regjistri Kombetar REMIT_Shqiperi

Nr.	Vendi	Kodi i ECRB	Data e paraqitjes	Emri Ligjor i Kompanisë	Forma Ligjore	Adresa e Kompanisë (Zyrat Qendrore)	Qyteti ku ndodhet Kompania	ZIP Code	Kodi EIC i Kompanisë	Kodi BIC i Kompanisë	Kodi LEI i Kompanisë	NIPT i Kompanisë	Website i kompanise	Webpage ku jane publikuar informacionet e lirenduhme
1	Shqiperi	ECRB-AL-20220105-001	05.01.2022	GSA	SHPK	Njesia Bashkiake Nr.5 Rr. Ibrahim Rugova 64,	Tirane	1019	22XGSA---N	SGSBALTX		J61820031J	www.gsa.al	www.gsa.al
2	Shqiperi	ECRB-AL-20220125-001	25.02.2022	GEN-I Tirana	SHPK	Ish-Noli Business center, Rr. Ismail Qemali Nr. 27	Tirane	1000	22XL---120709GEN0	SGSBALTX		K91413005A	https://www.gen-i.eu/at/en/	https://www.gen-i.eu/at/en/
3	Shqiperi	ECRB-AL-20220216-001	16.02.2022	Alfasy Trading & Consulting	SHPK	Rruga "Vaso Pasha" Nr. 20	Tirane	1001	54XL-1-10100.AESPF			M12221008H	www.alfaexpt.al	www.alfaexpt.al
4	Shqiperi	ECRB-AL-20220601-001	01.06.2022	Kompania Elektroenergjitike Shqiptare	SHA	Rruga "Viktor Eftimiu"	Tirane	1023	22XL-1309184PC-M	SGSBALTX		J61817005F	www.kesh.al	www.kesh.al
5	Shqiperi	ECRB-AL-20220228-001	28.02.2022	NOA Energy Trade	SHPK	Bulevardi "Deshmoret e Kombit" Kullat biznjake kati 2	Tirane	1001	22XL--1506130-N-6			L42200201A	www.noaenergy.al	
6	Shqiperi	ECRB-AL-20220225-001	25.02.2022	Operatorit te Sistemit te Transmetit	SHA	Autostrada Tirane-Durres KM 9 Kashar	Tirane	1051	10XAL-ADSH- J	SGSBALTX		K42100101N	www.ost.al	www.ost.al/re-dhenj
7	Shqiperi	ECRB-AL-20220218-001	18.02.2022	INFO-Telecom	SHPK	Rruga "Pash Komica" Nr1 Pallati kaq perball fakultetit ekonomik	Tirane	1001	54XL-1-1100-INFTI	SGSBALTX		K92402002P	www.infotelecom.al	
8	Shqiperi	ECRB-AL-20210712-001	12.07.2021	ReNRGY Trading Group	SHPK	Rruga "Dervish Hima" Nr1 Tirane	Tirane	1010	54XL-101RNX02S16R			L81818026N	www.renrgy.com	www.renrgy.com
9	Shqiperi	ECRB-AL-20220218-001	18.02.2022	Tirana International Development	SHPK	Rruga "Sami Frasheri" NG, shkalla F, kati 1 Zyra 2	Tirane	1001	54x-1-0101-TID-F	PUPP-ALTR		J82427007R		
10	Shqiperi	ECRB-AL-20220218-001	18.02.2022	ENER TRADE	SHPK	Rruga e Elbasanit, Objekti Park Gate , Kati 1	Tirane	1001	54XL-101ET0911180	USALALTR	894500CDLHLLANDKZY22	L82218017S		https://www.linkedin.com/company/ener-trade-shpk/mycompany/
11	Shqiperi	ECRB-AL-20220203-001	03.02.2023	Energy Financing Team Tirana	SHPK	Rruga Murat Toptani, Qendra e Biznesit EUROCOL, Kati 3	Tirane	1001	54XL-EFT-TIRANA-V			L71001017U	www.eft-group.net	
12	Shqiperi	ECRB-AL-20220207-001	07.02.2023	Energy 24	SHPK	Rruga Ismail Qemali Pall 11 Kati 2 (Pallati Telesport)	Tirane	1001	54-1-101-E3W-240			L91331002S		
13	Shqiperi	ECRB-AL-20220216-001	16.02.2023	Future Energy Trading and Exchange Dynamics	SHPK	Rruga Bilal Golemi, Ndertesa 28 Hyrja 7 Ap 14	Tirane	1019	54-X-1-101FETED-J	SGSBALTX		M21421046C	www.futureenergydynamics.com	
14	Shqiperi	ECRB-AL-20220220-001	20.02.2023	Ayen AS Energji	SHA	Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center,	Tirane	1001	22XL--1504416--A-N	SGSBALTX		L11731564A	http://www.ayen.com.tr/	http://www.ayen.com.tr/en/ayen-a-s-energji-sha-arnautluk
15	Shqiperi	ECRB-AL-20220220-001	20.02.2023	Ayen Energy Trading	SHA	Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Nr.601	Tirane	1001	22XL--1404326--NY-W	SGSBALTX		L32130006F	http://www.ayen.com.tr/	
16	Shqiperi	ECRB-AL-20220222-001	22.02.2023	EZ-S ENERGY	SHPK	Rruga Vaso Pasha, Pasuria me Nr. 3/564-1-7/2, Zona Kadastrale 8270	Tirane	1019	54X-1-1UEZS9219-U	SGSBALTX		L91325928D	https://www.ez-S-energy.com	https://www.ez-S-energy.com
17	Shqiperi	ECRB-AL-20220217-001	17.02.2023	Devoll Hydropower	SHA	ABA Business Center, Zyra Nr. 1206, Rruga "Papa Gjon Pali II"	Tirane	1010	22X- 1504D9-DHPS	SGSBALTX	529900FC5S80IQ1B8S80	K82418002C	https://www.statkraft.al/	https://www.ere.rs-transparency.com/power/albania/production/availability
18	Shqiperi	ECRB-AL-20230310-001	10.03.2023	ENSCO Trading (Albania)	SHPK	Njesia Bashkiake nr. 10, Rruga Bogdaneve, Vila nr.22, nr.2	Tirane	1019	54X-1029540210NG	HHVEDEMMS91		-9989025L	https://www.ensco.eu/	
19	Shqiperi	ECRB-AL-20230316-001	16.03.2023	Lengarica & Energy	SHPK	Rruga Jul Variboba, Vila nr. 10, Tirane	Tirane	1022	54X-L-1010N4-ENU	USALALTR		K83256020A	www.ensohydro.al	
20	Shqiperi	ECRB-AL-20230317-001	17.03.2023	FURNIZUESI I TREGUT TE LIRE	SHA	Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndertesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV, Njesia Administrative Nr. 7,	Tirane	1023	54X-101 0FT022OP	AL37202110500000000010446945		L81530028Y	www.nzhee.al	www.nzhee.al
21	Shqiperi	ECRB-AL-20230317-002	17.03.2023	KURUM INTERNATIONAL	SHA	Rruga Ibrahim Rugova, pallati nr. 1 4 KT, "Green Park", Ap.nr.39, kati 6, Njesia Administrative Nr.5	Tirane	1001	22H-1311546--1	SGSBALTX (RAIFFEISEN BANK) NCBAALTX (BKT)	K02727230T	K02727230T	www.kurum.al	www.kurum.al
22	Shqiperi	ECRB-AL-20230317-003	17.03.2023	Danske Commodities Albania	SHPK	Rruga.Ibrahim Rugova, Sky Tower, Godina nr. 5, Kati 9, Zyra 91	Tirane	1000	22H--1211200CALG	SGSBALTX		L21700058Y	www.danskecommodities.com	
23	Shqiperi	ECRB-AL-20230320-001	20.03.2023	Dragobia Energy	SHPK	Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndertese Nr. 12, ABA Business Center	Tirane	1010	54X-1-1 1DRG--H W	SGSBALTX / PUPP-ALTR		K92025004T		
24	Shqiperi	ECRB-AL-20230320-002	20.03.2023	Nanye Energy	SHPK	Rruga Prush Nr 4(),Vaqarr	Tirane	1041	54X-1211-EN-1199L	USALALTR		L72220033M	www.nanyeenergy.com	
25	Shqiperi	ECRB-AL-20230317-003	20.03.2023	Furnizuesi Shedimit Universal	SHA	Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndertesa Nr. 88, H. 1, Kati i 2, Njesia Administrative Nr. 7,	Tirane	1023	54X-0101F5402ZQ			L81530016L	www.fshu.al	
26	Shqiperi	ECRB-AL-20230323-001	23.03.2023	LATINEZA INVEST	SHA	Laprisht, Njesia Administrative Qafe-mali,	Fushe -Ardez	4402	54X-1-101-UTH-IS	PUPP-ALTR XXX		J96009201P	www.latheza.al	
27	Shqiperi	ECRB-AL-20230324-001	24.03.2023	Hec-i Bicbitsica 1.2	SHPK	Blvd: B.Curri, E.T.C, kat IV, zyra 5/2,	Tirane	1017	54X-1-1001SH812W	AL84202211075000000010285588D		K02403011S		
28	Shqiperi	ECRB-AL-20230324-002	24.03.2023	Hecz Tervolit	SHPK	Komuna Pokaj Gramsh	Gramsh	3301	54X-1-2101IWHTE1	AL63202112190000000013351935		K73621202N	www. hecztervolit.com	www. heczteervolit.com
29	Shqiperi	ECRB-AL-20230331-001	31.03.2023	Aspo Albania	SHA	Rruga e Bitaxit, Tirana Business Park, Nd.07, Fushe Preze	Tirane		22H--1520330-A4-K	SGSBALTX	529900ZD4BTUMWS85S85	K51628011V	www.aspo.com	www.aspo.com
30	Shqiperi	ECRB-AL-20230331-002	31.03.2023	ADA SOLAR SE	SHPK	Rruga "Dervish Hima", Ada Tower	Tirane	1001	54X-1-01 00042S-6			L81966036J		
31	Shqiperi	ECRB-AL-20230406-001	06.04.2023	Operatori i Sistemit te Shperndarjes	SHA	Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndertesa 88, Kati V,Hyrja 1	Tirane	1023	54X-101OFT022OP	AL152121101000000000001386653		L81530018E	www.osh.al	www.osh.al
32	Shqiperi	ECRB-AL-20230414-001	14.04.2023	G.S.K	SHPK	Rruga e Barrikadave, Pasuria nr.7/35+1-2,Zona Kadastrale 8360	Tirane	1010	54X-0101-G1SK-M	SGSBALTX		M01707503J		
33	Shqiperi	ECRB-AL-20230511-001	11.05.2023	GJO-SPA POWER	SHPK	Kdesa e Kamzes, Pallati perballe spitalit Hygeia, Kati IV, Kashar	Tirane	1025	54X-HEC-LAP-A0075	USALALTR		K07928201S		
34	Shqiperi	ECRB-AL-20230511-002	11.05.2023	Erdat Lura	SHPK	Kdesa e Kamzes, Pallati perballe spitalit Hygeia, Kati IV, Kashar	Tirane	1025	54X-HEC-LURA-I-069	USALALTR		K82321008Q		
35	Shqiperi	ECRB-AL-20230515-001	15.05.2023	TEODORI 2003	SHPK	Rruga "Vaso Pasha", Godina 10, Hyrja 1, Ap. 6	Tirane	1057	54X-L-110-TE-ALLI	AL872131104400000000013 4377		K42300106L		
36	Shqiperi	ECRB-AL-20230524-001	24.05.2023	KROI MBRET ENERGJI	SHPK	Rezidenca Olimpik, Kryqezimi i Rrugeve Liman Kaba dhe Prokop Mima,Shkalla 3	Tirane		54X-101-KM-10-E5	CIDSALTRXXX		L29336401S		
37	Shqiperi	ECRB-AL-20230612-001	12.06.2023	Prioritini Consulting	SHPK	Njesia Bashkiake Nr.5, Rr. Teh Dabiq, Zona Kadastrale 8260 Nr. Pasurie 6/739+3-14, Kompleksi Kila 2, Objekti 7, Shkalla 7, Kati 5	Tirane	1060	54X-PRO-1NFIN-I0	SGSBALTXXXX		M21525012S	www.prioritinitconsulting.com	
38	Shqiperi	ECRB-AL-20230630-001	20.06.2023	Hydro Energy Sotira	SHPK	Elbasan Kashrre SOTIRE Godine 1-katshe e HEC,3(Qendrore) Sotire-Gramsh,zona kadastrale 34/84 me nr.2/405	Gramsh,Sotire		54X-1-0111503-H-X	AL762001100000002048593501 (EURO) AL522001110100000024485935302 (ALL)		K87212810C	ehpsotirasphoo.com	
39	Shqiperi	ECRB-AL-20230712-001	12.07.2023	Albanian Green Energy	SHPK	Rruga "Abdi Toptani", Torre Drini,Apartamenti 61	Tirane	1001	54X-1-1011-AGEF	USALALTR010		K71624027U	www.essegei.eu	
40	Shqiperi	ECRB-AL-20230712-002	12.07.2023	Balkan Green Energy	SHPK	Rruga "Abdi Toptani", Torre Drini,Apartamenti 61	Tirane	1001	54X-10001BGE-R	USALALTR010		K71624028M	www.essegei.eu	
41	Shqiperi	ECRB-AL-20230712-001	12.07.2023	SOLE 24 DOORS.SHKUP	SHPK	Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Hotel Rogner ,Kati II	Tirane	1001	54X-1-110-SOLE-3	CIDSALTRXXX		M31625023G		
42	Shqiperi	ECRB-AL-20230711-002	11.07.2023	Idro Energjia Pulita	SHPK	Lagja 17, Rr"Haxhi Ballhysi", Kompleksi Jedas, 2006	Durres		54X-1-0111ENJ-9-O	AL623001100000002109573502 (EURO) AL493001100000002109573501 (ALL)		L01390510P	idroenergjiapulita.shpk@gmail.com	
43	Shqiperi	ECRB-AL-20230711-003	11.07.2023	"Emiksi"	SHPK	Lagja Qendër, 2324/3, Pasuria 268, Godina e Gemrtë Lezë	Gramsh	3301	54X-E-SHPK-16044	EMPOALTRXXX		K23410201C		
44	Shqiperi	ECRB-AL-20230718-001	18.07.2023	DUFERCO SHQIPËRIA	SHPK	Rruga Myrteziu Kelliçi, Pallati ALFAM, Shk1, Apartamenti 2,Njesia Bashkiake nr 2	Tirane	1001	54X-1-01DUG-SHQ-B	PUPP-ALTRXXX		L91813001D	www.dufercoenergia.com	
45	Shqiperi	ECRB-AL-20230906-001	06.09.2023	GLOBAL TECHNICAL MECHANICS	SHPK	Sfinges, Aeroporti I Kukesit	Kukes	8502	54X-1-GL01-MEC-P	SGSBALTX		L71529028M		
46	Shqiperi	ECRB-AL-20230914-001	14.09.2023	C & S ENERGY	SHPK	Rruga e Kosoves, Nr. 151, Njesia Bashkiake Nr.7, Tirane	Tirane	1023	54X-1-0111-CSU-E	EMPOALTR		K92402005Q		
47	Shqiperi	ECRB-AL-20230914-002	14.09.2023	HEC LLENGE	SHPK	Rruga e Kosoves, Nr. 151, Njesia Bashkiake Nr.7, Tirane	Tirane	1023	54X-1-L101-HEC-0	UNALALTR		L22125013H		
47	Shqiperi	ECRB-AL-20231101-001	01.11.2023	Karavasta Solar	SHPK	Bulevardi Bajram Curri, Godina ETC, kati 14, Tirane	Tirane	1000	54X-1-1010-KVR-C	USALALTR	894500GBPOLTMP9S1P27	K02020001J	www.Karavastasolar.com	www.Karavastasolar.com
48	Shqiperi	ECRB-AL-20231204-001	04.12.2023	M&K Energy Trading Co	SHPK	Rr "I MAJT", Pasuria Nr.3/1103+4/415, vol.59, fq. 229, Zona Kadastrale Nr 8561	Korce	7001	54X-L-1101OMR-1-S	FINVALTR		M04516001I		
49	Shqiperi	ECRB-AL-20231204-002	04.12.2023	Eroika Solar Park 1	SHPK	Rr.Anastas Lakce, Kompleksi Fonisa, Nr, pasurie 3/1149-N2, Korce	Korce	7001	54X-1-11ER-SO1-O	FINVALTR		M24860011T	https://www.eroikasolarpark.com/	
50	Shqiperi	ECRB-AL-20231221-001	21.12.2023	Balkan Energy Trade	SHPK	Rr.Sami Frasheri, pallati TID, Nobis Wellness Center ,Shkalla C, Kati 1, Apartament 2, Njesia Bashkiak Nr.5	Tirane	1001	54X-B-1010-ETB-T	NCBAALTX		L63022010A		

Burimi: ERE

Figura 69. Regjistri i pjesëmarrësve të tregut sipas REMIT 2023

2.2.4. Monitorimi i zbatimit të detyrimeve sa i takon sigurisë kibernetike per vitin 2023

Rregullorja për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike e miratuar me Vendimin Nr, 126 datë 30.07.2020 nga Bordi i ERE-s, përcakton rregullat dhe masat që duhet të ndërmerren nga subjektet e licensuara në sektorin e energjisë

elektrike të cilët kanë përgjegjësi të garantojnë sigurinë kibernetike në infrastrukturat kritike që zotërojnë dhe operojnë, ne funksion te sigurimit te furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të konsumatorëve. Neni 6 i kësaj rregulloreje përcakton detyrimin nga subjektet e ngarkuara për zbatimin e kësaj rregulloreje për raportim periodik një herë në 6 muaj, për cështje që i përkasin sigurisë kibernetike. Sa i përket monitorimit nga ERE për zbatimin e këtij detyrimi gjatë vitit 2023 u vërejt:

Gjate vitit 2023 nuk u raportua të ketë pasur sulme të ndodhura në sistemet e kompanive të sektorit elektroenergjitik.

OST sh.a. është kompania e parë në sektorin energjitik në Shqiperi e çertifikuar me standardin ISO 27001 (03.08 2021). Për vitin 2023 OST sh.a. raportoi se ka siguruar gatishmërinë dhe ka krijuar një program sigurie të qendrueshëm dhe te mirëmenduar për sigurinë kibernetike nëpërmjet masave të shtuara teknike për rritjen e sigurisë kibernetike në infrastrukturën IT dhe OT. Shoqëria përmbushi detyrimin për paraqitjen e raporteve periodike të vetëvlerësimit për të dy gjashtëmujoret në përputhje me formatin e përcaktuar në Rregulloren e ERE-s. U konstatua rritje e nivelit të plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm të përcaktuar në Rregullore nga 90% në pjesën e parë të vitit në 92% në pjesën e dytë. OST sh.a. ka dëshmuar vazhdimisht përmirësim të vazhdueshëm në drejtim të raportimit për sigurinë kibernetike. Megjithatë, nga analiza e dokumentacionit shtesë të kërkuar nga ERE për raportimin e 6-mujorit të parë u vërejtën mangësi.

OSHEE sh.a. gjatë vitit 2023 nuk informoi mbi ecurinë e procesit të certifikimit me standartin ISO 27001 i cili është një detyrim i përcaktuar në nenin 10 të Rregullores për Sigurinë Kibernetike. Ndërkohë, OSHEE sh.a. informoi se kishte publikuar proçedurën "Vlerësim i përgjithshëm mbi Sigurinë Kibemetike dhe kryerjen e testimeve mbi Infrastrukturën dhe Platformat Teknologjike" dhe se ishte në fazën e shqyrtimit të ofertave. Shoqëria nuk paraqiti raportin e vetëvlerësimit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 ndërsa nga raporti per 6-mujorin e dytë 2023, rezultoi se shoqëria kishte hartuar apo ishte në proces hartimi të 29% të dokumentave të formularit të raportit të vetëvlerësimit. Konsiderohet pozitiv fakti që OSHEE sh.a. rifilloi të raportojë mbi sigurinë kibernetike mbas një ndërprerje të gjatë.

KESH sh.a. ka përfunduar procedurat dhe është licencuar me standardin ISO 27001 gjatë vitit 2022. Shoqeria paraqiti ne rrugë elektronike raportet e vetëvlerësimit për gjashtëmujorin e parë dhe të dytë 2023 mbi sigurinë kibernetike në përputhje me formatin e përcaktuar në Rregulloren për sigurinë kibernetike. Shkalla e plotësimit të dokumentacionit raportohet të jetë 100% për secilën nga dy periudhat. Në funksion të analizës së raportit të vetëvlerësimit për 6-mujorin e parë, ju kërkua KESH sh.a.-s dokumentacion shtesë. Nuk pati pergjigje nga shoqeria për sa i përket kësaj kërkese. Ndërkohë, jemi në pritje të plotësimit të kërkesës për dokumentacion shtesë për analizën e raportit të vetëvlerësimit për 6-mujorin e dytë.

Procesi i asistencës nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Shoqata Kombëtare e Komisionerëve Rregullatore të Shërbimeve (NARUC) per implementimin e Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike ka vijuar edhe përgjate vitit 2023. ERE ka ndërtuar një bashkëpunim me USAID/NARUC, qëllimi kryesor i të cilit është asistenca teknike për ngritjen e kapaciteteve të Rregullatorit në drejtim të shqyrtimit më të mirë të raporteve të vetëvlerësimit të paraqitura nga shoqëritë. Në këtë kuadër USAID/NARUC ofroi trajnim për stafin e ERE-

s dhe të shoqërive OIKI. Përgjatë këtij trajnimi u shqyrtua legjislacioni i sigurisë kibernetike në Shqipëri dhe u prezantua një metodologji për vlerësimin në mënyrë efektive te gatishmërisë kibernetike te shoqërive.

Ne janar 2023, u prezantua ne ERE drafti perfundimtar i dokumentit "Vlerësimet Rregullatore të Maturimit Kibernetik në Sektorin Shqiptar tëe Energjisë" i përgatitur nga NARUC. Ky dokument finalizoi dhe përmblodhi gjetjet e analizës së legjislacionit mbi sigurine kibernetike si dhe parashtroi një plan zbatimi për adresimin e vëzhgimeve të identifikuar në analizë, gjithashtu propozoi një metodologji për të krijuar një proces që mbështet vlerësimet rregullatore efektive të maturise së shoqërisë, bazuar në premisën se çdo shoqëri do të zbatojë ISO27001.

Në vijim të programit të marrëveshjes së sipërcituar USAID/NARUC zhvilloi në prill 2023 pjesën e dytë të trajnimit bazuar në Web për rregullatorët e energjisë të Evropës Juglindore dhe Euroazisë. Qëllimi i këtij webinari ishte vlerësimi i maturisë së Infrastrukturave Kritike te Informacionit. Ne kete webinar ERE paraqiti konkluzionet kryesore të përftuara nga asistenca teknike e personalizuar dhe ndau eksperiencën me rregullatorë të tjerë partnerë. Ndër konkluzionet më të rendesishme vlerësuam si vijon:

- Ligji Nr. 2/2017 është në përputhje me standartin ISO27001.
- Certifikimi me ISMS ISO27001 është i rëndësishëm për ERE-n, pasi certifikimi nga një organizatë audituese e akreditуar krijon besimin se shoqëria ndjek proceset e ISO 27001 në vijimesi.
- Përputhshmëria me masat e sigurisë të Ligjit Nr. 2/2017 demonstrohet nëpërmjet auditimeve të brendshme dy herë në vit per standartin ISO27001 nga shoqëritë e certifikuara. Kjo lehtëson ERE -n pasi do t'i duhet vetëm të vlerësojë raportin e auditimit të brendshëm ISMS, i cili do të jetë dukshëm më pak i komplikuar dhe më i shkurtër se raportet e vetëvlerësimit të ligjit nr. 2/2017.

Konkluzionet e mësiperme, u vunë në zbatim për vlerësimin e raporteve të vetëvlerësimit të shoqërive të certifikuara me standartin ISO 27001duke filluar që nga pjesa e dytë e vitit 2022.

Në vijim të bashkepunimit me USAID përfaqësuesit e ERE morën pjesë ne webinarin e datës 23 maj ku u prezantua vendimi i Komisionit Federal Rregullator i Energjisë i SHBA (FERC) për nxitjen e investimeve vullnetare në sigurinë kibernetike. Po ashtu, ka vijuar komunikimi me USAID sa i takon shkëmbimit të informacioneve mbi cështje të tilla si: përditësimi në lidhje me përkufizimet e infrastrukturës kritike të informacionit, raportimi mbi progresin në sigurinë kibernetike ne sektorin e energjisë, etj

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i cili monitoron ecurine e sektorit të energjisë, ne Raportin Vjetor te Implementimit per vitin 2023 te dates 1 nëntor 2023, ne kapitullin për Shqiperine e ka trajtuar sigurinë kibernetike si pjesë përbërëse të cështjes së sigurisë së furnizimit. Në total, sa i takon shkallës së implementimit të acquis, siguria e furnizimit është e vleresuar në shkallen 75% pra me rritje te konsiderueshme ne krahasim me vitin 2022 ku ky tregues vleresohej 61% . Raporti evidentoi se "Në përputhje me rregullat kombëtare për sigurinë kibernetike në sektorin e energjisë elektrike, kompanitë e energjisë elektrike paraqitën vetëvlerësimet për sigurinë kibernetike, të cilat u rishikuan nga rregullatori. Operatori i sistemit

të transmetimit OST dhe kompania e prodhimit të energjisë elektrike KESH kanë përmbushur detyrat e tyre, ndërsa operatori i sistemit të shpërndarjes OSSH nuk mundi të paraqese dokumentacionin e kërkuar". Duke konsideruar faktin që ky raport ka përfunduar në fund të vitit 2023 ndërsa detyrimi për raportim për 6-mujorin e dytë ishte në fund të muajit janar 2024 gjykojmë se vlerësimet e mësiperme nuk pasqyrojnë situatën për gjysmën e dytë të vitit e cila rezultoi e përmirësuar sa i përket OSHEE sh.a.. Gjithashtu, në këtë raport evidentohet fakti që gjatë vitit 2023 nuk ka pasur sulme serioze kibernetike në sektorin e energjisë.

Në kuader të forcimit dhe mbajtjes së standarteve të sigurise kibernetike për vetë rregullatorin, ERE ka zhvilluar procedurën me objekt "Përmirësimi i mbrojtjes dhe sigurisë së rrjetit të ERE dhe implementimi i firewall" dhe ka finalizuar kontraten me operatorin ekonomik fitues.

3. BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE (ALPEX)

3.1. Ecuria e Krijimit të Bursës Shqiptare të Energjisë ALPEX sh.a.

Bazuar në vendimet e Këshillit të Ministrave, respektivisht Nr. 322, datë 15.05.2019 dhe atë Nr. 609, datë 11.09.2019, në Tetor të vitit 2020 u themelua Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX) si një Shoqëri Aksionare, në bashkëpronësi të Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit të Shqipërisë (OST) dhe Kosovës (KOSTT).

Në 27 Prill 2016, me qëllim përmbushjen e objektivave të paketës së tretë legjislative në fushën e energjisë elektrike të BE për themelimin e tregut të brendshëm evropian të energjisë elektrike dhe bazuar në vendimet e arritura në samitin e Ballkanit perëndimor, të mbajtur në Vienë në 27 Gusht 2015, Shqipëria dhe Kosova u angazhuan të krijojnë operatorët (bursat) për operimin dhe rrjedhimisht bashkimin e tregjeve të ditës në avancë (DAM) dhe brenda të njëjtës ditë (IDM) në një treg rajonal.

Në Qershor 2018 operatorët e sistemeve të transmetimit OST, KOSTT, enteve rregullatore ERE dhe ZRRE nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit për bashkimin e tregut të energjisë elektrike për ditën në avancë.

Në Dhjetor të vitit 2020 Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE) miratoi kërkesën e KOSTT për të deleguar tek ALPEX autoritetin për organizimin e tregut të ditës në avancë dhe atë brenda së njëjtës ditë për tregun e Kosovës. Ndërkohë, ALPEX ka hapur në datën 6 Maj 2021 degën e saj në Prishtinë e cila ka si fokus menaxhimin e pjesëmarrëseve të tregut për Kosovën, çështjet rregullatorë etj.

Në linjë me Memorandumin e Mirëkuptimit të WB6, ne daten 21 Tetor 2021 u nënshkrua një tjetër Marrëveshje Kornizë midis OST, KOSTT, ERE dhe ERO për bashkimin (coupling) e tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike dhe brenda së njëjtës ditë. Shqipëria dhe Kosova nënshkruan Marrëveshjen Kornizë si dhe marrëveshje të tjera të suksesshme, të nevojshme për operimin e bashkimit të tregut të ditës në avancë dhe atë brenda së njëjtës ditë.

ALPEX me fillimin e vitit 2021 nisi punë për përgatitjen e termave të referencës për përzgjedhjen e Ofruesit të Shërbimit me asistencën e USAID.

Në fund të vitit 2021, u arrit përzgjedhja e këtij Ofruesi Shërbimi me fitues bashkimin e operatorëve të udhëhequr nga Bursa e Athinës “Hellenic Exchanges - Athens Stock Exchange S.A.”, Grupi i Bursës së energjisë elektrike të Greqisë me dy kompanitë e saj **“**Hellenic Energy Exchange S.A." dhe "Enex Clearing House S.A.

Në zbatim të detyrimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Shqipëria dhe Kosova janë zotuar të zbatojnë Paketën e Tretë të Energjisë të Komunitetit të Energjisë, e cila udhëzon palët në lidhje me krijimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike. Si rrjedhojë, modelet e tregut në të dyja vendet parashikojnë që nëpërmjet ALPEX të zbatohet Modeli i Synuar Evropian i Tregut, për Tregjet e Ditës në Avancë (DAM) dhe Brenda Ditës (IDM).

Fillimisht është parashikuar qe tregu për DAM dhe IDM do të krijohet me minimalisht dy zona kontrolli (Shqipëri dhe Kosovë) duke zbatuar në të ardhmen projekte për bashkimin me tregje të tjera potenciale.

3.2. Operimi i Bursës Shqiptare të Energjisë

ALPEX sh.a operon bazuar në Vendimin e Bordit të ERE Nr. 347, datë 27.12.2022 "Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX – Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)", si dhe Vendimin e Bordit të ERE Nr. 106, datë 23.03.2023 "Mbi miratimin e disa shtesave në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 347, datë 27.12.2022".

Në të njëjtën kohe bazuar në Vendimin e Bordit të ERE Nr. 127, datë 07.04.2023 "Për miratimin e Njësisë Kohore të Tregut" operimi i burses shqiptare të energjisë ka filluar në oren 00:00 të datës 12.04.2023.

3.3. Anëtarësimi në Bursë për zonën e ofertimit Shqipëri

Me fillimin e operimit të bursës shqiptare të Energjisë nga ALPEX sh.a. në datën 12.04.2023, ka vijuar edhe regjistrimi i antarëve në këte burse. Përgjate vitit 2023 numri i anëtarëve të bursës të regjistruar është - 17 (shtatëmbëdhjetë). Gjithashtu anëtar i Përgjithshëm i Klerimit te Burses është Raiffeisen Bank Albania. Ka aplikuar për tu bërë Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit, Tirana Bank, e cila është në fazën e parë të anëtarësimit pranë ALPEX.

Më poshtë Lista e antarëve të regjistruar në ALPEX sh.a. përgjate vitit 2023.

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit – OST sh.a
2. Furnizuesi i Tregut të Lirë – FTL sh.a
3. Furnizuesi i Shërbimit Universal – FSHU sh.a
4. Korporata Elektroenergjitike Shqiptare – KESH sh.a
5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – OSSH sh.a
6. Ener Trade sh.p.k
7. EZ-5 Energy sh.p.k
8. GEN-I TIRANA sh.p.k
9. ReNRGY Trading Group sh.p.k
10. Future Energy Trading and Exchange Dynamics Shpk
11. Natyre Energy shpk
12. NOA shpk
13. Danske Commodities
14. GSA shpk
15. Energy Financing Team Tirana shpk
16. Devoll Hydropower shpk
17. Dragobia Energy shpk

Bursa Shqiptare e Energjise është parashikuar që tregu për tregun e nje dite më parë dhe për tregun brenda të njejtës ditë do të operojë me dy zona kontrolli Shqipëri dhe Kosovë, duke zbatuar në të ardhmen projekte për bashkimin me tregje të tjera potenciale. Në këtë proces ALPEX sh.a. ka vijuar me antarësimin e antarëve për zonen e ofertimit në Kosove. Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit në Kosovë është ProCredit Bank Kosovë.

3.4. Anëtarësimi në Bursë për zonën e ofertimit Kosovë

Numri i anëtarëve të bursës të regjistruar është - 4 (katër)

1. Operatori i Sistemit të Transmesionit dhe Tregut – KOSTT sh.a
2. Korporata energjetike e Kosovës – KEK SH.A.
3. Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër-Lepenc"sh.a
4. Kosovo Electricity Supply Company – KESCO sh.a.

3.5. Operimi i tregut.

Gjatë viti 2023, ALPEX-i ka vënë në përdorim për anëtarët e Bursës platformën e tregtimit ETSS dhe për anëtarët e përgjithshëm të klerimit platformën EMCS. Platforma e tregtimit ETSS ka qenë e aksesueshme gjatë gjithë kohës për përdoruesit përkatës dhe ka performuar pa cënuar funksionimin normal të aktivitetit tregtar. Tregtimi është kryer çdo ditë sipas kalendarit përkatës të tregtimit, të publikuar në faqen e internetit të ALPEX sh.a.: www.alpex.al.

ALPEX në zbatim te Vendimit të ERE Nr. 139, datë 14.04.2023 "Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë", aplikon ankandin e dytë me qëllim ruajtjen e tregut nga çmimet që konsiderohen të gabuara ose të paqëndrueshme, këto në referencë me Kufirin Minimal të Lejuar të Çmimit 0 (zero) euro/MWh dhe Kufirin Maksimal të Lejuar të Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë çmimin 900 euro/MWh.

Gjatë vitit 2023 ankandi i dytë është aktivizuar shtatë herë ku çmimet pas këtij ankandi rezultuan të qëndrueshme.

Tregu i ALPEX-it është dominuar nga volumet e shoqërive publike të sektorit të energjisë të bazuar në kontratën për diferencë siç janë blerjet për humbjet e OST sh.a. dhe volumet e FMF-së, ndersa në shitje nga volumet e KESH sh.a.. Prej muajit nëntor 2023 është konstatuar rritja e aktivitetit të tregtimit në bursë nga kompani private, të cilat vazhdojnë të jenë në nivele te ulta. Ndërkohë disa anëtarë të bursës shoqëri private vazhdojnë përsëri të mos jenë aktivë në bursë me argumentin që pas fillimit të bashkimit të tregjeve Shqipëri-Kosovë aktiviteti i tyre në ofertimin në bursë do të rritet.



Figura 70.Të dhëna mbi ofertat dhe blerjet – shitjet në ALPEX sh.a.

3.6. Klerimi dhe shlyerja

Aktiviteti i klerimit dhe transaksionet e shlyerjes në ALPEX sh.a. përgjatë periudhës 12 Prill e në vijim deri në 31 Dhjetor 2023, janë kryer në mënyrë periodike nëpërmjet anëtarëve të përgjithshme të klerimit dhe bankës për shlyerje Raiffeisen Bank Albania (RBAL).

3.7. Bashkimi i tregjeve të ditës në avancë Shqipëri-Kosovë

Paralelisht me aktivitetin e përditshëm të tregtimit, klerimit dhe shlyerjes për Tregun e Ditës në Avancë në Zonën Ofertuese të Shqipërisë, ALPEX sh.a. ka punuar për të lancuar tregun e Ditës në Avancë për zonën e ofertimit të Kosovës, si dhe për të realizuar bashkimin e tregjeve ndermjet Shqipërise dhe Kosovës.

Referuar nenit 4 të Marrëveshjes Kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, të nënshkruar më 21.10.2021, ndërmjet Entit Rregullator të Energjisë të Shqipërisë (ERE), Zyrës së Rregullatorit për Energji të Kosovës (ZRRE), Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT), është përcaktuar se Rregullatorët do të bien dakord që të përcaktojnë NEMO (Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike) respektive në të njëjtën kohë në të dyja shtetet.

Për këtë qëllim, më datë 17.07.2023, në Prishtinë, Kosovë u zhvillua mbledhja e përbashkët nga ana e ERE dhe ZRRE (Zyra e Rregullatorit për Energji Kosove), me qëllim shqyrtimin dhe miratimin e aplikimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A. për tu përcaktuar/emëruar si Operator i Emëruar i Energjisë Elektrike (NEMO) për zonën ofertuese të Shqipërisë dhe Kosovës.

Në vijim, Rregullatorët vendosën përcaktimin/emërimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për zonën ofertuese të Shqipërisë dhe Kosovës, përkatësisht me:

- Vendimin e Bordit të ERE nr. 228, datë 17.07.2023 "Mbi përcaktimin e shoqërisë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX" sh.a si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);
- Vendimin e Bordit të ZRRE V_1748_2023, datë 17.07.2023.

Gjithashtu pas caktimit si NEMO për zonën e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës, sipas detyrimeve të dala nga Marrëveshja Kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, OST- të respektiv dhe NEMO krijuan një Komitet Drejtues për qeverisjen e bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike, i cili eshte efektiv nga data e përcaktimit të NEMO-ve përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë zhvilluar nëpërmjet Ofruesve të Shërbimit të ALPEX, OST, KOSTT dhe SEE CAO teste për të provuar dhe kontrolluar funksionalitetin dhe integrimin e Platformave të shoqëruara edhe me teste simulimi, në kuadër të bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës. ALPEX sh.a. ben me dije se janë testuar te gjithe skenarët e bashkimit të tregjeve te cilet në total jane 11. Me përfundimin e këtyre test-skenareve duhej të niste periudha e testimeve (dry-run) të tregut të bashkuar, por për shkak se nga ofruesi i shërbimit të OST-ve u kërkuan disa ndryshime në ndërlidhjet midis platformave, këto test-skenare duhet të ripërsëriteshin në të shumtën e tyre. Testet rinisën më datën 4 dhjetor 2023. Janë kryer dhjetë (10) teste nga dhjetë (10) gjithsej. Me përfundimin e këtyre testeve nisi simulimi i shtatë skenarëve të bashkimit të tregjeve, i cili përfundoi me datë 03/01/2024, dhe më pas do të fillojë procesi i testimeve nga anëtarët e bursës të dy zonave të ofertimit deri në fillimin e bashkimit të tregjeve.

ALPEX gjithashtu po zhvillon procesin e dry-run së bashku me anëtarët e bursës të dy zonave të ofertimit deri në fillimin e bashkimit të tregjeve.

Referuar Nenit 5 të "Marrëveshjes Kornizë për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës", është kompetencë e këtij Komitetit drejtues (OST-të dhe NEMO) të vendosin mbi Ditën e Fillimit të bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, vendim i cili do i bëhet me dije menjëherë ERE dhe ZRRE.

Paralelisht me këtë, ALPEX ka nënshkruar të gjitha marrëveshjet e nevojshme për procesin e bashkimit të tregjeve të Shqipërisë dhe Kosovës.

Banka për Shlyerje në tregun e Kosovës do të jetë Procedit Bank Kosova për të cilën u nënshkrua marrëveshja përkatëse. Gjithashtu Procedit Bank Kosova do të jetë njëri prej Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit.

ALPEX do të kryejë rolin e Agjentit të transferimit (shipping agent) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike për të dyja zonat e ofertimit, duke u bazuar në metodologjinë për kalkulimin dhe shpërndarjen e të ardhurave e cila është duke u shqyrtuar nga Autoritetet rregullatore.

Eshtë parashikuar që gjithçka do të jetë gati teknikisht rreth fundit të muajit janar 2024 për lançimin e Tregut të Ditës në Avancë në Kosovë, i cili përkon edhe me lançimin e bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë. Komiteti Drejtues do të propozojë datën e lançimit dhe më pas me vendim të Enteve Rregullatore të të dy vendeve (ERE dhe ZRRE) do të përcaktohet data e fillimit të operimit të tregut në Kosovë dhe bashkimi i tregjeve Shqipëri-Kosovë.

3.8. Të dhënat e tregtimit dhe klerimit

Pergjate periudhes 12 Prill 2023 – 31 Dhjetor 2023, ALPEX sh.a. ka vijuar aktivitetin e tregtimit të Energjisë elektrike në zonën e ofertimit të Shqiperisë. Të dhënat për këtë aktivitet jepen ne tabelat e meposhtëme.

Të dhënat e Tregut të Ditës në Avancë				
Progresive 2023	**Min Ditor**	**Max Ditor**	**Mesatare Ditore**	**Total**
Volumi në MWh	2,029	4,450	3,125	827,541
Çmimi (€/MWh)	€ 7.97	€ 362.07	€ 100.15	106,536

Tabela 71. Të dhënat e Tregut të Ditës në Avancë

Faturimet (blerje-shitje)				
Periudha	**Min Ditor**	**Max Ditor**	**Mesatare Ditore**	**Total**
Prill 2023	€ 603,528	€ 943,110	€ 820,251	€ 15,584,772
Maj 2023	€ 354,052	€ 917,353	€ 680,946	€ 21,109,325
Qershor 2023	€ 364,373	€ 1,040,447	€ 699,688	€ 20,990,665
Korrik 2023	€ 363,934	€ 909,319	€ 614,872	€ 19,061,041
Gusht 2023	€ 306,359	€ 742,373	€ 460,430	€ 14,273,353
Shtator 2023	€ 310,387	€ 595,900	€ 462,417	€ 13,872,502
Tetor 2023	€ 433,607	€ 988,393	€ 674,380	€ 20,905,782
Nëntor 2023	€ 298,267	€ 1,020,396	€ 716,160	€ 21,484,804
Dhjetor 2023	€ 341,465	€ 1,189,196	€ 658,727	€ 20,420,561
Akumulative 2023	€ 298,267	€ 1,189,196	€ 635,238	€ 167,702,808

Tabela 72. Faturimet (blerje-shitje)

Volumet e tregtuar në MWh				
Periudha	**Min Ditor**	**Max Ditor**	**Mesatare Ditore**	**Total**
Prill 2023	2,779	3,698	3,434	65,252
Maj 2023	3,045	3,989	3,626	112,420
Qershor 2023	3,154	4,450	3,736	112,089
Korrik 2023	2,223	4,153	2,978	92,327
Gusht 2023	2,190	2,551	2,397	74,293
Shtator 2023	2,029	2,414	2,224	66,715
Tetor 2023	2,817	3,278	3,115	96,552
Nëntor 2023	2,750	3,753	3,379	101,357
Dhjetor 2023	2,893	3,836	3,437	106,536
Akumulative 2023	2,029	4,450	3,135	827,546

(te dhenat – Alpex)

Tabela 73. Volumet e tregtuar në MWh



Tabela 74. Çmimi Klerues orar në €/MWh - 2023



Tabela 75. Volumet në MWh

Volumet ditore mesatare të tregtuara në ALPEX jepen në grafikun e mëposhtëm



ALPEX sh.a. ka bërë analizën midis çmimeve mesatare të nxjerra ne tregun vendas me ato të Burses Hungareze HUPX për të gjetur korrelacionin midis tyre. Nga të dhënat rezulton se në 73.8% të rasteve, çmimet ndjekin të njëjtin trend (rritës ose zbritës) ndërkohë çmimi mestar në HUPX rezulton më i ulët në 52.9% të rasteve ndërsa në ALPEX në 47.1% të rasteve.

Tabela e meposhtëme jep të dhënat krahasimore të çmimeve mesatare të nxjerra ne tregun vendas me ato të Burses Hungareze HUPX.



Tabela 76. Të dhënat krahasimore të çmimeve mesatare të nxjerra ne tregun vendas me ato të Burses Hungareze HUPX.

4. LICENCIMI, DHËNIA E AUTORIZIMEVE DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARIVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE GJATË VITIT 2023

4.1 Licencimet dhe kërkesat e trajtuara gjatë vitit 2023

Gjatë vitit 2023, ERE brenda fushës së saj të veprimtarisë ka shqyrtuar dhe marrë vendimet përkatese qe lidhen me aplikimet per licencimin e subjekteve në veprimtaritë/aktivitetet e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike, në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

Për aplikimet e paraqitura, është respektuar transparenca e parashikuar në procedurat për licencim, në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar, Ligjit nr.102/2015 "*Për sektorin e gazit natyror",* i ndryshuar, "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike",* e ndryshuar së fundi me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220 datë 01.09.2022, si dhe *"Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror"*.

Gjatë vitit 2023 janë paraqitur 16 aplikime per licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Për shkak të kompleksitetit që paraqesin aplikimet në vetvete, si pasojë e nevojës që këto subjekte të ushtrojne veprimtarinë e tyre në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e integruar të burimeve ujore, lejeve të tjera zhvillimore, planeve të biznesit të ketyre subjekteve, është zhvilluar korrespondencë e vazhdueshme me institucione te tilla, si Ministrinë e Infrastruktureë dhe Energjisë, Agjencia Kombetare e Mjedisit, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës etj. Si praktikë e nje procedure licencimi, edhe gjatë këtij viti janë zhvilluar seanca degjimore me aplikuesit, me qëllim sqarimin e dokumentacionit të licencimit. Për të gjitha aplikimet janë marrë vendimet perkatëse të Bordit për fillimin e procedurave të licencimit dhe janë bërë publikimet në median e shkruar, në web-in dhe në rrjetet sociale te ERE-s, për marrjen e opinioneve të mundshme nga palët e interesuara. Gjithashtu çdo aplikim për licencim i është nënshtruar një analize të kujdesshme të rregullshmërisë dhe plotësimit me korrektësi të dokumentacionit ligjor, administrativ, financiar, teknik si dhe marrjes së lejeve përkatëse të përdorimit të ujrave apo leje mjedisore, të dhëna nga institucionet e tjera në përputhje me veprimtarinë që subjektet kanë kërkuar të licencohen ne ERE.

Gjithashtu, rast pas rasti, në zbatim të vendimeve të licencimeve përgjatë vitit 2023, ERE ka vijuar me ndjekjen e zbatimit të kushteve dhe rishikimit të vendimeve respektive, për ato licenca të dhëna me kusht, vlefshmeria e të cilave është e kushtëzuar nga afatet e përcaktura në lejet/autorizimet e dhëna nga organe të tjera.

Nga analizimi i të dhenave dhe dokumentacionit të aplikimeve, është konstatuar problematikë në lidhje me afatin e lejeve/miratimeve të organeve të tjera, të cilat jane të ndryshme nga afatet e përcaktuara në autorizimin/kontratën e nënshkruar me MIE-n për ndërtimin dhe administrimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë elektrike.

<u>Ne veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2023 jane licencuar 15 subjekte, si vijon:</u>

Nr.	Subjekti	Prodhues energjie elektrike	Kapaciteti i instaluar	Vendimi i ERE-s
1.	"ATEANI" shpk	HEC "Shutri" 1	0.37 MW	Nr. 107, datë 23.03.2023
		HEC "Shutri" 2	1.6 MW	
2.	"SUN AVENUE" shpk	Central Fotovoltaik	2 MW	Nr. 72, datë 13.03.2023
3.	"SUNPOWER 2017" shpk	Central Fotovoltaik	2 MW	Nr. 73, datë 13.03.2023
4.	"KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)"	TEC "Tigri 1"	50 MW	Nr. 109, datë 27.03.2022
		TEC "Tigri 3"	60 MW	
5.	"TPLANI HC" sh.p.k	HEC "Valbona"	2.1 MW	Nr. 111, datë 27.03.2023
6.	"Sun Energy Solutions" shpk	Central Fotovoltaik	2 MW	Nr. 123, datë 04.04.2023
7.	"Erseka Solar Park 1" shpk	Central fotovoltaik	20 MW	Nr. 176, datë 18.05.2023
8.	"NOVA SOLAR PARK" shpk	Central Fotovoltaik,	50 MW	Nr. 242, datë 03.08.2023
9.	"ALB SUN ENERGY" shpk	Central Fotovoltaik	2 MW	Nr. 250, datë 16.08.2023
10.	"Erseka Solar Park 2" shpk	Central fotovoltaik	20 MW	Nr. 253, datë 23.08.2023
11.	"G.S.K" shpk	Central Fotovoltaik	2 MW	Nr. 254, datë 23.08.2023
12.	"Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" shpk	Central Fotovoltaik	1.95 MW	Nr. 268, datë 11.09.2023
13.	"IDI 2005" shpk	Centrali Fotovoltaik,	2 MW	Nr. 303, datë 23.10.2023
14.	"Gealb Energy" shpk	HEC "Guri i Bardhë 1"	5.36 MW	Nr. 361, datë 07.12.2023
		HEC "Guri i Bardhë 2"	3.94 MW	
15.	"GERTI" shpk	HEC "Mireshi"	1.9 MW	Nr. 362, datë 07.12.2023

Sikurse rezulton nga tabela e mësiperme, në total gjatë vitit 2023, kapaciteti prodhues i energjisë elektrike është rritur me 229.22 MW, nga të cilat 125,27 MW nga prodhimi i energjisë elektrike nga burimet hidrike dhe termike dhe 103,95 MW nga prodhimi i energjisë elektrike nga burimet fotovoltaike.

Po ashtu, gjatë vitit 2023 me vendimin e Bordit nr. 142, datë 24.04.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "ECO- ELB" sha, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan.

Ne aktivitetin e prodhimit gjate vitit 2023 janë miratuar 2 kërkesa për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 150, datë 28.04.2023, është vendosur modifikimi i licencës së shoqërisë "KURUM INTERNATIONAL" shpk, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i "Shkopet", duke ndryshuar kapacitetin e instaluar të këtij HEC-i nga 24 MW në 28 MW.

- Me vendimin e Bordit nr. 177, datë 18.05.2023, është vendosur modifikimi i licencës së shoqërisë "SEKA HYDROPOWER" shpk, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, i ndryshuar, duke shtyuar në këtë licencë dhe HEC "Zais", me kapacitet të instaluar 2295 kW.

4.2 Licensimi në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike

ERE ka vijuar pergjate vitit 2023 të licensojë subjektet në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike. Në tabelën më poshtë jepen subjektet e licensuara nga ERE në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të cilat për vitin 2023 janë 6 të tilla.

Të licencuarit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike gjatë 2023

Nr.	Subjekti	Vendimi i ERE-s
1.	"G.S.K" shpk	Vendimi nr. 22, datë 09.02.2023
2.	"NATYRE ENERGY" shpk	Vendimi nr. 71, datë 13.03.2023
3.	"Energy24" shpk	Vendimi nr. 124, datë 04.04.2023
4.	"PROINFINIT CONSULTING" shpk	Vendimi nr. 187, datë 06.06.2023
5.	"SPV BLUE 1" shpk	Vendimi nr. 233, datë 19.07.2023
6.	"Swiss Balancing Pool" shpk	Vendimi nr. 372, datë 26.12.2023

Në të njëjtën kohë po gjatë vitit 2023 janë paraqitur në ERE dhe janë miratuar 7 kërkesa për rinovimin e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, për shkak të përfundimit të afatit 5-vjeçar të vlefshmërisë së tyre.

- Me vendimin e Bordit nr. 121, datë 04.04.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË" sha, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 130, datë 07.04.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "GEN-I TIRANA" sha, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 165, datë 15.05.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "ENER TRADE" shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 190, datë 06.06.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "ReNRGY Trading Group" shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 271, datë 19.09.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE" (KESH) sha, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 272, datë 19.09.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "AYEN ENERGY TRADING" shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 288, datë 09.10.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "EZ-5 ENERGY" shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

4.3 Licensimi në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

Përgjatë vitit 2023 ERE ka vijuar të licensojë subjekte në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Në tabelën më poshtë jepen subjektet e licencuara nga ERE në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Sikurse evidentohet për vitin 2023 janë realizuar 10 licencime nga ERE në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

Nr.	Subjekti	Vendimi i ERE-s
1.	"Balkan Energy Trade" shpk	Vendimi nr. 18, datë 06.02.2023
2.	"G.S.K" shpk	Vendimi nr. 21, datë 06.02.2023
3.	"NATYRE ENERGY" shpk	Vendimi nr. 66, datë 03.03.2023
4.	"ATEANI ENERGY" shpk	Vendimi nr. 108, datë 23.03.2023
5.	"Energy Market Albania" shpk	Vendimi nr. 138, datë 14.04.2023
6.	"PROINFINIT CONSULTING" shpk	Vendimi nr. 188, datë 06.06.2023
7.	"SPV BLUE 1" shpk	Vendimi nr. 232, datë 19.07.2023
8.	"GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" shpk	Vendimi nr. 238, datë 27.07.2023
9.	"EU GREEN ENERGY" shpk	Vendimi nr. 246, datë 19.08.2023
10.	"Swiss Balancing Pool" shpk	Vendimi nr. 371, datë 26.12.2023

Gjatë vitit 2023 janë paraqitur në ERE dhe janë miratuar 8 kërkesa për rinovimin e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për shkak të përfundimit të afatit 5-vjeçar të vlefshmërisë së tyre.:

- Me vendimin e Bordit nr. 19, datë 06.02.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "ReNRGY Trading Group" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Me vendimin e Bordit nr. 131, datë 07.04.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "GEN-I Tirana" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 144, datë 24.04.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "AEE" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 166, datë 15.05.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "ENER TRADE" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 189, datë 06.06.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË" sha, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 247, datë 09.08.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "HYDRO SETA" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 273, datë 19.09.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "AYEN ENERGY TRADING" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 289, datë 09.10.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "EZ-5 ENERGY" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 373, datë 26.12.2023, është vendosur rinovimi i licencës së shoqërisë "ENERGY24" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

4.4 Njohje e Licensave

ERE gjatë vitit 2023, ka ushtruar aktivitetin dhe ne njohjen e licensave te lëshuara nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër, Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë, një shteti Anëtar të Bashkimit Europian, ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator.
Në tabelën e mëposhtëme jepen licensat të cilat jane njohur ku evidentohet dhe lloji i veprimtarisë së tyre.

Nr.	Subjekti	Autoriteti Rregullator që ka lëshuar licencën	Lloji i veprimtarisë	Vendimi i Bordit të ERE-S
1	"SOLE 24 DOOEL Shkup-Dega në Shqipëri" Dege e shoqërisë së huaj	Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut,	Furnizim dhe tregtim i energjisë elektrike	Vendimi nr. 206, datë 28.04.2023
2	"FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K.; Dega në Tiranë", degë e shoqërisë së huaj	Zyra e Rregullatorit për Energji, e Republikës së Kosovës	Furnizim i energjisë elektrike	Vendimi nr. 216, datë 04.07.2023

Ne vijim ne menyre grafike paraqiten te dhena nder vite te licensimit te subjelteve ne aktivitet e sektorit te energjise elektrike



Tabela 77. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike



Tabela 78. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror



Tabela 79. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e e tregtimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror



Tabela 80. Nr. i licencave të miratuara për çdo veprimtari sipas viteve

4.5 Licencimi në aktivitetet e Gazit Natyror

Gjatë vitit 2023, ERE nuk ka realizuar procese të licencimit si dhe nuk ka pasur modifikime të licencave në sektorin e gazit natyror.

4.6 Kërkesat për të cilat është vendosur mosfillimi i procedurës ose refuzimi i dhënies së miratimit nga ERE

ERE, gjatë këtij viti, ka marrë në shqyrtim edhe kërkesa të tjera të të licencuarve, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedurës ose refuzimi i dhënies së miratimit për shkak se aplikantët kane pasur mungesë të dokumentacionit thelbesor në aplikimet e tyre.

Gjatë këtij viti nga ERE është vendosur mosfillimi i procedurës/mosmarrje në shqyrtim i kërkesës përkatësisht për 3 (tri) aplikime për licencim prodhim; 4 (katër) aplikime për licencim tregtim; 2 (dy) aplikime për licencim furnizim; 6 (gjashtë) vendime për mosmarrje në shqyrtim të kërkesës për dhënien e autorizimit nga ERE; 1 (një) vendim për rrëzim kërkese për rishikimin e vendimit të Bordit dhe modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike; si dhe është vendosur refuzimi i kërkesës për licencim në prodhim për 1 (një) aplikim.

Po ashtu, është vendosur pezullimi i vendimmarrjes së Bordit përkatësisht për 1 (një) aplikim për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike; 1 (një) aplikim për transferim licence në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike; 1 (një) aplikim për rinovim licence në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike; 1 (një) aplikim për modifikim licence në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, 1 (një) aplikim për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Si rezultat i pamundësisë së plotësimit të dokumentacionit të aplikimit në kohë, Bordi i ERE-s ka marrë 18 (tetëmbëdhjetë) vendime për shtyrje të afatit administrativ të vendimmarrjes përfundimtare mbi këto aplikime.

Përveç sa më sipër, në kuadër të plotësimit të kushteve të licencimit nga ana e të licencuarve, janë marrë 42 (dyzet e dy) vendime për rishikimin e këtyre vendimeve.

Gjatë vitit 2023, është hequr 1 (një) licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për shkak të mosshlyerjes së pagesës së rregullimit; 1 (një) licencë, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për shkak të shkeljes së kushteve të licencës; 2 (dy) licenca me kërkesë të vetë të licencuarve, përkatësisht në veprimtarinë e tregtimit dhe atë të furnizmit të energjisë elektrike.

4.7 Dhënia e Autorizimeve nga ERE per vitin 2023

Të licencuarit, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe kushteve të licencës, kanë detyrimin për të marrë autorizimin e ERE-s për transferimin e aseteve të paluajtshme, ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve.

Vendimmarrjet përkatëse për aplikimet e paraqitura nga të licencuarit për marrjen e autorizimit të ERE-s jane paraprirëe nga korrespondenca dhe seancat degjimore me palët. Gjatë vitit 2023, janë marrë vendimet për dhënie autorizimi , nga të cilat 4 vendime për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e shoqerisë; 5 vendime për vendosjen e kuotave/aksione si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve; 3 vendime për transferimin e aseteve të paluajtshme të të licencuarve.

4.8. Dhënia e Garancive të Origjinës

ERE në Maj te vitit 2023 ka firmosur me shoqerinë Grexel e përzgjedhur nga Sekretariati i Energjise në Vienë, kontratën për shërbimin e mbajtjes së regjistrit elektronik të garancive të origjinës në vendet e Traktatit të Energjisë së vendeve të Evropes Juglindore. Sa më siper shënon një hap të rëndësishëm në njohjen e Garancive të Origjinës në vendet e rajonit. Në po këtë kuadër përgjatë vitit 2024 do të realizohet dhe pjesmarrja e plotë e ERE-s në Shoqatën Evropiane te Autoriteteve lëshuese të garancive të Origjinës (AIB). Përgjatë 2023 janë lëshuar Certifikata të Garancisë së Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme për të licencuarit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike. Në tabelën më poshtë jepet lista e garancive të origjinës të dhëna nga ERE:

Nr.	Subjekti	Impianti	Vendimi i Bordit të ERE-S
1	“DEVOLL HYDROPOWER” sha	HEC “Banjë”	Vendimi nr.151, datë 28.04.2023
2	“DEVOLL HYDROPOWER” sha	HEC “Moglicë”	Vendimi nr.152, datë 28.04.2023
3	“KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)”	Centrali fotovoltaik në digën e Qyrsaqit, Vau i Dejës	Vendimi nr. 164, datë 15.05.2023
4	“KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)”	HEC “Fierzë”	Vendimi nr. 346, datë 22.11.2023

5	"KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)"	HEC "Koman"	Vendimi nr. 347, datë 22.11.2023
6	"KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)"	HEC "Vau i Dejës"	Vendimi nr. 348, datë 22.11.2023

4.9. Përcaktimi i Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)

Një risi në vendimmarrjet e ERE-s për vitin 2023, ka qenë dhe përcaktimi i shoqërisë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX" SH.A., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 228, datë 17.07.2023.

Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), është subjekt ligjor i përcaktuar nga Enti Regullator i Energjisë për të kryer detyrat që kanë lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe të tregut brenda të njëjtës ditë sipas kësaj rregullore. Monopoli ligjor në vend është caktimi i vetëm një Operatori të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike për sigurimin e shërbimeve të tregtimit të ditës në avancë dhe/ose tregtimin brenda ditës.

Përcaktimi i Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) mbetet i vlefshëm deri në përfshirjen e Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve në legjislacionin e vendit, sipas të cilës përcaktimi i NEMO-s duhet të konfirmohet bazuar ne Rregulloren e Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve (CACM Regulation).

4.10. Raporti vjetor i Pajtueshmërisë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (OST sha)

Në zbatim te përcaktimeve të vendimit nr. 43, datë 15.03.2017, *"Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë", si dhe në zbatim të përcaktimeve të Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a miratuar me vendimin e Bordit te ERE-s nr. 103, datë 30.04.2018*, Zyrtari i Pajtueshmërisë së shoqërisë "OST" sh.a, në përmbushje të detyrave të tij, datën 29.03.2023, ka dërguar në ERE raportin e pajtueshmërisë së "OST" sh.a. për vitin 2022.

Nga ky raport u konstatua se "OST" sh.a gjatë vitit 2022 ka bërë një punë të mirë në drejtim të zbatimit të parashikimeve të vendimit të certifikimit, por mbetet ende për tu bërë në lidhje me zbatimin e programit të pajtueshmërisë dhe implementimit të rekomandimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë. Nga ana e ERE-s janë dhënë disa rekomandime në kuadër të përmirësimeve të përmbushjes së këtyre detyrimeve të cilat duhet të merren në konsideratë nga ana e administratës së "OST" sh.a dhe të raportohen nga Zyrtari në vijim përgjatë raportit të vitit pasardhës.

4.11. Raporti vjetor i Pajtueshmërisë i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSSH sha

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 257, datë 21.12.2020, ka miratuar Programin e Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), me vendimin nr. 343, datë 21.12.2022, ka miratuar Kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sha dhe me vendimin nr. 114, datë 27.03.2023, ka miratuar emërimin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë së OSSH sha. Ky fakt coi dhe në mbylljen me datë 18.04.2023 të procedimit ECS-4/17 të ngritur nga ana e Sekretariatit të Energjisë në Vienë ndaj Shqiperisë cështje e hapur më herët nga Sekretariati lidhur me mungesën e ndarjes së plotë të OSSH. Ky vendim i Sekretariatit erdhi pas konstatimit të plotësimit dhe transpozimit të kërkesave për ndarjen funksionale të OSSH në nivel kombetar, ndarjes ligjore dhe progresit të bërë në këtë drejtim ku miratimi i programit të pajtueshmërisë dhe zgjedhja e Zyrtarit të Pajtueshmërise finalizoi procesin e ndarjes së OSSH.

Brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Bordit nr. 198/2023, në datën 10.07.2023, Zyrtari ka depozituar në ERE Raportin vjetor të Pajtueshmërisë së OSSH sha, për vitin 2022.

Pas shqyrtimit të këtij raporti, duke marrë në konsideratë është konstatuar se është hartuar kryesisht sipas detyrave që lë Programi dhe i është evidentuar Zyrtarit informacioni që duhet plotësuar më tej. Në vijim nga ana e Zyrtarit është depozituar dhe informacioni plotësues i Raportit.

5. AKTIVITETI I ERE-s NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË TARIFAVE DHE ÇMIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR

Në zbatim të neneve 19, 20, 79 dhe 83 të Ligjit Nr. 43/2015 *"Për Sektorin e Energjisë Elektrike"*, i ndryshuar, të neneve 16, 17, 32, 75 dhe 92 të Ligjit Nr.102/2015 *"Për Sektorin e Gazit Natyror"*, i ndryshuar, si dhe nenit 10 të Ligjit Nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për veprimtaritë e rregulluara dhe ato që kanë detyrimin e shërbimit publik në sektorin e energjisë, bazuar në metodologjitë respektive në fuqi. Në këtë kuadër, veprimtaritë kryesore të ERE-s në fushën e rregullimit të tarifave dhe çmimeve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror gjatë vitit 2023 kanë qenë:

Shqyrtimi i aplikimeve, analiza e kostove dhe miratimi i tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për:

- Aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike;
- Aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike;
- Aktivitetin e furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike;
- Aktivitetin e furnizimit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike;
- Aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror;
- Përcaktimin e çmimit të mesatarizuar të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3MW
- Përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi;

Përcaktimin e strukturës së tarifave të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) dhe miratimin e listës së tarifave.

Hartimi, Rishikimi dhe Miratimi i Metodologjive të llogaritjes së tarifave në sektorin e energjisë elektrike.

- Vijimi i procesit të miratimit të ''Metodologjisë për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme për t'u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike''.
- Vijim i procesit të miratimit të "Metodologjisë për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX".

5.1. Vlerësimi i aktiviteteve të shoqërive të rregulluara si dhe Shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin 2023.

5.1.1. Aktiviteti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023.

Bordi i ERE me anë të vendimit nr. 72, datë 13.04.2022 vendosi miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Maj 2022 – 31 Dhjetor 2024, prej 0.85 lekë/kWh. Gjatë vitit 2023 OST sh.a. ka vijuar ushtrimin e një aktiviteti normal financiar në të cilin kostot e parashikuara dhe të konsideruara për efekt të përllogaritjes së tarifës mesatare të transmetimit të energjisë elektrike nuk janë tejkaluar. Viti 2024 është viti i fundit i ciklit 3-vjeçar të periudhës rregullatore në të cilin, në zbatim të legjislacionit në fuqi, do të rishikohet realizimi i komponentëve përllogaritës të tarifës së transmetimit për efekt të vlerësimeve mbi të cilat ERE do të mbështetet për përllogaritjen e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën pasardhëse.

5.1.2. Lidhur me aplikimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike për përcaktimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Në lidhje me miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, në mungesë të aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a., për përcaktimin e tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2023 Bordi i ERE-s me vendimin nr. 324, datë 14.12.2022, vendosi të shtyjë fuqinë juridike të vendimit nr. 73, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2023 ose konstatimit të ndryshimit të kostove bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përmes korrespondencave të zhvilluara mes ERE-s dhe OSSH sh.a., shoqëria ka theksuar se meqënëse gjendet në kushtet e vazhdimit të furnizimit me energji elektrike për mbulimin e humbjeve në zbatim të VKM-së nr. 456, datë 29.06.2022 "Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" dhe të ndryshimeve në çmimin e energjisë elektrike që do të blihet për mbulimin e humbjeve, kërkoi që edhe për vitin 2024 të vijojnë të mbeten në fuqi tarifat e miratuara sipas vendimit të ERE-s Nr.73, datë 13.04.2022. OSSH sh.a. ka sqaruar gjithashtu se kjo kërkesë lidhet me mos ndryshim të kushteve (kostove të përfshira) në furnizimin me energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe se rezervon të drejtën për të aplikuar për ndryshim të tarifave vetëm në rast të ndryshimit të kostove të lidhura me mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. ERE me qëllim kryerjen e vlerësimeve për një tarifë sa më të drejtë e kosto-reflektuese, kërkoi nga OSSH sha.a. paraqitjen e të dhënave dhe dokumentacionit të nevojshëm lidhur me ushtrimin e aktivitetit si operator i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike. OSSH sh.a. përcolli në ERE informacionin dhe të dhënat paraprake mbi aktivitetin e saj ushtrimor e financiar për vitin 2023 dhe parashikimeve për vitin 2024.ERE, bazuar në dokumentet e sipërcituara, evidentoi se nisur nga fakti ku treguesit ekonomik të periudhës 2021 – 2022 janë ende në proces rivlerësimi dhe auditimi, komponentët përllogaritës të tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilët kanë shërbyer dhe për përcaktimin e tarifave të miratuara nga ERE me anë të vendimit nr. 73/2022, mund të pësojnë ndryshime. Gjithashtu në mungesë të argumenteve dhe shpjegimeve përkatëse për zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara për vitin 2023, të cilët ishin të paraqitura vetëm në formë sintetike, nuk mund të kryhej

përllogaritja dhe vlerësimi i kostove faktike të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2023 si dhe parashikimi për vitin 2024.

Me përfundimin e gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike më datë 31 dhjetor 2023, përfundon edhe vendosja e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë "Furnizuesi i tregut të lirë" sh.a." për shitjen e energjisë elektrike e cila shkon për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes. Si rrjedhojë, shoqëria përgjatë vitit 2024 mund të përballet me faktin e blerjes së sasisë së energjisë elektrike me çmim të paparashikuar në treg të parregulluar me qëllim mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes. Nëse ERE do të konstatojë një ndryshim të kostove të njohura në përllogaritjen e tarifave të shërbimit të shpërndarjes të miratuara me anë të vendimit nr. 73/2022 të Bordit të ERE-s, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, diferenca e korrigjueshme do të duhet t'i lihet si rezervë shoqërisë, me qëllim përballimin e kostove të paparashikuara që mund të afektohet për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes përgjatë vitit 2024 si dhe rikuperimin e kapitalit negativ të akumuluar ndër vite.

Në vijim, me qëllim që shoqëria OSSH sh.a. të mund të realizojë aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike konform legjislacionit në fuqi për vitin 2024, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 365, datë 15.12.2023, vendosi të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2024 ose konstatimit të ndryshimit të kostove, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nëse ky vendim do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë OSSH sh.a., do të bëhet korrigjimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 20, germa "c" të ligjit nr. 43/2015, *"Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar.

5.1.3 Lidhur me miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal

Mbështetur në përcaktimet e nenit 16; nenit 19, gërma "c", pika "i"; nenit 20, germa "c"; nenit 83 dhe nenit 85 të Ligjit Nr. 43/2015 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimeve të rregulluara për klientët fundorë që furnizohen sipas Shërbimit Universal të Furnizimit.

Sikurse evidentuar edhe në raportin e vitit 2022, shoqëria FSHU sh.a, nuk paraqiti pranë ERE-s aplikim për miratimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2023.

Gjendur në rrethanat e mësipërme, me qëllim që shoqëria FSHU sh.a. të vijonte të ushtronte aktivitetin për të cilin është licencuar edhe për vitin 2023, konform ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 325, datë 14.12.2022, miratoi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2023.

Në vijim, ERE solli sërish në vëmendje të shoqërisë FSHU sh.a. detyrimin për të aplikuar për vitin 2024, për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal, në përputhje me kërkesat e nenit 5, pika 3, të "Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me

Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal" dhe nenit 21 të "Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s".Shoqëria FSHU sh.a. bëri me dije se edhe për vitin 2024 pritet që shoqëria KESH sh.a.. do të vazhdojë të furnizojë me energji Furnizuesin e Shërbimit Universal, me çmimin prej 2.6 lekë/kWh, duke patur si synim mosndryshimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për klientët fundorë të cilët shërbehen nga FSHU sh.a.. Referuar parashikimeve të shoqërisë, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a. do të mundet të sigurojnë mbulim të shpenzimeve të reduktuara të FSHU sh.a. si dhe sigurimin e një performance minimale pozitive mbijetese. Në këto kushte, shoqëria FSHU sh.a. kërkoi që për vitin 2024, të vijojnë të mbeten në fuqi çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal të miratuara me anë të vendimit të Bordit të ERE nr. 74, datë 13.04.2022.Me qëllim që ERE të bënte një vlerësim të të ardhurave të parashikuara të FSHU sh.a për vitin 2024, kërkoi nga shoqëria, paraqitjen e të dhënave dhe dokumentacionin e nevojshëm lidhur me ushtrimin e aktivitetit të saj.Në lidhje me sa kërkuar, shoqëria FSHU sh.a. sqaroi se për shkak të vonesave në vlerësimin e aseteve për 2020 të OSHEE Group, ka kërkuar që të bëhen ndryshimet dhe aprovimet e nevojshme në Pasqyrat Financiare të vitit 2020 dhe 2021. Procesi i auditimit të tyre bashkë me pasqyrat financiare të vitit 2022 referuar deklaratës së FSHU sh.a. nuk ka përfunduar . Më tej, shoqëria ka paraqitur të dhëna sintetike, në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të saj, pa dhënë sqarimet dhe argumentet përkatëse, sikurse parashikohet në dispozitat e metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal .

Në mënyrë që shoqëria FSHU sh.a edhe për vitin 2024, të mundet të realizojë aktivitetin për të cilat është licencuar, konform Ligjit Nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 366, datë 15.12.2023, ERE vendosi të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a., për vitin 2024, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nëse vendimi i mësipërm do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërive, do të bëhet korrigjimi dhe kompensimi përkatës i tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 20, gërma "c" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe metodologjive përkatëse, të miratuara nga ERE.

5.1.4. Mbi përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2023

Në zbatim të Nenit 87, pika 4 të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me Vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me Vendimet e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019, Enti Rregullator i Energjisë ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) , për kategoritë e klientëve si më poshtë:

- Klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit;
- Klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit;

- Shoqëritë Ujësjellës-Kanalizime, të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Përllogaritja e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është kryer konform formulës së përcaktuar në "Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", të miratuar me anë të vendimit nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar.

Përllogaritja e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e furnizuar në kushtet e mundësisë së fundit të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësise së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për vitin 2023 ka rezultuar të jetë 19.09 lekë/kWh. Gjatë vitit 2023, ky çmim ka pësuar një rënie domethënëse prej 40% krahasuar me çmimin mesatar të vitit 2022, i cili ka rezultuar 31.84 lekë/kWh. Në vijim janë paraqitur në formë tabelare të dhënat mujore mbi çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV si dhe vendimet respektive të Bordit të ERE-s. Për qëllime krahasimi, përbri të dhënave të vitit 2023 janë pasqyruar edhe të dhënat e vitit paraardhës.

Viti 2022	Vendimi	ERE (lekë/kWh) 2022	Viti 2023	Vendimi	ERE (lekë/kWh) 2023
Janar	Nr. 75, Datë 13.04.2022	32.76	Janar	Nr. 28, Datë 16.02.2023	32.27
Shkurt	Nr. 76, Datë 13.04.2022	32.85	Shkurt	Nr. 105, Datë 23.03.2023	32.24
Mars	Nr. 77, Datë 13.04.2022	32.92	Mars	Nr. 134, Datë 11.04.2023	20.49
Prill	Nr. 105, Datë 19.05.2022	32.72	Prill	Nr. 163, Datë 15.05.2023	16.85
Maj	Nr. 148, Datë 10.06.2022	32.14	Maj	Nr. 194, Datë 19.06.2023	16.41
Qershor	Nr. 173, Datë 07.07.2022	31.75	Qershor	Nr. 222, Datë 10.07.2023	14.22
Korrik	Nr. 207, Datë 17.08.2022	31.20	Korrik	Nr. 244, Datë 09.08.2023	15.33
Gusht	Nr. 229, Datë 12.09.2022	31.29	Gusht	Nr. 276, Datë 19.09.2023	15.80
Shtator	Nr. 261, Datë 14.10.2022	31.15	Shtator	Nr. 294, Datë 12.10.2023	16.06
Tetor	Nr. 287, Datë 10.11.2022	31.50	Tetor	Nr. 318, Datë 08.11.2023	16.13
Nëntor	Nr. 318, Datë 12.12.2022	31.21	Nëntor	Nr. 376, Datë 28.12.2023	17.26
Dhjetor	Nr. 05, Datë 16.01.2023	30.59	Dhjetor	Nr. 1, Datë 22.01.2024	16.00
MESATARE VJETORE		**31.84**			**19.09**

Figura 81. Çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për klientët 35 kV për vitet 2022 – 2023

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Mesatare
ERE (lekë/kWh) 2023	32.27	32.24	20.49	16.85	16.41	14.22	15.33	15.80	16.06	16.13	17.26	16.00	19.09
ERE (lekë/kWh) 2022	32.76	32.85	32.92	32.72	32.14	31.75	31.20	31.29	31.15	31.50	31.21	30.59	31.84
Diferenca në përqindje	-1.50%	-1.86%	-37.76%	-48.50%	-48.94%	-55.21%	-50.87%	-49.50%	-48.44%	-48.79%	-44.70%	-47.70%	-40.05%

(Burimi: ERE)

Grafiku i mëposhtëm paraqet kurbën lëvizëse e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të miratuara nga Bordi i ERE-s për vitin 2023. Për efekt krahasimi, në grafik pasqyrohet gjithashtu kurba e çmimeve të shitjes për vitin 2022:



(Burimi: ERE)

Figura 82. Kurba lëvizëse e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të miratuar nga ERE për vitet 2022-2023

Sikurse vërehet në grafikun e mësipërm, kurba e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike të miratuara nga Bordi i ERE-s për vitin 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, ka patur të njëjtin trend me kurbën e kostos së blerjes së energjisë elektrike. Për rrjedhojë, trendi i rënies së tyre gjatë gjashtë mujorit të parë, si dhe qëndrueshmëria e tyre në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023 reflektohen qartë edhe në çmimin mujor të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Nga analizimi i të dhënave të raporteve periodike të vitit 2023, evidentohet se sasia e energjisë elektrike e shitur për klientët e FMF-së, të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, ka qenë 21.1 GWh, me një vlerë të faturuar prej 250 milion lekë, duke rezultuar në një çmim mesatar vjetor të realizuar prej 11.83 lekë/kWh. Në tabelën në vijim paraqesim diferencat e këtyre treguesve për vitet 2022 - 2023.

Periudha (Klientët e lidhur në 35 kV)	Sasia (kWh)	Vlera (Lekë)	Çmimi mesatar i realizuar (Lekë/kWh)
2022	22,906,846	735,517,781	32.11
2023	21,179,381	250,642,413	11.83
Diferencë	**-7.54%**	**-65.92%**	**-63.14%**

(Burimi:OSHEE Group sh.a, ERE)

Figura 83. Realizimi i treguesve të FMF për vitet 2022 - 2023.

Çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për vitin 2023 ka rezultuar të jetë 15.17 lekë/kWh. Ky çmim ka pësuar nje rënie domethënëse prej 44.56% në krahasim me çmimin mesatar të blerjes së energjisë elektrike të vitit 2022, i cili ka rezultuar 27.36 lekë/kWh. Në vijim janë paraqitur në formë tabelare të dhënat mujore mbi koston e blerjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Për qëllime krahasimi, përbri të dhënave të vitit 2023 janë pasqyruar edhe të dhënat e vitit paraardhës:

Muaji	ÇBEt (lekë/kWh) 2023	ÇBEt (lekë/kWh) 2022	Diferenca në përqindje
Janar	27.97	27.88	0.32%
Shkurt	27.94	27.97	-0.11%
Mars	16.53	28.04	-41.05%
Prill	13.00	27.84	-53.30%
Maj	12.57	27.84	-54.85%
Qershor	10.45	27.47	-61.96%
Korrik	11.52	26.93	-57.22%
Gusht	11.98	27.02	-55.66%
Shtator	12.23	26.88	-54.50%
Tetor	12.30	27.22	-54.81%
Nëntor	13.40	26.94	-50.26%
Dhjetor	12.17	26.34	-53.80%
Mesatare	**15.17**	**27.36**	**-44.56%**

Figura 84. Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për mbulimin e nevojës së klientëve FMF të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për periudhën 2022 – 2023

Më poshtë paraqitet kurba lëvizëse e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të mundësisë së fundit për klientët e lidhur në 35 kV, për vitet 2022 - 2023.

Figura 85. Kurba lëvizëse e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga FMF, për vitet 2022-2023



(Burimi: ERE)

Nga grafiku e mësipërm, evidentohet qartë se vlera më e ulët për vitin 2023 rezulton në muajin qershor, ku 1 kWh është blerë me 10.45 lekë, ose 61.96% më i ulët se sa çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë në muajin qershor të vitit 2022. Referuar të dhënave të gjashtë-mujorit të dytë të vitit 2023 rezulton se çmimet mesatare të ponderuar të blerjes së energjisë në treg të lirë për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF, të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, nuk kanë pësuar luhatje domethënëse. Qëndrueshmëria e tyre pasqyrohet dhe në kurbën e grafikut të mësipërm, ku duket se vlerat ruajnë thuajse të njëjtin trend. Vlen të theksohet se nga krahasimi i mesatares vjetore të vitit 2022 (27.36 lekë/kWh) me mesataren vjetore të vitit 2023 (15.17 lekë/kWh), çmimi i energjisë elektrike të blerë në treg të lirë për mbulimin e kërkesës së kësaj kategorie klientësh FMF, ka pësuar një rënie në masën 44.56%.

Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV

Bazuar në Ligjin nr.43/2015 *"Për Sektorin e Energjisë Elektrike",* i ndryshuar, klientët që plotësojnë kushtet teknike për daljen në treg të liberalizuar, nga data 01 janar 2022 mund të zgjedhin lirisht furnizuesin e tyre. Në pamundësi të sigurimit të një marrëveshje furnizimi me një nga subjektet e licencuara në këtë aktivitet, klientëve ju lind e drejta e përdorimit të shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Në zbatim të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, shoqëria KESH sh.a. , sikurse dhe në vitin paraardhës, furnizoi edhe për vitin 2023 të gjithë sasinë e kërkuar të energjisë elektrike për klientët e FSHU sh.a., përfshirë këtu edhe klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV, të cilët u gjendën në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit. Kosto e blerjes së sasisë së energjisë për mbulimin e kërkesës së kësaj kategorie klientësh, ishte 12 lekë/kWh. Për aq kohë sa kostoja e blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a mbetej e pandryshuar dhe komponentët e tjerë të përllogaritjes së çmimit të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh ishin konstante, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 29, datë 16.02.2023, miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike për vitin 2023 për klientët FMF të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV. Në rast të ndryshimit të ndonjërit prej komponentëve përllogaritës së çmimit, u parashikua rishikimi i këtij vendimi.

Referuar raporteve periodike të ERE-s për vitin 2023, rezulton se sasia e energjisë së konsumuar nga klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV për këtë vit është 1,07 GWh me një vlerë të faturuar prej afro 18,802 milion lekë.

Figura 86. Realizimi i treguesve të FMF për vitet 2022 - 2023 , për klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV

Periudha (Klientët e lidhur në 20-10-6 kV)	Sasia (kWh)	Vlera (Lekë)	Çmimi mesatar i realizuar (Lekë/kWh)
2022	1,079,440,181	20,058,932,674	18.58
2023	1,070,667,285	18,802,002,357	17.56
Diferencë	-0.82%	-6.69%	-5.82%

(Burimi:OSHEE Group sh.a, ERE)

5.1.5 Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2023 për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. paraqiti në ERE për vitin 2023 kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për Shoqëritë e Ujësjellës Kanalizime, të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV si dhe 20/10/6 kV, të cilat shërbehen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Bazuar në pikën 1 të nenit 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.06.2022 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", përcaktohet se shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve kanë status të veçantë, si shoqëri të cilat sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve. Më tej referuar pikës 2, neni 8, të VKM së mësipërme, *"klientëve të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, i sigurohet furnizim i pandërprerë edhe në rast se kanë dalë në treg të liberalizuar dhe furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar".*

Në zbatim të sa më sipër, shoqëria KESH sh.a. me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit me nr. 10253/1, datë 04.01.2023, miratoi ndër të tjera edhe çmimin mesatar të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., me qëllim mbulimin e kërkesës për furnizim e shoqërive të Ujësjellës Kanalizime, për vitin 2023, të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV si dhe 20/10/6 kV prej 5.70 lekë/kWh.

Bazuar në të dhënat e aplikimit të FSHU sh.a, si dhe në nenin 8 të "*Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*", ERE kreu përllogaritjen e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për këtë kategori klientësh, në varësi të nivelit të tensionit ku janë të lidhur, të cilat rezultuan si më poshtë:

Figura 87. Çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga FMF sipas nivelit të tensionit për vitin 2023 , për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime Viti 2023				
			Nivelet e tensionit	
			35 kV	20/10/6 kV
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	5.70	5.70
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.17	0.17
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		**Leke/kWh**	**9.33**	**11.77**

(Burimi: ERE)

Me vendimin nr. 16, datë 06.02.2023, Bordi i ERE-s vendosi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2023, prej:

- 9.33 lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV
- 11.77 lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.

Në rast të shfaqjes së ndryshimeve të komponentëve përbërës së përllogaritjes së çmimeve, u parashikua rishikimi i këtij vendimi.

5.1.6. Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga Shoqëria Albgaz sh.a. për vitin 2024.

Në zbatim të nenit 17, pika 1, germa "e'', të Ligjit nr.102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, përcaktohet se "ERE ka të drejtë të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarje, në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave.

Duke patur parasysh se Bordi i ERE-s me vendimin nr. 293, datë 23.10.2023 vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetë-vjeçar të investimeve nga shoqëria "Albgaz" sh.a., që përmban investimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të shoqërisë dhe në mungesë të paraqitjes së një aplikimi për rishikimin e tarifës së transmetimit të shoqërisë Albgaz sh.a. për vitin 2024, si dhe në zbatim të direktivave të Komunitetit të Energjisë, meqënëse aksesi në rrjet për përdoruesit e Sistemit të Transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t'i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE, Bordi i ERE-s me vendimin Nr.367, datë 15.12.2023 vendosi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019 të bordit të ERE-s për vitin 2024, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., ku përditësimi dhe kompensimi i

të ardhurave të kërkuara të shoqërisë Albgaz sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme do të bëhet në mbështetje të përcaktimeve të nenit 17, pika "e" të Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror*",* i ndryshuar. Tarifa e transmetimit e gazit natyror nga shoqëria "Albgaz" sh.a. edhe për vitin 2024 do vazhdojë të jetë ajo prej *28 lekë/m3* ose *2.6457 lekë/kwh.*

5.1.7. Mbi propozimin për Miratimin e metodologjisë për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX dhe Miratimin e listës së Tarifave.

Bordi i ERE me vendimin nr. 228, Datë 17.07.2023 vendosi të përcaktojë shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX" si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

Në vijim, Shoqëria "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX" sh.a. me shkresën nr. 257, datë 31.07.2023, protokolluar me tonën me nr.1991 prot., datë 02.08.2023, ka paraqitur në ERE "Propozimin për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX dhe miratimin e Listës së Tarifave".

ALPEX sh.a. në kërkesën e paraqitur në ERE përcolli dhe draft dokumentin "Metodologjia për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX", i cili përfshin propozimin e ALPEX për metodologjinë e përcaktimit të strukturës së tarifave dhe propozimin e listës së tarifave të ALPEX sh.a. si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për tregjet e Shqipërisë dhe Kosovës. Në kuadër të marrëveshjes kornizë të nënshkruar ndërmjet ERE dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji të Kosovës (ZRRE) "Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës" më datë 21.10.2021, propozimi është paraqitur në të njëjtën kohë edhe pranë ZRRE-së, në mënyrë që kjo metodologji të aprovohet me të njëjtën përmbajtje.

Në përcaktimin e strukturës së tarifave për anëtarët pjesëmarrës në tregjet e ALPEX-it sipas shoqërisë është marrë në konsideratë objektivi që kapitali neto i saj të jetë i barabartë me kapitalin e nënshkruar. Dokumenti gjithashtu përmban parimet e përcaktimit të strukturës së tarifave dhe një krahasim të nivelit të tarifave krahasuar me nivelin e tarifave në bursat rajonale.

Lista e tarifave e propozuar nga ALPEX sh.a. do të jetë e aplikueshme përkohësisht për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), deri në momentin e miratimit të tyre bazuar në një metodologji të strukturuar qartë, ku të përcaktohet metoda e përllogaritjes së tarifave dhe periudha rregullatore.

ERE në zbatim të nenit 6, pikave 6.1 dhe 6.4 të "Marrëveshjes Kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës" të datës 21 tetor 2021, do të bashkëpunojë me ZRRE për miratimin e "Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)", dokument i cili në përfundim duhet të bazohet në parime dhe metoda të njëjta të mbështetura në aktet ligjore në fuqi sipas secilit juridiksion. Me fillimin e procedurave për miratimin e "Metodologjisë së përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)", shoqëria ALPEX sh.a. duhet të vijojë me përditësimin e metodologjisë gjatë procesit të konsultimit publik, në mënyrë që ERE të vijojë me shqyrtimin dhe miratimin e saj.

Në vijim të sa më sipër, Bordi i ERE me vendimin nr. 287, Datë 09.10.2023 vendosi mbi miratimin e "Listës së Tarifave të ALPEX" të cilat do jenë të aplikueshme për Operatorin e

Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), deri më 31.03.2024 sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi si dhe fillimin e procedurës për miratimin e "Metodologjisë së përcaktimit të tarifave" të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

5.2 Përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2023

5.2.1. Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike për vitin 2023.

Gjatë vitit 2023, u miratua ligji i ri për burimet e rinovueshme të energjisë, i cili përafron pjesërisht Direktivën e BE 2018/2001 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"*. Ligji i ri nr. 24/2023 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme",* i cili shfuqizoi ligjin nr. 7/2017 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", i ndryshuar*. Ligji nr. 24/2023 në pikën 5 të nenit 10 ngarkon ERE-n me detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, e cila duhet të ketë të përcaktuara kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

Mbështetur në pikën 37 të nenit 3 të Ligjit Nr. 24/2023 *"*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", "Prodhues ekzistues me përparësi*"* është një prodhues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues fotovoltaik deri në 2 MW, eolik deri në 3 MW dhe për hidrocentrale me kapacitet të instaluar deri në 15 MW.

Mbështetur në pikën 2 të nenit 31 të Ligjit Nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", mbetet në fuqi metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369/2017, në zbatim të Ligjit Nr. 7/2017, për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli deri në 2 MW dhe era deri në 3 MW për prodhuesit ekzistues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues.
Në zbatim të legjislacionit të sipërcituar si dhe orientimeve të MIE ku për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike dhe eolike të merret në konsideratë metodologjia e vlerësimit të kostove të energjisë nga burimet e rinovueshme, e cila mbështetet tek e njëjta formulë e LCOE, sipas VKM Nr. 369, datë 26.04.2017.

Bordi i ERE me Vendimin Nr. 179, datë 29.05.2023, miratoi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike për vitin 2023.

MIE përcolli në ERE informacionin e përditësuar në kuadër të monitorimit nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) të kontratave për ndërtimin, shfrytëzimin dhe

administrimin e impianteve gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike, të paraqitur nga subjektet, të cilët janë pajisur me miratim për ndërtimin e impianteve gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet deri në 2 MW për vitin 2023. Mbas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar në MIE dhe në ERE, në zbatim të Metodologjisë së miratuar me Vendimin Nr. 369, datë 26.04.2017, dhe vlerësimeve të ERE, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 25, Datë 22.02.2024 miratoi çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW prej 95.04 Euro/MWh, për vitin 2023.

5.2.2. Në lidhje me çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2023.

Bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 7/2017 *"Për nxitjen e përdorimit të energjis*ë *nga burimet e rinovueshme"*, si dhe në përputhje me *"Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi"*, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017, i ndryshuar, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 327, datë 14.12.2022, vendosi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do ti paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi prej 8.5652 lekë/kWh, për vitin 2023.

Nisur nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2022 rezultoi **271,67 Euro/MWh**.

Nga të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit Lekë/EUR për çdo ditë të vitit 2022, rezultoi që kursi mesatar i këmbimit për vitin 2022 të jetë **114,96 Lekë/EUR**.

Nisur nga elementët e përcaktuar sa më sipër dhe në zbatim të formulës llogaritëse të pikës 3 të VKM-së 687/2017, i ndyshuar, çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi rezulton **37.47 Lekë/kWh**.

Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, Këshilli i Ministrave me anë të Vendimit nr. 67, datë 08.02.2023 "Për një ndryshim në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi", të ndryshuar, vendosi që niveli maksimal i çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike, në çdo rast nuk do të jetë më i lartë se çmimi 10 lekë/kWh (pa TVSH).

Në vijim të ndryshimit të miratuar me VKM-në nr. 67, datë 08.02.2023, çmimi rezultues është mbi nivelin maksimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike të përcaktuar në gërmën "d" të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, e ndryshuar, prej 10 lekë/kWh.

ERE me anë të postës elektronike, më datë 10.02.2023 ka njoftuar OSSH sh.a. dhe OST sh.a., për dijeni dhe FTL sh.a., për hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023, duke i kërkuar operatorëve të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e VKM-së dhe leximin e menjëhershëm të aparateve matës të energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi, me qëllim reflektimin e saktë të sasisë së energjisë elektrike të prodhuar gjatë muajit shkurt 2023, deri në momentin e hyrjes në fuqi të VKM-së nr.67/2023.

Sa më sipër, Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 27, datë 16.02.2023 vendosi:

1. Miratimin e çmimit të aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, prej 10 lekë/kWh.

2. Efektet financiare të këtij çmimi fillojnë nga data 09.02.2023 me publikimin në Fletoren Zyrtare të VKM-së nr. 67/2023 e deri më 31.12.2023.

5.3 Kosto e blerjes së energjisë elektrike në zbatim të kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për vitin 2023

5.3.1 Kosto e blerjes së energjisë elektrike nga "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a.

FSHU sh.a., në zbatim të detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohet ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, ka detyrim për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen nga shteti (KESH sh.a.), si dhe blerjen e energjisë në tregun e parregulluar, nëpërmjet shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë (FTL) për sasinë e pasiguruar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë.

Me shpalljen e gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike, Këshilli Ministrave me vendimin nr.620, datë 22.10.2021 miratoi kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimin e saj dhe e rishikoi atë me anë të vendimit nr.758, datë 9.12.2021. Në vijim në këtë vendim u parashikua se Furnizuesi i Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të Ligjit nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti. Shoqëria e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të Furnizuesit të Shërbimit Universal, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. Në vijim, gjatë vitit 2022 sikurse cituar më lartë, Qeveria Shqiptare me anë të vendimit nr. 456, datë 29.6.2022 vendosi të miratojë kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, vendim i cili përcaktoi dhe dispozitat e nevojshme për përballimin e situatës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, mbështetur në përcaktimet e Ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

Sa më sipër, sasia e energjisë së blerë për qëllime të shërbimit universal të furnizimit gjatë vitit 2023 është siguruar prej KESH sh.a.. Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a., sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për vitin 2023 ka qenë 2.6 lekë/kWh.

Të ardhurat e realizuara nga klientët familjarë kanë rezultuar në të njëjtat nivele me ato të realizuara gjatë vitit 2022. Ndërkohë që evidentohet se të ardhurat e realizuara prej klientëve jo familjarë, kanë pësuar një diferencë në rritje me 2%.

Të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. gjatë vitit 2023, prej furnizimit të shërbimit universal kanë pësuar një rritje prej 2% krahasuar me të ardhurat e vitit 2022, sikurse reflektohet në tabelën në vijim:

Përshkrimi	Sasia (kWh)		Diferencë në sasi	Diferencë në %
	2023	2022	2023-2022	2023-2022
Jo Familjare	1,360,226,514	1,332,357,733	27,868,780	2.1%
Familjare	3,115,466,152	3,071,883,298	43,582,854	1.4%
Total	4,475,692,666	4,404,241,031	71,451,635	1.6%

Përshkrimi	Te ardhura (Lek)		Diferencë në lek	Diferencë në %
	2023	2022	2023-2022	2023-2022
Jo Familjare	18,601,626,709	18,200,287,643	401,339,067	2%
Familjare	29,596,998,494	29,182,934,335	414,064,158	1%
Total	48,198,625,203	47,383,221,978	815,403,225	2%

Figura 88 Sasia e energjisë së shitur dhe të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike të FSHU sh.a.

(Burimi: FSHU sh.a., OSHEE Group sh.a.)

5.3.2 Kosto e blerjes së energjisë elektrike nga "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2023

Sasia e energjisë elektrike e blerë për qëllime të mbulimit të humbjeve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, përbëhet nga:

- **96%** e sasisë është prokuruar nga HEC-et private dhe HEC Ashta;
- **4%** e sasisë është prokuruar nga prodhimi i burimeve të rinovueshme fotovoltaike.

Në grafikun në vijim paraqesim sasinë e energjisë elektrike për qëllime të mbulimit të humbjeve të rrjetit të shpërndarjes, sipas burimit, për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.





Figura 89. Struktura e sasisë së blerë për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2023-2022

(Burimi: OSSH sh.a., OSHEE Group sh.a.)

Struktura e shpenzimeve të OSSH sh.a. për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve, për vitin 2023, paraqitet si vijon:

- **96%** të shpenzimeve të blerjes e përfaqëson energjia e blerë nga HEC-et private dhe HEC Ashta
- **4%** të shpenzimeve të blerjes e përfaqëson energjia e blerë nga BRE (Centrale fotovoltaike)

Në grafikun në vijim paraqesim strukturën e shpenzimeve të blerjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Figura 90. Struktura e shpenzimeve të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2023 - 2022



(Burimi: OSSH sh.a., OSHEE Group sh.a.)

Sikurse cituar më lartë, Qeveria Shqiptare me anë të vendimit nr. 456, datë 29.6.2022 vendosi të miratojë kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike. Në këtë vendim parashikohet se sasia e tepërt mujore e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria publike e prodhimit, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve universalë, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas përcaktimeve të vendosura në pikën 4, të këtij neni, si dhe pas ezaurimit të sasisë së energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë në periudhat pararendëse i shitet Furnizuesit Publik të Tregut të Lirë, për llogari të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve, me çmimin e blerjes së energjisë së prodhuesve me përparësi hidrike. Kjo dispozitë e vendimit sipërcituar i ka mundësuar shoqërisë OSSH sh.a. mbajtjen në mënyrë të ekuilibruar të kostove të mbulimit të humbjeve të rrjetit të shpërndarjes pa u afektuar nga kostot e larta të prokurimit të tregut të lirë të cilat kanë qenë në nivele të larta përgjithësisht gjatë gjithë vitit 2023.

Gjithashtu vërehet se gjatë vitit 2023, sasia e nevojshme e energjisë për mbulimin e humbjeve nga OSSH është pëmbushur 100% nga burimet e rinovueshme të energjisë, ku peshën më të madhe të sasisë e zënë burimet hidrike si Prodhuesit me përparësi të energjisë dhe HEC Ashta me 96%, shoqëruar nga sasia e prodhuar nga centralet fortovoltaike me 4%.

5.4 Hartimi, Rishikimi dhe Miratimi i Metodologjive të llogaritjes së tarifave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

5.4.1 Metodologjia për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme për t'u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike.

Në zbatim të nenit 16, pika 8 të ligjit nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, ERE është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e "Metodologjisë së përcaktimit të detyrimit për energjinë e rinovueshme për tu paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike"

Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 377, datë 26.12.2023, ka miratuar fillimin e procedurës për miratimin e Metodologjisë mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme. ERE, në zbatim të parashikimeve të "Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe procedurave të ERE-s", në bashkëpunim me ekspertët e zyrës së konsulencës "DLA Piper Weiss – Tessbach Rechtsanwalte GmbH" ka nisur hartimin e kësaj metodologjie.

Në vijim, ERE ka kërkuar opinionin e palëve të interesit dhe është në fazën e finalizimit të konsultimeve për përfundimin dhe miratimin e kësaj metodologjie, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.4.2 Metodologjia për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX"

Shoqëria "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX" sh.a. paraqiti pranë ERE-s ''Propozimin për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX'', në cilësinë e të licencuarit si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, (NEMO), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 228, datë 17.07.2023, si dhe përgjegjësive dhe roleve të ndërmarra në zbatim të vendimmarrjeve të ERE-s, mbi Operatorin e Tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe mbi shoqërinë ALPEX.

ERE vlerësoi se metodologjia e paraqitur nuk ishte e plotë pasi tarifat duhet të mbështeten në një metodologji, e cila parashikon jo vetëm parimet e përgjithshme rregullatore, por dhe metodën mbi të cilat do të përllogariten të ardhurat e kërkuara ku mund të mbështetej Alpex për të strukturuar tarifat që do të aplikohen ndaj pjesëmarrësve të tregut.
Por gjithashtu u vlerësua se dokumenti përmbushte kriteret minimale për zhvillimin e procesit konsultativ me qëllim hartimin e një metodologjie të strukturuar qartë në të cilën duhet të evidentohen përcaktimet thelbësore që një metodologji tarifash duhet të ketë, ndaj me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 287 datë 09.10.2023 u vendos ''Fillimi procedurës për miratimin e "Metodologjisë së përcaktimit të tarifave" të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)''.
Në vijim, ERE ka kërkuar opinionin e palëve të interesit dhe është në fazën e finalizimit të konsultimeve për përfundimin dhe miratimin e metodologjisë në fjalë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.5. Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE dhe çmimet e energjisë elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2023

5.5.1 Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE

Në grafikun dhe tabelën në vijim paraqitet ecuria e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike të miratuara ndër vite nga ERE në zbatim të legjislacionit në fuqi.



Figura 91. Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike të miratuara ndër vite periudhën 2012 - 2023.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve mesatare të realizuara të shitjes së energjisë elektrike nga FSHU sh. a për klientët e furnizuar në kushtet e shërbimit universal:

Figura 92. Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për periudhën 2012 – 2023.



Nga analiza e strukturës së shitjes të shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2023, çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike i realizuar për klientët fundorë ka rezultuar pothuajse në të njëjtin nivel me atë të përllogaritur nga ERE për periudhën respektive.

5.5.2. Çmimet e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2023

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike në eurocent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për klientët jofamiljarë për vitin 2023. Sipas të dhënave të publikuara nga EuroStat, çmimi mesatar i energjisë elektrike për klientët jofamiljarë për vendet e rajonit për vitin 2023 ka rezultuar 14.85 lekë/kWh.

Figura 93. Çmimet e energjisë elektrike të klientëve jo-familjarë në vendet e rajonit për vitin 2023



(Burimi: Eurostat)

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike në eurocent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për klientët familjarë për vitin 2023. Sipas të dhënave të publikuara nga EuroStat, çmimi mesatar i energjisë elektrike për klientët familjarë për vendet e rajonit për vitin 2023 ka rezultuar 15.48 lekë/kWh.

Figura 94. Çmimet e energjisë elektrike të klientëve familjarë në vendet e rajonit për vitin 2023



(Burimi: Eurostat)

6. RREGULLIMI I SEKTORIT TË GAZIT NATYROR

6.1. Ecuria e Furnizimit me Gaz në Botë dhe Pozicioni i Strategjik i Vendit Tonë

Tregjet globale të gazit lëvizën drejt një ribalancimi gradual gjatë sezonit të ngrohjes 2022 dhe 2023, pas goditjes së furnizimit të shkaktuar nga lufta në Ukrainë qe filloi në shkurt 2022.

Çmimet e gazit në treg në tregjet kryesore të Azisë verilindore, Amerikës së Veriut dhe Evropës ranë me afër 70% midis mesit të dhjetorit dhe fundit të tremujorit të parë të 2023, ndërsa vendet e magazinimit përfunduan sezonin e ngrohjes shumë mbi mesataret e tyre pesëvjeçare. Sforcimet e reduktuara të tregut dhe vendet e ruajtjes relativisht të pajisura përpara verës janë arsye për një optimizëm të kujdesshëm për sigurinë e furnizimit. Megjithatë, kjo ndërthurje e faktorëve nuk duhet të shpërqendrojë nga masat e mëtejshme të nevojshme për të zbutur rreziqet e mundshme që mund të rinovojnë shpejt tensionet e tregut dhe paqëndrueshmërinë e çmimeve.

Përgjate vitit 2023 çmimet evropiane të gazit vazhduan prirjen rënëse. Çmimi mesatar tremujor i tregut spot ishte 53.32 €/MWh. Kjo përfaqëson një rënie prej 44% nga tremujori i kaluar (95.15 €/MWh), dhe një rënie prej 45% nga viti në vit (97 €/MWh).

Pavarësisht rënies së çmimeve, çmimi mesatar i tregut spot ishte 187% më i lartë krahasuar me mesataren e tremujorit të parë të vitit 2021.

6.2. Konsumi i Gazit Natyror

Konsumi i gazit në vendet e BE në tremujorin e parë të 2023 vazhdoi të bjerë nën vijën e trendit mesatar pesëvjeçar. Megjithatë, ka pasur një rikthim 19% nga rënia ekstreme e konsumit të gazit në tremujorin e mëparshëm. BE konsumoi gjithsej 113.2 bcm gaz në tremujorin e pare te viti 2023, ose 17,8 bcm më shumë se në tremujorin e katërt të 2022. Nga viti në vit, konsumi i gazit ra me 13%, duke ndjekur një 8% rënie nga viti në vit krahasuar me tremujoret respektiv te mëparshëm.



Figura 95. Konsumi i gazit në BE

Burimi: Eurostat



Figura 96. Ndryshimi nga viti në vit në konsumin e gazit të BE-së në çdo tremujor ne (%)

Në tremujorin e parë të 2023, të gjitha shtetet anëtare të BE-së, përveç Maltës, kanë treguar një rënie të konsumit të gazit nga viti në vit. Rënia me e madhe e konsumit është vërejtur në Greqi (-34%) dhe Lituani (-31%), e ndjekur nga Estonia (-28%), Bullgaria (-26%) dhe Finlanda (-24%).

Reduktim i konsiderueshëm i konsumit është regjistruar edhe në Austri dhe Hungari me një rënie prej 23%, si dhe në Itali, Çeki dhe Sllovakia me një rënie prej 19%.



Figura 97. Ndryshimi nga viti në vit në konsumin e gazit në tremujorin e parë të 2023

Burimi: Eurostat

6.3. Prodhimi i Gazit Natyror në Bashkimin Europian

Prodhuesi më i madh i gazit në BE edhe për vitin 2023 mbeti Holanda me një prodhim total tremujor rreth 4 bcm, me një rënie prej 5%. Rumania ishte prodhuesi i dyte më e madh me nje prodhim 2.4 bcm e ndjekur nga Polonia 1.4 bcm dhe Gjermania 1 bcm.

Prodhimi i gazit natyror në të gjitha Shtetet Anëtare te BE prodhuese te gazit ra me përjashtim të Hungarisë, ku prodhimi u rrit me 10%.



Figura 98. Prodhimi mujor i gazit në BE

Burimi: Eurostat.

6.4. Eksporti dhe Importi i Gazit natyror me Tubacione

Eksporti total i gazit nëpërmjet tubacionit në vendet e BE-së ka pësuar renie prej 32% rnga vitet e mëparshëm. Norvegjia mbeti eksportuesi më i madh i gazit në BE me një pjesë prej 53% te eksportit te realizuar (21,7 bcm), nga 47% në të kaluarën. Eksportuesi i dytë më i madh në BE u bë Afrika e Veriut (Algjeria dhe Libia) me një eksport prej 18% pjesa (7.3 bcm), e ndjekur nga Rusia (12%, 5 bcm), Mbreteria e Bashkuar (11%, 4.4 bcm) dhe Azerbajxhani (7%, 2.8 bcm).

Vëllimet e eksportit të gazsjellësve u ulën nga të gjitha burimet e gazsjellësve (Mbreteria e Bashkuar -24%, Rusia -20%-, Afrika e Veriut, - 17%, Azerbajxhani - 6%), me përjashtim të Norvegjisë, e cila e rriti atë në mënyrë margjinale me 1% tremujor më tremujor. Pjesa e importit të Rusisë u tkurr më tej në 12% nga 14% në vitin e mëparshëm.

6.5. Importet e LNG-së

Eksporti i përgjithshëm bruto ne BE i LNG-së ishte 30 bcm, me një rritje prej 12% nga viti në vit. Pjesa e LNG në importin total të gazit të BE-së u rrit në 42% nga 33% një vit më parë.



Figura 99. Skenarët e ofertës globale të LNG kundrejt kërkesës për vitet 2023-2024

SHBA mbeti furnizuesi më i madh i BE-së me LNG me 41.5% (12.5 bcm). Rusia u rendit e dyta (19%, 5.7 bcm) dhe Katari eksportuesi i tretë më i madh (12%, 3.7 bcm).

6.6. Çmimet e gazit me shumicë

Çmimet ne tregun spot evropian (TTF-ditë përpara) vazhduan prirjen e tyre rënëse dhe kulmi historik arriti në gusht 2022. Çmimi mesatar tremujor i spotit ishte 53,32 €/MWh, që përfaqëson një rënie prej 44% nga çmimi i mëparshëm tremujor (95.15 €/MWh), një rënie prej 45% nga viti në vit (97 €/MWh) dhe 73% rënie krahasuar me kulmin (198.24 €/MWh) në tremujorin e tretë të 2022. Megjithatë, çmimi mesatar spot ishte ende 187% më i lartë krahasuar me mesataren e tremujorit të parë të 2021.

Kontratat Forward ndoqën nga afër çmimin spot. Ato treguan një rritje të lehtë . Cmimi ne kontratat mesatare të tremujorit të parë ishte 0,76 €/MWh mbi çmimin spot, ndërsa dy tremujorët e ardhshëm dhe ato të një viti më parë kontratat u shitën përkatësisht me prime 1,88 €/MWh dhe 1,95 €/MWh.

6.7. Çmimet e gazit me pakicë.

Çmimet mesatare mujore të shitjes me pakicë të gazit për konsumatorët familjarë u ulën në mënyrë të qëndrueshme gjatë tremujorit të parë të 2023 nga maja historike prej 17,57 Eurocent/KWh në shtator 2022 në 13,27 Eurocent/KWh në mars 2023, pra e thënë ndryshe një rënie prej 17%. Niveli mesatar i çmimeve ishte ende 15% më i lartë krahasuar me tremujorin e parë të 2022, dhe 85% mbi nivelet historike.

6.8. GAZSJELLËSI TRANS ADRIATIK (TAP) – GREQI, SHQIPËRI, ITALI

6.8.1. Aksionerët e Kompanisë TAP

Gjatë vitit 2023 nuk kemi patur ndryshime aksionerësh, për këtë janë njoftuar të gjitha palët e interesuara përfshi edhe tre Autoritetet Kombëtare, ajo Greke, Italiane dhe Shqiptare.

Tashmë aksionerët e TAP AG janë: SOCAR (Azerbajxhan) me 20%, BP(Angli) me 20%, SNAM S.p.A (Itali) me 20%, Fluxys (Belgjikë) me 19%, Enagas (Spanja) me 16% dhe Axpo (Zvicerane) me 5%.

6.8.2. Veprimtaria e TAP gjatë vitit 2023

Gjatë vitit kalendarik 2023, në përputhje me dispozitat e Vendimit të ERE-s Nr. 15, datë 31 janar 2019, i ndryshuar, TAP ka realizuar veprimtarinë e evidentuar më poshtë.

TAP ka paraqitur në ERE pasqyrat financiare (Pasqyrën e Pozicionit Financiar; Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurat e Tjera gjithë-përfshirëse; shënimet shpjeguese të Pasqyrës së Flukseve Monetare) për vitin 2022.

TAP ka paraqitur në ERE çertifikatat e sigurimit në vlerën 10,000,000 dollarë amerikanë - për Detyrimet e Përgjithshme ndaj Palëve të Treta, të vlefshme nga data 15 nëntor 2022 deri në prill 2024 dhe me nr. 15/0101/017968, me limit detyrimi prej 10 milionë dollarë, lëshuar nga SIGAL UNIQA Group Austria Sha dhe me të Siguruar Shtesë Entin Rregullator të Energjise. Çertifikata është siguruar në gjuhën shqipe dhe angleze.

Çertifikata e sigurimit është një detyrim i përsëritur që TAP-i duhet ta përmbushë gjatë gjithë kohëzgjatjes së vlefshmërisë së Licencës së tij të Transmetimit. Ky detyrim është përcaktuar si ***periodik*** në Liçencën e Transmetimit nëpërmjet ndryshimit në Liçencën e Transmetimit në Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 120, datë 11.05.2021.

Në dt. 14 shkurt 2023, TAP i ka dorëzuar ERE-s politikën e tij të konfidencialitetit në përputhje me nenin 16.4 të Liçencës së Transmetimit dhe ka informuar ERE-n për përmbushjen e detyrimeve të saj nëpërmjet Programit të Përputhshmërisë Rregullatore.

TAP ka njoftuar edhe ERE-n për ndryshimet në strukturën aksionare të TAP-it, sipas parashikimeve të nenit 8 të Licencës së Transmetimit, pra largimin e AXPO-së si aksionar i TAP-it dhe ndryshimet e mëpasshme në Statut.

Gjithashtu, TAP ka njoftuar ERE-n se faza e parë detyruese e Testimit të Tregut ka përfunduar dhe se ofertat detyruese që TAP ka marrë gjatë periudhës së dorëzimit të ofertave në janar 2023 i kanë kaluar testet e qëndrueshmërisë ekonomike të TAP, SRG dhe DESFA, sipas Projekt propozimit për Testimin e Tregut 2021. Mbi këtë bazë, TAP vazhdoi me nivelin e parë të zgjerimit, siç përfshihet në Projektpropozimin për Fazën e parë Detyruese të Testimit të Tregut 2021.

6.8.3. Rishikimi i Kodit të rrjetit nga TAP dhe Bashkëpunimi me Rregullatorët

Pas përfundimit të konsultimit publik për propozimin e rishikimit të Kodit të Rrjetit, TAP ka marrë miratimin për rishikimin e dëshiruar nga Rregullatorët e perfshirë në këtë proces respektivisht Rregullatori Shqiptar, Italian dhe Grek dhe në prill 2022 publikoi një version të ri të Kodit të Rrjetit të TAP-it.

Në funksion të detyrimeve të TAP-it që rrjedhin nga vetë Kodi i Rrjetit, TAP ka vazhduar me organizimin e një konsultimi të ri publik, i cili u hap më 20 dhjetor 2022 duke iu referuar procedurave të menaxhimit të mbingarkesës dhe afatit kohor për tenderat për blerjen e gazit për operacione tregtare.

Në rishikimin aktual synohet të zbatohen detyrimet për TAP- in në lidhje me procedurat afatshkurtra të menaxhimit të mbingarkesës, si dhe të integrohen kërkesat për tenderimin lidhur me prokurimin e gazit operacional. TAP ka marrë miratimin për Kodin e përditësuar të Rrjetit TAP, duke përfshirë procedurën e menaxhimit të mbingarkesës "Përdore ose humbe" të Ditës në Avancë (FDA UIOLI) deri në datën 31 mars 2023, nga të tre Rregullatoret, nëpërmjet vendimit të tyre të përbashkët të miratimit për përditësimin e Kodit të Rrjetit TAP.

Me të njëjtin vendim miratimi, Rregullatoret i kanë dhënë TAP-it përjashtimin nga dispozitat e Rregullores së Këshillit 2022/2576 për rritjen e solidaritetit nëpërmjet koordinimit më të mirë të blerjeve të gazit, standardeve të besueshme të çmimeve dhe shkëmbimeve të gazit përtej kufijve.



Figura 100. Vendosja e TAP në hartë

TAP ka filluar zbatimin e FDA UIOLI nga data 1 prill 2023, (me një periudhë monitorimi që zgjati deri më 30 shtator 2023, fundi i vitit të gazit), për të vlerësuar nëse ndodh mbingarkesë në tubacionin e TAP-it. Në rastet e identifikimit te mbingarkesës, TAP vazhdon zbatimin e një mase të tillë mbingarkese dhe kufizimin e nominimeve të transportuesve në vitin e ardhshëm të gazit.

Nuk është evidentuar mbingarkesë në vitin e gazit 2022-2023, arsye për të cilën, për vitin e gazit 2023 – 2024, TAP-i do të vazhdojë të monitorojë veprimtarinë e transportuesve dhe, në rast se TAP-i identifikon mbingarkesë, masa e CMP-së do të zbatohet në vitin e ardhshëm të gazit.

TAP gjithashtu u ka dorëzuar Rregullatoreve respektiv Raportin e tij Vjetor të Përdorimit për procedurën afatgjatë "Përdore ose humbe" ose procedurën e Ditës në Avancë "Përdore ose humbe" në përputhje me seksionin 13(3), germat c) dhe d) të Kodit të Rrjetit të TAP-it.

TAP ka organizuar 2 Forume të Palëve të Interesit në vitin 2023, ku çështjet operacionale tregtare dhe ato në lidhje me zhvillimin e TAP-it u diskutuan me transportuesit dhe palët e regjistruara të interesit.

Në bashkërendim me Autoritetet Rregullatore, TAP-i filloi të përcaktonte një kuadër rregullator të detajuar të zbatueshëm për kërkesat për Lidhje në TAP, sipas kuadrit rregullator dhe tregtar të TAP- it. Në këtë kuadër anketa e klientëve të TAP-it iu dërgua palëve të regjistruara më 5 tetor 2023.

Përafërsisht 30% e palëve të regjistruara u përgjigjën dhe vlerësimi përfundimtar është 8.8. Numri i ankesave të parashtruara ishte zero.

Në vitin 2021, TAP nisi proçesin e Testimit të Tregut, nën mbikëqyrjen e Autoriteteve Rregullatore përfshirë ERE. Kështu, në korrik 2021, TAP nisi Testimin e Tregut, pasi në qershor 2021 u dha miratimi i Udhëzimeve për Testimin e Tregut 2021 të TAP-it nga 3 tre rregullatorët.

TAP e nisi Fazën e parë Detyruese më 14 nëntor 2022, pas miratimit të Projektpropozimit nga Rregullatoret shqiptare, greke dhe italian.

Faza e parë detyruese zgjati nga nëntori 2022 deri në mesin e shkurtit 2023 dhe rezultoi në hapin e parë të zgjerimit të TAP-it, me një rritje prej afërsisht 1.2 bcm duke filluar nga viti 2026 e në vazhdim.

Gjatë vitit 2023, TAPi ka vijuar me hartimin e një Projektpropozimi të dytë, së bashku me OST-të e tij fqinje, dhe mbi këtë bazë dhe miratimet e kërkuara nga Rregullatoret nisi Fazën e dytë Detyruese në tetor 2023, me mundësi për Ofertim Detyrues në dhjetor 2023.

Gjatë periudhës korrik-gusht 2023, palët patën mundësinë të paraqisnin të dhëna jodetyruese të kërkesës pranë TAP, SRG dhe DESFA. Për më tepër, Udhëzimet parashikojnë mundësinë e një periudhe rishikimi, e cila do të zgjasë nga 19 janari deri më 2 shkurt 2024, ku palët e interesuara do të kenë mundësinë të rishikojnë të dhënat jodetyruese të kërkesës të paraqitura tashmë pranë TAP-it dhe/ose të paraqesin të dhëna të reja jodetyruese të kërkesës në Testimin e Tregut 2023. Të dhënat jodetyruese të kërkesës do të publikohen, në mënyrë të përmbledhur, për IP, në një Raport të Vlerësimit të Kërkesës në T1 për vitin 2024.

Në përputhje me nenin 26(10) të CAM NC, TAP në bashkëpunim me OST-të fqinje, duhet të publikojë DAR-in në anglisht në faqen e tij të internetit, jo më vonë se 16 javë pas fillimit të Ankandit Vjetor të Kapaciteteve të Përvitshme. Për Testimin e Tregut 2023 dhe në mungesë të dispozitave të qarta në CAM NC, të cilat rregullojnë menaxhimin e një procesi të ri të kapacitetit rritës, ndërkohë që proçesi i mëparshëm është ende në vazhdim, Udhëzimet për Testimin e Tregut 2023 përfshinë fleksibilitet në afatin kohor për të shmangur ndërhyrjen nga një Fazë e dytë paralele Detyruese e Testimit të Tregut 2021. Nëse DAR-i identifikon kërkesën për projekte të kapaciteteve në rritje, testimi i tregut vazhdon me fazën e projektimit të koordinuar në përputhje me nenin 27(2) të CAM NC.

Sipërmarrja e përbashkët (Trans Adriatic Express Ltd.), që u formua në vitin 2022, midis EXA Infrastructure, platformës më të madhe dedikuar infrastrukturës digjitale që lidh Evropën me Amerikën e Veriut, dhe Trans Adriatic Pipeline AG (TAP), pjesë e Korridorit Jugor të Gazit që transporton gazin natyror nga Azerbajxhani në Evropë, u bë plotësisht funksionale më 30 nëntor 2023. Kjo ka mundësuar ndërlidhjen me shpejtësi të lartë të Francës, Italisë, Bullgarisë, Greqisë, Shqipërisë dhe Turqisë. TAP e ka informuar ERE-n për këtë përpjekje me dorëzimin e shkresës për informacion në shkurt 2022. Kjo përpjekje e TAP ka mundësi të jetë e dobishme për vëndin tonë pasi mund të:

- lehtësojë vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe rrjedhimisht lidhje më të mirë në treg, dhe
- zvogëlojë ndikimin social dhe mjedisor duke shfrytëzuar infrastrukturën tashmë ekzistuese, gjë që do të pakësojë ndjeshëm nevojën për punime civile për vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike.
- Në përputhje me këtë përpjekje, sipërmarrja e përbashkët (përmes EXA) ofron tashmë shërbime telekomunikimi midis Tiranës dhe Milanos, Tiranës dhe Barit dhe Tiranës dhe Selanikut për klientë të ndryshëm.

6.8.4. Ndryshimet në Liçencën e Transmetimit

Ndryshimi i parë i bërë nga ERE me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 120, datë 11.05.2021, që parashikonte detyrimin e TAP-it për të paraqitur certifikatat vjetore të sigurimit në vlerën 10,000,000 dollarë amerikanë.

Ndryshimi i dytë i bërë nga ERE lidhur me kohëzgjatjen e Licencës së Transmetimit të TAP-it, të dhënë fillimisht nga ERE për një periudhë 25-vjeçare, është zgjatur maksimumi në 30 vjet, me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 154, datë 30.06.2021.

Ndryshimi i tretë i bërë nga ERE me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 152, datë 13 qershor 2022, lidhej me pikën 2 të Licensës së Transmetimit dhe përfshinte miratimin e ERE-s për paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë në format elektronik dhe zgjatjen e afatit të dorëzimit deri në korrik 2024.

6.8.5. Përmbushja e detyrimit për informimin e klientëve dhe marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit

Në përputhje me Rregulloren REMIT dhe Rregulloren Zbatuese REMIT, në vitin 2023, TAP ka publikuar në faqen e tij dhe në Platformën e Transparencës ENTSOG (gjashtë) mesazhe Urgjente të Tregut (UMM) që e informojnë tregun mbi disponueshmërinë e kapaciteteve në gazsjellësin TAP, ofertën e produkteve të reja dhe rezultatet e Fazës së parë Detyruese të Testimit të Tregut 2021.

TAP-i ka ngarkuar vazhdimisht informacione operacionale mbi ENTSOG TP, si kapacitetet e disponueshme, të rezervuara dhe teknike, ndërprerjet e planifikuara të kapacitetit të qëndrueshëm dhe ndërprerjet e planifikuara të kapacitetit të ndërprerë, si dhe informacionet tarifore.

TAP-i ka publikuar edhe planin e tij vjetor të mirëmbajtjes në përputhje me afatin e vendosur nga Rregullorja 715/2009 deri më 15 nëntor 2023. TAP-i vazhdon të dërgojë të dhëna operacionale të përmbledhura në ENTSOG për arsye transparence, ose çdo ditë ose çdo orë.

Për më tepër, për të siguruar ndërlidhjen e mirë të sistemeve, cilësinë e besueshme të shërbimeve dhe shkëmbimin ndërveprues të të dhënave, TAP-i zbatoi sistemin e komunikimit Edig@s si një zgjidhje të përbashkët të shkëmbimit të të dhënave me OST-të e tij fqinje, sipas detyrimeve të TAP- it që rrjedhin nga Rregullorja e Komisionit (BE) 2015/ 703, datë 30 prill 2015, për vendosjen e një kodi rrjeti mbi rregullat e ndërveprimit dhe shkëmbimit të të dhënave **(*BE INT&DE NC***) dhe Marrëveshjet e nënshkruara të Interkoneksionit (***IA***) me OST-të fqinje të TAP-it

TAP-i ka siguruar komunikim të vazhdueshëm dhe të besueshëm me palët dhe transportuesit e tij të regjistruar, në kohën e duhur, sipas parashikimeve të Kodit të Rrjetit të TAP-it, nëpërmjet sistemeve të dedikuara TIK dhe aksesit në Platformën Elektronike të të Dhënave (***EDP***).

Sipas seksionit 3.1.e të Kodit të Rrjetit të TAP-it, të gjitha palëve të regjistruara u kërkohet që kur regjistrohen në TAP të kryejnë një test komunikimi, si kusht *sine qua non* për regjistrimin e tyre të suksesshëm në TAP dhe rezervimin e ardhshëm të kapaciteteve në sistemin e transmetimit të gazit natyror të TAP-it.

Për më tepër, TAP-i publikon informacionin përkatës në lidhje me nominimet, rinominimet, ndërprerjet, alokimet, flukset aktuale fizike, ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara në Platformën e Transparencës ENTSOG, që është një platformë gjerësisht dhe virtualisht e aksesueshme pa pagesë. Për më tepër, transportuesit e TAP-it kanë akses në platformën elektronike publike dhe private të të dhënave të TAP-it.

Ndërsa platforma publike tregon informacion të përgjithshëm dhe të përmbledhur mbi nominimet, rinominimet, flukset fizike për çdo IP, aksesi në EDP-në private jepet në bazë të regjistrimit të suksesshëm në TAP dhe përmban informacione të ndjeshme tregtare dhe individuale për çdo dërgues. Prandaj, çdo dërguesi i caktohet një emër përdoruesi dhe një fjalëkalim, në bazë të të cilave ai mund të aksesojë informacionin e ndjeshëm tregtar në lidhje me veprimtarinë e tij të transportit me TAP-in. Informacioni mbi EDP-në private ndahet për çdo dërgues.

Për momentin, TAP-i publikon çdo ditë në ENTSOG TP dhe në EDP-në e TAP-it konsumin e gazit si lëndë djegëse në Stacionin e Kompresorit Fier ASC03.

Për të siguruar informacion të menjëhershëm dhe komunikim në kohë reale me palët e përfshira (qofshin ato OST fqinje apo palë/transportues të regjistruar në TAP) dhe për të garantuar besueshmërinë e sistemit të transportit të gazit natyror të TAP-it dhe flukset e vazhdueshme, po ndërmerren veprimet e mëposhtme:

Për Mirëmbajtjen e Planifikuar, Menaxheri i Operacioneve Tregtare do t'u dërgojë OST-ve fqinje një komunikim pas bashkërendimit të brendshëm.

Nëse ndodh një ngjarje e jashtëzakonshme, TAP-i ka rënë dakord me OST-të e tij fqinje për t'i paraqitur detajet e ngjarjes me një raport të posaçëm në Excel. Gjatë vitit kalendarik 2023, në Shqipëri nuk ka pasur asnjë ngjarje të jashtëzakonshme.

6.8.6. Zhvillimet e operacioneve tregtare dhe produktet e reja

Interkonektori Greqi-Bullgari (Gazsjellësi IGB) u vu në punë më 1 tetor 2022. Që nga ai moment, TAP-i ka filluar lehtësimin e transportit fizik të gazit drejt Bullgarisë, Rumanisë dhe më gjerë nëpërmjet gazsjellësit IGB. Lista e përdoruesve të TAP-it mund të gjendet në faqen e internetit të TAP-it, ajo perditesohet rregullisht.

Pas ndryshimeve në Kodin e Rrjetit të TAP-it, si dhe fillimit të operacioneve tregtare të IP Komotini, është zgjeruar portofoli i produkteve të ofruara të TAP-it, për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të mjediseve në ndryshim të tregut dhe transportuesve. Kështu, shumëllojshmëria e produkteve të ofruara nga TAP-i është rritur: Kapaciteti i qëndrueshëm dhe i ndërprerë me drejtim përpara; Kapaciteti virtual në hyrje; dhe Kapaciteti tregtar me drejtim të kundërt si produkt i gjurmës. Duke ofruar një gamë kaq të madhe produktesh, TAP-i po kontribuon në integrimin e tregut.

Pas një Konsultimi Publik të zhvilluar në mars 2022 dhe me miratimin e mëpaseshëm nga Rregullatoret greke, italiane dhe shqiptare për ndryshimet në Kodin e Rrjetit të TAP-it, që nga data 14 prill 2022, TAP-i filloi të ofrojë në Nea Mesimvria IP një produkt me Kapacitet Virtual në Hyrje (si Kapaciteti i ndërprerë me drejtim përpara i ditës në avancë). Në këtë mënyrë, u shtua një pikë e re (virtuale) hyrëse në gazsjellësin TAP për të dhënë një fluks me drejtim përpara nga Nea Mesimvria në Melendugno dhe me fluks me drejtim të kundërt nga Nea Mesimvria në Komotini (Gjurma Tregtare e Kundërt 3, *CRF 3*), duke përmirësuar integrimin e tregut.

Për më tepër, nga data 1 tetor 2022, në IP Komotini, TAP-i ofron në platformën PRISMA këto produkte me kapacitet:

- Kapaciteti i qëndrueshëm me drejtim përpara në dalje.
- Kapaciteti tregtar me drejtim të kundërt (Gjurma 2: Melendugno – Komotini dhe Gjurma 3: Nea Mesimvria – Komotini).
- Hyrja virtuale e Komotinit (për fluksin me drejtim përpara në Nea Mesimvria ose Melendugno).

Deri në fund të vitit 2023, TAP-i ka finalizuar konceptet për zbatimin e produktit Brenda Ditës në TAP, pas bashkërendimit me Autoritetet Rregullatore, si një mjet fleksibiliteti ofruar për transportuesit dhe OST-të fqinje në Greqi, Itali dhe Bullgari. Në T1 të 2024-ës, TAP-i planifikon të zhvillojë një Konsultim Publik dhe t'ia nënshtrojë produktin e ri Brenda Ditës reagimeve nga tregu. Në Raportin Operacional Vjetor për vitin 2024, TAP-i do ta informojë ERE-n për statusin e zbatimit të produktit të ri.

Për të vënë në dispozicion të tregut produktet e kapacitetit, TAP-i po zhvillon ankandet e kapaciteteve në përputhje me Kalendarin e Ankandeve të ENTSOG në Platformën e Rezervimeve të Kapacitetit PRISMA.

Ndërmjet datës së operacioneve tregtare të TAP-it dhe datës 31 dhjetor 2023, TAP-i zhvilloi ankandet e mëposhtme - për rezervimin e kapaciteteve tregtare të qëndrueshme me drejtim përpara dhe të ndërprera me drejtim të kundërt në IP Kipoi, IP Komotini, IP Melendugno dhe IP Nea Mesimvria:

- 7515 ankande të ditës në avancë;

- 212 ankande mujore;
- 178 ankande tremujore;
- ankand 9-vjeçar.

Kështu, deri në fund të vitit 2023, TAP-i ka transportuar gjithsej 29.37 bcma nga kufiri greko-turk në Kipoi, ku 25.9 bcma janë transportuar deri në Itali duke kaluar përmes Shqipërisë dhe afërsisht 2.87 bcma që kanë dalë drejt Greqisë dhe 1.73 bcma drejt Bullgarisë, sikurse tregohet më poshtë:

Nga COD (15/11/20) deri më 31 dhjetor 2023	**Gjithsej KWh**	**Gjithsej Nm^3**	**Gjithsej BCMA**
Pika hyrëse e TAP (Kipoi)	344,746,893,269	29,372,582,610	29.37
Pika dalëse e TAPt (Nea Mesimvria - Greqi)	33,651,439,365	2,868,977,401	2.87
Pika dalëse e TAP(Komotini – IGB)	20,294,983,310	1,730,946,066	1.73
Pika dalëse e TAP-it (Melendugno - Itali) duke kaluar transit përmes Shqipërisë	287,673,713,593	24,540,814,317	25.90

Figura 101. Krahasimi i vëllimit të gazit natyror të transmetuar përmes Shqipërisë në vitin 2023 me vëllimin e transmetuar në vitin 2022.



Për sa i përket ruajtjes së të dhënave të matura, TAP-i e ruan informacionin e matjeve ditore duke përdorur sistemin SCADA dhe në sistemin e tij të brendshëm Sharepoint.

Për të dhënë një panoramë të plotë, duket që nga fillimi i operimit të tij më 15 nëntor 2020, falë besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së vazhdueshme të infrastrukturës së TAP-it, janë përpunuar menjëherë nominimet e transportuesve të TAP-it në tubacionin TAP dhe janë siguruar me sukses dërgesat e gazit në Pikat e Interkoneksionit me sistemin kombëtar të transmetimit në Itali dhe Greqi (rrjetet SRG dhe DESFA) dhe me Interkonektorin Greqi-Bullgari (IGB në Komotini).

Besueshmëria e shërbimeve të TAP-it lidhet edhe me komunikimin e ngushtë me transportuesit e tij, që ndërlidhin OST-të dhe autoritetet rregullatore kombëtare në Shqipëri,

6.8.7. TAP një projekt strategjik për Shqipërinë dhe Europën Jug-Lindore

TAP është pjesa Europiane dhe pjesa kryesore e Korridorit Jugor të Gazit, një projekt i rëndësishëm nga ana strategjike dhe ekonomike për BE dhe Komunitetin e Energjisë.

TAP është i domosdoshëm për të siguruar akses të besueshëm tek një burim i ri i gazit natyror nga Deti Kaspik dhe në një rrugë të re. TAP forcon diversifikimin e burimeve dhe rrugëve të furnizimit dhe mundëson gazifikimin e Europës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor, përfshirë gazifikimin e vendit tonë. TAP është prezent në mënyrë aktive në krijimin dhe funksionimin e tregut Shqiptar të gazit.

Ndër të tjera, TAP mbështet synimet e BE për tu bërë neutral ndaj klimës deri ne vitin 2050 dhe nxit arritjen e synimeve të dekarbonizimit të BE dhe Komunitetit të Energjisë në mënyrë të veçantë TAP lejon përdorimin e mëtejshëm të gazit (natyror, të rinovueshëm, ose dekarbonizuar) duke zëvendësuar karburantet më të ndotura si qymyri, nafta/benzina dhe vajërave të rënda në transport, sektorët e ngrohjes dhe gjenerimit të energjisë, të përdorura më tepër në Europën Jug-lindore dhe Ballkanin Perëndimor.

Gazsjellësi TAP është projektuar për të dyfishuar kapacitetin e tij deri në 20 Miliard NM^3në vit (deri në 20 bcm / në vit) dhe për ti dhënë mundësi çdo pale të interesuar të paraqesë një kërkesë në lidhje me gazsjellësin TAP, për sa kohë perputhet me kushtet teknike dhe rregullatore nga Opinioni Përfundimtar i Përbashkët.

Gazsjellësi TAP është futur në periudhën e Market Testit për rritjen e kapacitetit në 20 miliard NM^3 /vit(bcm/vit) dhe tani është faza e konsultimit publik.

Në vijim të testimit të tregut të vitit 2021, gjatë fazës jodetyruese të shprehjes së interesit për vitin 2022, TAP ka marrë një interes të konsiderueshëm për kërkesat për kapacitet dhe lidhje në Shqipëri

TAP do të lehtësojë ndërlidhjen më të madhe midis vendeve në rajonin e Europës Jug Lindore dhe krijimin e një tregu rajonal të gazit plotësisht të integruar me Tregun Europian.

Nëpërmjet këtij projekti vëndi jonë i jepet mundësia e krijimit të një nyje të domosdoshme për rajonin sepse jep mundësinë edhe të ruajtjes nëntokësore të gazit si dhe një terminal të gazit të lëngët LNG.



Figura 102. Zgjerimi i kapacitetit të projektit TAP.

6.9. Vendimet e Miratuara nga ERE gjatë vitit 2023 për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e gazit natyror.

Vendim nr. 115, datë 30.03.2023 "Mbi miratimin e një ndryshimi në "Kodin e Rrjetit Tap" propozuar nga Tap Ag"

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, neneve 13, 15, pika 1, gërma "a", 16, pika 24 dhe nenit 108 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e gazit natyror" i ndryshuar, dispozitave të "Opinionit Përfundimtar të Përbashkët" të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përjashtimit të TAP AG, datë 06 Qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC ("Opinioni Përfundimtar i Përbashkët"), të Opinionit 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 Maj 2013, si dhe të neneve 15 dhe 26 të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë l7.06.2016, Bordi i ERE-s me anë të këtij vendimi ka vendosur të miratojë ndryshimin e propozuar nga TAP AG cilësuar si Aneks A, në "Kodin e rrjetit TAP" dhe ndryshimet e cilësuara si ANEKS B. Versioni në gjuhën anglisht ka përparësi nga varianti i gjuhet Shqip ne interpretim nga palët.

Vendimi nr. 133, datë 07.04.2023 mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 355, datë 28.12.2022 "Mbi miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së "Albgaz" sh.a.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 47, pika 2, të ligjit nr. 102 /2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe proçedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.04.2023, vendosi, të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 355, datë 28.12.2023 "Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së "ALBGAZ" sh.a.

Vendimi nr. 184, datë 29.05.2023 mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE -s nr. 187, datë 10.11.2017, "Për licencimin e shoqërisë albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror", i ndryshuar

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 80 të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, vendosi të ndryshojë pikën 1 të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar, si vijon: "Të licencojë shoqërinë "Albgaz" sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.08.2023, të depozitojë Certifikatën e Sigurimit.".

Vendimi nr. 185, datë 29.05.2023 mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE -s nr. 188 datë 10.11.2017, "Për licencimin e shoqërisë albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror", i ndryshuar

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 80 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, vendosi: Të ndryshojë pikën 1 të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, i ndryshuar, si vijon: "Të licencojë shoqërinë "Albgaz" sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.08.2023, të depozitojë në ERE Certifikatën e Sigurimit."

Vendim nr. 212, datë 27.06.2023 "Mbi miratimin e "Udhëzuesit për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik"

Në zbatim të Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 13 Korrikut 2009; Direktivën (BE) 2019/692 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 17 Prillit 2019; Rregulloren e (BE) 2017/459 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 16 Marsit 2017 (CAM NC); Rregulloren 2019/942/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 5 Qershorit 2019; Vendimin e Komisionit Evropian të 16 Majit 2013; Rregulloren 715/2009/Ke të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 13 korrik 2009; Paragrafin 4.1.7 të Opinionit të Përbashkët, ku TAP AG duhet rregullisht (të paktën çdo dy vjet) të kryejë një Testim Tregu me qëllim që t'u ofrojë të gjitha palëve të interesuara kapacitetet shtesë derisa të arrihet mundësia maksimale e zgjerimit të tubacionit. Testimi i Tregut, i referuar në paragrafin e mëparshëm, duhet të kryhet në përputhje me Udhëzimet e miratuara bashkarisht nga Autoritetet Rregullatore të Energjisë, konkretisht Shqiptare (ERE), Greke (RAE) dhe Italiane(ARERA). Në datën 16 Qershor 2023, në përputhje me Paragrafin 4.1.7 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP AG u ka paraqitur Autoriteteve "Udhëzimet e vitit 2023 për Testimin e Tregut të Gazsjellësit Trans Adriatik". Autoritetet, pas analizimit të "Udhëzimit të Testimit të Tregut 2023", i cili në thelb përfshin të njëjtat parime të ndjekura për Testimin e Tregut 2021, së bashku zhvilluan një dokument që përmban vendimin e miratimit dhe arsyet përkatëse. Në vijim, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 212, datë 27.06.2023, vendosi të miratojë "Udhëzuesin për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2023".

Vendim nr. 285, datë 05.10.2023 "Mbi miratimin e "Projektpropozimit të TAP A.G., SRG dhe DESFA për procesin e rritjes të kapacitetit për vitin 2021- faza 2 detyruese"

Në datën 01 Shtator 2011, TAP AG paraqiti tek Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (ERE) "Aplikimin e Përjashtimit për Gazsjellësin Trans Adriatik", në përputhje me nenin 22 të Direktivës së Gazit 2003/55/EC. Më datë 16 Mars 2017 është miratuar Rregullorja e re e BE-së 459/2017 "Për Kodin e tarifave, TAR NC". Rregullorja e BE-së 459/2017 (në vijim: CAM NC) vendos një Kod të Rrjetit që përcakton mekanizmat e shpërndarjes së kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit si për kapacitetin ekzistues ashtu edhe për atë në rritje dhe shfuqizon Rregulloren e BE-së 984/2013. Më 11 qershor 2021 TAP AG dorëzoi tek Autoritetet "Udhëzimet për Testin e Tregut 2021 të Gazsjellësit Trans Adriatik" për procesin e rritjes së kapacitetit, i cili u miratua nga Autoritetet në nëntor 2022, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 28 të KK CAM dhe faza detyruese filloi me publikimin e Projekt Propozimit në faqen e internetit të TAP AG më 14 nëntorit 2022.
Në shtator 2023, ERE, ARERA dhe RAEWW hartuan një dokument të përbashkët " Miratimi i Projektit të TAP AG., SRG dhe DESFA për procesin e kapacitetit rritës të vitit 2021- Faza 2 detyruese (ANEKS A)", i cili është vlerësuar se është në përputhje me parimet e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, Udhëzuesit të Testit të Tregut dhe të CAM NC si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar. Në vijim, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 285, datë 05.10.2023, vendosi të miratojë dokumentin e përbashkët te dakortësuar me rregullatorin e Italisë (ARERA) dhe Greqisë (RAEWW) bashkëlidhur si ANEKS A.

Vendim nr. 293, datë 12.10.2023 "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria ALBGAZ sh.a"

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 293, datë 12.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për miratimin e "Planit të investimeve dhjetëvjeçar nga Shoqëria "Albgaz" sh.a.. Shoqëria "Albgaz" sh.a., në cilësinë e Operatorit të Kombinuar të gazit natyror paraqiti kërkesën për miratimin e Planit të Investimeve dhjetëvjeçar, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për Gazin Natyror në Republikën e Shqipërisë, që përmban investimet afatshkurtra e afatmesme të kompanisë. Shoqëria "Albgaz" sh.a. deklaron se parimet e ndjekura në hartimin e planeve të investimeve janë në harmoni me strategjinë kombëtare të zhvillimit të sektorit të gazit natyror, të miratuara me VKM-në nr. 87/2018 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Sektorin e Gazit (Master Planit të Sektorit të Gazit për Shqipërinë, e ndryshuar me VKM-në nr. 563, datë 04.10.2023, të parashikuara në nenin 6, gërmat "a" dhe "b" të "Rregullores për proçedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së gazit natyror".

Vendimi nr. 367, datë 15.12.2023 mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a. për vitin 2024"

Në mbështetje të neneve 13 pika 1, 16 pika 2, 17 gërma "e" dhe 33 të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, si dhe nenit 21 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, vendosi: (1) Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të bordit të ERE-s për vitin 2024, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. (2) Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë "Albgaz" sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre

sipas përcaktimeve të nenit 17, pika "e" të ligjit nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.

6.10. Situata dhe Veprimtaria e ALBGAZ sh.a. përgjatë Vitit 2023

Albgaz sh.a, është licensuar nga ERE si operator i kombinuar i gazit për transmetim dhe shperndarje. Albgaz sh.a. në përputhje me objektin e veprimtarisë së themelimit dhe më pas licensimit të tij, i cili përfshin zhvillimin dhe operimin e infrastrukturës së transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri ka zhvilluar aktivitetin përgjate vitit 2023. Ndër të tjera Albgaz sh.a., përballet me disa sfida kryesore:

- Mobilizimin e fondeve dhe gjetjen e burimeve financiare për zhvillimin e projekteve të infrastrukturës;
- Përmirësimi i infrastrukturës aktuale të gazit natyror në Shqipëri, e cila është tejet e amortizuar, rehabilitimi i të cilës kërkon investime te konsiderueshme.
- Ristrukturimi dhe përshtatja e modelit organizativ dhe burimeve njerëzore; etj

Albgaz sh.a, që nga momenti i krijimit, mori detyren e zhvillimit të mëtejshëm të proceseve në përputhje me objektivat dhe strategjitë e përcaktuara, kësisoj një nga detyrimet ishte edhe përmbushja e angazhimeve ndaj shoqërisë TAP AG. Për këtë qëllim, u krijua shoqëria "Albanian Gas Service" sh.a me objekt të veprimtarisë realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së gazsjellësit TAP. Kjo u bë e mundur nëpërmjet partneritetit me shoqërinë italiane SNAM S.p.A, një shoqëri lider në fushën e infrastrukturës së gazit natyror dhe njëkohësisht aksionar i shoqërisë TAP AG. Gjithashtu, në funksion të realizimit të detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjen e Mirëmbajtjes, janë financuar nga TAP AG dhe realizuar nga "Albgaz" sh.a, Qendra e Mirëmbajtjes në Korçë dhe Qendra e Mirëmbajtjes në Fier. Të dyja këto qendra tashmë funksionojnë në përputhje me standartet më të larta të sektorit të përcaktuara nga ana e TAP. Albgaz sh.a është aksionari mazhoritar në Shoqërinë "Albanian Gas Service" sh.a, zotërues i 75% të aksioneve dhe rrjedhimisht përfitues nga fitimet e shpërndara çdo vit në formën e dividentit duke zbutur dhe ndikuar në bilancin e shoqërisë.

Në përputhje me kushtet e tregut, Albgaz sh.a ka klient të vetëm për ofrimin e shërbimit të transmetimit të gazit natyror shoqërinë Albpetrol sh.a, e cila duke filluar me pandeminë COVID-19 uli në mënyrë të ndjeshme prodhimin e naftës dhe rrjedhimisht edhe sasitë e gazit shoqërues për transmetim, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe të ardhurat nga ky aktivitet. Megjithatë, Albgaz ka vijuar të mbajë në funksion linjat e transmetimit për nevojat e Albpetrol.

6.11. Zhvillimet e fundit në sektorin e gazit

Në prizmin e zhvillimeve të fundit dhe prioriteteve të shpalluara të Qeverisë së Shqipërisë, përgjatë vitit 2023, përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndërtimin e një tubacioni të gazit natyror nga Terminali i Vlorës në Fier, Albgaz sh.a mori në dorëzim dokumentacionin final të projektit WB20-ALB-ENE-04 "Projekti i detajuar dhe dokumentat e tenderit" për gazsjellësin Fier-Vlorë, të financuar nga WBIF.
Inicimin e ndryshimit të ***VKM nr.87/2018*** *"Plani i zhvillimit te sektorit te gazit natyror në Shqiperi dhe Identifikimi i Projekteve Prioritare"*, ndryshim i cili u reflektua në ***VKM Nr. 563***

datë 04.10.2023 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.87 datë 14.02.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare",* i cili në pikën 2 të tij amendon pikën 5.6, nëndarja e parë dhe shprehet për presionin maksimal të lejuar deri në 100 bar, për sistemin e transmetimit në Shqipëri kur IAP nuk ekziston. Në përputhje me ndryshimet ligjore, ndër aktivitetet e kryera nga Albgaz ka qenë analizimi i projektit të detajuar të financuar nga WBIF dhe të dokumentave, mbi të cilat u bazua studio C&M Engineering e cila hartoi projektin e detajuar me qëllim mundësimin e realizimit të ndërtimit të këtij gazsjellësi, ne perputhje me ndryshimet e fundit ligjore.
Nga kjo analizë Albgaz bën me dije se ky projekt, pavarësisht cilësisë së hartimit nga pikëpamja inxhinierike dhe dokumentacionit shoqerues të tij, nuk adresonte disa cështje kryesore si për shembull:

- Lidhjen e rrjetit te tubacioneve shqiptare me sistemet ndërshtetërore të transmetimit të gazit rajonal dhe evropian për shkak të projektimit të këtij tubacioni për transport gazi natyror vetëm me një drejtim, nga Pika e Interkoneksionit TAP CP1 në drejtim të TEC Vlorë. Presioni i projektimit prej 55 barg i përdorur nga projektuesi pë llogaritjet hidraulike dhe konstruktive të gazsjellësit Fier-Vlorë nuk lejon adoptimin e tij si gazsjellës bi-direksional për të injektuar gaz natyror në tubacionin e TAP për shkak se presioni i punës në tubacionin e TAP është mbi 82 barg.
- Mundësinë e përdorimit të këtij gazsjellësi të ri për transportimin gazit natyror nga Vlora në drejtim të TAP, në rastin e ndërtimit të një Terminali të Gazit të Lëngshëm në portin e Vlorës si një mundësi shumë e mirë për kompensimin e nevojave të tregut rajonal dhe evropian për gaz natyror për shkak të heqjes graduale nga përdorimi i qymyreve si dhe të nevojave për të kompensuar gazin natyror të munguar nga tregu rus.
- Mundësinë e perdorimit të këtij gazsjellësi të ri për transportimin e burimeve të gjelbërta të energjisë sic është hidrogjeni për shkak të zgjidhjes konstruktive të këtij tubacioni (materialeve e pajisjeve të projektuara vetëm për gaz natyror).

Në ndryshimet ligjore, konkretisht VKM 563/2023, ndër të tjera përcakton se ne listën e prioriteteve me terma afatshkurtër shtohet nënndarja 2/1 me përmbajtje "Zhvillimi i pikës së daljes dhe rrjetit të shpërndarjes Bashkia Korçë" dhe "Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së gazit të lëngshëm natyror". Me këto ndryshime, Albgaz bën me dije se ndjek me prioritet mundësitë për realizimin e projektit të gazifikimit të qytetit të Korçës.

Albgaz vlerëson se ka të nevojshme dhe të domosdoshme, mbështetjen financiare por edhe teknike, me qëllim optimizimin dhe realizimin e projekteve dhe sipërmarrjeve tregtare. Mbështetje e tillë, do të duhet të sigurohet nëpërmjet partneritetit me kompani ndërkombëtare, me eksperiencë të zgjeruar në fushën e infrastrukturës së gazit natyror, jo vetëm sa i përket projektimit por edhe aktiviteteve pasuese sic janë operimi dhe mirëmbajtja e saj.
Bashkëpunimi me aktor të rëndësishëm ndërkombëtar do të sillte përmirësime në të gjitha aspektet e veprimtarisë duke përfshirë atë teknike, financiare sikurse përthithjen dhe sigurimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira në sektor, kjo edhe për aktivitetet pasuese të ndërtimit të infrastrukturës, sic janë operimi dhe mirëmbajtja, të cilat kërkojnë kapacitete financiare por edhe njerëzore me ekspertizë të thelluar në sektor.

6.12. Objektivat që synohen të arrihen ne sektorin e gazit

Në përmbushje të angazhimeve të ndermara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me (i) rivënien në punë të TEC-it të Vlorës, (ii) krijimin e një terminali për shpërndarjen e gazit natyror të lëngshëm si dhe (iii) ndërtimin e një tubacioni të gazit natyror nga Terminali i Vlorës në Fier, Albgaz sh.a ka vënë në dispozicion kapacitetet e saj për eksplorimin e mundësive të realizimit të projekteve. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë, sikurse faktorë të tjerë si: (i) përfundimi i ndërtimit dhe fillimi i operacioneve të TAP, (ii) situata e vështirë ndërkombëtare e furnizimit me gaz prej agresionit rus në Ukrainë, (iii) nevoja për të diversifikuar burimet e furnizmit me energji, (iv) si dhe vendosmëria e Qeverisë së Shqipërisë për të mbështetur gazifikimin e vendit, janë faktorë kryesorë të cilat krijojnë një moment te pershtatshem për zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri.

6.13. Projektet e targetuara nga ALBGAZ sh.a.

Albgaz sh.a, gjatë kësaj periudhe, ka operuar në një kohë kur gazi natyror nuk konsiderohej burim tranzitor drejt objektivit për sigurimin e energjisë së gjelbër dhe për rrjedhojë ishte jashtë agjendës evropiane, duke bërë që burimet për financimin e projekteve në fushën e transmetimit të gazit të kufizoheshin në mënyrë drastike, por sic theksuam më lart situata e vështirë ndërkombëtare e furnizimit me gaz prej agresionit rus në Ukrainë riktheu vëmendjen tek gazi natyror duke rikonsideruar atë si një burim tranzitor energjie, ky fakt lidhet ngushtësisht me nevojën tonë imediate të brendshme për diversifikim të burimeve energjitike.
Për këtë arsye, Albgaz në ndërveprim me aktorë të tjerë të konsoliduar në Evropë e më gjërë, janë angazhuar në krijimin e një hub-i rajonal në Vlorë. Synimi është bashkërendimi i përpjekjeve dhe ndarja e roleve të secilit aktor në këtë konfigurim të sektorit të gazit i cili i përgjigjet jo vetëm sfidave energjetike në rang kombëtar por edhe në rang rajonal.
Në vijim po ju rendisim sipas prioritetit projektet e paraqitura nga Albgaz sh.a., pjesë e të cilave është Albgaz, në rolin si operator i kombinuar i gazit, investitor apo si partner strategjik.

6.14. Tubacioni Fier-Vlorë-Fier (Interkoneksioni me TAP)

Shoqëria "Albgaz" sh.a., në cilësinë e përfituesit, i është vënë në disponim projekti i detajuar për linjën e transmetimit të gazit natyror Fier-Vlorë, projekt i cili është vlerësuar si prioritar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 87/2018 (Master Plani i Gazit Natyror për Shqipërinë). Në lidhje me këtë projekt, Albgaz sh.a. po merr masat e nevojshme mbi planifikimet tekniko-financiarë, sikurse edhe vlerësimin e kuadrit rregullator, në zbatim të legjislacionit në fuqi, për mundësinë e ndërtimit të tubacionit Fier-Vlorë-Fier.

Hub-i Vlorës parashikon që Terminali GNL të shërbejë si pikë furnizimi ndërmjet gazit të lëngëzuar dhe konsumatorëve. Për këtë qëllim, krahas pranisë së një konsumatori kyç siç është TEC-i i Vlorës, sasi të konsiderueshme gazi duhen të kontraktohen nga furnizues (*shippers*) nëpërmjet një tubacioni që lidh terminalin me nyjën ndërlidhëse të TAP. Për të mundësuar këtë ndërlidhje, është projektuar tubacioni Vlorë-Fier, me gjatësi rreth 46 km, dhe që do të ri-dizenjohet përsa i përket parametrave teknikë të kapacitetit transmetues, për të akomoduar optimalisht volumet e furnizimit nga FSRU-ja. Albgaz sh.a synon të zotërojë një pjesë të

rëndësishme të kuotave në tubacion dhe do të operojë këtë aset së bashku me cilindo partner të dakordësuar sipas liçencës së transmetimit, njohur dhe çertifikuar nga Enti Rregullator.

Një aset infrastrukturor i lidhur ngushtë me tubacionin është edhe Pika e Daljes në Fier. Sipas Marrëveshjes HGA, TAP do te ndërtojë dhe dorëzojë nëpërmjet "Handover Agreement" Pikën e Daljes, e projektuar për një volum prej 0.7-1.8 bcm. Ndërkohë po punohet me dizajnin e detajuar të projektit të potencimit të kësaj Pike Dalëse, në mënyrë që të akomodohen kërkesat e reja që rrjedhin nga rritja e volumit të transmetimit deri në 5 bcm/vit.

6.15. Seksioni i IAP: Fier-Kashar

Tubacioni Ionian-Adriatic, i cili mbetet nje prioritet kombetar do lidhet me TAP në nyjën ndërlidhëse në Fier do të përshkojë rreth 170 km në territorin shqiptar, për të vazhduar më tej në veri përmes Malit të Zi, Bosnjë-Hercegovinës dhe për të përfunduar në Kroaci ku lidhet me sistemit e transmetimit kroat, Plinacro. Kapaciteti do të projektohet për të transmetuar deri në 5 bcm. Parametrat teknikë janë: 32" (pol) për diametrin, 75-85 bar për presionin.

Ne perputhje me MoU e nënshkruar midis qeverive të shteteve të cilat preken nga ky tubacion, aksionerët e këtij tubacioni do të jenë 4 operatorët e transmetimit përkatës të çdo vëndi ku do të kalojë tubacioni, me kuota pronësie të barabartë, prej 25%. Aktualisht, angazhimi i secilit entitet është shprehur me anë të draftimit të Marrëveshjes Aksionare (Shareholder Agreement), e cila pritet që së shpejti të nënshkruhet, duke themeluar kështu Kompaninë Projekt "IAP".

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të nisë të projektohet seksioni Fier-Kashar, me gjatësi 84 km, dhe vlerë investimi rreth 150 Milionë Euro. Pre-FEED dhe FEED do të ndërmerren në 2025, dhe konkludohet me komisionimin në 2030.

6.16. Seksioni i IAP: Kashar-Mali i Zi

Ky seksion përshkon një gjatësi rreth 86 km, nga Kashari në pikën kufitare me Malin e Zi. Vlera e pritshme e investimit është 165 Milionë EUR. Studimi i Fizibilitetit është kryer, ndërsa në harkun kohor përgjatë viteve 2025 deri 2026 parashikohet të kryhen Pre-FEED dhe FEED, për të konkluduar me komisionimin e asetit në vitin 2030.

6.17 Depozita nëntokesore Dumrea.

Një projekt tjetër i rëndësishëm që lidhet me infrastrukturën e gazit është ai i ndërtimit të një vend-depozitimi të gazit natyror në zonën e Dumresë, i cili është parashikuar të realizohet në dy faza, bazuar tek bashkëpunimi mes Albgaz sh.a dhe SNAM, i cili parashikohet të nisë me krijimin e një strukture të ndarë në dy vend-depozitime me kapacitet të kombinuar prej 260-280 mcm gaz, ndërsa faza e dytë parashikon zgjerimin e kësaj strukture deri në kapacitetin e 1.2 bcm, duke i dhënë kësisoj dimension rajonal.

6.18. Gazifikimi i qytetit të Korçës

Sot, qyteti i Korçës si një qytet me klimë relativisht të ftoht ngrohet kryesisht me dru zjarri dhe një pjesë e vogël me energji elektrike. Duke konsideruar faktin që tubacioni i TAP kalon 7 km larg qytetit, përbën një premisë reale për ngrohjen me gaz të qytetit. Në projektin e TAP është parashikuar që një nga pikat e lidhjes (Connection Point CP) për rrjetin në Shqipëri do të jetë në afërsi të qytetit. Më tej, ndërtimi i rrjetit të presionit të lartë nga kjo pikë CP deri në hyrje të qytetit (PRMS) është detyrim i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit OST-G.

Sistemi perspektiv i shpërndarjes së gazit do të furnizohet nga stacionet e reduktimit dhe matjes së presionit (PRMS) të cilat janë planifikuar të vendosen në afërsi të qendrave të mëdha të konsumit në Shqipëri. Për qytetin e Korçës në Masterplanin e Gazit është parashikuar që furnizimi i tij me gaz të bëhet direkt nga PRMS-të, të cilat janë planifikuar si shtesa të ardhshme të objekteve mbitokësore të TAP-it siç parashikohet në Planin Kombëtar Sektorial për projektin TAP dhe VNMS për TAP-in në Shqipëri. Së bashku me PRMS Fier dhe Kuçovë, këto janë tri pikat dalëse të TAP-it. Referuar Masterplanit te Gazit - Seksioni 24: CP3 Korçë - PRMS Pogradec, Ky seksion është rreth 35.3 km i gjatë dhe në pjesën më të madhe kalon përmes fushës së Korçës.

Në vazhdën e projektit inovativ të gazifikimit të Korçës, që do sjellë përfitime shumë planëshe për qytetin dhe komunitetin, ku Albgaz zhvilloi një takim konsultativ me aktorët dhe palët e interesuara duke përfshirë përfaqësues të bizneseve lokale, shoqërisë civile dhe industrisë me synim koordinimin drejt përmbushjes së këtij objektivi ambicioz. Në takim ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e SOCAR, liderit azer në fushën e naftës dhe gazit, që si partnerë strategjikë të Albgaz sjellin ekspertizën dhe mbështjen e nevojshme për implementimin e këtij projekti të parë në llojin e tij, konform standarteve më të larta ndërkombëtare. Ecuria optimale e realizimit të këtij projekti dhe optimizmi me të cilin ai është pritur prej grupeve të interesit dhe komunitetit dëshmojnë për vullnetin e qeverisë shqiptare karshi prioritizimit të zgjidhjeve afatgjata që garantojnë siguri energjitike dhe zhvillim të qëndrueshëm që mëton paralelisht edhe reduktimin e impaktit në mjedis.

6.19. Plani i Investimeve te ALBGAZ 2023-2032

Sherbimi i konsulences i realizuar nga konsulenti A.T. Kearney GmbH – organizační složka në kuadër të përgatitjes së *"Strategjia dhe Plani i Biznesit të kompanisë 2021-2025, përgatitja e Planit 10-vjecar të Investimeve, studim për mundësinë zhvillimit dhe përhapjes së përdorimit të gazit natyror të lëngshëm, zhvillimi i ngritjes së kapaciteteve në të gjithë sektorët"*

Në raportin e tij final në kuadër të komponentit 3 (Deliverable 5-Final Investment Plan), konsulenti ka përllogaritur edhe parashikimet për nevojat për gaz në Shqiperi, rajon dhe më gjerë.

Sipas pikës 3.2 të këtij raporti Shqiperia ka një potencial real konsumi gazi pothuaj 0.95 bcm në vitin 2030 dhe mbi 1.2 bcm në vitin 2040.

Nga perspektiva e Planit të Investimeve, komponentët kyç më kryesore janë në zonat ku ka një potencial të lartë për konsumin e gazit për të justifikuar kostot e ndërtimit për linjat e transmetimit.

Zonat e identifikuara perfshijnë:

- Rajonin e Vlorës ku konsumatori spirancë do të jetë kryesisht TEC Vlore (300 MW), e ndjekur nga TEDA Vlorë, klientë të tjerë industrial dhe bizneset e mesme dhe të vogla.
- Qytetet Durrës dhe Tiranë dhe autostrada Durrës-Tiranë ku ka një aktivitet të rëndësishëm të bizneseve dhe vecanërisht zhvillimi i prodhimit.
- Qyteti i Elbasanit me konsumator potencial gazi industrinë e përpunimit të metaleve

Vlerësimi i detajuar i nevojave për gaz natyror dhe LNG (gaz natyror të lëngëzuar) jepen në raportin "Studimi i Fizibilitetit të LNG" në kuadër të Komponentit 2.

Në kuadrin rajonal sipas projektimeve afat gjata të ENTSO-G vendet e basenit të TAP do të duhet të mbulojne 19 BCM nevoja shtesë për gaz natyror. Me daljen nga tregu të gazit natyror të furnizuar nga Rusia ky deficit mund të arrijë 57 BCM në vitin 2030.

Kjo situatë e krijuar në tregun energjitik rajonal dhe nevojat në rritje për energji ne vend solli edhe fillimin e studimeve për ngritjen e terminalit të LNG në portin e Vlorës.

Ngritja e ketij terminali do te kishte kuptim vetëm nëse ne do të ofronim infrastrukturën e nevojshme të injektimit të LNG së rigazifikuar ne tubacionin e TAP.

Projektimi dhe ndërtimi i ketij tubacioni bidireksional me presionin e duhur mundëson jo vetëm injektimin e gazit në tubacionin e TAP por njëkohësisht realizon lidhjen e rrjetit shqiptar të gazit me sistemet ndërshtetërore.

6.20. Hidrogjeni

Planifikimi i injektimit të një sasie Hidrogjeni prej jo më shume se 10% në volum në tubacion Fier-Vlorë është bërë në referencë të parametrave teknik të TAP si dhe duke marrë në konsideratë edhe studimet e shumta që janë bërë në fushën e transportimit të Hidrogjenit në rrjetin e tubacioneve të gazit natyror.

6.21. Situata Aktuale-Konteksti i Përgjithshëm në sektorin e gazit

Aktualisht, Shqipëria ka një prodhim mjaft modest të gazit natyror, trashëgon një sistem tubacionesh të vjetëruara dhe kryesisht jofunksional dhe ky rrjet nuk është ende i lidhur me TAP-in apo ndonjë rrjet tjetër rajonal të gazit natyror. Përdorimi i parë i gazit për përdorim industrial në Shqipëri daton në vitin 1963 kur vendi prodhoi vëllime të konsiderueshme të gazit natyror nga fushat e tij të gazit dhe gazit shoqërues gjatë nxjerrjes së naftës në segmentin e rrjedhës së sipërme të gazit për përdorim industrial dhe shtëpiak. Megjithatë, gjatë 30 viteve të fundit ka pasur një rënie të konsiderueshme në rrjedhën e gazit (nga 1 BCM/vit në 1982 në një minimum prej 0,01 BCM/vit në fillim të viteve 1990) për shkak të mungesës së zbulimeve të reja dhe investimeve në burimet ekzistuese. Infrastruktura lokale e gazit në Shqipëri përfshin një rrjet total tubacionesh me një gjatësi prej 498 km që lidh të gjitha fushat e gazit që kanë funksionuar më parë, shumica e të cilave për shkak të korrozionit dhe mungesës së mirëmbajtjes janë jashtë përdorimit.

Shqipëria sot, së bashku me Malin e Zi dhe Kosovën, është i vetmi vend në Evropën kontinentale që nuk është i lidhur me sistemet ndërshtetërore të transmetimit të gazit dhe ka një sistem kombëtar të shpërndarjes së gazit plotësisht të izoluar dhe të pazhvilluar.

Për zhvillimin e Sektorit të Gazit në Shqipëri si një nga sektorët më të rëndësishem të zhvillimit ekonomik dhe sigurisë energjitike të vendit, Qeveria Shqiptare ka ndërmarre hapa të rëndësishme në hartimin e legjislacionit përkatës e shoqëruar dhe me plane zhvillimi, projekte dhe investime në këtë fushë.

Me mbështetjen e BE-së dhe BERZH-it në kuadër të Investimeve për Ballkanin Perëndimor ("WBIF") Qeveria Shqiptare hartoi Masterplanin e Gazit dhe Planin e Identifikimit të Projektit ("GMP & PIP") me qellimin e zhvillimit te një sistemi të qëndrueshëm të gazit natyror që jep një kontribut të balancuar në sektorin e energjisë, duke filluar nga siguria e furnizimit me gaz natyror deri te konkurrenca dhe mbrojtja e mjedisit.

Vitet e fundit ne Shqiperi operon Gazsjellësi Trans-Adriatik (TAP), i cili transporton gaz natyror nga fusha e Shah Deniz II në Azerbajxhan, përmes Greqisë dhe Shqipërisë për në Italinë jugore dhe konsiderohet si gurthemeli i gazifikimit të Shqipërisë dhe pika kryesore e lidhjes së saj me infrastrukturën ndërkombëtare të gazit.

Veprimtaria e saj bazohet në dy dokumente kyçe:

- Marrëveshja e Qeverisë Pritëse ndërmjet TAP-it dhe Qeverisë së Shqipërisë dhe
- Vendimi i përbashkët i rregullatorëve të energjisë të Italisë, Shqipërisë dhe Greqisë për përjashtimin e palës së tretë, njohur ndryshe si "Opinion i Përbashkët Përfundimtar".

Në përputhje me Marrëveshjen e Qeverisë Pritëse, TAP është angazhuar të ndërtojë një pikë dalje, në Seman të Fierit Shqipëri dhe në përputhje me Opinionin e Përbashkët Përfundimtar TAP duhet të ndërtojë një tjetër valvul T në rrethin e Kuçovës.

Pritshmëritë e Shqipërisë janë që TAP-i do të gjenerojë efekte të tjera te tilla si zhvillimi i infrastrukturës fizike të vendit (p.sh. tubacionet dhe objektet e depozitimit nëntokësor te gazit natyror), ngritja e institucioneve të tregut të gazit dhe kapaciteteve rregullatore dhe do të kontribuojë në pranimin e perdorimit te përgjithshëm të gazit si energji dhe zgjerimin e rrjeteve urbane të gazit. *Sektori i prodhimit të energjisë dhe industrisë janë konsumatore të tjere potenciale me kapacitete per furnizimin me gaz*. Për më tepër, TAP është Operatori i parë i Pavarur i Transmetimit i certifikuar ndonjëherë në Komunitetin e Energjisë ("KE") dhe është një pikë referimi e rëndësishme për Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

6.22. Shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe rregullator

Për sa i përket legjislacionit dhe kuadrit rregullator, Shqipëria ka miratuar Traktatin e Komunitetit të Energjisë, si një nga Palët Kontraktuese të këtij traktati. Për këtë arsye, ajo ka marrë angazhime ligjërisht të detyrueshme në nivel ndërkombëtar për të miratuar dhe zbatuar legjislacionin bazë të Acquis Communautaire të BE-së në fushën e energjisë. Përveç Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Shqipëria është edhe nënshkruese e Traktatit të Kartës së Energjisë. Gjatë transpozimit të Paketës së Tretë të Energjisë ("TEP"), në vitin 2015, Shqipëria miratoi Ligjin për Sektorin e Gazit Natyror.

Legjislacioni i ri i gazit për pasoje solli edhe marrjen e masave për ndryshime të tjera ligjore për ndarjen e OST-së dhe OSSH-së së gazit dhe certifikimin rregullator të OST-së së gazit në bashkëpunim me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë

Përveç zbatimit të Ligjit për Gazin Natyror, Shqipëria është fokusuar edhe në zhvillimin institucional dhe zhvillimin e legjislacionit dytësor, te tilla si sistemet tarifore, kodet e rrjetit, rregullat e furnizimit dhe kodet e tregut. Këto lloj aktivitetesh në të ardhmen do të hedhin themelet për funksionimin e sektorit të gazit në Shqipëri.

Komuniteti i Energjisë po ndihmon vazhdimisht Shqipërinë në këtë drejtim. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme duke qenë se TAP-it iu kërkua të certifikohej plotësisht përpara se të fillonte ndërtimin e gazsjellësit sipas modelit ITO. Për më tepër, Shqipëria po forcon kapacitetet e saj administrative në lidhje me sektorin e gazit natyror me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë.

Për të zbutur këto sfida dhe për të rritur shkallen e gazifikimit te vendit, WBIF siguroi një grant për të mbështetur zhvillimin e Projektit të Detajuar dhe Dosjes së Tenderit per Projektin e Gazsjellësit Pika e Daljes Trans-Adriatik-Pipeline (TAP) në Termocentralin e Vlorës (TEC).

Masterplani i Gazit (GMP) dhe Plani i Identifikimit të Projektit, i përgatitur me mbështetjen e grantit të WBIF (WB11-ALB-ENE-01), u përfundua në vitin 2017. Analiza e dhënë në GMP Shqiptare arriti në përfundimin se *tubacioni i transmetimit që lidh TAP me TEC Vlorë është projekti i parë i investimeve prioritare (PIP 1) për gazifikimin e Shqipërisë*.

Projekti i Detajuar përfshin konkretisht ndërtimin e një gazsjellësi rreth 40 km, i cili lidh TEC-in e Vlorës me TAP-in. Gjithashtu, TEC-i i Vlorës do të konvertohet për të përdorur gaz natyror si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë elektrike në vend të naftës.

Dokumenti kryesor bazë për këtë nënprojekt është "*Studimi i Fizibilitetit duke përfshirë VNMS dhe Projektimin Paraprak për gazsjellësin Fier–Vlorë".* Ky studim për gazsjellësin nga pika e lidhjes me Gazsjellësin Trans Adriatik (TAP CP1) në Termocentralin e Vlorës (TEC) u financua nga SECO dhe u finalizua në Mars 2018 (IMPaC Offshore Engineering GMBH, anëtar i konsorciumit Roland Berger).

Projekte në vazhdim të financuara nga BE përmes WBIF dhe të mbështetura nga BERZH si IFI kryesor, përfshijnë përgatitjen e një modeli paraprak për Gazsjellësin Adriatiko-Jonian (IAP) (studimi i fizibilitetit dhe VNMS-ja u përgatit në 2014 nën kujdesin e WBIF dhe u mbështet nga BERZH si IFI kryesor), përgatitja e para-fizibilitetit për ALKOGAP qe eshte Gazsjellësi Shqipëri-Kosovë, *përgatitja e Projektimit të Detajuar për Gazsjellësin Fier-Vlorë* dhe përgatitja e Studimit të Fizibilitetit për Magazinimin Nëntokësor te gazit natyror në Dumre.

Me shkresën Nr.6429/1 date21.08.2023 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Albgaz sh.a mori dokumentacionin final të Projektit të Tubacionit Fier-Vlore në format dixhital si projekti i pare prioritar i Master Planit të Gazit për Shqiperinë miratuar me *VKM nr.87/2018* "*Plani i zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqiperi dhe Identifikimi i Projekteve Prioritare"* te financuara nga WBIF. Projekti i Detajuar i Gazsjellesit Fier-Vlore u realizua nga studio inxhinierike C&M Engineering.

Për sa shpjeguar më lart, Albgaz sh.a përballet me nevoja emergjente në përgjigje të dinamikave të fundit në kuadër të sigurisë energjetike, diversifikimit të burimeve dhe politikave

të dekarbonizimit- këto të fundit duke pranuar rolin thelbësor të gazit natyror si një "*transition fuel*" të domosdoshëm për ekonomitë në mbarë botën. Për këtë arsye, Albgaz sh.a, në ndërveprim me aktorë të tjerë të konsoliduar në Europë e më gjërë, janë angazhuar në krijimin e një hub-i rajonal në Vlorë. Synimi është bashkërendimi i përpjekjeve dhe ndarja e roleve të secilit aktor në këtë konfigurim të sektorit të gazit i cili i përgjigjet jo vetëm sfidave energjitike në rang kombëtar por edhe ato në rang rajonal.

Rrjedhimisht, për realizimin e këtyre nismave kërkohet mobilizim i vlerave monetare dhe ekspertizës nëpërmjet kapaciteteve njerëzore, të cilat Albgaz nuk mund ti disponojë nga të ardhurat nga aktiviteti i saj modest dhe në kushtet tejet të vështira të një rrjeti transmetimi jashtë funksioni dhe në mungesë të një tregu të brendshëm, gjithashtu edhe në aspektin e eksperiencës së pakët të burimeve të saj njerëzore, në një treg të hapur dhe të standardizuar sic është ai i gazit natyror.

Duke gjykuar që ky moment paraqet një mundësi të artë për maksimizimin e interesit publik, jo vetëm nëpërmjet shfrytëzimit të pozicionit gjeostrategjik të Shqipërisë por edhe për të berë të munduar zgjerimin e kapaciteteve të sigurisë energjitike nëpërmjet diversifikimit me një burim alternativ të besueshëm sic është gazi natyror, sikurse edhe partneriteti serioz me kompani ndërkombëtare me reputacion të padiskutueshëm në sektor, Albgaz mbetet i përkushtuar për të ndjekur me prioritet zbatimin e projekteve aktuale dhe mundësinë e përfshirjes në projekte të reja kombëtare dhe më gjerë.

6.23 Terminali GNL në Vlorë.

Terminali i importit të GNL në Vlorë do të shërbejë për pritjen e anijeve të dedikuara të ngarkimit dhe rigazifikimit të gazit natyror. Terminali do të furnizohet me GNL nëpërmjet Njësive Lundruese e Rigazifikuese (FSRU). FSRU është një "tanker" i madh GNL-je, që kryen operacionet e shkarkimit, rigazifikimit, depozitimit të përkohshëm. Kjo njësi lundruese ankorohet në terminal dhe është e lidhur me rrjetin e transmetimit, ku gazi i rigazifikuar injektohet për transmetim përgjatë tubacionit. FSRU-ja është rezervuar për t'u ankoruar në këtë terminal dhe do të furnizojë terminalin me deri në 5 bcm/vit. Albgaz sh.a synon të investojë në këtë vepër infrastrukturore në një përqindje të caktuar të kuotave të veprës.

6.24 Ionian Adriatic Pipeline (IAP)

6.24.1. Seksioni i IAP: Fier-Kashar

Tubacioni Ionian-Adriatic, i cili do lidhet me TAP në nyjën ndërlidhëse në Fier do të përshkojë rreth 170 km në territorin shqiptar, për të vazhduar më tej në veri përmes Malit të Zi, Bosnjë-H. dhe për të përfunduar në Kroaci ku do të lidhet me sistemit e transmetimit kroat, Plinacro. Kapaciteti do të projektohet për të transmetuar deri në 5 bcm. Parametrat teknikë janë: 32" (pol) për diametrin, 75-85 bar. Pritet rritja e kapacitetit deri në 7 bcm/vit

Aksionerët e këtij tubacioni do të jenë 4 operatorët e transmetimit përkatës të çdo vëndi ku do të kalojë tubacioni, me kuota pronësie të barabartë, prej 25%. Aktualisht, angazhimi i secilit

entitet është shprehur me anë të draftimit të Marrëveshjes Aksionare (Shareholder Agreement), e cila pritet që së shpejti të nënshkruhet, duke themeluar kështu Kompaninë Projekt "IAP".

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të nisë të projektohet seksioni Fier-Kashar, me gjatësi 84 km, dhe vlerë investimi 150 Milionë Euro. Pre-FEED dhe FEED do të ndërmerren në 2025, dhe konkludohet me komisionimin në 2030.Theksojmë se në Kashar do të jetë edhe pika e lidhjes për furnizimin me gaz të qytetit dhe rrethinat e Tiranës.Një projekt mjaft perspektiv.

6.24.2. Seksioni i IAP: Kashar-Mali i Zi

Ky seksion përshkon një gjatësi rreth 86 km, nga Kashari në pikën kufitare me Malin e Zi. Vlera e pritshme e investimit është 165 Milionë EUR. Studimi i Fizibilitetit është kryer, ndërsa në harkun kohor përgjatë viteve 2025 deri 2026 parashikohet të kryhen Pre-FEED dhe FEED, për të konkluduar me komisionimin e asetit në vitin 2030.

Depozita nëntokësore Dumre.

Një projekt tjetër i rëndësishëm që lidhet me infrastrukturën e gazit është ai i ndërtimit të një vënd-depozitimi të gazit natyror në zonën e Dumresë, i cili është parashikuar të realizohet në dy faza, bazuar tek bashkëpunimi mes Albgaz sh.a dhe SNAM, i cili parashikohet të nisë me krijimin e një strukture të ndarë në dy vënd-depozitime me kapacitet të kombinuar prej 230 m^3 /h gaz, ndërsa faza e dytë parashikon zgjerimin e kësaj strukture deri në kapacitetin e 800 m^3/h gaz duke i dhënë kësisoj dimension rajonal.Theksojmë se depozitimi i gazit natyror në periudhën e verës është një domosdoshmëri për konsumatorët gjatë periudhës së dimrit. Kripërat që ndodhen në këtë zonë janë ideale për depozitim.Ky depozitim do ti shërbejë të gjithë rajonit tonë, dhe kjo e bën edhe më të leverdishëm këtë projekt potencial.

Interkoneksioni me RMV

Projekt me rëndësi është edhe ndërlidhja ndërmjet sistemeve të transmetimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Me gjatësi rreth 60 km, ky investim do të kryhet nga ana e Albgaz sh.a. Periudha e implementimit do të zgjasë përgjatë viteve 2025 deri 2028, ku kapaciteti i pritshëm në afatgjatë pritet të shkojë në 0.3 bcm.

6.25. Objektiva për të Ardhmen në Sektorin e Gazit Natyror

Në përmbushje të angazhimeve të MIE lidhur me (i) rivënien në punë të TEC-it të Vlorës, (ii) krijimin e një terminali për shpërndarjen e gazit natyror të lëngshëm si dhe (iii) ndërtimin e një tubacioni të gazit natyror nga Terminali i Vlorës në Fier, Albgaz sh.a ka vënë në dispozicion të gjitha kapacitetet e saj për eksplorimin e mundësive të realizimit të projekteve. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë, sikurse faktorë të tjerë si: (i) përfundimi i ndërtimit dhe fillimi i operacioneve të TAP, (ii) situata e vështirë ndërkombëtare e furnizimit me gaz prej agresionit rus në Ukrainë, (iii) nevoja për të diversifikuar burimet e furnizmit me energji, (iv) si dhe vendosmëria e Qeverisë së Shqipërisë për të mbështetur gazifikimin e vendit, janë faktorë kryesorë të cilat krijojnë një momentum për zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri.

- Bashkëpunimi me Entet Rregullatore të Energjisë së shteteve fqinje, Greqi dhe Itali, si dy shtete anëtare të BE-së, për ecurinë normale të TAP. Përditësimi i të gjitha akteve nënligjore, në përputhje me rregulloret dhe marjen e vendimeve të përbashkëta të nevojshme për to, në përputhje me Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU, Komissionit të Rregullimit(EU) 2017/459 (CAM NC) dhe një sërë rregulloresh të tjera që kanë të bëjnë me transparencën, diskriminimin e palëve të treta si dhe marjen e vendimeve të përbashkëta për këtë qëllim.
- Bashkëpunimi me TAP AG dhe Entet Rregullatore të Italisë dhe Greqisë për përfundimin me sukses të Testimit të Tregut që filloj në vitin 2021, vazhdoj përgjatë vitit 2022 për zgjerimin e kapacitetit nga 10 miliard m^3/vit në 20 miliard m^3/vit. Ky testim është harmonizuar me dispozitat e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përjashtimit të TAP AG, datë 6 Qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, ('Opinioni Përfundimtar i Përbashkët') i Kodit të Tarifave të TAP [1] me Rregulloren e BE 2017/459 duke krijuar kodin e rrjetit mbi Mekanizmat e Alokimit te Kapacitetit tek sistemet e transportit te gazit ("CAM NC").
- Bashkëpunimi me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për transpozimin e ndryshimeve që po kryhen në Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU si dhe akteve të tjera në lidhje me sektorin e gazit natyror, biogazit,biometanit,hidrogjenit, përdorimit të gazit të lëngëzuar me shkallë të vogël(small scale),përdorimit të gazit metan të komprimuar(KGN) etj.

  Bashkëpunimi me Ministrinë së linjës(MEI) për rrjeti i transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit në Shqipëri si dhe mundësinë për rezervim të kapacitetit në Fier dhe në Kuçovë, Roskovec i planifikuar për pikat e hyrjes dhe të daljes.

7. MBI RAPORTIMIN E ERE NË LIDHJE ME ZBATIMIN DHE NDJEKJEN E PLOTËSIMIT TË REKOMANDIMEVE TË "REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ERE PËR VITIN 2022

ERE me vendimin nr. 351/2023, ka miratuar planin e masave për zbatimin dhe ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit. Në kuadër të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, ERE ka vijuar me përgatitjen e Kalendarit të Masave duke detajuar aktivitetet dhe Strukturat përgjegjëse për implementimin e këtyre rekomandimeve.

1. Për sa i përket rekomandimit të parë, ku është parashikuar që ERE; "*Të luajë një rol proaktiv dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët për të bërë të mundur lehtësimin e barrierave dhe nxitjen e investimeve në rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme (dielli, era dhe forma të tjera), shfrytëzimi i burimeve diellore dhe të erës do të përmirësonte ndjeshëm sigurinë energjetike të vendit duke diversifikuar burimet e energjisë dhe duke e bërë sistemin më pak të ekspozuar ndaj ndikimeve klimatike*":
ERE nëpërmjet Grupi të Punës ka nisur punën për vlerësimin e pengesave të mundshme dhe identifikimin e çështjeve që lidhen me konsumin dhe mundësitë e diversifikimit të prodhimit nga burimet e rinovueshme.

Ne perputhje me parashikimet e Ligjit nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" ERE ka draftuar dhe ka nisur proceduren per;

(i) Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme

(ii) Metodologjisë mbi përcaktimin të detyrimit për energjinë e rinovueshme

(iii) kontratat per diference per mbeshtetjen e e burimeve te rinovueshme

Te cilat jane ne proces konsultimi me palet e interesit dhe jane ne proces miratimi.

Po ashtu ne perputhje me Ligjit nr. 24/2023 eshte miratuar dhe cmimi i blerjes se energjise nga Burimet e rinovueshme fotovoltaike si dhe eshte ne proces ai i miratimit te cmimeve blerjes se energjise elektrike te burimeve eolike.

2. Për sa i përket rekomandimit të dytë, ku është parashikuar që ERE; "*Të angazhohet në miratimin në një kohë sa më të shkurtër të akteve rregullatore që dalin si detyrim pas miratimit në Kuvend të ligjit "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"*:
Sic percaktuar sa me siper ERE ka pergatitur draft aktet ligjore dhe njëkohësisht të vijojë konsultimi edhe me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, për praktikat që i përkasin (i) Draftit të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës Tip për Mbështetje, siç parashikuar në nenin 14, pika 2 të ligjit nr. 24/2023 dhe (ii) Metodologjisë së vëllimit të energjisë së kufizuar nga injektimi në rrjet, por të ruajtur në objektin e depozitimit të prodhuesve me përparësi, siç parashikuar në nenin 17, pika 5 të të njëjtit ligj.

Gjithashtu, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 377, datë 26.12.2023, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e "Metodologjisë mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme për t'u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike", e cila ka si qëllim të përcaktojë përllogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme për t'u paguar nga

konsumatorët fundorë të energjisë elektrike, sikurse përcaktuar në ligjin nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme".

3. Për sa i përket rekomandimit të tretë, ku është parashikuar që ERE; "*Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, të bashkëpunojë me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe aktorët e tjerë në draftimin e rregullores për kriteret specifike dhe procedurat për përfitimin e statusit të klientëve në nevojë të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Përditësimi e Studimit te praktikave më të mira rregullatore për adresimin e mbështetjes për kategorinë e klientëve në nevojë dhe nxjerrja e skenarëve me te aplikueshëm*":

Perfqësues të ERE kanë kontribur gjatë vitit 2023 në realizimin e studimit të Expertise France me temë "Ndikimet e rritjes së mundshme të çmimit të energjisë elektrike dhe udhëzimet për krijimin e një Plani Kombëtar të Veprimit në lidhje me zbutjen e varfërisë energjetike Ky studim ka prekur tema që lidhen me Kompensimin e energjisë në dispozicion për familjet në nevojë. Ky Raport është përpjekur të japë përmbajtjen thelbësore të Planit Kombëtar të Veprimit Kombëtar (2022-2027) në lidhje me Varfërinë e Energjisë që do të synojë përmirësimin e skemës ekzistuese drejt një skeme efektive të kompensimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Ne kete studim te konsulenteve Expertise France eshte evidenuar kontributi i vlefshëm i ERE në lidhje me veprimet e mundshme për reformimin e sistemit të varfërisë energjetike në Shqipëri. Po ashtu ERE eshte pjese e grupit te punes nderinstitucional ngritur me urdher te Kryeministrit per percaktimin e kritereve per perfitimin e statusit te Klienteve ne nevoje.

4. Për sa i përket rekomandimit të katërt, ku është parashikuar që ERE; "*Të marrë masa që numri i gjelbër të jetë funksional dhe të ketë stafin përkatës, i cili bën të mundur adresimin në kohë reale të kërkesave për informacion të konsumatorit, si dhe jep orientimet për adresimin më të shpejtë të ankesave sipas legjislacionit në fuqi. Në të njëjtën kohë, duke patur parasysh fuqinë e mediave sociale, të jetë më aktive në promovimin përmes tyre të të drejtave të konsumatorëve, sensibilizimin e tyre mbi kursimin e energjisë elektrike, broshurave informative për konsumatorin, si dhe informacione të tjera që i shërbejnë konsumatorit":*

Për sa i përket këtij rekomandimi, ERE ka vijuar punen per funksionim të numrit të gjelbër për informimin e konsumatorit dhe në vijim do të përcaktojë për çdo strukture edhe personat e ngarkuar sipas strukturave përgjegjëse për adresimin e kërkesave për informacion që vijnë përmes numrit të gjelbër të ERE që nuk lidhen me çështjet e konsumatorit. ERE në vijim do vazhdojë me fushata në rrjetet sociale për promovimin e numrit telefonik me qëllim promovimin përmes tyre të të drejtave të konsumatorëve, sensibilizimin e tyre mbi kursimin e energjisë elektrike dhe informacione të tjera që i shërbejnë konsumatorit.

Jane publikuar broshura rregullisht eshte nisur nje fushate sensibilizuese mbi kursimin e energjise me video ne web dhe rrjete sociale.

5. Për sa i përket rekomandimit të pestë, ku është parashikuar që ERE; *"Të rrisë përpjekjet për implementimin brenda vitit 2023 të platformës së krahasimit të çmimeve (Price Comparison Tool), e cila u ofron furnizuesve mundësinë e paraqitjes së çmimeve të energjisë*

elektrike për konsumatorët që zgjedhin të furnizohen nga tregu i lirë duke i dhënë mundësinë e vlerësimit në mënyrë transparente të ofertave".

ERE tashmë ka prokuruar platformën e cila është në fazën e implementimit me konsumatorët dhe furnizuesit, me qëllim garantimin efecient për shfrytëzimin e saj dhe gjithashtu është parashikuar identifikimi i nevojës për ndërhyrje në kuadrin aktual nënligjor, për vendosjen e detyrimit të përdorimit të kësaj platforme në tregun e lirë si dhe zhvillimin e fushatave promovuese mbi modalitetet e përdorimit të saj. Ndërkohë është ngritur Grupi i Punës për vlerësimin e ndërhyrjeve në kuadrin nënligjor për vendosjen e detyrimit të publikimit të të dhënave nga ana e furnizuesve në platformën e krahasimit të çmimeve. Jane kryer trajnime me strukturat e ERE si dhe me furnizuesit mbi modalitetet e përdorimit të platformës e cila tashmë është gati e pret të lancohet e të përditësohet me ofertat e furnizuesve.Aktualisht jane disa furnizues te rregjistruar ne kete platforme.

6. Për sa i përket rekomandimit të gjashtë, ku është parashikuar që ERE: *"Të vijojë kontributin e saj për bashkërendimin e punës mes rregullatorëve, TSO-ve dhe bursës për të mundësuar bashkimin e tregjeve jo vetëm ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe më tej me Maqedoninë e Veriut apo Malin e Zi"*:

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 247, datë 29.09.2022 vendosi të licencojë shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX" sh.a., në aktivitetin e operimit të tregut të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022 miratoi "*Rregullat e Tregut të Energjisë elektrike (rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes)*".

Gjatë vitit 2023, bordi i ERE-s me vendimin nr. 172/2023 vendosi fillimin e procedurës për miratimin e kërkesës së shoqërisë ALPEX sh.a., lidhur me procedurat e Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë ndërsa me vendimin nr. 228/2023 vendosi të përcaktojë shoqërinë "*Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX" sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)"*. Në vijim, me vendimin nr. 287/2023 bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për miratimin e "*Metodologjisë së përcaktimit të tarifave*" të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe me vendimin nr. 308/2023 vendosi miratimin e "*Rregullores së Alokimit në Hije të kapaciteteve (Shadoë Auction) në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri – Kosovë*".

Për sa më sipër, vlerësojmë se përmes këtyre vendimmarrjeve janë realizuar hapat paraprakë të bashkimit të tregjeve dhe njëkohësisht është vlerësuar të vijohet komunikimi ndërinstitucional për bashkërendimin e punës mes rregullatorëve të rajonit, TSO-ve dhe Bursës. Gjithashtu, së fundmi ERE ka nënshkruar një Memorandum of Understanding (MOU) me përfaqësues të Entit Rregullator të Italisë, Maqedonisë së Veriut, Greqisë mbi bashkimin e tregjeve të ditës në avancë brenda vitit 2026.

7. Për sa i përket rekomandimit të shtatë, ku është parashikuar që ERE; "*Të vijojë bashkëpunimin me Albgas sh.a., lidhur me tubacionin nga Terminali në Vlorë deri në pikën e takimit me TAP në Fier, e cila, nga njëra anë, krijon mundësinë e përshpejtimit të riparimit të TEC-it Vlorë dhe të vendosjes se tij në punë dhe, nga ana tjetër, krijon mundësinë që të injektohet gaz edhe në rrjetin e TAP-it për nevojat e rajonit"*:

Për sa i përket bashkëpunimit me shoqërinë Albgas sh.a., nëpërmjet vendimit nr. 133/2023, ERE ka ndjekur nga afër procesin për "Miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së "Albgaz" sh.a., dhe njëkohësisht ka vlerësuar të vijohet komunikimi me të gjithë aktorët e përfshirë dhe vijimin e bashkërendimit të punës me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në vijim ERE gjithashtu, ka miratuar dy vendimmarrje që lidhen me licencimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror dhe për aktivitetin e transmetimit duke konkretizuar me vendimmarrjet: (i) Vendim Nr. 184/2023 "Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, "Për licencimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror", i ndryshuar dhe (ii) Vendim nr. 185/29.05.2023 "Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, "Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror", i ndryshuar. Bordi i ERE-s me vendimin nr. 293/2023 vendosi të fillojë procedurën për miratimin e "Planit të investimeve dhjetëvjeçar nga shoqëria "Albgaz" sh.a.

8. Për sa i përket rekomandimit të tetë, ku është parashikuar që ERE; "*Në bashkëpunim me aktorët e tjerë të fushës, të ndërmarrë veprime koherente dhe me objektiva të qartë për të krijuar një treg funksional gazi, që shfrytëzon potencialin e infrastrukturës ekzistuese në vend dhe krijon bazat e tregut për planet e zhvillimit të infrastrukturës*", ERE në vijim të këtij rekomandimi ka miratuar disa vendimmarrje të rëndësishme siç janë; vendim nr. 115/2023 "Mbi miratimin e një ndryshimi në "Kodin e rrjetit TAP" dhe vendim nr. 285/2023 "Mbi miratimin e projekt propozimit të TAP A.g., SRG dhe DESFA Për procesin e rritjes të kapacitetit për vitin 2021- faza 2 detyruese". Duke pasur në konsideratë rekomandimet për sa i përket bashkëpunimit me aktorët e tjerë vlen të theksojmë se gjithashtu ERE ka ndërmarrë veprime konkrete me qëllim krijimin e një tregu funksional duke miratuar edhe Vendim e përbashkët me nr. 212/2023 mbi miratimin e "*Udhëzuesit për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik*" në bashkëpunim me Rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE. Njëkohësisht është vlerësuar vijimi i trajnimit të strukturave përgjegjëse me praktikat më të mira ndërkombëtare në integrimin e një tregu gazi operativ.

9. Për sa i përket rekomandimit të nëntë, ku është parashikuar që ERE; *"Të vijojë bashkëpunimin me Agjencinë e Efiçencës për hartimin e një strategjie të përbashkët afatmesme për adresimin e çështjeve me interes të konsumatorit sa i përket përdorimit efiçent të energjisë"*:

Nga ana e ERE-s, ka vijuar komunikimi me Agjencinë për Efiçencën e Energjisë (AEE) me qëllim organizimin e takimeve bilaterale por dhe ngritjen e Grupeve të Punës me qellim bashkërendimin e punës per arritjen e objektikvave të përbashkëta të interesit. Eshte draftuar marreveshgja e bashkepunimit nderinstitucional mes ERE dhe Agjencise se Eficiences qe do te adresoje ne plan afatgjate rakordimin e punes ne bashkepunim mes ketyre dyn institucioneve.

10. Për sa i përket rekomandimit të dhjetë, ku është parashikuar që ERE; "*Gjatë vitit 2023 të punojë për implementimin e sistemit të lëshimit, anulimit dhe tregtimit të garancive të origjinës në përputhje me standardet e BE-së"*:

ERE nëpërmjet marrëveshjes me Ofruesin e shërbimit Grexxel për regjistrin elektronik të sistemit rajonal të GO, ka statusin e vendit anëtar të regjistrit të sistemit rajonal. Ndërkohë, "Rregullorja për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019 është hartuar në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ligj ky i cili u shfuqizua në vijim me ligjin nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 64, datë 14.04.2023.

Në kuadër të këtyre ndryshimeve të ndodhura u vlerësua përcaktimi i disa rregullave të përkohshme në lidhje me dhënien e GO-ve të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, deri në miratimin nga ERE dhe hyrjen në fuqi të Rregullores së re për dhënien, transferimin apo anulimin e GO-ve, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 24/2023 (Vendimi i bordit të ERE nr. 317, datë 08.11.2023).
Me vendimin e bordit të ERE nr. 378, datë 28.12.2023, u vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e "*Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme*".
Ne po këtë prizëm kanë filluar procedurat dhe eshte kryer aplikimi për anëtarësimin e plote te ERE-s në Shoqatën Evropiane të lëshuesve të garancive të Origjinës (AIB) proces i cili do përfundojë brenda muajit maj te vitit 2024 kur do te behet dhe mbledhja e radhes e Bordit te Shoqates.

8. AKTIVITETI I ERE NË ZHVILLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKONDAR DHE NDRYSHIME TË TJERA LIGJORE TË NDODHURA GJATË VITIT 2023

8.1 Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të zbatimit te ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar

Enti Rregullator i Energjisë gjatë vitit 2023 ka vijuar punën me plotësimin e kuadrit ligjor në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, përmes miratimit të një numri të konsiderueshëm aktesh të cilat e pasurojnë edhe më tepër legjislacionin sekondar. Bordi i ERE-s gjatë këtij viti është shprehur me 406 vendimmarrje në 65 mbledhje bordi.

Vendimet e bordit të ERE, edhe këtë vit, kanë pasur objekt të tyre rishikimin apo ndryshimin e akteve të miratuara me herët, shtyrjen e afateve të përcaktuara në vendime apo akte, zgjatjen e afateve të vendimmarrjes së bordit të ERE, fillimin e procedurës apo licencimin/rinovimin e licencave të subjekteve në veprimtaritë e tregtimit, prodhimit, furnizimit të energjisë elektrike apo në veprimtaritë e tregtimit të gazit natyror, shqyrtimin e aplikimeve të shoqërisë OSSH sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni për vitin 2023 dhe FSHU sh.a., për miratimin e çmimit të shërbimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2021, miratimin e tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2023 dhe të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023 dhe periudhën 2022-2024 për të cilat ERE janë zhvilluar edhe disa seanca zyrtare publike, etj. Gjithashtu gjatë këtij viti janë zgjidhur edhe disa mosmarrëveshje ndërmjet të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror

8.2. Vendimet kryesore te ERE-s në Sektorin e Energjisë Elektrike për Vitin 2023

Vendim nr. 27, datë 16.02.2023 "Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet Prodhuesve Ekzistues me Përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023"

Në zbatim të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, e ndryshuar, formula e llogaritjes së çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi është: "Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.20 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit". Në vijim të ndryshimit të miratuar me VKM-në nr. 67, datë 08.02.2023, çmimi rezultues është mbi nivelin maksimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike të përcaktuar në gërmën "d" të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, e ndryshuar, prej 10 lekë/kWh.

Vendim nr. 30, datë 16.02.2023 "Mbi miratimin e Amendimit nr. 1 të kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit, OST sh.a. dhe KESH sh.a."

Palët kanë shprehur vullnetin e tyre për amendimin e kontratës duke e nënshkruar bashkërisht atë, për ndryshimin e kohëzgjatjes së kontratës, dhe shtrirjen e efekteve të saj deri më datë 30.06.2023, duke përcjellë kontratën në ERE. Ndryshimi i kohëzgjatjes së kontratës, vjen si pasojë e zgjatjes së periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri më datën 30.06.2023, sikurse shprehur në VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike (të ndryshuar)".

Vendim nr. 106, datë 23.03.2023 "Mbi miratimin e disa shtesave në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022"

Me miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe parashikimin e shoqërisë ALPEX sh.a. për fillimin e fazës operacionale go-live të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a., lindi nevoja për miratimin e disa shtesave në këto rregulla, me qëllim saktësimin e disa prej procedurave të parashikuara në to. Për këtë qëllim, shoqëria ALPEX sh.a. ka paraqitur në ERE disa propozime për miratimin e disa shtesave shkresa të cilat janë publikuar për konsultim në faqen e internetit të ERE. Në vijim të diskutimeve dhe marrjes së konfirmimit nga palët e interesi, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 106, datë 23.03.3023 ka miratuar shtesat nën emertimin e anekseve në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

Vendim nr. 110, datë 27.03.2023 "Mbi kërkesën e OST sh.a., për intervalin kohor 1 orë në operimin e proceseve të tregut balancues dhe nominimeve të transaksioneve tregtare"

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. në funksion të operimit në Tregun Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike ka parashtruar argumentet, kushtet si dhe vlerësimet mbi implementimin e platformës së menaxhimit të tregut për intervalin kohor 1 orë ku vlerëson se nuk mund të operohet me rezolucion 15 minuta. Shoqëria OST sh.a., ndër të tjera deklaron se në vijim të operimit me bazë orare për llogaritjen e disbalancave, për proceset në tregun balancues dhe për proceset e nominimit, ka bërë reflektimet e saj duke i përcjellë si draft propozime të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit. Gjithashtu në vijim të zhvillimeve rajonale, OST sh.a. shprehet se ka infrastrukturën e nevojshme për të vepruar si vendet e rajonit për sa i përket tregut balancues. Duke qenë se për periudhën në vijim të vitit 2023, ALPEX sh.a. pritet të fillojë operimin komercial të tregut të energjisë elektrike, Bordi i ERE-s vendosi të pranojë pjesërisht kërkesën e OST sh.a. për periudhën 1 Prill 2023 deri 1 Pril 2024, pra për një vit të operohet në tregun e balancimit të energjisë elektrike me intervalin kohorë prej 1 ore.

Vendim nr. 114, datë 27.03.2023 "Mbi miratimin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë të "Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes" (OSSH) sh.a."

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 343, datë 21.12.2022, vendosi të miratojë Kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë (ZP) të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a., duke i lënë detyrë shoqërisë që brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi të përcjellë për miratim në ERE Zyrtarin e Pajtueshmërisë, pas miratimit nga organet drejtuese të saj, e po ashtu të dokumentojë në ERE plotësimin nga Zyrtari i Pajtueshmërisë të kritereve të përcaktuara në Shtojcën 1 të Kontratës.

Vendim nr. 127, datë 07.04.2023 "Mbi miratimin e datës së fillimit të tregtimit në Bursën Shqiptare të energjisë elektrike"

Shoqëria ALPEX sh.a., ka paraqitur propozimin e saj mbi Ditën e Fillimit të tregtimit të tregut të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë (BSHE). Rezulton se Grupi i Punës dhe shoqëria ALPEX sh.a., kanë vlerësuar se kërkesat e nevojshme për fillimin e operimit të Tregut të Ditës në Avancë janë përmbushur dhe janë në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, ndaj Bordi i ERE-s vendosi të miratojë Njësisë Kohore të Tregut që i përket orës 00:00 të datës 12.04.2023, si dita e fillimit të tregtimit në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

Vendim nr. 135, datë 11.04.2023 "Mbi miratimin e Amendimit nr. 2 të Kontratës "Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a."

Palët kanë përcjellë në ERE amendimin nr. 2 të Kontratës "Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit" ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a. Duke mattë në konsideratë procesin e operimit të bursës ALPEX, amendimet e paraqitura nga palët, vlerësohen se do të mundësojnë që Kontrata të trajtohet si Kontratë OCT (Over the Counter Contract) në DAM që do zhvillojë ALPEX, ku i jep përparësi përputhjes si Urdhër Porosivë të blerësit dhe shitësit.

Vendim nr. 139, datë 14.04.2023 "Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë"

Shoqëria ALPEX sh.a., me shkresën nr. 106 prot., datë 31.03.2023, ka paraqitur një propozim për miratimin e Kufijve Minimalë dhe Maksimalë të Lejuar të Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Maximum and Minimum Price Threshold), për operimin e Jo-Bashkimit të Tregjeve, për të cilin ALPEX-i i referohet si mundësi për kryerjen e një ankandi të dytë, sipas përcaktimeve të Procedurës së Tregtimit të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e ERE-s Nr. 347/2022.

- Kufiri Maksimal i Lejuar i çmimit për Tregun e Ditës në Avancë: + 900 €/MWh.
- Kufiri Minimal i Lejuar i çmimit për Tregun e Ditës në Avancë: 0 €/MWh

Vendim nr. 173, datë 18.05.2023 "Mbi disa ndryshime në Kontratën Tip mbi verifikimin e matësave të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 164/2016"

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 70, datë 13.03.2023, vendosi fillimin e procedurës për disa ndryshime në kontratën tip mbi verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 164/2016. Këto ndryshime të kontratës TIP, lidhen me ndryshmet e mundshme ligjore sipas përcaktimeve të nenit 39 të ligjit "Për Metrologjinë".

Vendim nr. 227, datë 14.07.2023 "Mbi miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren e procedurave për Lidhjet e Reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me Rrjetin e

Transmetimit, Marrëveshjen e operimit në Rrjetin e Transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.04.2018"

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 120, datë 04.04.2023, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e ndryshimeve në rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018. Në vijim të njoftimeve, OST ka përcjellë në ERE propozimin lidhur me disa ndryshime në "Rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit; Marrëveshjen e Operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a., dhe përdoruesit".

Vendim nr. 228, datë 17.07.2023 "Mbi përcaktimin e shoqërisë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX" sh.a., si operatori i emëruar i tregut të energjisë elektrike (Nemo)"

Shoqëria "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX" sh.a., paraqiti aplikimin për t'u përcaktuar si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe depozitoi dokumentacion shtesë të këtij aplikimi. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 200, datë 23.06.2023, vendosi të fillojë procedurën për përcaktimin e shoqërisë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX" sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)". Në vijim të plotësimit të dokumentaciont nga shoqëria, Bordi i ERE-s ka vlerësuar që shoqëria "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX" sh.a., të përcaktohet Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

Vendim nr. 280, datë 25.09.2023 "Mbi miratimin e Rregullores "Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, Rregullave për shlyerjen e disbalancave, Kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar"

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 280 ka miratuar rregullat "Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar", e cila është bërë nga shoqëria OST sh.a. Kjo rregullore është e përbërë nga 16 nene të cilat përcaktojnë elementet e nevojshëm për pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar.

Vendim Nr. 296, Datë 19.10.2023 Mbi miratimin e Amendimit nr. 3 të Kontratës "Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a."

Palët kanë shprehur vullnetin e tyre për amendimin e kontratës duke e nënshkruar bashkërisht atë, për ndryshimin e kohëzgjatjes së kontratës, dhe shtrirjen e efekteve të saj deri më datë 31.12.2023, duke përcjellë kontratën në ERE me shkresë të përbashkët ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., me nr. 2134 prot. të ERE, datë 11.09.2023 "Për amendimin e kontratës "Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit", të

miratuar dhe nënshkruar ndërmjet palëve OST sh.a dhe KESH sh.a.. Ndryshimi i kohëzgjatjes së kontratës, vjen si pasojë e zgjatjes së periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri më datën 31.12.2023, sikurse shprehur në VKM-në nr. 449, datë 26.07.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike (të ndryshuar)". Pikëa 2 e VKM-së nr. 449/2023 përcakton se në pikën 5 fjalët "... 30 qershor 2023." zëvendësohen me "... 31 dhjetor 2023."

Vendim nr. 308, datë 30.10.2023 "Mbi miratimin e Rregullores së alokimit në hije të kapaciteteve (Shadow Auction) në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri-Kosovë"

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 308, datë 30.10.2023 ka miratuar Rregulloren e Alokimit në Hije të kapaciteteve (Shadow Auction) në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri - Kosovë, në vijim të shkresës së shoqërisë OST sh.a., e cila ka parashtruar Ndryshmet në draftin e rregullores për (Shadow Auction) të Kapaciteteve në hije. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij akti, drafti i përcjellë nga OST sh.a., me qëllim realizimin e konsultimit publik të tij është realizuar publikimi i tij në faqen zyrtare të internetit të ERE-s në rubrikën konsultime.

Vendimi nr. 364, datë 15.12.2023 "Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2024"

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 23 Mars 2023 ka miratuar ligjin e ri nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 7/2017. Në nenin 10, pika 4 përcaktohet se: *"Për prodhues ekzistues me përparësi, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 MW caktohet nga ERE-ja në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit,... Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE- ja në vitin 2016".*
Bordi i ERE-s me anë të këtij vendimi ka miratuar çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi prej 10 Lekë/kWh, për vitin 2024.

Vendimi nr. 365, datë 15.12.2023 "Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022"

Bordi i ERE-s me anë të këtij vendimi ka vendosur të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2024, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë OSSH sh.a. do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 20, gërma "c" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe metodologjisë përkatëse, të miratuar nga ERE.

Vendimi nr. 366, datë 15.12.2023 "Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022"

Bordi i ERE-s me anë të këtij vendimi ka vendosur të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a., për vitin 2024, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërive, do të bëhet korrigjimi dhe kompensimi përkatës i tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 20, gërma "c" të ligjit nr. 43/2015, *"Për sektorin e energjisë elektrike",* i ndryshuar dhe metodologjive përkatëse, të miratuara nga ERE.

Vendimi nr. 367, datë 15.12.2023 "Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të Gazit Natyror nga shoqëria Albgaz sh.a." për vitin 2024"

Bordi i ERE-s me anë të këtij vendimi ka vendosur të Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të bordit të ERE-s për vitin 2024, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë "Albgaz" sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika "e" të ligjit nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.

Vendimi nr. 369, datë 26.12.2023 "Mbi caktimin e rolit të Agjentit të Transferimit (Shipping Agent) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri - Kosovë"

Bordi i ERE-s me anë të këtij vendimi ka vendosur caktimin e NEMO (ALPEX sh.a.) në rolin e "Agjentit të Transferimit" (Shipping Agent), për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës. Agjenti i Transferimit, të ardhurat të cilat mblidhen nga konxhestionet do t'i transferojë OST-ve respektive jo më vonë se dy javë pas datës së shlyerjes.
Efektet juridike të kësaj vendimmarrje, hynë ne fuqi pas bërjes operacionale të bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë.

Vendimi nr. 379, datë 28.12.2023 "Mbi disa shtesa në vendimin e bordit të ERE-s nr. 317, datë 08.11.2023"Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat për dhënien e garancive të origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme "

Bordi i ERE-s me anë të këtij vendimi ka vendosur që vendimin e Bordit të ERE-s nr. 317, datë 08.11.2023, të shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje: Pika 4. Neni 7.1 i "Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anullimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019, e ndryshuar, ndryshon dhe bëhet: 7.2 *"Garancia e Origjinës për një impiant prodhues të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme lëshohet me bazë mujore, me përjashtim të rasteve kur janë kryer ndryshime të mëdha në impiantet prodhuese të energjisë elektrike të cilat janë të pajisura me parë më GO".*
Pika 5. Neni 14.1 i "Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me

vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019, e ndryshuar, ndryshon dhe bëhet: *14.1 "Garancia e origjinës lëshohet për një periudhë 1-mujore dhe shteron fuqinë e saj sipas afatit të shprehur ne certifikatën e Garancisë së Origjinës".*

8.3. Proceset gjyqësore në të cilat ERE ka qenë palë gjatë vitit 2023

Gjatë vitit 2023 ERE ka qenë pjesë në 53 procese gjyqësore të cilat janë iniciuar, vazhdojnë ose kanë përfunduar gjatë këtij viti, në cilësinë e palës paditëse, të paditur apo personit të tretë, të ndjekura gjyqësisht në të tre shkallët e sistemit gjyqësor në Tiranë, Durrës, Sarandë dhe për të gjitha këto procese gjyqësore.
Çështjet gjyqësore në të cilat ERE është thirrur në cilësinë e palës së paditur, janë në total 11 procese gjyqësore , nga këto 8 pëer vitin 2023 dhe 3 të mbartura nga vite e tjera,. Çështje gjyqësore në të cilën ERE është thirrur në cilësinë e palës së tretë janë 25 në total, procese këto të mbartura nga vitet e mëparshme. Sa i përket çështjeve gjyqësore në të cilat ERE është përfaqësuar në cilësinë e palës paditëse në total janë 16 të tilla. Gjatë vitit 2023 kane ardhur 8 çështje të reja gjyqësore, ndërkohë çështje në të cilat gjykatat janë shprehur me vendim për vitin 2023 janë 10 në total.
Me qëllim pasqyrimin në kohë të të gjithë proceseve gjyqësore të reja por dhe ndryshimet të cilat ndodhin me shtimin apo pakësimin e objektit të kërkesë-padive, rregullimin e palëve ndërgjyqëse si dhe kalimin e proceseve në shkallët më të larta të gjykimit apo rikthimin e tyre për rigjykim në shkallët më të ulëta eshte mbajtur dhe përditësuar periodikisht Regjistri i Proceseve Gjyqësorë në të cilat ERE është palë.

8.4. ERE në cilësinë e palës së tretë

Sa i përket proceseve ku ERE është thirrur në gjykatë në cilësinë e palës së tretë në total janë 25 procese, ku kryesisht objekt gjykimi janë: pavlefshmëri fature tatimore; shpërblim dëmi nga ana e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.; marrjen e masës së pezullimit të zbatimit të ekzekutimit të faturës së shitjes të energjisë elektrike; anulimin e faturave tatimore; ankesë nga ana e konsumatorëve drejtuar shoqërisë OSHEE Group sh.a etj.

8.5. ERE në cilësinë e palës paditëse

ERE në cilësinë e palës paditëse ka iniciuar 13 procese gjyqësore ndaj shoqërive debitore ndaj ERE. Në nenin 37, pika 1 të Ligjit nr. 43/2015 është parashikuar se "Çdo person juridik, që kryen një veprimtari në sektorin e energjisë elektrike, sipas pikës 2, të këtij neni, duhet të pajiset me licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji". Gjithashtu, në nenin 17, pika 4 të Ligjit nr.43/2015, i ndryshuar, është përcaktuar se për çdo të licencuar ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që duhet të paguhet prej këtyre të fundit, në përputhje me Rregulloren mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, i ndryshuar me vendimin nr.129, datë 10.08.2020. Pagesa rregullatore përkufizohet në pikën 52 të nenit 3 të Ligjit

nr.43/2015 si "pagesa vjetore që të gjitha shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike paguajnë për llogari të ERE-s, për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore të tij. Pagesa rregullatore për çdo shoqëri të licencuar miratohet çdo vit nga ana e ERE-s në bazë të një metodologjie të miratuar nga ky institucion".
Bordi i ERE-s me vendimet respektive ka përcaktuar pagesat rregullatore për çdo të licencuar, vendime të cilat janë botuar në Fletoret Zyrtare përkatëse dhe faqen Web të ERE si dhe i janë komunikuar të licencuarve edhe përmes njoftimeve shkresore.
Në vijim, ERE ka vijuar me procedurat e brendëshme administrative për vleresimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluara.
Bordi i ERE me vendimet respektive ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencave dhënë shoqërive debitorë, vendime të cilat i janë njoftuar shkresërisht subjekteve duke i bërë gjithashtu me dije se kanë të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.
Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimeve të fillimit të procedurës për heqjen e licencave, rezultoi se disa shoqëritë debitorë nuk kishin marrë asnjë masë për shlyerjen e debive apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk kane bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës. Për sa më sipër, bordi i ERE-s vendosi përfundimisht heqjen e licencave të shoqërive debitorë, vendimmarrja kjo e cila nuk i heq shoqërive detyrimin për kryerjen e pagesave rregullatore.
Gjatë vitit 2023, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesë padive të ngritura kundrejt subjekteve Alb Wind sh.p.k, Energy to Energy sh.p.k., Alb Energy Market sh.p.k.

8.6. ERE në cilësinë e palës se paditur

Gjatë vitit 2023, ERE është përfaqësuar në 11 procese gjyqësore në total, 3 prej të cilave kanë qenë të mbartura nga vitet e mëhershme.

Ndër këto procese, vlen të përmendim atë më palë paditëse shoqata "Albanian Renewable Energy Association" (AREA) dhe palë të paditura Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe ERE, person i tretë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe objekt: 1. Shfuqizimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 13.05.2020 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi"; 2. Shfuqizimi i Vendimit nr. 94, datë 08.06.2020 të Entit Rregullator të Energjisë "Mbi çmimin e aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi, për vitin 2020, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në Nr. 396 datë13.05.2020"; 3. Marrjen e masës së pezullimit të zbatimit të Vendimit nr. 94, datë 08.06.2020 të Entit Rregullator të Energjisë deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor të çështjes; 4. (Shtim objekti) Shfuqizimi i vendimit të ERE nr. 16, datë 20.01.2021 "Mbi çmimin

vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021".
Me Vendimin nr. 79 (86-2022-740), datë 24.11.2022, Gjykata Administrative e Apelit, vendosi rrëzimin e padisë së shoqatë AREA dhe në vijim të depozitimit të rekursit të kësaj të fundit, ERE ka përgatitur dhe depozituar kundër-rekursin duke kërkuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë lënien në fuqi të vendimit nr. 79 (86-2022-740), datë 24.11.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe mos pranimin e rekursit të ushtruar nga shoqata "Albanian Renewable Energy Association". Aktualisht, ERE është në pritje të datës që do të caktohet nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e kësaj çështjeje.
Gjatë vitit 2023, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka përfunduar çështja me palë paditëse Albpetrol sh.a, të paditur ERE, person i tretë Avokatura e Shtetit dhe shoqëria "Anio Oil & Gas" sh.a dhe objekt: 1. Shfuqizimin e aktit administrativ Vendim nr. 178, datë 13.07.2022; 2. Lejimin e shoqërisë Albpetrol sh.a si operator i licencuar për furnizim me energji elektrike, operimin me të njëjtin çmim të parashikuar në nenin 6 të kontratës së lidhur me shoqërinë Anio Oil & Gas sh.a me Nr. 5208/2 Alb. Datë 16.07.2018. Me vendimin nr. 337 (80-2023-352), datë 21.02.2023 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së palës paditëse shoqëria "Albpetrol" sh.a si të pambështetur në ligj dhe prova.

Gjykata e Apelit me vendim e datës 18.7.2023 Nr.174 (31154-03077-86-2022)Regjistri Themeltar Nr.54(86-2023-794), ka vendosur "Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 133, datë 06.06.2022 "Mbi kërkesën e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, i ndryshuar". Ne kuadër te unifikimit te praktikes ligjorë te ERE-s me ketë vendim, është marrë vendimin i Bordit Nr. 350, Datë 22.11.2023 "Mbi shfuqizimin e vendimit të bordit të ere nr. 133, datë 06.06.2022 "mbi kërkesën e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, e ndryshuar". Kto vendime nuk kanë sjellë asnjë pasoje financiare për ERE apo palët e treta te përfshira ne ketë proces (me përjashtim te shpenzimeve gjyqësore).

8.7. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Ligji nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, ka parashikuar në nenin 20, germa "ë" të drejtën e ERE-s për të zgjidhur mosmarrëveshjet, në lidhje me ankesat e paraqitura nga klientët dhe mosmarrëveshjet e lindura midis të licencuarve. Neni 24 në vijim, parashikon ndër të tjera, se ERE vepron si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura midis të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve dhe trajtimit të ankesave.

Gjithashtu, edhe ligji nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar, në nenet 16, pika 16, neni 17, pika 1, germa "ë" dhe neni 98, pika 1 dhe 2 ka përcaktuar autoritetin e ERE-s për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve në sektorin e gazit natyror si dhe

ndërmjet tyre dhe klientëve si dhe për të miratuar rregulloren për procedurat dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Në mbështetje të sa më sipër, bordi i ERE-s me vendimin nr. 114, datë 08.07.2016, miratoi Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

Gjatë vitit 2023, bordi i ERE-s me vendimin nr. 319, datë 08.11.2023, pranoi për shqyrtim nga ERE, kërkesat e paraqitura nga shoqëritë "TREN SUN SYSTEM" sh.p.k., "SUN BEAT SYSTEM" sh.p.k., "NTSP" sh.p.k., "KORCA PHOROVOLTAIC PARK" sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërive dhe shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL sh.a), duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me "Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror" miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114/2016.

9. AKTIVITETI I ERE NË FUSHËN E MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE

9.1. Veprimtaria e ERE Për Mbrojtjen e Konsumatorit.

ERE ka nder objektet kryesore në veprimtarinë e saj, mbrojtjen e konsumatorëve të energjisë elektrike, duke siguruar më tej trajtimin në mënyrë të drejtë e të barabartë dhe të përfitimin e konsumatorëve nga një mjedis më i pastër dhe më i gjelbër.
Mbrojtja e konsumatorit bën që tregjet të funksionojnë si për bizneset ashtu edhe për konsumatorët fundorë.
Konsumatorët duhet të jenë në gjendje të marrin informacion të saktë dhe të paanshëm për produktet dhe shërbimet që blejnë. Kjo u mundëson atyre të bëjnë zgjedhjet më të mira bazuar në interesat e tyre dhe i pengon ata të keqtrajtohen apo manipulohen nga bizneset. Politikat, ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e konsumatorit ndihmojnë në rritjen e mirëqenies së konsumatorëve duke siguruar që bizneset të mbajnë përgjegjësi. ERE si institucioni përgjegjës për garantimin e sa më sipër, me veprimtarinë e tij rregullatore, punon çdo ditë që Konsumatori por edhe subjektet tregëtare që ofrojnë shërbime në sektor të jenë të informuar mbi të drejtat, detyrimet e përgjegjësitë e tyre.
Mbrojtja e konsumatorit, kontribuon në rritjen e tregjeve dinamike dhe efektive për bizneset. Kërkesa e konsumatorëve nxit inovacionin dhe zhvillimin ekonomik pasi bizneseve u kërkohet të mbajnë çmime të drejta dhe cilësi të mirë të produkteve dhe shërbimeve të tyre.

Një pjesë e rëndësishme e punës së ERE-s fokusohet në zgjidhjen e ankesave të klientëve të energjisë elektrike duke mbledhur dhe përpunuar të dhëna për numrin dhe natyrën e tyre. Veçanërisht vitet e fundit, e më konkretisht gjatë viteve 2022-2023, ERE ka marrë një rol shumë më aktiv sa i përket kanaleve të komunikimit me konsumatorët duke gjetur mënyrat bashkëkohore të komunikimit me publikun jo vetëm drejtëpërdrejtë por edhe nëpërmjet rrjeteve sociale, si një rrugë më të shpejtë e të aksesueshme për të orientuar informacion drejt destinacionit të synuar, konsumatorit fundor. Në përputhje me aktet ligjore në fuqi, Rregullatori merr përsipër zgjidhjen e një ankese, pasi verifikon se kërkesa e paraqitur plotëson kriteret minimale për t'u trajtuar, dhe pasi konstaton se çështja që paraqitet për shqyrtim përfshin një shoqëri të licencuar në një nga aktivitetet në sektorin e energjisë apo atë të gazit natyror.

Në ERE gjatë vitit 2023 janë paraqitur 99 ankesa dhe 65 kërkesa për orientim apo informacion në lidhje me trajtimin e një çështje apo adresimin e një shqetësimit të konsumatorëve. Nga 164 numri total ankesa/kërkesave të adresuara në ERE rreth 66 prej tyre janë adresuar nëpërmjet



mjeteve elektronike të komunikimit, faqes së ERE dhe formularit të aplikueshëm të depozitimit të një ankese. Kështu edhe gjatë vitit 2023 shihet një trend në rritje i praktikave digjitale të komunikimit me institucionin e ERE, duke çuar në një lehtësim të praktikave administrative, uljes

së kohës së procesimit të një ankese por edhe uljes së kostove të vetë konsumatorit në arritjen e synimit, për gjetjen e një zgjidhje.

Nga totali i 164 ankesë/kërkesave të rregjistruara në ERE, 56 prej tyre janë përcjellë nëpërmjet formularit në faqen web të ERE-s "**bëj një ankesë**", 10 të tjera nëpërmjet e-mail dhe 98 me anë të postës tradicionale apo zyrave të ERE-s.

Figura 103. Ankesat e rregjistruara

Grafiku në të majtë paraqet me ngjyrë blu ankesat e rregjistruara nëpërmjet formularit "bëj një ankesë", me gri ankesat e rregjistruara nga e-mail dhe me jeshile ato të rregjistruara nëpërmjet postës dhe paraqitjes në ambjentet e ERE.

Duke analizuar grafikun më poshtë, vërejmë sipas objektit të ankesës, peshën specifike që zënë sipas secilës kategori ankesat që janë adresuar nëpërmjet ERE, për vitin 2023 krahasuar me të njëjtat kategori të dhënash të rregjistruara për vitin 2022.

Figura 104. Ankesat që janë adresuar nëpërmjet ERE, për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022



Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në grafik evidentohet se, në vitin 2023 ka një rënie të numrit të ankesave për mbifaturim, të cilat kanë rezultuar 20, krahasuar me vitin 2022 gjatë të cilit janë trajtuar 37 të tilla. Numri i ankesave me objekt dëmin ekonomik gjatë vitit 2023 ka pësuar një rënie të vogël duke e krahasuar me atë të vitit 2022. Gjatë vitit 2023 numri i ankesave për faturim me dëm ekonomik rezulton të jetë 20, ndërsa në vitin 2022 ky numër ka rezultuar 24. Nga të dhënat statistikore të ERE-s, rezulton se, në vitin 2023 numri i ankesave të rregjistruara për faturimin me objekt vlerë referuese, ka një rritje shumë të lehtë, nga 8 ankesa për faturim me vlerë referuese që janë rregjistruar në vitin 2022, në 9 ankesa të rregjistruara në vitin 2023. Lidhjet e reja janë një tjetër kategori për të cilën shumë konsumator paraqiten në ERE për të marrë zgjidhje për ankesat e tyre. Sa i përket kësaj kategorie këtë vit janë rregjistruar 2 ankesa duke rregjistruar një rënie krahasuar me vitin 2022 ku numri i ankesave të adresuara në ERE ka qenë 6.

Krahasuar me ankesat që rregistrohen në FSHU sh.a., rezulton se problematikat më të mëdha gjatë vitit 2022 janë ankesat me objekt kreditimin/pagesa të energjisë elektrike. Ndërkohë në

vitin 2023 problematika që zënë vend më të lartë janë ankesat me objekt për mbifaturim të energjisë elektrike.

9.1.1. Ankesat Për Mbifaturimin e Energjisë Elektrike

Me mbifaturim të energjisë elektrike kuptojmë rastet kur sasia e energjisë së konsumatorit për të cilin është përllogaritur vlera e detyrimit të tij është më e madhe se të dhënat e gjeneruara të matjes. Nga të dhënat statistikore, konstatohet se ankesat me objekt "mbifaturimi i energjisë elektrike", zënë një total prej 20 ankesash, ose rreth 20.2 % e totalit të ankesave të regjistruara në ERE. Këto ankesa kanë ardhur si pasojë e disa problematikave të ndryshme si: (i) pasaktësi në të dhënat e matjes për shkak të defekteve në matës, (ii) mos rakordimi i gjëndjes së hedhur në sistem me gjendjen reale të matësit, etj. Rezulton se nga totali i 20 ankesave me objekt mbifaturim të energjisë elektrike, 3 prej tyre i përkasin faturimeve të lëshuara gjatë viteve 2011-2013, ndërkohë që 12 prej tyre i përkasin viteve 2020-2022, dhe 5 prej tyre jane fatura te gjeneruara gjate vitit 2023. Shpesh herë konsumatorët paraqiten pranë të licencuarit përgjegjës apo ERE, me vonesë për goditjen administrative të një fature. Shkaqet e mospranimit të ankesave kanë të bëjnë me raste kur konsumatorë ndodhen në padijeni të faturës së lëshuar ose kur mungon dokumentacioni mbështetës nga ana e tyre.

Për të gjitha këto ankesa, ERE kërkon nga shoqëria FSHU sh.a, dhe shoqëria OSSH sh.a, verifikimin e praktikave dhe dokumentacionit të disponuar lidhur me faturimet e kryera së bashku me rekomandimet për korrigjimet përkatëse që duhen realizuar në zbatim të afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për këtë qëllim sipas fushës së kompetencës.

Nga ana e të licencuarve janë marrë masa për trajtimin e 20 nga 20 ankesat e adresuara nga ERE me objekt mbifaturimin e energjisë elektrike. Rezulton se vetëm për 4 prej tyre, shoqëria FSHU sh.a., pas verifikimeve të kryera, ka konkluduar se ka patur pasaktësi në përllogaritjen e konsumit, e në vijim në zbatim të rekomandimeve të ERE, janë marrë masa për saktësimin/korrigjimin e faturimit, si dhe anullimin e disa faturimeve si dhe bërë saktësimet e nevojshme në faturimin e muajit vijues sikurse parashikohet në legjislacionin në fuqi. Rezulton se për 3 prej këtyre ankesave nga ana e FSHU sh.a., nuk është përcjellë dokumentacion, pasi faturimet janë të hershme dhe si rrjedhojë mungon dokumentacioni. Gjithashtu disa ankesa ka rezultuar se janë paraqitur në FSHU jashte afatit 12 mujor, të parashikuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me energji elektrike, Miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018. Në këtë akt nënligjor parashikohet se: Klienti fundor mund të kundërshtojë në çdo kohë faturën e lëshuar nga Furnizuesi por jo me vonë se 1 vit nga data e lëshimit të saj, si në rast kur dyshon në saktësinë e faturimit, gabime të tjera të konstatuara në faturë apo pasaktësi në sistemin e matjes.

9.1.2. Ankesat Për Dëm Ekonomik

Ankesat për dëmin ekonomike lidhen me kundershtimin e faturimit nga ana e operatorit të rrjetit të kostove të shkaktuara nga konsumatorët nga nderhyrjet e paligjshme në sistemin e

matjes dhe rrjetin e shpërndarjes se energjisë elektrike nga ana e përdoruesve të rrjetit të lidhur në sistemin e shpërndarjes.

ERE ka trajtuar 20 ankesa me objekt dëm ekonomik ose rreth 20.2% të totalit të ankesave të regjistruara në ERE. Rezulton, se 5 prej tyre i përkasin faturimeve të dëmit ekonomik të konstatuar gjatë viteve 2011-2012, 6 prej tyre për faturime të dëmit ekonomik gjatë 2020-2021 dhe 9 ankesa për faturime të dëmit ekonomik gjatë vitit 2022-2023. Për të gjithë këto ankesa ERE i është drejtuar shoqërisë OSSH sh.a, duke kërkuar informacion/dokumentacion lidhur me procedurën e ndjekur, (proces-verbalin e akt-konstatimit) si edhe verifikimin e sistemit të matjes nga subjekti i autorizuar për rrethanat në të cilat rregullorja e dëmit ekonomik parashikon një detyrim të tillë. Sa i përket ankesave që lidhen me faturimet e dëmit ekonomik që i takojnë një periudhe të mëhershme, ERE e ka trajtuar ankesën në ato raste, kur nga ana e konsumatorit është dokumentuar se nuk ka marrë dijeni në afat në lidhje me faturimin.

Nga totali i 20 ankesave të trajtuara nga ERE, rezulton se 19 prej këtyre ankesave kanë marrë trajtim nga ana e OSSH sh.a. Rezulton se vetëm për 4 prej tyre, OSSH sh.a., pas verifikimeve të dokumentacionit dhe informacionit të konsultuar, në zbatim të rekomandimeve të ERE, ka marrë masa për sistemin e faturimit. ERE në çdo rast ka vijuar komunikimin me të licencuarin dhe përcjelljen e urdhërave për dokumentimin e procedurave të faturimit të dëmit ekonomik.

Sa i përket dëmit ekonomik të konstatuar dhe faturuar gjatë vitit 2023 nga OSSH sh.a., rezulton se janë faturuar 680 konsumatorë . Vlera e dëmit ekonomik të shkaktuar Operatorit të rrjetit gjatë vitit 2023, për të cilën OSSH sh.a., ka faturuar dëmin ekonomik për llogari të konsumatorëve, është 196,490,575 lekë. Rezulton se numri më i lartë të faturimeve me dëm ekonomik i përket rajonit të Kukësit me 144 faturime me vlerë 12.950,872 lekë, Burreli me 135 faturime në vlerën 8,725,071 dhe Shkodra me 85 faturime në vlerën 27,619, 774 lekë.

9.1.3. Ankesat Për Vlera Referuese

Në rastet kur Furnizuesi merr dijeni nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesi në të dhënat e matjes), faturimi i energjisë elektrike, mbështetur në rregulloren e miratuar nga ERE për këtë qëllim kryhet duke aplikuar vlerën referuese. Kjo përllogaritet bazuar në të njëjtin konsum të muajit respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj. Gjatë vitit 2023 konstatohet se në ERE janë paraqitur 9 ankesa me objekt “vlerë referuese”, ose rreth 10 % e totalit të ankesave të rregjistruara gjatë 2023, të cilat i përkojnë faturimeve me vlerë referuese të aplikuara gjatë viteve 2021-2023. Nga ana e FSHU sh.a., për 4 ankesa është konstatuar se faturimi është i drejtë duke e dokumetuar përllogaritjen e konsumit të energjisë elektrike mbi të dhënat historike të konsumit mesatar dhe në përputhje me rregulloren e miratuar nga ERE për këtë qëllim. Për 5 prej tyre ERE ka shqyrtuar dhe analizuar praktikën dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe i ka dhënë urdhra/rekomandime të licensurarve të cilat në kuptim të “*Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e*

mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", janë të detyrueshme për zbatim.

9.1.4. Ankesat Për Kontratë Fiktive

Përgjatë vitit 2023 në ERE janë rregjistruar 10 ankesa me objekt "kontratë fiktive", ose rreth 10 % e totalit të ankesave të rregjistruara në vitin 2023, për kontratat e hapura për periudhat 2001-2012. Këto kontrata të vjetra, rezulton se nuk kanë të dhëna indentifikuese të mjaftueshme për të vërtetuar lidhjen ligjore mes përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit.
Përgjithësisht rezulton se konsumatorët kanë marrë djeni për këto kontrata në momentin që kanë aplikuar për lidhje të re, gjatë vitit 2022-2023, çka ka penguar miratimin e lidhjes së re duke qënë se rezultojnë debitorë për këto kontrata të kontestuara.
Për këto ankesa ERE ka kërkuar nga FSHU sh.a., informacion e dokumentacion sikurse parashikuar në legjislacionin në fuqi në kohën e lidhjes së kontatës si dhe të dhëna të tjera dokumentare historike për të provuar lidhjen ligjore mes ankuesit, dhe të dhënave të kontratës.
Duke qenë se këto kontrata fiktive rezultojnë të hershme, nga ana e të licensurave ka qenë e pamundur të dokumetohet procedura e hapjes së këtyre kontratave, ku dhe vetë Ligji Nr. 43/2015, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", i ndryshuar, në nenin 89 parashikon se: *Të licencuarit për furnizimin e energjisë elektrike ruajnë të dhëna për kontratat e furnizimit me energji elektrike, për kontratat me operatorët e shitjes me shumicë dhe operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, **për një periudhë të paktën pesëvjeçare.***

9.1.5. Ankesat e Konsumatorëve Për Lidhje të Re

Në rregulloren e lidhjeve të reja parashikohet se si konsumatori mund të kryejë aplikimin pranë shoqërisë OSSH sh.a., për miratimin e një lidhje të re dhe pas përmbushjes së dokumetacionit, kritereve teknike dhe pagesës brenda afateve të parashikuara në rregulloren e lidhjeve të reja procedohet me lidhjen e re. Kusht pengues për miratimin e aplikimit të lidhjes së re mund të jetë vonesa në shlyerjen e detyrimeve, ekzistenca e një kontrate tjetër e cila mban statusin debitor, mospërmbushja e dokumentacionit ligjor, financiar dhe teknik etj. Në të gjitha rastet, i licencuari ka detyrimin të njoftojë aplikuesin për pengesat e hasura në miratimin e lidhjes së re, brenda afateve të parashikuara në Rregullore për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes apo njoftimin e miratimit të aplikimit.
Rezulton që në ERE gjatë vitit 2023 janë rregjistruar vetëm 2 ankesa për mosmiratim apo vonesa të miratimit të aplikimit për lidhje të re. Nga ana e OSSH sh.a., janë dhënë shpjegime mbi shkaqet që kanë penguar miratimin e këtyre lidhjeve të reja, e që konkretisht kanë qenë të lidhura me mungesa në dokumentacionit nga ana e aplikuesit.

9.1.6. Ankesat Për Ndryshim Tarifimi

Përgjithësisht ankesat e kësaj natyre lidhen me aplikimin e tarifave të ndryshme nga kategoria së cilës i përket konsumatori dhe rastet më tipike gjatë vitit 2013 kanë qenë ato të furrave të bukës të cilat ushtrojnë aktivitet tjetër përveç furrë buke si psh. (pasticeri, bulmet etj), të cilët

nuk kanë plotësuar kriteret ligjore dhe teknike për të përfituar tarifën e miratuar për këtë qëllim. Gjithashtu gjatë këtij viti ka pasur ankesa nga disa konsumatorë të cilët gabimisht kanë kaluar në FMF. Nga ana e FSHU sh.a., janë marrë masa për korrigjimin e tarifimit dhe për rikthimin në ligjshmëri të këtyre konsumatorëve. Në ERE në vitin 2023 janë rregjistruar 4 ankesa për ndryshim tarifimi ose rreth 4% e totalit të ankesave. Nga ana e të licencuarve janë marrë masa për trajtimin e këtyre ankesave.

9.1.7. Ankesa të ndryshme

Në këtë grup të ankesave, përfshihen ankesat me objekt: faturë sistemuese, faturim aforfe, keqfaturimi i energjisë elektrike, ndërprerje e energjisë elektrike, nënfaturim, keqtarifim, kryqëzim matësi, konsum si rezultat i testimit të matësi, ankesë lidhur me gjenerimin e kamatvonesave etj. Në këtë grup ankesash konstatohen rreth 34 ankesa ose rreth 34% të totalit të ankesave të regjistruara në ERE. Rezulton se 3 prej tyre janë në proces shqyrtimi nga ana e FSHU sh.a, dhe 6 prej ankesave kanë marrë zgjidhje përfundimtare. Rezulton se për 4 prej këtyre ankesave nga ana e FSHU sh.a është bërë me dije se klienti nuk ka përmbushur kriteret ligjore për të shmangur shkakun për të cilin ushtron ankim, i cili varion nga mos depozitimi i një kërkesë për pezullim kontrate në rastet e aplikimit të tarifës së mirëmbajtjes së kontratës, mungesa e aplikimit formal të klientëve që synojnë të ndryshojnë tarifën e aplikueshme të energjisë elektrike. Të tjera raste janë ato të ankesave të konsumatorëve ne lidhje me të dhënat e gjeneruara të matjes, e për të cilat pas verifikimeve nga ana e operatorit përgjegjës është dokumentuar gjendja operative e saktë e matësit. Ndërsa për 21 të tjera është vijuar komunikimi duke dhënë orientimet e duhara për të verifikuar, plotësuar dokumentacionin dhe për të reflektuar parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Gjatë vitit 2023 ERE ka zhvilluar 23 seanca dëgjimore me qëllim zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve të energjisë. Seancat dëgjimore të organizuaranga ERE bashkarisht me palët, janë vlerësuar rast pas rasti si një medium i mirë për të marrë shpjegimet e nevojshme në lidhje me problematika të veçanta të ankesave të adresuara në ERE, për të cilat praktika e pakët dokumentare nuk lejon shqyrtimin përfundimtar të tyre.

Vlen të theksojmë se në Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, parashikohet se ERE, sipas rastit, do të dërgojë për verifikim ankesën pranë subjektit të ankimuar brenda 15 ditëve kalendarike. Nga analizimi i praktikave të trajtuara në ERE përgjatë këtij vitit kalendarik, rezulton se koha mesatare e përmbushjes së sa më sipër, është rreth 11 ditë kalendarike. Po ashtu nga ana tjetër, rregullorja e sipërcituar parashikon detyrimin për të licencuarit përgjegjës që të përcjellin në ERE informacionin e kërkuar jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga njohja me kërkesat e ERE. Rezulton se nga ana e të licencuarve përgjegjës, në disa raste ka pasur vonesë në trajtimin e kërkesave të ERE apo moskuptim të drejtë të kërkesave për informacion apo dokumentacion.

9.2.Ankesat e Trajtuara nga FSHU sh.a.

Për sa i përket ankesave të regjistruara në FSHU sh.a., ato vijnë nga të gjitha burimet, qoftë drejtëpërdrejtë në qendrat e kujdesit të klientit, nga ERE, platforma e bashkëqeverisjes, apo nëpërmjet institucioneve të tjera. ERE ka analizuar të dhënat e FSHU sh.a., në lidhje me numrin total të ankesave të regjistruara, që nga data 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2023 sipas kategorive respektive; mbifaturim, dëm ekonomik/ energji e pamatur, matje jashtë kushtit teknik, keqtarifim, faturim aforfe, vlerë referuese.

Nga të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2023 rezulton se totali i ankesave të paraqitura gjatë vitit 2023 në FSHU sh.a., nga të gjitha burimet është 29.939. Niveli i zgjidhshmërise së këtyre ankesave është 92.6%, konkretisht të zgjidhura sipas FSHU sh.a, rezultojnë se janë 27,744 ankesa.

Në grafikun në vijim evidentohet niveli i zgjidhshmërisë.

Figura 105. Niveli zgjidhshmërisë së ankesave



Nga totali prej 27,744 ankesave/kërkesave të regjistruara gjatë vitit 2023, pjesën më të madhe të burimeve të adresimit të ankesve e zënë ato të adresuara në njësitë fizike të Qendrave të kujdesit ndaj klientit në të cilën janë rregjistruar 27,197 ankesa, 282 ankesa janë adresuar nëpërmjet platformës së bashkëqeverisjes, 110 ankesa në ERE (prej të cilave 99 ankesa janë regjistruara për herë të parë në ERE dhe 11 prej tyre të rregjistruara më herët) dhe 79 kërkesa janë adresuar nga Avokati i Popullit dhe 76 ankesa Online.

Sipas statistikave të mësipërme, evidentohet se peshën më të madhe e zënë ankesat e rregjistruara pranë qendrave të kujdesit ndaj klientit.

Ankesat e ndara sipas kategorive në FSHU sh.a:

- Ankesa për pagesa/kreditime të regjistruara në FSHU sh.a janë 447, prej të cilave vetëm 399 kanë marrë zgjidhje, përkatësisht 89%. Krahasuar me vitin 2022 ka një rënie të

këtij numri, që nga viti 2022 nga ku ka rezultuar se janë rregjistruar 705 ankesa, prej të cilave 652 janë zgjidhur.

- Sa i përket ankesave/kërkesave për keqfaturim të energjisë elektrike, (në të cilën përfshihen kategoritë e ankesave për mbifaturim, keqfaturim/ faturim aforfe, dëm ekonomik, tarifim i gabuar etj) janë rregjistruar në FSHU sh.a 29,939 ankesa, prej të cilave 27,197 janë zgjidhur, konkretisht 92.6 %.
- Ankesat për cilësi shërbimi në të cilën përfshihen kategoritë e ankesave (përcilësinë e furnizimit me energji, tensioni, ndërprerjet e energjisë, defekte në rrjetin e shpërndarjes, vonesa në dhënien e shërbimit), rezultojnë se në FSHU sh.a., të jnë rregjistruar 2.395, prej të cilave vetëm 94 ankesa kanë marrë zgjidhje, përkatësisht 3.9 %. Krahasuar me vitin 2022 ka një rënie të numrit të ankesave, të cilat në vitin 2022 rezultojnë të jenë regjistruar 2655, prej të cilave 155 janë zgjidhur.
- Kategoritë e ankesave që përfshijnë matjet jashtë kushtit teknik, vlerat referuese, etj) zënë 89.6% të totalit të ankesave duke qëndruar në totalin prej 35,059 të tilla prej të cilave 31,442 janë zgjidhur. Krahasuar me vitin 2022 ka një rënie të tyre, ku janë rregjistruar 36,008 ankesa prej të cilave janë zgjidhur 32, 976.
- Sa i përket ankesave për ndryshimin e të dhënave të kontratës, në të cilën përfshihen kategoritë, ndryshimin e titullarit të kontratës të energjisë elektrike, ndryshimin e përdoruesit të pronës etj. janë rregjistruar në FSHU sh.a.58,532 ankesa, prej të cilave 55, 116 janë zgjidhur, përkatësisht 94.1 %. Krahasuar me vitin 2022 ka një rënie të dukshme të këtyre ankesave. Në vitin 2022 rezulton se janë rregjistruar 70,260 ankesa për këtë kategori, prej të cilave janë zgjidhur 66, 987.

Në mënyrë grafike, në vijim, evidentohet ndryshimi në numrin e ankesave të adresuara pranë Furnizuesit dhe performancën e tij gjatë vitit 2023, sa i përket zgjidhjes së ankesave krahasuar me të dhënat e vitit 2022



Figura 106. Ndryshimi në numrin e ankesave të adresuara pranë Furnizuesit dhe performancën e tij gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022.

Gjatë vitit 2022 marzhi i gabimit sa i përket sistemimeve të kryera në raport me faturimet për të cilat është bërë ankesë është në vlerën 79 %. Gjatë vitit 2023 marzhi i gabimit referuar sistemieve të kryera të faturimit është në vlerën 69 % dhe nga shifrat e disponuara, rezulton se marzhi i gabimit në vitin 2023 është rritur në vlerën 10% krahasuar me vitin e kaluar.

Gjatë vitit 2023 janë lidhur 29,089 kontrata të reja furnizimi me energji elektrike. Krahasuar me vitin 2022 ka një rënie të numrit të kontratave të reja të lidhura në rrjet.

Në grafikun në të djathtë janë reflektuar të dhënat 5 vjeçare të kontratave të reja të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë kësaj periudhe.

Për kategorinë e faturimeve me vlerave referuese të cilat janë të aplikueshme në rastet kur të dhënat e matjes janë të padisponueshme, rezultojnë të rregjistruara 2,959 ankesa.



Figura 107. Të dhënat 5 vjeçare të kontratave të reja të lidhura në rrjetin e shpërndarjes.

Sipas parashikimit të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë citohet se konsumatorët kanë detyrim të paguajnë konsumin mujor të energjisë elektrike jo me vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit. Në të kundërt shoqëria FSHU sh.a., ka të drejtë pas kalimit të afatit të pagesës prej 30 ditësh ti faturojë klientit një kamatë vonesë të barabartë me 0.1 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.

Ndër vite një numër jo i vogël konsumatorësh kalojnë në statusin debitor apo kanë të dhëna historike të mbajtjes së statusit debitor. Të dhënat aktuale të paraqitura nga FSHU sh.a., përsa i përket vitit 2023 na paraqesin këtë panoramë.

Numri total i konsumatorëve familjarë dhe jo-familjarë, të cilët kanë kaluar në statusin debitor gjatë vitit 2023, rezulton të jetë 564,509 konsumatorë familjarë dhe jo-familjarë. Numri i konsumatorëve me problematikë në shlyerjen e pagesave të furnizimit me energji elektrike në afat është 276,567 konsumatorë debitor. Aktualisht rezulton se 287.942 konsumatore mbajnë statusin e debitorit të marrë gjatë vitit 2023.

Për shkak se debitë mblidhen në vlera të mëdha dhe shpesh të papërballueshme për konsumatorin për tu shlyer në një pagesë të vetme nga ana e FSHU sh.a., ofrohet mundësia e shlyrjes me këste të detyrimeve historike të tyre të prapambetura. Çdo vit me propozimin e Administratorit, Asambleja e Përgjithshme miraton kushtet e azhurnuara të marrvëshjeve tip që nënshkruajnë me konsumatorët për shlyrjen me këste.

9.3. Masat e marra për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga "Plani i masave për furnizuesin e shërbimit universal për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike" miratuar me Vendimin nr. 201, datë 03.09.2018, i ndryshuar.

Në zbatim te ligjit nr. 43/2015,"Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ERE ka të drejtën dhe detyrën për të monitoruar, kontrolluar dhe inspektuar shërbimet e operatorëve të licencuar në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore, kushteve të shërbimit publik, kushteve të kontratës, si dhe zbatimin e vendimeve dhe urdhrave të ERE-s. Misioni i ERE-s, ndër të tjera, përfshin një treg energjie që reflekton një shërbim të mirë për klientët familjarë dhe jofamiljarë të shërbyer nga Fumizuesi i Shërbimit Universal dhe Fumizuesit e tjerë. ERE nëpërmjet vendimit nr. 201, datë 03.09.2018, ka miratuar planin e masave me anë të të cilit ngarkon me detyrime për FSHU sh.a., që synojnë dhënien e një shërbimi më cilësor për konsumatorët. ERE ka të drejtë të kërkojë raportim dhe të monitorojë të licencuarin për përmbushjen e detyrimeve që burojnë prej këtij akti që mbron dhe respekton të drejtat e klientëve të fumizimit me energji elektrike.

Lidhur me detyrimin e përmbushjeve të Planit të masave, shoqëria FSHU sha, bën me dije mënyrat sesi i informon klientët siç janë: nga ëebsite online www.fshu.al, Postës dhe Qëndrave të Kujdesit Ndaj Klientit; për rastet kur pretendimi i klientit nuk qëndron, dhe në rastet kur pretendimi qëndron, ai vihet në dijeni përmes Qëndrave të Kujdesit.

ERE mbas mbikqyrjes së website-it të OSHEE Group ka konstatuar se gjenden të publikuara të dhëna mbi legjislacionin e zbatueshëm sa i përket të drejtave dhe detyrimeve të konsumatorit në raport me të licencuarit. Gjithashtu ERE konstaton që ndërmjet rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të OSHEE Group sh.a., shpërndahen informacione lidhur me informimin e konsumatorëve.

OST -Sa i përket ankesave të regjistruara nga furnizuesit në treg të lirë **në lidhje me cilesinë e shërbimit** të rrjetit nuk rezulton të ketë të tilla përt viitin 2023.

9.4. Ankesat e Konsumatorëve Në Treg të Lirë

ERE-s ka miratuar Regulloren e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në treg të lirë e cila ka për qëllim mbrojtjen e interesave të klientëve në tërësi bazuar në një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues përmes procedurave ligjore e transparente dhe monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve që ofron i licencuari ndaj klientëve të energjisë elektrike.

Rregullorja mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit kërkon nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike që të përcjellin raport 3 (tre) mujor duke iu përmbajtur aneksit 2 të rregullores për standardet e trajtimit të ankesave.

Sipas të dhënave të disponuara nga raportimet e 31 furnizuesve të licencuar për këtë aktivitet, rezulton se gjatë 2023 ka patur 9 furnizues të cilët kanë ushtruar aktivitet për konsumatorët që kanë dale në treg të lirë, të cilët kanë raportuar përgjithësisht sipas kritereve të rregullores.

Gjatë vitit 2023, rezulton se vetëm shoqëria Albpetrol sh.a. ka raportuar për 3 ankesa. Natyra e këtyre ankesave ka të bëjë me çmimin/tarifën e faturuar për këto konsumatorë. Nga ana tjetër përgjatë vitit 2023, ndarë në baza 3 mujore të licenuarit e tjerë nuk kanë regjistruar ankesa. Numri shumë i ulët i ankesave lidhet me faktin se disa subjekte nuk kanë ushtruar aktivitet furnizimi të energjisë elektrike, nuk kanë lidhur kontrata me konsumatorë apo janë ende në fazën e regjistrimit me Operatorin e Tregut. Gjithashtu edhe numri i konsumatorëve që kanë marrë shërbimin e furnizimit në treg të lirë përgjatë 2023 është mjaft i ulët, e të gjithë këto faktorë rrjedhimisht sjellin një numër të ulët të problematikave të konsumatorëve. Raportimet nga furnizuesit përcillen përgjithësisht në përputhje me rregulloren dhe ankesin 2 të rregullores.

9.5. Dhënia Zë e Konsumatorit

ERE ka pasur gjithnjë në vëmëndje informimin e Konsumatorit, përpos mbrojtjes së tij. Më tej ERE është impenjuar me edukimin e tij, me qëllim njohjen e hapave që mund të ndërmarrë në rast se has problematika të ndryshme lidhur me energjinë elektrike. Misioni i Entit Rregullator të Energjisë veç të tjerash ka për qëllim dhe sensibilizimin e konsumatorit në lidhje me të drejtat dhe detyrimet nëpërmjet vendosjes së urave të komunikimit dhe të kontaktit.
Fushata sensibilizuese e ERE përfshin ndarjen e informacionit në formë broshurash në ambjentet tona por edhe nëpërmjet rrjeteve sociale. Për t'u gjendur sa më afër dhe në funksion të ruajtjes së standardeve dhe cilësisë së shërbimit, kemi ndarë edhe anketa e sondazhe për të kuptuar më tej konsumatorin.

Broshurat e shpërndara në rrjetet sociale përgjatë vitit 2023, konsistojnë në informative dhe në formë këshillash me titujt respektivë si më poshtë:

- Si të bëni një lidhje me rrjetin e shpërndarjes?
- Çfare kuptimi ka vlera referuese në faturën tuaj të energjisë?
- Kur dhe si duhet të paguani faturën e energjisë elektrike?
- Metodat e pagesës së energjisë elektrike?
- Si mund të lidhni një kontratë energjie elektrike?
- Dita botërore e të drejtave të konsumatorit?
- Procedura për ndryshimin e fumizuesit.
- Ndërprerja e furnizimit nga furnizuesi dhe rilidhja.
- Përfundimi i kontratës me kërkesë të klientit.
- Çfarë duhet të bëni për të qenë vetëprodhues?
- Si të bëni një lidhje me rrjetin e shpëmdarjes në tension të mesëm?
- Si të bëni një lidhje me rrjetin e shpërndarjes 50-100 kW në tension të ulët?
- Çështjet që adreson kontrata e furnizimit.
- Si të kursejmë energji?
- Keni një ankesë për furnizuesin e energjisë elektrike. Mund të drejtoni një ankesë me një klikim në faqen e zyrtare www.ere.gov.al.
- Keni një pyetje në lidhje me kushtet e furnizimit me energji elektrike.
- Si të kursejmë energji elektrike.

- Sistemi ngrohës/ftohës.
- Numrat e kontaktit në rast mungese/defekti të energjisë elektrike.
- Çfarë kushtesh duhet të plotësoni për të lidhur një kontratë energjie elektrike?
- Çfarë është matësi inteligjent?

Sa i përket Anketës, është krijuar me qëllim që reagimi i Konsumatorit ndaj saj të jetë një ndihmë për hapat që ndërmerren vazhdimisht në mbrojtje të këtij të fundit.
Ajo ka konsistuar në formën e një mini-pyetësori, përgjigjet e së cilit konsumatori mund ti përzgjidhte në një ankete online.
Pyetjet lidheshin kryesisht me formën e adresimit të ankesës, mendimet mbi legjislacionin e për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, mbi informacionin që dëshirojnë të marrin në ERE, mbi të drejtat e konsumatorit dhe informacionin që mundëson faqja e internetit e ERE, mbi efektshmërinë e këtij informacioni lartëpërmendur, mbi feedbackun e shërbimit të kërkuar dhe mundësuar nga ERE.
Kësaj ankete Konsumatori i është përgjigjur duke votuar si më poshtë:

- Sa i kënaqur jeni me shërbimin që keni marrë në ERE?
  Konsumatori ka votuar kryesisht- “Shumë i kënaqur”.

- Si keni mësuar rreth ERE-s?
  Konsumatori ka votuar më tepër opsionin; “Nëpërmjet faqes se internetit - 46%”.

- Ankesën për furnizuesin e energjisë elektrike e adresoni:
  Konsumatori ka votuar në pyetesor; Furnizuesi - 50% dhe ERE - 50%.

- Mendoni se legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të Konsumatorit:
  Konsumatori ka votuar “I plotë” dhe “I plotë por nuk zbatohet.”

- Sa i efektshëm është informacioni që merrni nëpërmjet faqes së ERE-s?
  Konsumatori kryesisht ka votuar se informacioni është i qartë.

- Informacioni për konsumatorin në faqen e ERE-s:
  Konsumatorit ka votuar që të jetë më profesional dhe më i thjeshtë në raport 50/50.

- Dëshironi të merrni më shumë informacion mbi të drejtat e konsumatorit:
  Kryesisht prej Faqes web, lajmeve në mail, dhe rrjeteve sociale - 16%

- Çfarë lloj informacioni dëshironi të merrni nëpërmjet ERE:
  Konsumatori ka kërkuar të marrë më tepër informacion lidhur me “Të drejtat për cilësinë e shërbimit”, “Të drejtat për të qenë vetëprodhues.”

9.6. Konsumatorët Në Treg Të Lirë



Sipas të dhënave të përcjella nga OST sh.a., furnizues që kanë ushtruar aktivitet në treg të lirë, referuar njoftimeve të tyre të kontratave të furnizimit të konsumatorëve, janë **7** shoqëri për konsumatorët e lidhur në Sistemin e Transmetimit dhe **2** shoqëri për konsumatorët e lidhur në Sistemin e Shpërndarjes. Pra, në total janë **9** furnizues që furnizojnë në treg të lirë gjatë periudhës së raportuar (vitit 2023).

Në tablën në të majtë janë paraqitur furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të lirë, referuar njoftimeve të kontratave të furnizimit me konsumatorët, të përcjella nga Operatori i Tregut (OT) të ndara në transmetim dhe shpërndarje.

Figura 108. Furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të lirë

Numri klientëve përfitues nga shërbimi i furnizimit në treg të lirë është **13** për klientë të lidhur në Sistemin e Transmetimit dhe **72** klientë të lidhur në Sistemin e Shpërndarjes. Në total janë **85** konsumatorë që furnizohen aktualisht në treg të lirë. Sipas raportimeve nga OSSH sh.a gjatë vitit 2023 janë furnizuar në treg të lirë 76 konsumatorë të lidhur në rrjetin 35kV.

9.7. Lidhjet e Reja Në Transmetim

Sa i takon procedurave për lidhje të reja, si dhe statusit të aplikimeve për lidhje me rrjetin e transmetimit, për periudhën janar-dhjetor 2023 ka patur një sërë aplikimesh për lidhje të centraleve prodhuese të energjisë elektrike, të listuara si më poshtë:

- Centrale të tipit "Gjenerues Hidrik", 5 aplikime, fuqia totale e kërkuar 64.33 MW, realizuar 3 Marrëveshje Lidhjeje.
- Centrale të tipit "Gjenerues Solar", 83 aplikime, fuqia totale e kërkuar 5620.82 MWp, realizuar 2 Marrëveshje Lidhjeje.

- Centrale të tipit "Gjenerues Eolik", 50 aplikime, fuqia totale e kërkuar 4874.10 MW, realizuar 1 Marrëveshje Lidhjeje.

- Centrale të tipit "Gjenerues Termik" 2 aplikime, fuqia totale e kërkuar 300 MW, nuk është realizuar asnjë Marrëveshje Lidhjeje.
- Pergjate vitit 2023 eshte vene ne operim Impianti Fotovoltaik Karavasta 140 MWp, lidhur në anën 220 kV të Nënstacionit 220/110/35/20 kV.



Figura 109. Numri i aplikimeve në njësi të lidhura

Në krahasim me vitin 2022 është shtuar kërkesa dhe interesi për aplikim dhe marrëveshje lidhjeje në rrjetin e transmetimit për të gjitha burimet e reja të prodhimit të energjisë elektrike. Sa i përket aksesit në Rrjetin e Transmetimit, vërejmë se në krahasim me vitin 2022, kemi rritje të numrit të aplikimeve nga 117 në 140 aplikime për lidhje të reja, rreth 16% më shumë se në vitin 2022. Edhe gjatë vitit 2023, në operim është vendosur vetëm një burim gjenerues.
Për sa i përket afatit ligjor për kthim-përgjigje (60 ditë kalendarike) sipas "Rregullores të Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit", OST sh.a., ka përcjellë përgjigjet brenda afatit kohor, siç përcaktuar në rregulloren e sipërcituar.

9.8. Lidhjet e Reja në Rrjetin e Shpërndarjes

Në mbështetje të Ligjit 43/2015 Për Sektorin e Energjisë Elektrike, dhe të Rregullores për lidhjet e reja në sistëmin e shpërndarjes miratuar me vendimin Vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, i ndryshuar, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes rregullon marrëveshje me përdoruesit e sistemit të shpërndarjes të cilët kërkojnë të realizojnë një lidhje të re ose të modifikojnë lidhjet e tyre ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes. OSSH sh.a. në cilësinë e operatorit të rrjetit të shpërndarjes përcakton procedurat, afatet dhe tarifat për kryerjen e këtij shërbimi si dhe të realizon punimet, në përputhje të standardeve dhe karakteristikave teknike të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes të sektorit elektro energjitikë.



Figura 110. Aplikimet për lidhjet e reja dhe shtesë fuqie.

Sa i përket aksesit në rrjetin e shpërndarjes, gjatë vitit 2022, rezulton se ka patur një total prej 13467 aplikime për lidhje të reja apo shtesë fuqie në rrjetin e shpërndarjes, prej të cilave 10560 janë aplikime për Lidhje të Re 2907 aplikime për Shtesë Fuqie. Në krahasim me vitin 2022, grand totali i aplikimeve është ulur ndjeshëm. Aplikimet për lidhje të re referuar vitit 2022 rezultojnë 21157, mbi 35% më shumë krahasuar me këtë vit. Gjithashtu, kërkesat për lidhje të re apo shtesë fuqie kanë pësuar rënie krahasur me vitin e kaluar.

Siç evidentohet edhe nga grafiku në të majtë 78.4% e totalit të aplikimeve për vitin 2023 zënë aplikimet për Lidhje të Re dhe 21.6% aplikimet për Shtesë Fuqie.

Tirana, Durrësi dhe Shkodra, vazhdojnë të mbajnë numrin me të lartë të aplikimeve për lidhje të reja, për çdo kategori. Kukësi vazhdon të mbetet rajoni me më pak aplikime për lidhje të reja në rrjet. Kwto trende mbeten te pandryshuara nga viti 2022.

Në kuadër të aplikimeve totale për vitin 2023, OSSH sh.a. ka raportuar dhe statusin e këtyre aplikimeve, ndër të tjera veçojmë se statusi i përfunduar zë 65% e peshës së totalit të këtyre aplikimeve me 8692 aplikime, ndërsa rastet e refuzuara janë 1163. Rastet e aplikimeve të refuzuara kanë një rritje të lehtë refuar vitit 2022.

9.9. Standardet e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit

9.9.1. Standardet Për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancën e Sigurisë së Rrjetit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, ka miratuar “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë

elektrike", e cila parashikon detyrimin e shërbimit publik të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) që të përmbushë standardet e cilësisë së furnizimit të specifikuara nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit dhe nga kjo Rregullore.

Standardet e miratuara me vendimin e Bordit te ERE nr. 244, date 02.12.2021 janë në fuqi dhe të pandryshuara për vitin 2023.



Referuar diagramës, me ngjyrë portokalli paraqiten standardet e miratuara nga ERE me vendimin nr. 244/2021 ndërsa me ngjyrë gri janë paraqitur kriteret standarde të cilësisë së furnizimit të raportuar nga OST sh.a. për vitin 2023. Nga kriteret e paraqitura, shihet qartazi një ulje në të gjithë treguesit, e parë ndryshe si trend përmirësimi për vitin 2023.

Figura 111. Standartet e cilësisë së OST sh.a dhe ato të miratuara nga ERE.

Në të djathtë, paraqitet në formë grafike analitike Performanca e OST sh.a. për vitin 2023 krahasuar me Standardet e miratuara nga ERE për OST sh.a. për vitin 2022 me vendimin e Bordit nr. 244/2021.



Figura 112. Performanca e OST sh.a dhe ato të miratuara nga për vitin 2023 .

Këto tregues sikurse vërejmë edhe më sipër janë konform Vendimit të ERE nr. 244/2021, e disa prej tyre, rezultojnë të përmirësuar. Vërejmë se parametrat me lartë si *Koha Mesatare e Ndërprerjes së Furnizimit me Energji Elektrike eshtë ulur në 28.87 min nga 35* të përcaktuara në vendim, ashtu dhe Energjia e pafurnizuar duket shumë e përmiresuar në vlerat 383 MWh nga 467 MWh të miratuar. Gjithashtu tregues të rendësishëm si SAIDI (**Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve)** vijon të ulet edhe këtë vit në 42.21 min nga 100 të miratuara në vendimin e ERE. Vlera e këtij treguesi vjen tejet e përgjysmuar edhe nga vet propozimi i OST sh.a. për vitin 2022. Nga ana tjeter, Koha e Nevojshme për t'ju Përgjigjur Kërkesave për Lidhje të Reja është ulur në 25 ditë faktike, apo gjysma e kohës së miratuar nga ERE me propozimin e të licencuarit për vitin 2022.

KPI 2023	KPI 2022	KPI 2021	KPI 2020	KPI 2019
28.87 min	**29.58 min**	**28.76 min**	**35 min**	**35 min**
383.687 MW	**392.731 MWh**	**433.035 MWh**	**463.53 MWh**	**467.87 MWh**
Brenda diapazonit: +- 200 mHz.	Brenda diapazonit: +- 200 mHz.	Brenda diapazonit: +- 200 mHz.	Brenda diapazonit: +- 200 mHz.	Brenda diapazonit: +- 200 mHz.
72 orë	**72 orë**	**72 orë**	**72 orë**	**72 orë**
25 ditë	**26 ditë**	**32 ditë**	**60 ditë**	**60 ditë**
42.21 min	**50.43 min**	**70.31 min**	**71 min**	**104 min**
Brenda diapazonit: -10%, +11.8	Brenda diapazonit: -10%, +11.8	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.
Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

Figura 113. Key Performance Indicator (Treguesit kryesorë të performancës) nga OST sh.a.

Referuar sa më sipër, OST sh.a. ka raportuar Key Performance Indicator (Treguesit kryesorë të performancës) në mënyrë tabelare, të përfshirë janë parametrat nga viti 2019 deri në 2023. Gjithashtu, evidentojmë se këto tregues gjatë vitit 2023 janë përmirësuar ndjeshëm krahas viteteve të mëparshme.

Në krah është paraqitur një grafik-analitik i treguesve të cilësisë të OST gjatë 5 viteve të fundit.



Nga konstatimet e kryera, rezulton se, për vitin 2023 parametrat e cilësisë që lidhen me energjinë e pafurnizuar, kohën e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave për Lidhje të Reja janë përmirëusar ndjeshëm me vitet e kaluara, ndërkohë që rezulton me ulje qartazi indeksi i kohëzgjatjes

Figura 114. **Treguesit e cilësisë së OST sh.a. 5 vitet e fundit**

mesatare të ndërprerjes (SAIDI) nga 70.31 min në 42 min, çka rezulton në një përmirësim sikurse paraqitet në grafikun në të majtë. OST sh.a., në cilësinë e të licencuarit në aktivitetin e trasmetimit të enrgjisë elektrike ka përmirësuar ndjeshëm këto parametra krahasuar me 4 vitet e lëna pas e gjithashtu përmbush detyrimin e arritjeve të standardeve të miratuara nga ERE me vendimin nr. 244/2021.

9.9.2. Standardet e Matjes Për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes

Bordi i ERE me vendimin nr. 97/2021 ka miratuar Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes për vitin 2021. Nga ana e OSSH sh.a janë përcjellë në ERE raportet periodike në lidhje me treguesit për cilësinë e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sikurse përcaktohet në Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 181/2017 të ERE-s, ashtu si dhe vendimit nr 97/2021 sa i përket vitit 223. Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit së rrjetit të shpërndarjes mbeten të pandryshuara për vitin 2023 me treguesit në fuqi të miratuara me vendimin nr. 97/2021 të Bordit të ERE-s.



Figura 115. **Treguesit e realizuar nga OSSH sh.a për 2022, 2023 dhe treguesit e miratuar nga ERE**

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 shohim që ndërprerjet për forcë madhore vazhdojnë të zënë një peshë të lartë në total, ndërprerjet e rrjetit të OSSH sh.a., që në këtë rast kemi klasifikuar ndërprerjet për shkak të kushteve të këqija atmosferike, në performancën totale të rrjetit. Pra në vitin 2023 FM rezultojnë të zënë rreth 23% të ndërprejeve totale.

Siç vërehet edhe nga tabela në vijim, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar bazuar në të dhënat e SAIDI dhe SAIFI, përfshirë CAIDI rezultojnë se këto tregues janë përmirësuar. Një ndër llogaritjet që bëjmë për të parë ecurinë e treguesve ë performancës, është edhe krahasimi i këtyre vlerave me ato të një viti më përpara. Nga kjo analizë rezulton se vlerat e Treguesve SAIDI/ SAIFI kanë një përmirësim në krahasim me vitin 2022 prej 1 % në SAIF dhe 8.2% në SAID për total rrjetin e OSSH-së.

Krahasim i Performances se OSSH sh.a ne TL+TM+TU 2022-2023 Lidhur me Treguesit Kryesore SAIFI, SAIDI, CAIDI						
	SAIFI		SAIDI		CAIDI	
	Nr. i Konsumatoreve te prekur nga nderprerjet/ Nr. Konsumatoreve Gjithsej		Nr. i oreve te nderprerjeve gjithsej / Nr. Konsumatoreve Gjithsej		Nr. i oreve te nderprerjeve gjithsej /Nr. Kons. Te prekur nga nderprejet	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023
Janar	2.65	2.29	4.36	4.47	1.65	1.95
Shkurt	2.68	2.17	6.43	4.19	2.4	1.93
Mars	2.38	1.83	5.51	3.23	2.32	1.77
Prill	3.65	1.73	5.75	2.93	1.58	1.69
Maj	2.36	2.20	4.1	3.46	1.74	1.57
Qershor	2.49	2.17	3.92	3.40	1.57	1.57
Korrik	2.16	2.89	3.02	3.35	1.40	1.16
Gusht	2.40	2.78	3.41	4.05	1.42	1.46
Shtator	2.49	2.49	4.35	4.06	1.75	1.63
Tetor	1.80	3.06	3.38	5.65	1.87	1.85
Nentor	2.89	3.82	5.26	7.22	1.82	1.89
Dhjetor	2.97	3.31	4.47	4.17	1.61	1.26
GRAND TOTAL	31.16	30.86	54.68	50.18	1.75	1.63

Figura 116. Krahasim i Performances së OSSH sh.a në TL+TM+TU 2022-2023 Lidhur me Treguesit Kryesore SAIFI, SAIDI, CAIDI

Sa i përket SAIFI-t apo Indeksit të Frekuencës Mesatare të Ndërprerjeve, vlerat janë ulur në 2023 krahasuar me vitin 2022 përkatësisht nga 31.16 orë në 30.86 orë. Kjo ulje shihet si përmirësim i performancës së OSSH sh.a. në raport edhe me ndikimin sadopak pozitiv që këto ndërprerje sjellin tek konsumatori fundor. Vlera e përcaktuar nga ERE për SAIFI (Indeksit të Frekuencës Mesatare të Ndërprerjeve) me vendimin nr. 97/2021 është 25.08 orë. Për SAIDI apo Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve këto vlera janë përmiresuar krahasuar me vitin e kaluar. SAIDI ka pësuar një ulje nga 54.68 orë për vitin 2022 në 50.18 për vitin 2023. Sërish, vlerat e këtyre treguesve e standardeve të cilësisë janë larg targetit të përcaktuar nga ERE, që është 47.17 orë. Sidoqoftë, ky përmirësim mund te interpretohet si trend pozitiv për tëardhmen (vitin e ardhshëm).

9.10. Konsumatorët/Vetëprodhuesit e Energjisë Elektrike

Ligji nr. 24/2023 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme ka për qëllim të nxitë rritjen e përdorimit të energjisë prej burimeve të rinovueshme për të siguruar një

zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori në Republikën e Shqipërisë dhe të jetë në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë

Në përputhje me këtë ligj dhe Udhëzimin e MIE nr.3/2019, si dhe në përputhje me skemën e matjes, një shoqëri e vogël ose e mesme apo një klient familjar mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kW për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose dielli për të mbuluar një pjesë ose të gjithë energjinë që nevojitet për nevojat e tij dhe të injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes.

Si detyrë e ERE-s për të vëzhguar ecurinë e këtij tregu relativisht të ri janë kryer një serë korrespondencash me qëllim vlerësimin e impaktit që ka pasur kjo kategori prodhuesish në prodhimin bruto të vendit. Për këtë qëllim OSSH sh.a., kanë gjeneruar të dhëna të cilat mbikëqyren e analizohen periodikisht nga ERE. Në vitin 2023, është regjistruar një rritje në numrin e aplikimeve për marrjen e statusit të veteprodhuesit duke rezultuar në 982 të tilla.

Gjatë vitit 2023, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a) i ka dhënë statusin e Vetëprodhuesit 723 klientëve me një kapacitet total prej rreth 60,56 MWp duke treguar prirjen pozitive të konsumatorëve shqiptarë për të kontribuar në krijimin e një sistemi energjitik të qëndrueshëm dhe të pavarur. Pesha specifike e kategorisë së kontratave të cilat kanë të instaluar në rrjetin e shpërndarjes panele fotovoltaike, duke marrë statusin e vetëprodhuesve sipas kategorisë së konsumatorit dhe fuqisë është reflektuar në grafikun në të djathtë:



Figura 117. Kategoria e kontratave të cilat kanë të instaluar në rrjetin e shpërndarjes panele fotovoltaike

- Buxhetorë-27 me fuqi 790 FV kW
- Familjar-430 me fuqi 5375 FV kW
- Jo-buxhetor-6 me fuqi 756 FV kW
- Privat 1069 me fuqi 146,585 FV kW

Këto zhvillime pozitive inkurajojnë një tranzicion më të shpejtë drejt një mjedisi energjitik më të qëndrueshëm dhe të efektshëm.

9.11. Makinat Elektrike

Makinat elektrike janë e ardhmja e transportit dhe interesi për to është i lartë. Vendi po ecën ngadalë në përgatitjen e infrastrukturës që do të bënte të mundur përhapjen e tyre të shpejtë. Në fillim makinat elektrike provohen për kuriozitet, më pas ato kthehen në stil jetese, favorizuar nga një përparësi e madhe.
Për këtë arsye edhe Enti Rregullator i Energjisë ndër objektivat e saj të përgjithshme promovon krijimin e një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike si dhe lehtëson kushtet për pjesëmarrësit e rinj të tregut dhe atyre që prodhojnë nga burimet e rinovueshme. Për këtë qëllim, lidhur me integrimin në shkallë të gjëre të prodhimit të energjisë nga burimet e energjisë rinovueshme dhe me qëllim përdorimin e teknologjive të reja për stacionet e karikimit për makinat elektrike, ERE ka kryer një Vlerësim mbi kuadrin rregullator dhe ligjor me qellim perdorimin e teknologjive të reja për stacionet e ngarkimit të automjteve elektrike, përfshirë rregullimin e tarifimit të këtij shërbim. Ky dokument gjendet i publikuar në faqen zyrtare të ERE: www.ere.gov.al; në zërin Publikime, nën kategoria Studime.

Gjatë vitit 2023 sipas të dhënave janë instaluar 26 pika të reja për njësi të karikimit të makinave elektrike, respektivisht në Durrës 2 me fuqi të instaluar 250 kW, ndërsa në Tiranë janë në total 26 kontrata me fuqi të instaluar 2565 kW.
Megjithëse numri total i automjeteve elektrike ka pasur një rritje të qëndrueshme për më shumë se gjysëm dekade, shumë kompani dhe konsumatorë individualë ende nuk janë të vetëdijshëm sesi makinat elektrike krahasohen me makinat tradicionale me karburant.

10. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ERE

10.1 Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Ndër prioritetet e ERE-s është dhe mbetet përfaqësimi sa më dinjitoz dhe aktiv i punes se Rregullatorit në aktivitetet rajonale dhe ato ndërkombëtare, duke patur si qëllim përputhjen dhe harmonizimin e praktikave të saj me praktikat e vendeve të rajonit dhe BE-së. Qëllimi i pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ERE si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit dhe bashkëpunimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj.

Për vitin 2022, ERE ka vijuar në intensifikimin e marrëdhënieve multilaterale me organizatat ndërkombëtare si Sekretariati i Energjisë së Vjenës nëpërmjet ECRB apo dhe shoqatave si MEDREG, ERRA, NARUC, CEER, IGU, UfM OME etj. Gjatë vitit të kaluar ERE i ka kushtuar një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në trajnime, seminare, takime, workshop dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare. Interesi i stafit të institucionit tonë në këto aktivitete ka qenë i lartë për t'u njohur me eksperiencat më të mira ndërkombëtare si dhe zhvillimet e fundit në sektorin energjitik duke marrë pjesë në këto aktivitete ndërkombëtare si dhe për të prezantuar denjësisht rregullatorin në këto aktivitete me anë të fjalimeve, bashkëkryesimeve të Grupeve të punës apo dhe prezantimeve të ndryshme nëpër seminare apo dhe takime.

10.2 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare ne Organizma Ndërkombëtar

ERE vijon te jete anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Evropës Juglindore dhe Euro-Azisë (ERRA), duke realizuar një pjesëmarrje të rregullt në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të ERRA-s, takimet e Komiteteve të përhershme të ERRA-s, Konferecave te Investimeve si dhe marrjn pjese me prezantime ne keto konferenca apo dhe Grupeve të punës si atij të elektricitetit, gazit, apo dhe atij të Tarifave e Çmimeve, apo dhe konsumatorit.

ERE është anëtare e Shoqatës së Rregullatorëve të vendeve të Mesdheut (MEDREG) për energjinë elektrike. Gjithashtu, stafi i ERE-s ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e grupeve të punës perfshire dhe bashke drejtimin e grupit te punes se konsumatorit apo dhe grupet e punes se marrëdhëniet institucionale, energjitë e rinovueshme, gazit, të grupit të punës së elektricitetit duke qënë dhe draftues i materialeve apo raporteve peroidike të këtyre të fundit.

ERE ka po ashtu statusin e vëzhguesit pranë CEER (Këshilli i Rregullatorëve Evropian të Energjisë), status i cili mundëson fuqizimin dhe marrjen e njohurive të stafit të ERE-s gjatë pjesëmarrjes në grupet e punës dhe takimeve të asamblesë së Përgjithshme apo konferncave qe zhvillohen nga kjo e fundit.

ERE është pjesëmarrëse në takimet e UfM (Unioni për Mesdheun), i cili përbëhet nga 43 shteteve anëtare pjesë e Mesdheut dhe ka për qëllim të rrisë dhe forcojë bashkëpunimin rajonal si dhe implementimin e projekteve dhe iniciativave që do ti shërbenin rajonin. Në kuadër të bashkëpunimit në sektorin energjetik, UfM-së ka të hartuar platformën për sektorin e gazit natyror si dhe dy platforma të tjera në sektorin e energjisë elektrike, lidhur me burimet e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë.

ERE është anëtare me të drejta të plota në South – South-East Gas Regional Initiative (GRI SSE), e cila është Iniciativa e Rregullatorëve për Gazin në Rajonin Jug-Juglindje.

Po, ashtu ERE është anëtare me të drejta të plota në OME (Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë) forum mjaft i rëndësishem i Mesdheut per energjine.

Për vitin 2022 ERE ka vazhduar të mbajë një bashkëpunim të frytshëm me USAID dhe NARUC në projektin e përbashkët, të përkrahur nga USAID dhe NARUC në lidhje me zbatimit e strategjisë kibernetike.

ERE në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë gjatë vitit të kaluar ka marrë pjesë në Forumin e Athinës, Forumin e Gazit dhe aktivitetet e Komunitetit të Energjisë të organizuara nga Sekretariati i Vjenës si dhe grupeve të punës së këtij organizmi.

Gjithashtu ERE ka marrë pjesë në aktivitete duke bashkëpunuar në mënyrë intensive me Sekretariatin e Energjisë së Vjenës, duke u konsultuar për vendimet kryesore dhe duke kërkuar opinion për çështjet delikate. Po ashtu dhe draft vendimet e marra prej nesh si dhe draft rregulloret e hartuara nga ana jonë i janë dërguar për konsultim Sekretariatit të Vjenës ose janë realizuar takime me to për të permirsuar vendimarrjen, si dhe ndihmen e Sekretariatt Vjenës në draftimin e akteve sekondare regullatore. ERE ka ndjekur në mënyrë të rregullt dhe aktive takimet e Grupeve të Punës të ECRB për çështjet e konsumatorëve, të energjisë dhe tregut rajonal të saj, burimeve të rinovueshme, statistikave, elektricitetit, eficensës, sigurisë së furnizimit, REMIT (grup i cili kryesohet nga ana e ERE-s), gazit natyror. Për realizimin e një pune sa më të mirë dhe arritjen e rezultateve të larta, ERE ka zhvilluar takime të përbashkëta me Sekretariatin e Vjenës për sa i përket implementimit implementimit të Kodeve të Rrjetit, miratimi i të cilave vjen si detyrim që rrjedh nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe ENTSO-E.

Në Dhjetor të vitit 2022 në bashkëpunim dhe me regullatorët e Italise, Bosnje Herzegovinës, Malit të Zi dhe Maqedonise së Veriut është krijuar me qendër në Milano shkolla Ballkanike e Energjise e cila do të shërbejë për shkëmbimin e eksperiencave midis rregullatorëve. Pergjate vitit 2023 jane zhvilluar seminare me plet e interesuara per trajnimin e stafit te ERE-s dhe regullatoreve te tjere pjemarres ne Shkollen ne fjale per hapjen e tregjeve, problematikat qe lidhen me bashkimin e tregjeve apo dhe problematika te tjera si tregu i balancimit dhe nderveprimi me tregun e nje dite me pare etj. Pergjate vitit 2024 do vijohet me aktivitete te tjera ne kete prizem.

10.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s

Gjatë vitit 2022 janë intensifikuar në mënyrë të mëtejshme dhe marrëdhëniet bilaterale me Rregullatorin Italian (ARERA) si dhe atë Grek (RAE) apo dhe me regullatorin e Maqedonise se veriut apo dhe ate te Kosoves ku jane mbajtur mbledhje te perbashketa per miratimin e vendimeve qe lidhen me bashkimin e tregjeve te Shqiperise me Kosoven..

10.4 Marrëdhenit me Publikun

Strategjia e komunikimit ne ERE ka për qëllim informimin dhe promovimin me grupet e interesit dhe publikun e gjerë në lidhje me objektivat, nismat, progresin, impaktin dhe arritjet

që ka ky institucion gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Me qëllim përmbushjen e këtyre objektivave, përgjatë periudhës në fjalë, është punuar nëpërmjet krijimit dhe publikimit të materialeve ndihmëse dhe informuese, të aksesueshme lehtësisht në faqjen zyrtare të Entit Rregullator të Energjisë www.ere.gov.al, si dhe në rrjetet sociale të institucionit, në të cilat, sipas rastit dhe duke gjykuar mbi target grupet specifike, janë përshtatur në kontekst dhe në formë. Ka qënë me rëndësi bashkëpunimi me disa nga sektorët apo grupet e punës të krijuara me qëllim përpunimin e materialeve të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e ecurisë së punës së përditshme por dhe informimin e gjërë të publikut. Ndër këto të fundit mund të përmendim *Udhërrëfyesin mbi shërbimet që ofrohen nga Enti Rregullator i Energjisë,* i cili gjendet publikuar në faqjen zyrtare (në linkun https://www.ere.gov.al/images/files/2023/05/16/Udherrefyesi_2023.pdf) dhe në përmbajte jep informacion të përmbledhur, të saktë dhe lehtësisht të kuptueshëm mbi qëllimin dhe punën e përditshme të Entit Rregullator të Energjisë. Vlen për tu përmendur që disa nga publikimet qoftë në web dhe në rrjetet sociale, kanë patur në fokus kryesor informimin e konsumatorit dhe ndërgjegjësimin e këtij të fundit mbi kursimin e energjisë. Për këtë, janë përgatitur edhe disa video informuese por dhe është bashkëpunuar me partner vendas si MIE, KESH sh.a. apo OSHEE sh.a. për ripublikimin e materialeve nga njëra palë në tjetrën, me qëllim shpërndarjen dhe informimin sa më të gjërë. ERE-ka bashkëpunuar ngushtë dhe me Koordinatorin e të Drejtës për Infomim, me përgatitjen e përgjigjeve të kërkesave të ardhura në adresë të koordinatorit, brenda afateve dhe përcaktimeve të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të cilat i gjeni të reflektuara në rregjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në programin e transparencës në faqjen tonë zyrtare *(linku për akses të shpejtë https://ere.gov.al/sq/transparenca/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve).*

Gjatë vitit 2023 janë kryer mbi 150 publikime në rrjetet sociale të ERE, dhe ndër to përmendim

1. Newsletter i përmuajshëm – përmbledhje e aktiviteteve, vendimeve të marra, apo dhe ndryshimeve të bëra në rregullore të ndryshme.

- Publikime mbi skemat e kompensimit për mbrojtjen e shtresave në nevojë. Si të bëni një lidhje me rrjetin e shpërndarjes? Çfare kuptimi ka vlera referuese në faturën tuaj të energjisë? Kur dhe si duhet të paguani faturën e energjisë elektrike? Metodat e pagesës së energjisë elektrike? Si mund të lidhni një kontratë energjie elektrike? Dita botërore e të drejtave të konsumatorit,Procedura për ndryshimin e fumizuesit. Ndërprerja e furnizimit nga furnizuesi dhe rilidhja. Përfundimi i kontratës me kërkesë të klientit. Çfarë duhet të bëni për të qenë vetëprodhues? Si te besh nje lidhje me rrjetin e sherndarjes etj.

2. Studime të ndryshme
    a. Vleresimi mbi kuadrin rregullator dhe ligjor me qellim perdorimin e teknologjive te reja per stacionet e ngarkimit te automjteve elektrike, perfshire rregullimin e tarifimit te ketij sherbimi gjetjet paraprake dhe studimi mbi konsumin e energjisë elektrike në shqipëri dhe sjellja konsmatore

10.5 ERE në marrëdhëniet ndërinstitucionale

Me Urdhërin Nr.96, date 10.6.2022, të Kryeministrit të Shqipërisë, është ngritur grupi ndërinstitucional i punës për hartimin e strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikeqyrjen e tregut, 2023-2030" Enti Rregullator i Energjisë (ERE), ka qene pjese w Grupit te punes për hartimin e strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorit, me qëllim dhënien e kontributit të tij, në hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm si dhe përfshirjen e adresimin e interesave të konsumatorit të energjisë elektrike, si një kategori e veçantë konsumatori, për mbrojtjen e të cilit ERE ka ekspertizën e duhur dhe luan një rol primar. ERE, përfaqësohet në këtë GNPIE nga Znj. Erjola Sadushi, Komisionere e Bordit të ERE, si dhe Znj.Julia Guga "Drejtore në Drejtorinë e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performances dhe Standardeve' Po ashtu në kuadër të punës së zhvilluar nga ky GNPIE, qoftë në nivel të takimeve institucionale por edhe komunikimeve zyrtare, ERE ka përgatitur kontributin e saj sa i përket strategjisë për mbrojtjen e konsumatorëve ne kuadër të detyrave që burojnë nga Kapitulli 28 I *Acquis* së Bashkimit Europian dhe ka prezantuar sa përgatitur përpara komisionit në datat 16 dhe 17 shkurt 2023.

- Në datë 15 mars, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Konsumatorit, u organizua konferenca kombëtare "Varfëria Energjitike – Dialogu Politik" . Ky aktivitet u realizuar në kuadër të projektit EmpowerMed : "Fuqizimi i grave për të marrë veprime kundër varfërisë energjitike në Mesdhe" i cili adreson sfidën e varfërisë energjitike në zonën e Mesdheut, me fokus të veçantë në përfshirjen dhe fuqizimin e grave, në bashkëpunim me Milieukontakt Albania dhe Qendrën Konsumatori Shqiptar. Qëllimi i takimit ishte advokimi për adresimin e politikave dhe masave për varfërinë energjitike tek aktorët kombëtarë dhe lokal. ERE Albania - Enti Rregullator i Energjisë për Shqipërinë u përfaqësua në këtë aktivitet nga nja anetare Bordi dhe staf.
  Në panelin e diskutimit se bashku me Komisionerin Kundër Diskriminimit, përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ERE vuri theksin në rëndësinë e madhe që ka jo vetëm angazhimi në rang institucional për të adresuar sfidat që varfëria energjitike paraqet si fenomen për Rregullatorin, por edhe vendosja e urave të bashkëpunimit e bashkërendimit të planit të veprimit mes aktorëve politikëbërës, rregullatorë si dhe ndërmjetës apo përfaqësues të intresave të konsumatorëve qofshin ata në nevojë apo në kushtet e #varfërisëenergjitike ose jo. Po ashtu u adresuan dhe morren përgjigje pyetjet e organizatorëve dhe te pranishmeve sa i përket kontributit të ERE në adresimin rregullator të çështjeve të kompetencës ligjore, siç janë miratimi i rregullave të posaçme të kushteve të ndërprerjes së furnizimit për klientët në nevojë, mbikëqyrja aktive e ofrimit të shërbimit të furnizimit për klientët në kushte të pamundësisë financiare apo që u varet cilësia e jetës nga pajisjet elektrike që furnizohen me energji, miratimi i rregullave të cilësisë së shërbimit të furnizimit.
- Perfaqesues të ERE kanë kontribur gjatë vitit 2023 në realizimin e studimit të Expertise France me temë "Ndikimet e rritjes së mundshme të çmimit të energjisë elektrike dhe udhëzimet për krijimin e një Plani Kombëtar të Veprimit në lidhje me zbutjen e varfërisë energjetike". Ky studim ka prekur tema që lidhen me Kompensimin e energjisë në dispozicion për familjet në nevojë. Ky Raport është përpjekur të japë

përmbajtjen thelbësore të Planit Kombëtar të Veprimit Kombëtar (2022-2027) në lidhje me Varfërinë e Energjisë që do të synojë përmirësimin e skemës ekzistuese drejt një skeme efektive të kompensimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Ne kete studim eshte evidentuar nga ana e Expertise France kontributi i vlefshëm i ERE në lidhje me veprimet e mundshme për reformimin e sistemit të varfërisë energjetike në Shqipëri.

11. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ERE DHE ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE

11.1.Organizimi dhe Funksionimi i ERE

ERE është person juridik publik, i pavarur nga interesat e industrisë së energjisë dhe nga organet shtetërore. ERE funksionon në bazë të ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar dhe ligjit nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.

Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, neni 9, përcakton se ERE është institucioni i vetem Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit në Shqipëri dhe drejtohet nëpërmjet Bordit. Bordi i ERE-s përbëhet nga Kryetari dhe katër anëtarë të cilët përzgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me një mandat 5 vjeçar.

Enti Rregullator i Energjisë organizohet në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s me nr. 78, më datë 29.04.2020 dhe rregullores se brendshme se organizimit dhe funksioimit te ERE miratuar me vendimin e Bordit te ERE-s nr. 99 date 11.2021 Struktura organizative dhe organigrama e ERE-s përbëhet nga 63 punonjës teknikë, punonjës mbështetës dhe punonjës ndihmës, të organizuar dhe sipas hierarkisë funksionale nga Sekretari i Përgjithshëm, 7 Drejtori dhe 5 Sektore, si dhe sipas nevojave \eshte vleresuar dhe angazhimi eksperteve te jashtëm.



Figura 118. Struktura Organizative e ERE-s

Ne figuren me poshte paraqitet ne menyre grafike paraqitet pjesmarrja gjinore ne te gjitha nivelet e strukturave te ERE-s.



Figura 119. Pjesëmarrja gjinore në ERE

Struktura e ERE-s bazohet në një ndarje të qartë, me kapacitetet e nevojshme, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive që lidhen me fushat e rregullimit nga ERE në zbatim të legjislacioneve në fuqi.

Pergjate vitit 2023 cdo njësie organizativeka ushtruar detyrat funksionale të përgjithshme dhe të veçanta tme qellim permbushjen e detyrimeve ligjore te tilla si: Mbrojtja e Konsumatorit, Hartimi dhe miratimi i Akteve Nënligjore, Zhvillimit të Tregut të Gazit Natyror, Monitorimi i Tregut, Standarteve të Cilësisë, Vendosja e Tarifave dhe Çmimeve në Segmentet e Rregulluara të Tregut, Licensimi, Modifikimi, Rinovimi dhe dhënia e Autorizimeve për operimet në aktivitetet e identifikuara në ligjet respektive, Marrëdhënia institucionale brenda dhe jashtë vendit, Planifikimi e Hartimit i Buxhetit, Zhvillimi i Burimeve Njerëzore.

11.2. Rekrutimi dhe Trajnimi i Stafit në ERE

Politikat e rekrutimit dhe zhvillimit të punonjësve bazohen në dispozitat e ligjit “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Në përmbushje të detyrimit ligjor ERE si çdo vit ka hartuar planin vjetor për rekrutim të punonjësve. Në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore është orientuar drejt integrimit gjinor gjatë ushtrimit të veprimtarisë institucionale, duke synuar eliminimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, në funksion të respektimit të parimit të barazisë gjinore.

Ne vitin 2023 përfaqësimi gjinor në totalin e punonjësve aktivë paraqitet në raportin 65% për gjininë femërore edhe 35% për gjininë mashkullore, ndërkohë që ky raport në nivelet drejtuese është 40% femra dhe 60% meshkuj.

Në përmirësim dhe implementim të këtij statusi përfaqësuesit e ERE kanë marrë vazhdimisht pjesë në trajnime dhe grupe pune që janë realizuar nga organizata ndërkombëtare ku fokus kryesor ka qënë ndërgjegjësimi i barazisë gjinore dhe nën iniciativën për avancimin e grave liderë në energji me qëllim trajtimin e normave sociale të padrejta në vendin e punës dhe ndërgjegjësimin për ndryshime në politika dhe procedurat e komisioneve. Ndër aktivitete te tjera gjate vitit 2023 ka filluar përgatitja e draftit për strategjinë gjinore te ERE-s.

Në përmbushje të detyrimit ligjor ERE si për çdo vit ka hartuar kalendarin e nevojave për trajnim. Ky plan trajnimi detajuar është mbështetur në bazë të kërkesave specifike të çdo njësie organizative si dhe në përkrahje të angazhimit të punonjësve për të zhvilluar njohuritë e tyre profesionale e organizative në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe institucione te tjera kombetare dhe ndërkombëtare.

Përgjate viti 2023 është mundësuar pjesëmarrja e punonjësve në trajnimet specifike, të përgjithshme dhe sipas nevojave, por dhe ato online me qëllim thellimin e njohurive dhe përmirësimin e performancës së çdo punonjësi. Gjithashtu jane relizuar pjesëmarrje dhe trajnime te stafit të institucionit në takime dhe workshop-e të organizuara në kuadër të projekteve të ndryshme ku ERE është palë.

Kryesisht përmendim, trajnime për Rregullimin e Sistemeve të Transmisionit dhe Shpërndarjes së energjisë elektrike në Vendet e BE-së, Workshop për Rregulloren e (BE) 2022/869 mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike trans-evropiane, trajnim për zbatimin e rregulloreve të eneteve rregullatore ne rajon etj.

Gjate vitit 2023 ERE ka qënë pjesë e tryezave të ndryshme ndër instituconale të cilat kanë patur fokus përmirësimin dhe zhvillimin e sektorit të energjise elektrike në vend, e ndër të tjera ka qënë aktive në diskutime mbi mbështetjen për iniciativa që përshpejtojnë tranzicionin drejt energjisë së gjelbër, miratimin e masave për të adresuar sigurinë e furnizimit të gazit dhe për të përmirësuar mbrojtjen e konsumatorit; integrimin e matësave dhe rrjetit inteligjent si dhe rritja e bashkëpunimit të vendeve të rajonit për një qasje të përbashkët ndaj sfidave të tranzicionit energjetik. Kontributi i ERE-s nuk ka munguar edhe në përgatitjen përmbajtësore të takimeve dypalëshe për shqyrtimin analitik të acquis (Screening) në kuadër të negociatave me Bashkimin Evropian. Përvec kontributit në sektorin energjitik gjate ketij viti nuk kanë munguar iniciativat dhe kontributi në mbështetje të fushatave sociale sensibilizuese si “Tetori Roze” si dhe “Dita ndërkombëtare fëmijëve”.

Enti Rregullator i Energjise ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 35/2023, datë 25.5.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” i ndryshuar, duke rishikuar nivelin e pagave dhe trajtimin financiar te punonjesve ne perputhje me kerkesat e ligjit 43/2015 si dhe ecurine e nivelit te pagave ne sektorin e energjisë elektrike dhe te gazit natyror.

Adresa: Komuna e Parisit, Pallati Niku Konstruksion, Kati 7, Ap. 61
consultingpartnersshpk@gmail.com

Auditues Ligjor

Kondor Çeka

License: Nr. 480; 16.09.2021
Adresa: Nj.8, nr.2, Rruga Luigj Gurakuqi, P.18, Hyrja 4, Ap.21, Tirane
e-mail: dori.ceka@viar.al

Tiranë, më **28.03.2024**

Aneks 1. Letra e menaxhimit

Gjetje	Rekomandime	Komentet e drejtimit
Përgatitja e Pasqyrave Financiare		
Audituesit Ligjor konstatojnë se ERE nuk ka një metodologji të miratuar për mënyrën e trajtimit të llogarive të arkëtueshme të cilat arkëtohen me vonëse ose nuk arrijnë të arkëtohen. Më dhjetor 2023 shuma e debitoreve të parkëtuar mbi 360 ditë është 5,239 mijë lekë.	Në fund të çdo periudhe raportimi, Entiteti në bazë të një metodologjie duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar dhe nëse ekziston një evidencë objektive të zhvlerësimit, Entiteti duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.	Marrim në konsideratë rekomandimin e audituesve.
Struktura e Teknologjise e Informacionit (IT)		
Entiteti nuk ka në strukturë staf efiçent për mbulimin e sistemit të IT.	Entiteti duhen të investojë për funksionimin e një strukturë të IT-e efektive për aktivitetin e tij në mënyrë efiçente.	Marrim në konsideratë rekomandimin e audituesve.

Shtojcë

Kërkesat e Ligjit nr. 43/2015, Nenin 11 pika 7

Audituesit kanë konstatuar se ERE ka përcaktuar pagën dhe strukturën me anë të vendimit nr. 214/2023 dt. 30.06 2023 "Regulloren "PER caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përftitimeve të të punësuarve në ERE" në perputhje me ligjin nr. 35/2023,datë 25.5.2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi" dhe me sa përcaktuar ne Ligjin nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" nenit 11 pika 7 dhe Ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".

Përgjegjësia e Drejtimit për Objektivat dhe Kufizimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm

Komentet e mëposhtme u referohen përgjegjesisë së Drejtimit për sistemin e brendshem të kontrolleve, ku objektivat dhe kufizimet e qenësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm janë marrë nga Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilisteve.

Përgjegjësia e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të kontrolleve të brendshme. Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, Drejtimi duhet të vlerësojë përfitimet dhe kostot e pritura përkatëse të politikave dhe procedurave për kontrollet e brendshme.

Objektivat

Objektivat e sistemit të kontrollit të brendshem janë qe të japin siguri drejtimi, sa më shumë të jetë e mundur, që asetet të jenë të mbrojtura nga perdorimi i paautorizuar ose keqpërdorimi, dhe se transaksionet janë ekzekutuar në përputhje me politikat e drejtimit dhe të regjistrohen saktë, në mënyrë që të mundësohet përgatitja në kohë e informacionit të besueshem financiar në perputhje me parimet e zbatueshme të kontabilitetit.

Kufizimet

Për shkak të kufizirneve të qenësishme në çdo sistem të kontrollit të brendshëm, gabimet apo parregullsitë, mund të ndodhin dhe të mbeten të pazbuluara. Gjithashtu, parashikimi i çdo vlerësimi të sistemit të kontrollit të brendshëm për periudhat e ardhshme është subjekt i rrezikut që politikat dhe procedurat mund të bëhen të papërshtatshme për shkak të ndryshimeve të kushteve ose efektiviteti i hartimit dhe i zbatimit të politikave dhe procedurave mund të përkeqësohet.

SHTOJCA 2. Raporti i Performancës

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2023

LETER REKOMANDIMI E PROFESIONISTËVE TË PAVARUR

Drejtuar: Kryetarit dhe Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)

Gjatë planifikimit dhe kryerjes së procedurave tona për të shqyrtuar informacionin jo-financiar të paraqitur në Raportin Vjetor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 ("të dhëna të zgjedhura"), me qëllim dhënien e sigurisë së kufizuar ne morëm në konsideratë strukturën e kontrollit të brendshëm të Entit në mënyrë që të përcaktonim procedurat e Angazhimit për Dhënien e Sigurise planifikuar dhe kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar SNAS 3000, "Angazhimet e Dhënies së Sigurise ("SNAS 3000") që ndryshojnë nga Auditimet ose Rishikimet e Informacioneve Financiare Historike", me qëllim që të jepnim një opinion për dhënie sigurie të nivelit të kufizuar për:

- *Verifikimin e informacioneve shpjeguese cilësore dhe sasiore të paraqitura me strukturat organizative te ERE-s si dhe në Raportin Vjetor 2023 në mënyrë specifike për gjendjen në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në krahasim me kriteret e zbatueshme ("Kriteret e Përformances", të ilustruara në Raportin Vjetor), mbështetur në Ligjin nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar.*

Ne kemi raportuar vetëm ato çështje që kanë qenë në vëmendjen tonë gjate procesit të këtij angazhimi duke përfshirë dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm deri në masën e nevojshme për të përcaktuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të tjera. Puna jonë nuk ka pasur si qëllim kryesor zbulimin e dobësive, zbulimin e mashtrimeve ose parregullsive të ngjashme dhe si rrjedhim nuk duhet të merret si bazë që asnjë dobësi tjeter nuk ekziston.

Çështjet e ngritura në këtë leter janë vetëm ato të cilat kanë qenë në vëmendjen tonë gjatë këtij angazhimi dhe që ne besojmë se duhet të sillen në vëmendjen tuaj. Nuk përfshihen të gjitha çështjet e mundshme, dhe në veçanti, ne nuk mund të jemi përgjegjës për raportimin e të gjitha rreziqeve në biznesin tuaj ose të gjitha dobësive ne kontrollit e brendshëm. Rrjedhimisht, komentet në këtë letër i referohen vetëm çështjeve, të cilat kanë ardhur në vëmendjen tonë gjatë rrjedhës normale së punës sonë dhe nuk paraqet të gjitha përmirësimet e mundshme, të cilat mund të identifikohen nga një shqyrtim i veçantë.

Ky raport lëshohet vetëm për qëllim informativ dhe për përdorim nga Drejtimi dhe Bordi i ERE, e për rrjedhojë nuk mund të përdoret nga persona të tjerë.

Ne duam të shprehim vlerësimin tonë ndaj drejtimit dhe punonjësve për ndihmën dhe bashkëpunimin përgjatë procesit.

Nexia-AL sh.p.k
Orjana Kalaja
Auditues Ligjor
License Nr.284

Viar-Consulting
Fatime Alliu
Auditues Ligjor
License Nr.166

2

REKOMANDIME TË AUDITUESVE TË PAVARUR PËR VLERËSIMIN E PËRFORMANCËS 2023

1. Automatizimi i mënyrës së raportimit të licensuarve pranë ERE

Çështje
Gjatë kryerjes së procedurave tona për të shqyrtuar informacionin jo-financiar të paraqitur në Raportin Vjetor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023, ne vumë re që përpunimi i informacionit në lidhje me Bilancin Energjitik kryhej në formate excel në departamentin e monitorimit në bazë të raportimeve të kryar nga operatoret e licensuar.

Këto formate raportimi ishin të ndryshme në varësi të secilit operator, nga ku ERE, konsolidon të dhënat më pas në mënyrë manuale, gjë që kërkon kohë dhe mund të jetë subjekt i gabimeve manuale.

Impakti
ERE, përgatit Raportin Vjetor, mbështetur në Ligjin nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar, megjithatë, nuk ka implementuar një sistem informatik gjithëpërfshires për konsolidimin e informacionit nga entitetet raportuese pa patur nevojën e ndërhyrjeve manuale.

Rekomandimi
Të krijohet një tool në excel monitorues dhe raportues i cili te unifikojë mënyren e raportimit të entiteteve të licensuar nga ERE. Në këtë tool çdo operator i sektorit energjitik duhet të ketë mundësinë të raportojë dhe dokumentojë në mënyrë të standardizuar bilancin e tij energjitik, gjë që duhet të lehtësojë edhe procesin e konsolidimit të të dhënave në mënyrë të standardizuar.
Gjithashtu është evidentuar pamundësia e garantimit të një shërbimi cilesor që lidhen me inspektimet e të licensuarve ku përfshihen realizimet e inspektimeve të thelluara rastësore.

Komentet e Drejtimit
ERE sipas parashikimeve në Buxhetin e vitit 2023 ku në zërin për investime në automatizimin e mënyrës së raportimit të pjesëmarrësve të tregut në ERE ishte parashikuar një fond ka përfunduar kontratën për realizimin e kësaj platforme. Aktualisht pritrt të realizohen testimet dhe trainimet me të licensuarit për përdorimin e kësaj platforme dhe vijimin e raportimeve nëpërmjet saj, proces i cili pritet të përfundojë brenda muajit maj 2024.

3

2. *Mbivendosje funksionesh në strukturën organizative të ERE*

Çështje

Gjatë kryerjes së procedurave tona për të shqyrtuar informacionin jo-financiar të paraqitur në Raportin Vjetor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023, ne vumë re që disa funskione monitorimi ndaj operatorëve të licensuar pranë ERE janë të përsëritura dhe të mbivendosura përkatesisht pranë Departamentit të Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve, si edhe pranë Departamentit të Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes.

Gjithashtu ne vumë re se sipas kërkesave të Ligjit nr. 43/2015, Nenin 11 pika 7 ERE ka përcaktuar pagën dhe strukturën në përputhje me këto kerkesa. Kështu me anë të vendimit nr. 46, nr. 47 dhe nr. 61 të vitit 2016 janë miratuar Rregullorja për trajtimet financiare bazë të punonjësve të ERE, trajtimi financiar bazë me karakter të përkohshem si edhe përcaktimi i nivelit të trajtimit financiar bazë për kushtet e tregut të punës.

Impakti

Mbivendosja e funksioneve dhe përseritja e tyre në disa departamente, bën që të rriten kostot operacionale si edhe përseritje procedurash për subjektet e licensuara duke shtuar burokracitë dhe kohën e procesimit të informacioneve.

Rekomandimi

Të rishikohet struktura organizative e ERE si edhe përshkrimi i roleve të secilit department, duke parë mundësinë që funksionet mos të jenë të përsëritura por të rritet koordinimi midis departamenteve në menyre që të kontribuojë në rritjen e eficensës në kryerjen e proceseve të ndryshme administrative. Po ashtu verehet qe ambjentet e punes ne ERE nuk ofrojne kushte optimale per punojesit dhe per sherbimet ndaj konsumatoreve, te licensuarve si dhe pozicionit qe ERE ze në sektorin e Energjisë brenda dhe jashtë vendit.

Duhet vlerësuar mundësia e sigurimit të ambjenteve të përshtateshme për kryerjen e funksioneve të dhe shërbimeve të ERE sipas standarteve.

Komentet e Drejtimit

ERE, ka realizuar analizën përkatëse lidhur me ndarjen e funksioneve të drejtorive respektivisht DLAM, DMTI dhe DMKPS. Nga analiza rezulton se detyrat e këtyre drejtorive janë të ndara sikurse vijon:

- DLAM kryesisht realizon mbikqyrjen e kushteve të licenses, në të njëjtën kohë DMTI realizon procesin e monitorimit të tregut me shumicë të energjisë elektrike ku rol të vecantë kanë transaksionet në tregun e energjisë elektrike,
- DMPKS realizon mbikqyrjen e standarteve të cilësisë së furnizimit me energji elektrike në tregun me pakicë të energjisë.

ERE në vijim, në përputhje me dinamiken e zhvillimit të tregut të energjisë, si dhe eksperiencave të institucioneve homologe ka përgatitur rishikimin e organigramës e cila do të pasohet me ndryshimin e strukturës organizative për shmangjen e këtyre mbivendosjeve në detyrat funksionale. Në këtë kuadër të rishikohet dhe të përshtatet rregullorja e funksionimit të ERE në përputhje me strukturen e përgatitur. Bordi i ERE në përputhje me Ligjin nr. 43/2015, ka përcaktuar pagën dhe strukturën në përputhje me Nenin 11 pika 7 të ligjit. Për më tepër Bordi ka marrë parasysh edhe kushtet e tregut dhe nivelin e pagave të subjekteve që kontrollohen nga ERE në procesin e përcaktimit të tyre për punonjësit e saj proces i cili në perputhje dhe me Ligjin nr. 35/2023,datë 25.5.2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi" në perputhje me të cilën është miratuar me Vendimin 214/2023 dhe Regullorja "Për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në ERE".

Eshtë për tu theksuar po ashtu se ERE duhet të parashikojë në buxhet dhe në vijim marrjen e ambienteve të përshtatshme me qera për krijimin e kushteve për punonjësit pasi aktualisht ambientet e ERE-s nuk krijojnë mundësinë e funksionimit optimal të strukturës apo dhe sfidave që i dalin në hapjen e tregut apo dhe fushat si bashkëpunim me entet e tjera rajonale apo dhe më gjerë.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2023

REKOMANDIMET PËR VITIN 2023 SIPAS REZOLUTËS "PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ERE PËR VITIN 2022"

1. Nxitja e investimeve për prodhimin e energjise elektrike nga burimet e rinovueshme

Çështje
Të luajë një rol proaktiv dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët për të bërë të mundur lehtësimin e barrierave dhe nxitjen e investimeve në rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme (dielli, era dhe forma të tjera), shfrytëzimi i burimeve diellore dhe të erës do të përmiresonte ndjeshëm sigurinë energjitike të vendit duke diversifikuar burimet e energjisë dhe duke e bere sistemin më pak të ekspozuar ndaj ndikimeve klimatike.

Impakti
Lehtësimi i barrierave dhe nxitja e investimeve do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

Rekomandimi
Përcaktimi i afateve të pritshme për finalizimin e këtij procesi.

Komentet e Drejtimit
Për plotësimin e këtij rekomandimi ERE ka zhvilluar një sërë korrespondencash me OSSH sh.a. për të kërkuar informacion për të krijuar një panorame më të gjerë në lidhje me situatën dhe potencialin e burimeve të vogla të rinovueshme si ato fotovoltaike.

ERE ka kërkuar informacion subjekteve tregëtarë, lidhur me shkallën e interesit të shfaqur gjatë vitit 2023 nga konsumatorët e energjisë elektrike për instalimin e paneleve fotovoltaike për kategorinë e konsumatorëve familjarë dhe jofamiljarë si dhe një vlersim nga ana e subjekteve tragtarë në lidhje me masën e kthimit të investimit të kryer për këto impiante.

ERE ka qene pjese aktive e bashkepunimit me MIE ne draftimin e Ligjit "Per nxitjen e perdorimit te energjise nga burimet e rinovueshme" i cili ka hyre ne fuqi ne Prill te vitit 2023.

5

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2023

2. *Miratimi i akteve rregullatore për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*

Çështje
Të angazhohet në miratimin në një kohë sa më të shkurtër të akteve rregullatore që dalin si detyrim pas miratimit në Kuvend të ligjit "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

Impakti
Nxitja e investimeve të burimeve të vogla të rinovueshme nepërmjet krijimit të një terreni ligjor optimal, do ishte mjaft impaktuese për diversifikimin e prodhimit të energjisë por edhe në uljen e shpenzimeve konsumatore me qëllim garantimin e furnizimit me energji elektrike.

Rekomandimi
Materializimi i informacioneve të marra nga korrespondeca me OSSH sh.a dhe MIE, në raporte, relacionë, apo akte konkrete me qellim nxitjen e investimeve.

Komentet e Drejtimit
Për plotësimin e këtij rekomandimi ERE ka vijuar korrespondenca me OSSH sh.a. apo dhe OST sh.a. për të kërkuar informacion për të krijuar një panorame më të gjerë në lidhje me situatën dhe potencialin e burimeve të vogla të rinovueshme si ato fotovoltaike apo dhe korespondencen me te licensuarit lidhur hyrjen ne pune te impianteve te prodhimit te energjise elektrike nga burimet e rinovueshme si impianti i Karavastase me fuqi 140 MWp, licensat e dhëna në impiante për të cilat është marre autorizimi në MIE përgjatë vitit 2022-2023. Të dhënat e marra nga OSSH sh.a janë analizuar dhe janë bërë pjesë e raportit Vjetor.

Përvec sa më sipër, ERE në mënyrë periodike ka mbledhur të dhëna në lidhje me impaktin që burimet e rinovueshme, vecanërisht ato fotovolatike (vetëprodhuesit si një kategori në rritje vitin e fundit) kanë në bilancin energjitik, dhe ka mbajtur korespondenca të vazhdueshme me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjitikës , me qëllim plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor që do të lehtësojë rritjen e peshës se kësaj kategorie prodhuesish në prodhimin vendas e do të kontribuojë në uljen e shpenzimeve të konsumatorit sa i përket konsumit familjar të energjisë elektrike sic është draft VKM "Për miratimin e rregullave, procedurave dhe skemën mbështetëse të faturimit neto për vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme".

Duke qenë se aktualisht ligji për burimet e rinovueshme është miratuar, ERE është angazhuar dhe ka marrë masa për nxjerrjen e një sërë aktesh të rendesishme sic janë;

(i) Metodologjia mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme për t'u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike për të cilen ERE ka filluar procedurën dhe është në proces të konsultimeve të dokumentit me palët e interesit;
(ii) Rregullorja për Lëshimin, Transferimin, Shlyerjen dhe Revokimin/Anullimin e Garancive të Origjinës për Energjinë Elektrike të Prodhuar nga Burimet e Rinovueshme për të cilën po ashtu është filluar procedura dhe dokumenti po konsultohet me palet;
(iii) Kushtet e përgjithshme të Kontratës për Diferencë e cila është në fazën e përgatitjes.

3. Draft rregullorja për kriteret specifike për përfitimin e statusit të klientëve në nevojë

Çështje
Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, të bashkëpunojë me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe aktorët e tjerë në draftimin e rregullores për kriteret specifike dhe procedurat për përfitimin e statusit të klientëve në nevojë të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Impakti
Aksesimi i "Klientit në nevojë" në disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në përputhje me kriteret specifike dhe procedurat për përfitimin e statusit të klientëve në nevojë.

Rekomandimi
Draftimi i rregullores për kriteret specifike dhe procedurat për përfitimin e statusit të klientëve në nevojë të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Komentet e Drejtimit
Gjatë vitit 2023 ERE me ngritjen e grupit të punës ka realizuar dhe miratuar një vlerësim mbi politikat rregullatore për mbrojtjen e klientëve në nevojë në sektorin e energjisë elektrike. Në realizimin e këtij studimi janë mbajtur në konsideratë analizimi i të dhënave si:

- Varfëria energjitike dhe konsumatorët në nevojë në BE;
- Varfëria energjitike dhe konsumatorët në nevojë në Palet Kontraktore te Traktatit të Komunitetit të Energjisë;
- Faktoret që ndikojnë ne vleresimin e varferise energjitike;
- Krijimi i observatorit të varfërisë energjitike të Bashkimit Europian dhe Energy Advisory Hub;
- Monitorimi i Varferise Energjitike;
- Programet e Varferise Energjitike;
- Komunitetet e Energjise per zbutjen e varferise energjitike;
- Shqipëria dhe legjislacioni për konsumatorët në nevojë dhe varfërinë energjitike;
- Rekomandimet e ERE.

Gjetjet e këtij vlerësimi të ERE u janë përcjellë të gjitha palëve të identifikuara të interesit duke përfshirë ministritë përgjegjëse për draftimin e kritereve të idnetifikimit të klientëve në nevojë apo edhe shoqatave që në objekt të veprimtarisë së tyre kanë mes të tjerave dhe mbrojtjen e kësaj kategorie.

4. Adresimin në kohë reale të kërkesave për informacion të konsumatorit

Çështje
Të marrë masa që numri i gjelbër të jetë funksional dhe të ketë stafin përkatës, i cili bën të mundur adresimin në kohë reale të kërkesave për informacion të konsumatorit, si dhe jep orientimet për adresimin më të shpejtë të ankesave sipas legjislacionit në fuqi. Në të njëjtën kohë, duke patur parasysh fuqinë e mediave sociale, të jetë më aktiv në promovimin përmes tyre të të drejtave të konsumatorëve, sensibilizimin e tyre mbi kursimin e energjisë elektrike, broshurave informative për konsumatorin, si dhe informacione të tjera që i shërbejnë konsumatorit.

Impakti
Adresimi në kohë reale i kërkesave për informacion të konsumatorit si edhe realizimi i orientimit për adresimin më të shpejtë të ankesave.

Rekomandimi
Promovimi proaktiv përmes mediave sociale të të drejtave të konsumatorëve, sensibilizimin e tyre mbi kursimin e energjisë elektrike, broshurave informative për konsumatorin, si dhe informacione të tjera që i shërbejnë konsumatorit.

Komentet e Drejtimit
Gjatë vitit 2023 është realizuar dhe arritur nëpërmjet disa mjeteve të komunikimit ku peshën më të madhe e zë Vënia në funksion e numrit të gjelbër për informimin e konsumatorit.

Aktualisht konsumatorët telefonojnë rregullisht për të pyetur për stautsin e ankesës së bërë pranë ERE-s, por edhe për të marrë informacion të përgjithshëm mbi cështjet e tyre të interesit. Nga ana e strukturave përgjegjëse për menaxhimin e numrit të gjelbër jepen përgjigjet lidhur me trajtimin e ankesës si dhe orientohen gjithashtu për të ndjekur në faqën zyrtare të ERE-s në regjistrin e ankesave që përditësohet rregullisht.

Ky numër telefonik reklamohet jo vetëm në faqen zyrtare të ERE-s dhe në rrjetet sociale por dhe në shkresat e drejtorisë së DMPKS.

Përgjatë vitit 2023 janë organizuar disa aktivitete ndërkombëtare të organizatave në të cilat ERE aderon, ku objekti i diskutimit dhe fokusi ka qënë pikërisht arritja te konsumatori me informacion utilitar dhe aktivizimi i tij.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2023

5. *Implementimi i platformës së krahasimit të cmimeve*

Çështje
Të rrisë përpjekjet për implementimin brenda vitit 2024 të platformës së krahasimit të cmimeve {Price Comparison Tool), e cila u ofron furnizuesve mundësinë e paraqitjes së cmimeve të energjisë elektrike për konsumatorët që zgjedhin të furnizohen nga tregu i lirë duke i dhënë mundësinë e vlerësimit në mënyrë transparente të ofertave.

Impakti
Ju ofrohet furnizuesve mundësia e paraqitjes së cmimeve të energjisë elektrike për konsumatorët që zgjedhin të furnizohen nga tregu i lirë duke ju dhënë mundësinë e vlerësimit në mënyrë transparente të ofertave.

Rekomandimi
Implementimin brenda vitit 2024 të platformës së krahasimit të cmimeve {Price Comparison Tool) të energjisë elektrike nga furnizuesit për konsumatorët.

Komentet e Drejtimit
Platforma e krahasimit të cmimeve (PCT) është kontraktuar nga ana e ERE-s përgjatë vitit 2023 në përputhje me parashikimet e buxhetit të vitit 2023. Përgjatë fundit të vitit 2023 dhe fillimit të vitit 2024 nga ana e ERE janë zhvilluar trainime me përfaqësues të shoqatës së Furnizuesve dhe tregtarëve të energjisë elektrike për të mundësuar hedhjen e të dhënave në platformë e cila do të jetë funksionale brenda Prillit të vitit 2024.

6. Bashkimin e tregjeve në bursë edhe me Maqedoninë e Veriut / Malin e Zi

Çështje
Të vijojë kontributin e saj për bashkërendimin e punës mes rregullatorëve, TSO-ve dhe bursës për të mundësuar bashkimin e tregjeve jo vetëm ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe më tej me Maqedoninë e Veriut apo Malin e Zi.

Impakti
Funksionimi i bursës për të mundësuar bashkimin e tregjeve jo vetëm ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe më tej me Maqedoninë e Veriut apo Malin e Zi sjell lehtësim në bashkimin e tregjeve me vendet fqinje dhe modelin e synuar Europian.

Rekomandimi
Bashkërendimin e punës mes rregullatorëve me vendet fqinje për të mundësuar bashkimin e tregjeve edhe me Maqedoninë e Veriut apo Malin e Zi.

Komentet e Drejtimit
Në lidhje me këtë detyrë në përputhje dhe me Memorandumin e mirëkuptimit të nënshkruar në nëntor 2023 mes rregullatorëve, OST-ve dhe Bursave të Shqiperise, Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Greqisë synohet vijimi i punës për bashkërendimin e punës dhe përafrimin e legjislacionit apo dhe marrëveshjeve teknike për bashkimin e tregjeve me vendet e rajonit. Nëpërmjet platformës së trajnimit që do të trajtohen nëpërmjet shkollës së Balkanit të energjisë e krijuar me pjesëmarrjen e Italisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Bosnjes pjesë e së cilës u bë dhe Greqia do të shihet mundësia e trainimit të stafeve të Rregullatorëve për barrierat dhe sfidat e mundshme që dalin në vijim të këtij procesi.

7. *Bashkëpunimi me Albgaz për riparimin e TEC Vlore dhe mundësinë e injektimit të gazit në rrjetin TAP*

Çështje
Të vijojë bashkëpunimin me Albgaz sh.a. lidhur me tubacionin nga Terminali në Vlorë deri në pikën e takimit me TAP në Fier, e cila, nga njëra anë, krijon mundësinë e përshpejtimit të riparimit të TEC-it Vlorë dhe të vendosjes së tij në punë dhe, nga ana tjetër, krijon mundësinë që të injektohet gaz edhe në rrjetin e TAP-it për nevojat e rajonit.

Impakti
Funksionimi i tubacionin nga Terminali në Vlorë deri në pikën e takimit me TAP në Fier dhe riparimi i TEC-it Vlorë krijon mundësinë që të injektohet gaz edhe në rrjetin e TAP-it për nevojat e rajonit.

Rekomandimi
Bashkëpunimi me Albgaz për funksionimin e tubacionin nga Terminali në Vlorë deri në pikën e takimit me TAP në Fier e cila krijon mundësinë e përshpejtimit të riparimit TEC-it Vlorë si edhe krijon mundësinë që të injektohet gaz edhe në rrjetin e TAP-it për nevojat e rajonit.

Komentet e Drejtimit
Në lidhje me realizimin e këtij rekomandimi ERE nëpërmjet korrespondencës drejtuar MIE dhe Albgaz, ka ofruar ndihmesën dhe bashkëpunimin dhe dhënien e asistencës së nevojshme për çështje të kompetencës së saj, për të bërë të mundur ndërtimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror si dhe është kërkuar informacion lidhur me parashikimet dhe planet e investimet strategjike për ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror. Në po këtë proces është vijuar dhe me nisjen e procedurave të miratimit të planit të zhvillimit 10 vjecar të Albgaz e cila është në procesin e konsultimeve me palët e interesit pjesë e së cilës është dhe ndërtimi i tubacionit nga terminali në Vlorë në pikën e TAP në Fier.

8. Ndihmesë në funksionimin e tregut të gazit

Çështje

Në bashkëpunim me aktorët e tjerë të fushës, të ndërmarrë veprime koherente dhe me objektiva të qartë për të krijuar një treg funksional gazi, që shfrytëzon potencialin e infrastrukturës ekzistuese në vend dhe krijon bazat e tregut për planet e zhvillimit të infrastrukturës.

Impakti

Funksionimi i tregut të gazit krijon mundësinë që të injektohet gaz si edhe bazat e tregut për planet e zhvillimit të infrastrukturës.

Rekomandimi

ERE të japë ndihmesën e saj në bashkëpunimin me palët si edhe asistencën e nevojshme për ato problematika që janë në kompetencat e saj për realizimin e këtij procesi.

Komentet e Drejtimit

Në lidhje me realizimin e këtij rekomandimi ERE nëpërmjet korrespondencës drejtuar MIE dhe Albgaz, ka ofruar ndihmesën dhe bashkëpunimin dhe dhënien e asistencës së nevojshme për çështje të kompetencës së saj, për të bërë të mundur ndërtimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror si dhe është kërkuar informacion lidhur me parashikimet dhe planet e investimet strategjike për ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror apo dhe projekteve pilote për gazifikimin e rrethit të Korcës nëpërmjet takimeve me MIE dhe me perfaqesues të SOCAR.

12

9. *Vijojë bashkëpunimi me Agjencinë e Eficencës për përdorimin eficent të energjisë*

Çështje
Të vijojë bashkëpunimin me Agjencinë e Eficencës për hartimin e një strategjie të përbashkët afatmesme për adresimin e cështjeve me interes të konsumatorit sa i përket përdorimit eficent të energjisë.

Impakti
Futja e teknologjive të karikimit për makinat elektrike dhe shtimi i këtyre stacioneve. Duke qenë se përdoruesve të tyre do ju shtoheshin akoma më tepër mundësitë për karikim, kjo do nxiste edhe më tepër përdorimin e mjeteve elektrike, që do të sillte një impakt pozitiv në reduktimin e ndotjes nga emëtimet.

Rekomandimi
Duke marrë parasysh rëndësinë dhe impaktin e kësaj çështje, nga ana e ERE-s shihet e nevojshme nxjerrja e konkluzioneve në lidhje me opsionet dhe zgjidhjet përkatse, sa më shpejt të jetë e mundur.

Komentet e Drejtimit

Për plotësimin e këtij rekomandimi ERE ka adresuar disa korrespondenca me Agjensinë e Eficencës duke i kërkuar koordinimin e punës me qëllim adresimin më të shpejtë dhe eficient të çështjeve të interesit për konsumatorin apo informimin e tyre në lidhje me synimin tonë të përbashkët, mbrojtjen e interesave të konsumatorit si edhe përdorimin eficient të energjisë elektrike.

Lidhur me sa më sipër, aktualisht ERE është në negociata zyrtare me Agjencinë e Eficiencës për përgatitjen e borshurave informativeme qëllim lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi për koordinimi e punëve sa I përket të cilat do të synojnë të përcjellin këtë informacion të konsumatorit për të adresuar kësisoj bashkërisht këtë çështje interesi të përbashkët. Nga ana e ERE do të bëhen përpjekjet më të mira që broshura që do të përgatitet për këtë qëllim të mbërrijë tek çdo konsumator.

Po ashtu, gjatë vitit 2023 janë realizuar komunikime të vazhdueshme të mesazheve sensibilizuese për konsuamatorët me qëllim ndërgjesimin e tij në përdorimin më eficient të energjisë elektrike të tillë si informacione se si të kursejmë energji, si funksionon e operon Sistemi ngrohës/ftohës, si ndikon matësi inteligjent në menaxhimin e konsumati familjar apo edhe njohuri në lidhje me përdorimin eficient të pajisjeve eletkroshtëpiake dhe informacion mbi konsumin mesatar të tyre.

10. Implementimi i sistemit të lëshimit, anulimit dhe tregtimit të garancive

Çështje
Gjatë vitit 2023-2024 të punojë për implementimin e sistemit të lëshimit, anulimit dhe tregtimit të garancive të origjinës në përputhje me standardet e BE-së.

Impakti
Implementimi i sistemit të lëshimit, anulimit dhe tregtimit të garancive të origjinës në përputhje me standardet e BE-së.

Rekomandimi
Të bëhen përpjekje për implementimin e sistemit të lëshimit, anulimit dhe tregtimit të garancive të origjinës në përputhje me standardet e BE-së.

Komentet e Drejtimit
ERE në Maj të vitit 2023 ka firmosur me shoqerinë Grexel e përzgjedhur nga Sekretariati i Energjisë në Vienë, kontratën për shërbimin e mbajtjes së regjistrit elektronik të garancive të origjinës në vendet e Traktatit të Energjisë së vendeve të Evropës Juglindore. Sa më siper shënon një hap të rëndësishëm në njohjen e Garancive të Origjinës në vendet e rajonit. Në po këtë kuadër përgjatë vitit 2024 do të realizohet dhe pjesmarrja e plotë e ERE-s në Shoqatën Evropiane te Autoriteteve lëshuese të garancive të Origjinës (AIB). Përgjatë 2023 janë lëshuar Certifikata të Garancisë së Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme për të licencuarit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te cilat do te regjistrohen ne platformen elektronike GREXEL pergjate vitit 2024.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2023

STATUSI I ÇËSHTJEVE SIPAS LETRES SE DREJTIMIT TE VITIT 2021

1. *Zvogëlimi i barrierave rregullatore*

Çështje
Me qëllim zvogëlimin e barrierave rregullatore dhe shkurtimin e kohës së procedurave rregullatore, të kryeje një analize ex-post të rregulloreve përkatëse.

Impakti
Rishikimi dhe kryerja e një analize të rregulloreve aktuale, bën të mundur që të identifikohen mangësitë përkatëse, bazuar gjithashtu edhe në evidencat apo rastet specifike që mund të jenë raportuar, si pasojë e barrierave dhe burokracive rregullatorë. Dobësitë dhe problematikat e nxjerra nëpërmjet kësaj analize ex-post, shërbejnë për të përmirësuar kuadrin rregullator në vijim.

Rekomandimi
Realizuar me vendimin 220/2022.

Komentet e Drejtimit
Realizuar me vendimin 220/2022.

15

STATUSI I ÇËSHTJEVE SIPAS LETRES SE DREJTIMIT TE VITIT 2020

1. Pronësia e kabinave elektrike

Çështje
ERE për zgjidhjen e problematikës së pronësisë së kabinave elektrike të bëjë propozimet përkatëse edhe për ndryshime ligjore, nëse është e nevojshme, apo të japë rekomandimet e nevojshme për institucionet përkatëse dhe të kërkojë edhe ndërhyrjen e Kuvendit përmes Platformës Ndërinstitucionale Online, të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë, e cila është në dispozicion të institucioneve të pavarura si një mjet i ri që synon rritjen e autoritetit të institucioneve të pavarura, si dhe përfshirjen e Kuvendit të Shqipërisë si katalizator ndërmjet institucioneve të pavarura dhe atyre qeveritare për zgjidhjen e problemeve.

Impakti
Problematika me pronësinë e kabinave elektrike ndikon në krijimin e defekteve të shumta për abonentët duke ndikuar në cilësinë e shërbimit. Abonentët shpesh herë mbeten pa energji elektrike dhe ankohen drejtëpërdrejtë tek OSSH. Gjithashtu për OSSH humbjet në rrjet janë të mëdha për shkak të amortizimit të madh të kabinave dhe kushteve jo të mira të mbajtjes së tyre. Ato gjithashtu shfaqin edhe rrezik për jetën e individëve pranë tyre. Që ato të kalojnë në pronësi të tyre duhet bërë blerje të prokurimeve publike gjë që është e vështirë për tu realizuar.

Rekomandimi
Realizuar me ndryshimet e ligjit 43/2015 ne vitin 2020 neni 71/1.

Komentet e Drejtimit
Realizuar me ndryshimet e ligjit 43/2015 ne vitin 2020 neni 71/1.

16

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2023

3. Sistemet informative dhe rreziku i sulmit kibernetik

Çështje
Gjatë vitit 2020, me miratimin nga ERE të strategjisë për infrastrukturat kritike në ektorin e energjisë elektrike, ajo duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë implementimit të kësaj strategjie në përputhje me direktivën e BE-së *"Për sigurinëe sistemit dhe sistemeve informatike".*

Impakti
Strategjitë e rregullores për sistemin informative dhe mbrojtjen ndaj sulmeve kibernetike do të sillnin parandalimin e humbjeve të të dhënave në kushtet e një sulmi kibernetik. Vetëm OST deri më tani ka dërguar rregulloren e përcaktuar për informatizimin e tyre. Mungesa e një specialist IT të trajnuar mbi sigurine e informacionit tek ERE do të sillte problematika në shqyrtimin e rregulloreve të sjella nga ana e shoqërive. Mungesa e raportimeve periodike nga ana e shoqërive tregon rrezikshmëri për rënien në kontakt të tyre me sulmet kibernetike sepse vëmëndje kushtuar ndaj tyre mund të jetë më e vogël.

Rekomandimi
Ne rekomandojmë ERE të ndërmarrë masat e nevojshme dhe të vazhdueshme për të marrë rregulloret nga ana e 3 shoqërive KESH sh.a., OST sh.a, dhe OSHEE sh.a duke vendosur theksin tek sistemi i parandalimit të vjedhjes dhe humbjes së të dhënave.

Komentet e Drejtimit
Në përputhje me Rregulloren për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike ERE ka marrë masa për përcjelljen e infomacioneve periodike nga ana e 3 shoqërive KESH sh.a., OST sh.a, dhe OSHEE sh.a për marrjen e masave nga këta të fundit në lidhje me implementimin e kësaj regulloreje. Po ashtu zhvillimi i takimeve të ndryshme me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike AKCESK për të vijuar bashkëpunimin lidhur me permirësimin e legjislacionit në fuqi dhe përfshirjen në të të infrastrukturave energjetike pasi siguria kibernetike me avancimet teknologjike në çdo proçes për rrjedhojë edhe ekspozimi ndaj rreziqeve është i madh. Po ashtu ERE duhet të parashikojë masa dhe parashikime në buxhet përgjatë vitit 2024 për rritjen e sigurise kibernetike të sistemeve në përdorim të ERE-s si dhe në vijim duhet të merren masa për akomodimin e strukturës IT që përfshin paisjet hardware dhe ambjentet e nevojeshme sipas kërkesave të akteve ligjore.

18

REKOMANDIME TE TJERA

- Transpozimi dhe zbatimi i rregullores CACM (Alokimi i Kapaciteteve dhe Menaxhimi i Konxhestioneve) sipas vendimit te Keshillit te ministrave te vendeve antare te Komunitetit te Energjise.
- Transpozimi i regullores te FCA, (foreëord capacity allocation)
- Berjen funksionale te sistemit rajonal te garancive te origjines

Lidhur me keto transpozime dhe miratime te akteve rregullatore qe lindin si detyrime nga pjesmarrja ne tregun vendas dhe rajonal te energjise eshte e nevojeshme qe ERE te kete konsulence te jashtme te specializuar ne keto fusha.

Shtojcë

Përgjegjësia e Drejtimit për Objektivat dhe Kufizimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm

Komentet e mëposhtme u referohen përgjegjësise së Drejtimit për sistemin e brendshëm të kontrolleve, ku objektivat dhe kufizimet e qënësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm janë marrë nga Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve.

Përgjegjesia e Drejtimit
Drejtimi është përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të kontrolleve të brendshme.Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, Drejtimi duhet të vlerësoje përfitimet dhe kostot e pritura përkatëse të politikave dhe procedurave për kontrollet e brendshme.

Objektivat
Objektivat e sistemit të kontrollit të brendshëm janë që të japin siguri drejtimi, sa më shumë të jetë emundur, që asetet të jenë të mbrojtura nga përdorimi i paautorizuar ose keqpërdorimi, dhe se transaksionet janë ekzekutuar në përputhje me politikat e drejtimit dhe të regjistrohen saktë, në mënyrë që të mundësohet përgatitja në kohë e informacionit të besueshëm financiar në përputhje me parimet e zbatueshme të kontabilitetit.

Kufizimet
Për shkak të kufizimeve të qënësishme në çdo sistem të kontrollit të brendshëm, gabimet apo parregullsitë, mund të ndodhin dhe të mbeten të pazbuluara. Gjithashtu, parashikimi i çdo vlerësimitë sistemit të kontrollit të brendshëm për periudhat e ardhshme është subjekt i rrezikut që politikat dhe procedurat mund të bëhen të papërshtatshme për shkak të ndryshimeve të kushteve ose efektiviteti i hartimit dhe i zbatimit të politikave dhe procedurave mund të përkeqësohet.

STUDIO
"VIAR - CONSULTING" sh.p.k
Adresa:Rr."L.Gurakuqi;Ndëtesa.18; H.4; K.6: Ap.21,
Tiranë ,Albania
T:04 56 28 875
Web: www.viar.al

Nexia AL
Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

RAPORT I SIGURISË SË PROFESIONISTIT TË PAVARUR

Drejtuar: Kryetarit dhe Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)

Enti Rregullator i Energjisë ("ERE" ose "Enti") angazhoi audituesit e pavarur Shoqërinë VIAR-Consulting shpk me Audituese Ligjore Znj. Fatime Alliu me Licensë Nr.166 dhe Shoqërinë Nexia AL shpk, me Audituese Ligjore Znj. Orjana Kalaja me Licensë Nr.284 (referuar më tej si "Audituesit"), për të shqyrtuar informacionin jo-financiar të paraqitur në Raportin Vjetor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 ("të dhëna të zgjedhura"), me qëllim dhënien e sigurisë së kufizuar sipas kritereve të përshkruara më poshtë (Qëllimi i punës). Për qëllimet e këtij raporti, të dhënat e zgjedhura kanë të bëjnë me veprimtarinë e Entit në Shqipëri dhe nuk përfshijnë informacione që kanë të bëjnë me palë të tjera bashkëpunuese ose aktivitete / performanca të palëve të treta.

Qëllimi i punës

Angazhimi i dhënies së sigurisë është planifikuar dhe kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar SNAS 3000, "Angazhimet e Dhënies së Sigurise ("SNAS 3000") që ndryshojnë nga Auditimet ose Rishikimet e Informacioneve Financiare Historike", me qëllim që të japim një opinion për dhënie sigurie të nivelit të kufizuar për:

- Verifikimin e informacioneve shpjeguese cilësore dhe sasiore të paraqitura në Raportin Vjetor 2023 në mënyrë specifike për gjendjen në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në krahasim me kriteret e zbatueshme ("Kriteret e Përformances", të ilustruara në Raportin Vjetor), mbështetur në Ligjin nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar.

STUDIO
"VIAR - CONSULTING" sh.p.k
Adresa:Rr."L.Gurakuqi;Ndëtesa.18; H.4; K.6: Ap.21,
Tiranë ,Albania
T:04 56 28 875
Web: www.viar.al

Nexia AL
Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

Përgjegjësitë e drejtimit

Drejtimi i të Entit Rregullator të Energjisë është përgjegjës për përgatitjen, prezantimin, tërësinë dhe saktësinë e të dhënave jofinanciare të dhëna për ne, siç paraqiten në Raportin Vjetor 2023. Për më tepër, drejtimi i ERE është përgjegjës për regjistrimet e mbajtura dhe kontrollet e brendshme të përshtatshme që janë krijuar për të mbështetur procesin e raportimit dhe të përputhshmerisë ligjore. Në mënyrë të veçantë, drejtimi është përgjegjës për hartimin e kontrolleve të brendshme dhe zbatimin e tyre për të parandaluar që Raporti të këtë anomali materiale.

Përgjegjësitë e Audituesve

Ne kemi kryer një shërbim dhënie sigurie të kufizuar. Përgjegjësia jonë është të shprehim konkluzionin tonë bazuar në procedurat e kryera, për të dhënat e zgjedhura, siç përshkruhet më sipër në seksionin "Qëllimi i punës".

Përgjegjësia jonë është e kufizuar në informacionin shpjegues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023, të prezantuara në Raportin Vjetor për vitin 2023.

Në masën që lejohet nga legjislacioni në fuqi, ne nuk pranojmë dhe nuk marrim asnjë përgjegjësi për angazhimin tonë, ndaj kujtdo tjetër përveç ERE, përveç rasteve kur është rënë dakord në mënyrë të shkruar, me pëlqimin tonë paraprak.

Ne kemi kryer punën tonë duke mbledhur gjithë të dhënat, dokumentacionin përkates, informacionin dhe shpjegimet qe ne i konsideruam të nevojshme për të dhënat e zgjedhura të përshkruara, në seksionin "Qëllimi i punës". Procedurat e ndjekura në lidhje me të dhënat e zgjedhura përfshijnë:

- Intervistat me drejtimin dhe personelin përgjegjës për informacionin dhe supozimet përkatese.
- Vizita në ambientet e Entit Rregullator të Energjisë.

- Rishikimit dhe vlerësimit të proceseve dhe kontrolleve të përdorura për mbledhjen, grumbullimin, vlerësimin dhe raportimin e të dhënave;
- Teste me zgjedhje mbi të dhënat e mbledhura dhe formulat, kur kërkohen.

Niveli i Dhënies së Sigurisë

Procedurat që kemi kryer janë hartuar për të ofruar siguri te kufizuar, sic specifikohet në SNAS 3000, mbi të cilat ne u bazuam për të arritur në konkluzione për angazhimin tonë. Këto procedura nuk jane aq të zgjeruara sa ato që kërkohen për dhënien e sigurisë së arsyeshme, për pasojë, merret një nivel më i ulet i sigurisë.

Kufizimet

Për të kryer punën tonë, ne u mbështetem ekskluzivisht në informacionin e dhënë nga drejtuesit e Drejtorive të Entit Rregullator të Energjisë, të cilin ne e pranuam me mirëbesim si informacion të plotë, të saktë, të vërtetë dhe jo mashtrues.

- Si rrjedhim, ne nuk kemi kryer procedura verifikimi shtesë, përveç procedurave të përcaktuara në mënyrë të qartë në Raportin tonë në seksionin, Përgjegjësitë e Audituesve, të cilat rrjedhin nga metodologjia e rënë dakort reciprokisht.
- Asnjë punë nuk është kryer për të dhënat të periudhave të raportimeve të mëparshme, si dhe mbi të dhënat në lidhje me objektivat dhe parashikimet.
- Asnje punë nuk është kryer për asgjë tjetër përveç qëllimit të rënë dakord dhe për rrjedhojë, konkluzioni ynë është i kufizuar për këtë qëllim.

Pavarësia

Audituesit zbatojnë kërkesat e Standardit Ndërkombetar për Menaxhimin e Cilesise nr.1 (SNMC nr. 1). Bazuar në këtë, mbajmë një sistem të menaxhimit të integruar të cilësisë që përfshin politikat dhe procedurat për respektimin e parimeve morale, standardeve profesionale dhe kërkesave përkatese ligjore dhe rregullatore. Ne jemi në përputhje me kerkesat e pavarësisë dhe

STUDIO
"VIAR - CONSULTING" sh.p.k
Adresa:Rr."L.Gurakuqi;Ndëtesa.18; H.4; K.6: Ap.21,
Tiranë ,Albania
T:04 56 28 875
Web: www.viar.al

Nexia AL
Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

standardet e tjera etike të Kodit Etikes së IFAC për profesionistët të Bordit të Standardeve Ndërkombetare të Etikes për Audituesit (IESBA), i cili bazohet në parimet themelore të integritetit, paanshmerisë, përshtatshmerisë profesionale, konfidencialitetit dhe sjelljes profesionale. Në këtë kontekst, ekipi Audituesve për dhënien e sigurisë është i pavarur nga Enti Rregullator të Energjise dhe nuk ka marrë pjesë në përgatitjen e Raportit Vjetor për vitin 2023.

Konkluzione

Bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e marrë, asgjë nuk na ka tërhequr vëmendjen tonë që të na bëjë të besojmë se ka ndonjë gabim ose anomali që do të ndikonte materialisht në dhënien e informacioneve rreth përputhsherisë ligjore të aktivitetit (përfshire shënimet shpjeguese dhe referencat përkatese) sic paraqiten në Raportin Vjetor të Entit Rregullator të Energjisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023. Për më tepër, asgje nuk ka tërhequr vëmendjen tonë që të bëjë të besojme se të dhënat e paraqitura, nuk janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përmendura më lart, në seksionin "Qëllimi i punës".

Nexia-AL sh.p.k
Orjana Kalaja

Auditues Ligjor
License Nr.284

Viar Consulting
Ilirjan Allia

Auditues Ligjor
License Nr.166

Tiranë, 29 mars 2024